



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA X - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 16 MARS 2023, TIRANË

PROCESVERBAL

SEANCËN E DREJTOJNË
KRYETARJA E KUVENDIT
LINDITA NIKOLLA
DHE NËNKRYETARJA
ERMONELA FELAJ
(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 2.3.2023 (neni 44, pika 2, i Rregullores)

- Njoftime (neni 44, pika 3, i Rregullores)

2. Interpelancë me Ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti nga deputetja Ina Zhupa (neni 80 i Kushtetutës dhe neni 97 i Rregullores së Kuvendit)

3. Raporti mbi zbatimin e vendimeve/rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, për vitin 2022 (Vendimi i Kuvendit nr.49/2017, datë 20.04.2017 “Për krijimin e

mekanizmit për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura” dhe Vendimi i Kuvendit nr.134/2018, datë 20.12.2018 “Për miratimin e manualit të monitorimit vjetor dhe periodik”)

4. Projektligji “Për bletarinë” (në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin European.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

5. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë””. Nisma 1, Nisma 2 (në mbështetje të neneve 78 e 81, pika 1 të

Kushtetutës, dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim. Nisma 1 dhe Nisma 2 të bashkuara, pasi kanë të njëjtin objekt)

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”” *(në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

(Bazuar në Vendimin nr. 66/2022 “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për hartimin e shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në Procesin e Integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian””, shprehen dy bashkëkryetarët e Komisionit)

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

7. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë” *(në mbështetje të neneve 100 dhe 121, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Sigurinë Kombëtare.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

8. Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit” *(në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës dhe neneve 55 dhe 73-77 të Rregullores, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

Pyetje

Shprehet nismëtari.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

9. Projektvendimi “Për zgjedhjen e një anëtarë të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare” *(në mbështetje të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, dhe nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

10. Projektvendimi “Mbi disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 11/2011 “Për miratimin e strukturës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunitetit në Shqipëri”” *(në mbështetje të nenit 19, pika 2, të ligjit nr. 10242, datë 25.02.2010 “Për Institutin e Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunitetit në Shqipëri”, i ndryshuar, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

11. Projektvendimi “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar” *(në mbështetje të nenit 12, pika 6, të ligjit nr. 45/2015 “Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të*

Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, shumicë e thjeshtë votash për miratim)

12. Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar *(në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

13. Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së Komisioneve të Përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar *(në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, shumicë e thjeshtë votash për miratim)*

14. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (60’).

Ermonela Felaj – Mirëdita, kolegë!

Në bazë të nenit 44 të Rregullores, do ta drejtoj unë këtë fillim të seancës plenare.

Duke parë që kuorumi është plotësuar, e deklaroj të hapur seancën plenare. Në bazë të nenit 30 të Rregullores, dëshiroj t’ju bëj me dije rendin e ditës të seancës së sotme plenare.

(Pasi lexon rendin e ditës)

Fillojmë me çështjet e rendit të ditës.

Më lejoni fillimisht të kaloj te procedura!

Kush është dakord me procesverbalin? A ka vërejtje dhe sugjerime për procesverbalin e seancës plenare paraardhëse?

Dakord, nëse nuk ka vërejtje, ky procesverbal miratohet. Besoj se kolegët janë njohur me përmbajtjen e procesverbalit.

Kalojmë te njoftimet.

Ju njoftoj se në Kuvend janë depozituar 7 akte nga Këshilli i Ministrave. Të gjitha këto çështje ju i keni në *e-mail*-et tuaja zyrtare, sepse shërbimet e Kuvendit janë kujdesur që t’ju njoftojnë paraprakisht.

Gjithashtu, dëshiroj t’ju njoftoj se sot në orën 9:00 u mblodh Konferenca e Kryetarëve, e cila ka miratuar me mirëkuptim pjesën më të madhe të kalendarit të punimeve të Kuvendit, për periudhën 20 mars – 7 prill 2023.

Ndërkohë, kemi një kërkesë nga ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin, e cila, në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve, u prezantua nga kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, që në kalendar të shtohet edhe projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 “Për medien audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

Dua të vë në dukje se ky projektligj është depozituar në Kuvend në datën 6 mars dhe nuk është parashikuar në programin e punimeve të Kuvendit, që është i periudhës 27 shkurt – 3 prill. Në fakt, ky projektligj vjen si kërkesë e BE-së, në kuadër të procesit *screening* dhe të takimeve bilaterale. Për këtë arsye është kërkuar që të miratohet sa më shpejt, duke nisur me përfshirjen e tij në këtë kalendar, për të cilin diskutuam në Konferencën e Kryetarëve. Kjo është pika për të cilën ne nuk patëm mirëkuptim, kështu që, në bazë të Rregullores së Kuvendit, unë jam e

detyruar t'i kërkoj Kuvendit të vendosë për kalendarin e punimeve të Kuvendit.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Pikërisht, për arsyen që citova, kërkoja që të përfshihet në kalendar. Është një kërkesë e BE-së për ta përfshirë në kalendar dhe nuk është një gjë e re në traditën e punës së këtij Kuvendi dhe në praktikën tonë parlamentare që, për ligje që lidhen me procesin e integritimit evropian, të kemi një rrugë më të shpejtë të diskutimit dhe të shqyrtimit të tyre. Pra, kërkohet përfshirja në kalendar, se, sigurisht, ligji do të marrë kohën e nevojshme për diskutim në komisionet parlamentare.

Kush është dakord me kalendarin, me këtë shtesë? Kundër? 1 kundër. Abstenime?

Zoti Lefter, nuk e kishit për këtë?

Ju lutem, kini pak durim, se do të vijmë edhe të procedura!

Pasi lexuam çështjet e rendit të ditës dhe njoftimet, dëshiroj t'ju bëj me dije se ka një kërkesë nga bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm Parlamentar për hartimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në ligjin nr. 15, datë 05.03.2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian", që në rendin e ditës të bëhet një ndryshim në renditje dhe ky projektligj të diskutohet menjëherë pas interpelancës të kërkuar nga kolegja, zonja Zhupa. Pra, e theksoj që ka pasur mirëkuptim nga të dy bashkëkryetarët e komisionit, kështu që do të vijojmë në këtë mënyrë.

Po ashtu, ministrja e Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin ka kërkuar që të mos diskutohet në rendin e ditës së sotme raporti "Për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të Institucioneve të Pavarura Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj" për vitin 2022. Pra është kërkuar të diskutohet në një seancë tjetër.

Kush është dakord?

Faleminderit!

E kanë kërkuar fjalën për procedurë disa kolegë.

Zonja Zhupa, keni fjalën.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Siç e dini, ne vijmë pas një "Jave të gjelbër", java e takimeve me qytetarët për çështjet e zgjedhësve dhe, sipas Rregullores së Kuvendit, pikës 40/1, Kuvendi është i detyruar që, pas zhvillimit të "Javës së gjelbër", të ketë një seancë të dedikuar për çështjet e zgjedhësve. Në

Rregulloren e Kuvendit sqarohet se sa kohë zgjat (rreth 4 orë) kjo seancë e dedikuar dhe se si ndahet koha për grupet parlamentare. Është seancë shumë e rëndësishme, sepse flitet për problemet dhe për hallet e qytetarëve të zonave që ne përfaqësojmë, dhe të mos nxjerrim përherë edhe problemet e qytetarëve kur flasim këtu për çështjet e rendit të ditës, sepse ka një seancë të dedikuar për këtë çështje. Heqja në mënyrë arbitrare e kësaj çështjeje nga Kryetarja e Kuvendit, duke na thënë se disa deputetë kanë kërkuar të mos bëhet seanca, është shkelje flagrante e Rregullores dhe heqje e të drejtave të Kuvendit.

E para, zonja Kryetare e Kuvendit nuk na ka vënë në dispozicion asnjë kërkesë nga deputetë të caktuar, me shkrim dhe të protokolluar, dhe arsyet që kishin. Një SMS e ardhur nga kryetari i grupit, apo nga kushdo tjetër në celularin privat të Lindita Nikollës, nuk përbën arsye të mjaftueshme për të anuluar një seancë ku do të flitet për çështjet e zgjedhësve. Këtu nuk është anuluar asnjëherë asgjë, kur bëhej fjalë për të dhënë me koncesion Butrintin, portin e Durrësit dhe për të vjedhur fondet e shqiptarëve, përkundrazi, siç bëtë edhe sot, i keni futur me procedura të përshpejtuara, dhe kur duhet të flitet për hallet e qytetarëve, anulohen seancat dhe nuk jepet asnjë shpjegim.

Kërkesa ime procedurale është: meqë keni shkelur Rregulloren dhe nuk na latë të flisim për hallet e qytetarëve dhe për problematikat e zonave, të caktohet seanca plenare të hënën tjetër për çështjet e zgjedhësve, seancë e cila duhej të ishte zhvilluar këtë të hënë që kaloi. Është një detyrim që nuk jua kërkojmë si favor, se na e jep Rregullorja e Kuvendit. Besoj se edhe kolegët socialistë mund të kenë ndonjë hall të qytetarëve, se mbase nuk i kanë zgjidhur të gjitha; jetojnë në një realitet virtual me aplikacionin "Aktivist" dhe nuk e njohin realitetin.

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Kërkesa juaj, sa i takon vërejtjes për mosmbajtjen e seancës ditën e hënë, u trajtua edhe në Konferencën e Kryetarëve dhe, në fakt, kolegët deputetë të të gjitha krahëve janë njoftuar rregullisht nga shërbimet e Kuvendit se nuk do të mbahej seanca e pritur ditën e hënë. Arsyet kanë qenë ato që ju i përmendët në fjalën tuaj. Po kështu ka pasur mungesa të kolegëve, të cilët kanë

qenë në një delegacion jashtë vendit dhe për rrjedhojë nuk plotësohej as kuorumi për fillimin e seancës parlamentare ditën e hënë. Kjo ka qenë arsyeja që nuk është mbajtur seanca parlamentare ditën e hënë.

Ndërkohë që kërkesa juaj e dytë, për të mbajtur një seancë, nuk është një kërkesë procedurale, sepse Rregullorja e sqaron shumë qartë se si mblidhet Kuvendi i Shqipërisë dhe me kërkesë të kujt, kështu që nuk jemi në kushtet për të marrë një vendim për kërkesën tuaj.

Zonja Açka, keni fjalën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, ju dëgjova, shqetësimi ka qenë i drejtë, por, nga ana tjetër nuk është fshehur asgjë apo asnjë arsye që, në fakt, nuk dihej nga kolegët deputetë.

Po, zonja Açka.

Zonja Zhupa, a mund ta lejoni zonjën Açka të flasë?

Flutura Açka – Faleminderit, zonja Felaj!

Është një çështje që doja ta ngrija në Konferencën e Kryetarëve, por meqë keni vendosur t'i bëni nëpër furriqe, unë pëlqej më shumë gjëra transparente, nuk kam qejf të rri nëpër rrëza, ndaj do ta ngre për të gjithë kolegët e mi dhe për shqiptarët.

Ditën e hënë, në datën 13, flas për këtë të hënë, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik organizoi një seancë dëgjimore me grupet e interesit për të diskutuar për projektligjin “Për ndërgjegjësimin, kujtesën kolektive, ekspozimin dhe ndëshkimin publik të regjimit totalitar komunist”, që ishte propozimi i një grupi deputetësh të PD-së. Aty ishin të ftuar mbi 12 institucione, duke përfshirë edhe institucionet shtetërore që paguhen nga taksat e shqiptarëve dhe shumë organizata që lidhen me të drejtat e ish-të përndjekurve politikë. Kjo do të thotë se ishte diçka për t'u debatuar publikisht, sepse është me interes publik. Çfarë ndodhi, në fakt? Në syrin tim ka qenë një nga përvojat më të shëmtuara, perfide, të turpshme të këtij parlamenti, një censurë e hapur ndaj këtij komisioni dhe të them të drejtën, me të njëjtën egërsi e kanë mbajtur këtë popull nën dhunë për 47 vjet.

Çuditërisht, fiks në orën 11:30 audioja dhe videoja e asaj konference, e asaj sale të madhe ku sot do të bëni retorikë politike me komisionerin europian, nuk punonte, dhe i gjithë grupi prej 30

vetash u detyrua të shkonte në sallën ngjitur, por çuditërisht, edhe në atë sallë, nuk punonte as audioja, as videoja, pikërisht në atë sallë ku dje keni justifikuar një korrupsion të thellë shtetëror, ju, me drejtimin tuaj.

Pra, është e qartë që diçka e shëmtuar ka ndodhur në prapaskenë, pavarësisht se u justifikua me faktin që ka pasur defekt teknik. Nuk ka pasur asnjë defekt teknik, madje do të thosha që keni keqpërdorur nëpunësit e këtij parlamenti, duke i detyruar, në mënyrë të dhunshme, të mbyllnin audion dhe videon e asaj dëgjese shumë të rëndësishme. Ajo nuk është lutje, që të merrni pjesë dhe ta votoni, por është detyrim publik që ju të hapni videon dhe audion për shqiptarët, kur është fjala për një çështje dhe për një nga pikat më të rëndësishme për integrimin e Shqipërisë në BE, ajo e dekomunistizimit. Po ju them sinqerisht, se një shije të keqe më kanë lënë edhe disa nga kolegët e mi që u bënë dorëzanë...

(Bie gongu)

Më lini ta mbaroj! Kam hequr dorë nga fjala sot, se dua ta mbaroj atë që dua të them!

Më vjen keq që disa kolegë të mi u bënë dorëzanë të kësaj censure të hapur! Sigurisht, ju, ndryshe nga ata të 47 vjetëve, nuk hiqni thonj, nuk u vini vezë të ziera nën sqetull shqiptarëve, nuk i lidhni nëpër biruca, nuk i vini para togave të ekzekutimit, por duke qenë bastardë të tyre...

Ermonela Felaj – Ju mbaroi koha, zonja Açka.

Flutura Açka – Ta mbaroj, të lutem!

Ermonela Felaj – Jo, nuk mund ta mbaroni, se po merrni kohën e planifikuar për procedurë!

Flutura Açka – Është çështje shumë e rëndësishme, zonjë. Unë kam hequr dorë nga fjala...

Ermonela Felaj – Zonjë, ju mund të konsideroni të rëndësishme gjithçka, por unë do të konsideroj atë që thotë Rregullorja.

Flutura Açka – Zonjë, dikush duhet të më kërkojë falje në këtë parlament.

Ermonela Felaj – I lutem teknikës t'ia heqë fjalën zonjës Açka!

Ju kujtoj edhe një herë që ndërhyrjet për procedurë bëhen shkurtimisht dhe pa prekur thelbin e çështjes. Për sa u fol, është ngritur si problematikë në Konferencën e Kryetarëve, ndaj ju ftoj t'i shmangni nga fjalori juaj disa shprehje që cilësojnë Kuvendin e Shqipërisë, duke i konsideruar mjediset e Kuvendit si furriqe. Unë

nuk e di ku e gjeni kurajën të etiketoni si furriqe ambientet dhe sallat ku Kuvendi i Shqipërisë është mbledhur historikisht! Sapo thatë: “Ju mbledheni nëpër furriqe”. Jo, zonjë, ne jemi mbledhur në Kuvendin e Shqipërisë. Ne po qëndrojmë në sallën e Kuvendit të Shqipërisë dhe ju, si kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik kishit detyrimin të ishit në Konferencën e Kryetarëve dhe ta ngrinit atje këtë problem, t’ia bënit me dije Kryetares dhe të merreshin masat përkatëse. Seanca plenare nuk ka të bëjë fare se si shërbimet e Kuvendit e kryejnë punën e tyre. Kjo është e vërteta dhe ky është qëndrimi për këtë çështje.

Ju lutem, kolegë a keni gjë për çështjen e rendit të ditës? Të mos bëhemi abuzivë me rendin e ditës.

Zonja Çupi, ju kujtoj që nëse nuk keni gjë për të thënë për procedurë, do t’jua ndërpres fjalën.

Flutura Aça – Është e vetmja gjë që mund të bësh.

Dhurata Çupi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës, që më dhatë fjalën, si dhe për parashtrimin që bëtet! Shumë herë e keni ndërprerë fjalën. Kështu që, nuk është ndonjë gjë e re.

Unë kërkoj të jemi të gjithë bashkë për të ndryshuar rendin e ditës, duke shtuar një kohë të caktuar për një debat lidhur me një ngjarje shumë të rëndë që ka tronditur opinionin shqiptar: burgosja e një nëne 27-vjeçare dhe ndarja e saj në mënyrë të dhunshme nga foshnja 7-ditëshe. Kjo është një ngjarje e rëndë, e dhimbshme, dëshpëruese dhe e trishtuar. Opinioni shqiptar është habitur se si mund të thyhet kaq rëndë Kodi Penal, i cili, në nenin 34 të tij, e përcakton qartë rastin e burgosjes së një nëne që ka një foshnje më të vogël se një vjeç. Kështu që, ne duhet të zhvillojmë këtu një seancë debati, ku ministri i Drejtësisë dhe ministri i Brendshëm të informojnë opinionin publik për këtë ngjarje. Sot krimi është rrugëve, të korruptuarit janë rrugëve, kriminelët, vrasësit dhe përdhunuesit janë rrugëve, ndërkohë që kapet dhe burgoset një nënë, duke e ndarë atë në mënyrë të dhimbshme nga foshnja 7-ditëshe. Ndaj, nuk mund të fillojë asnjë seancë tjetër para një debati të tillë, sepse është një çështje shumë sensitive dhe ne duhet t’i informojmë qytetarët shqiptarë në lidhje me një padrejtësi. Janë të padrejtë dhe të padhembshur me njerëzit e

thjeshtë, ndërkohë që krimi është rrugëve. Ndaj këtu duhet të ketë një debat të fortë, ku institucionet shtetërore duhet të japin informacion për këtë ngjarje. Ka struktura monitorimi për këtë çështje. Ministria e Drejtësisë duhet të japë llogari. Ministria e Brendshme merret me ekzekutimin e këtij vendimi, që, e ripërsëris, është në shkelje të plotë të dispozitave të Kodit Penal.

Zonja drejtuese e seancës, para disa ditësh u festua 8 Marsi këtu dhe nuk ngeli asnjë qeveritar pa nxjerrë statuse me foto, ndoshta të rreme, për të marrë *like* dhe mbështetje, kurse sot nuk ka asnjë reagim nga asnjë qeveritar. Kështu duhet të fillonte sot seanca plenare, pra me një reagim nga institucionet qeveritare.

Unë besoj se isha brenda procedurës dhe rendit të ditës, zonja drejtuese e seancës.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çupi!

Për këtë kërkesë procedurale e ka kërkuar fjalën zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Edhe ne, përfaqësuesit e mazhorancës, jemi dakord për ta dënuar një ngjarje të tillë dhe është e qartë që ka të bëjë me moszbatimin e legjislacionit përkatës në fuqi, për pezullimin e vendimeve në rastet si ky që u paraqit, i cili parashikon qartësisht që një nënë, në kushtet në të cilat ndodhet, pra një nënë lehonë, nuk mund të mbahet me dënim me burg, por duhet të pezullohet ekzekutimi i vendimit.

Se ku ka çaluar kjo çështje, u takon organeve të drejtësisë dhe nuk është rasti për të bërë një debat politik në sallën e Kuvendit, por ne jemi në të njëjtën mendje me të gjithë, vuajmë njësoj si ju, që këto ngjarje, edhe pse sporadike, nuk duhet të ekzistojnë. Thënë këtë, të gjitha ne, gratë deputete të PS-së u mblodhëm dje...

Ermonela Felaj – Ju lutem, a mund të mbani qetësi? Siç dëgjuam kolegen e krahut tuaj, të dëgjojmë edhe kolegen Bushka!

Klotilda Bushka –...dhe diskutuam për çfarë thuhet në legjislacion, se deri ku shkon kompetenca e Kuvendit për të vepruar në këto raste dhe, siç kemi vepruar gjithmonë, ne do ndjekim anën procedurale, sipas kompetencave që kemi për të kërkuar informacion dhe për t’i nxitur organet përkatëse të përdorin të gjithë mekanizmat, që raste të tilla të mos përsëriten dhe që rasti i nënës lehonë të zgjidhet sa më shpejt,

sipas mekanizmave ligjorë që ka sot sistemi gjyqësor.

Thënë këtë, nuk është hera e parë që ne duhet të veprojmë dhe të jemi të kujdesshëm, siç kemi vepruar edhe më parë.

Dua t'ju vë në dijeni të gjithëve se marsi nisi i përgjakur, muaji i grave nisi me vrasjen e tri grave dhe me plagosjen e tri të tjerave. Komisioni i Ligjeve, dhe për këtë jam koordinuar me shumicën e kolegëve në këtë sallë, ka bërë kërkesa në institucionet përkatëse për të kuptuar se si ka funksionuar i gjithë zinxhiri. Për sa kohë ligjet ekzistojnë, ku çalon zbatimin i tyre? Në kuadër të kompetencës sonë monitoruese kemi kërkuar informacion dhe kanë ardhur përgjigjet e para, të cilat u janë shpërndarë anëtarëve të Komisionit të Ligjeve dhe do t'u shpërndahen të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Sigurisht që ne do të vijojmë ta bëjmë këtë analizë dhe të marrim masat tona përkatëse se çfarë duhet të bëjmë më mirë, nisur dhe nga ajo që them gjithmonë, që ta kërkojmë llogarinë fillimisht te vetja. Të gjithë kemi rol dhe punë për të bërë në këtë drejtim.

Edhe ne bashkohemi me shqetësimin që një nënë lehonë është dënuar dhe një fëmijë i sapolindur nuk ka kujdesin e nënës së tij, por do të duhet të veprojmë sipas kompetencave tona dhe të bëjmë gjithçka që na takon si Kuvend, pa e kthyer në një debat politik.

Meqë është rasti, unë do t'u bëja thirrje organeve të drejtësisë që, në përputhje me të gjithë mekanizmat ligjorë që kanë, të përshpejtojnë shqyrtimin e çështjes në fjalë apo të kenë kujdes në shqyrtimin e çështjeve të tilla, duke mbajtur në konsideratë, si unë, ashtu dhe të gjithë kolegët e tjerë, respektimin e parimit të balancimit dhe ndarjes së pushteteve dhe mosndërhyrjen në drejtësi. Sigurisht, fenomene të tilla që shqetësojnë shoqërinë, nuk mund të na lënë në mënjane dhe të pandjeshëm për të thënë fjalën tonë, për aq sa na takon si Kuvend i Shqipërisë.

Unë e përgëzoj zonjën Çupi, që e ngriti këtë çështje!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Bushka!

Koha ka mbaruar.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti Spaho, ju tërheq vëmendjen për këto skena që bëni në Kuvendin e Shqipërisë, duke iu drejtuar njerëzve me gisht!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

T'ju vijë turp juve për mënyrën si reagoni! Ju tërheq vëmendjen që ndërhyini në këtë mënyrë, duke fyer kolegët!

Kolegë, a jeni dakord që të merret informacion më parë për këtë çështje nëpërmjet Komisionit të Ligjeve? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Faleminderit, zonja Bushka!

Nuk kam asnjë dyshim që, nëpërmjet Komisionit të Ligjeve, do të merret sa më parë informacioni i kërkuar për të qartësuar rrethanat e çështjes dhe pastaj do të vendosim nëse është rasti për të bërë një debat parlamentar apo jo.

Zoti Gështenja ka kërkuar fjalën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, u mor vendimi për këtë çështje të procedurës! Rregullorja është e qartë: dëgjohej folësi pro dhe folësi kundër. Në fakt, nuk pati kundërshtim për kërkesën tuaj, por propozimi juaj u parapri nga një propozim tjetër, i cili është më i logjikshëm dhe unë e hodha në votim.

Zonja Çupi, jini më e kujdesshme që të ndiqni seancën dhe atë që thotë drejtuesja e seancës!

Ia kam dhënë fjalën zotit Gështenja. Ju lutem, ta respektojme!

Lefter Gështenja – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Në fakt, e kërkoja fjalën për procedurë për kalendarin, që ju sapo e miratuat.

Para më shumë se 3 muajsh kam depozituar në Kuvend, siç e kërkon rregulli, një projektligj për ndryshime në statusin e nëpunësit civil, me të vetmin qëllim: për të shpëtuar administratën publike nga kthetrat e kësaj mazhorance, nga përdorimi që po i bëhet administratës publike sot në të gjitha nivelet, qendrore dhe vendore, nga drejtuesit e pushtetit. Mjafton t'ju tregoj aplikacionin që ju, PS-ja, partia-shtet, keni vendosur në administratën shtetërore...

Ermonela Felaj – Zoti Gështenja, a mund të flisni për procedurë dhe t'i evitoni komentet e tjera? Cila është kërkesa juaj procedurale?

Lefter Gështenja – Çështja është se ka më shumë se 3 muaj që ky projektligj i depozituar në parlament, nuk është përfshirë në kalendar. A ka ndonjë arsye, ndonjë shkak? Ndërkohë që nga kjo mazhorancë, në shkelje të rregullit, futen në këtë kalendar projektligje që nuk kanë mbushur akoma dy javë. Projektligji që citova, ka më shumë se 3

muaj. Qëllimi është një: të shpëtojmë përdorimin e administratës publike nga kthetrat e kësaj mazhorance. Mjafton të shohësh se si postimet e Kryeministrit, të ministrave dhe drejtuesve të qarqeve bëhen *share* brenda 5 minutave nga administrata publike. Ky është përdorim i turpshëm i partisë-shtet. Ndaj do të kërkoja përfshirjen sa më parë të këtij projektligji në kalendarin e punimeve të këtij Kuvendi.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Njoftohem nga shërbimet që projektligji i propozuar nga ju është përfshirë në kalendar, ndërkohë që vendimi i Konferencës së Kryetarëve, që në fillim të sesionit parlamentar, ka qenë që të gjitha nismat e deputetëve, të cilat kishin ngelur pa u shqyrtuar, të trajtohen këtu. Nga ajo që ne diskutuam në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve sot, u bë me dije se shqyrtimi i këtyre nismave ka filluar. Unë gjykoj se do të ishte më e dobishme që shqetësimin tuaj ta ngrinin në grupin tuaj parlamentar, sepse jeni të përfaqësuar në Konferencën e Kryetarëve, dhe më pas në komisionin përkatës. Ju siguroj se të gjitha projektligjet, iniciativat e deputetëve, edhe të opozitës, kanë filluar të trajtohen në komisionet parlamentare; dikush ka ecur më përpara në procesin legjislativ, dikush është më mbrapa, por nuk ka asnjë vullnet për t'i lënë pa u trajtuar.

Kjo është e vërteta, zoti Gështenja, dhe më vjen keq që e bëni objekt debati!

Po, zonja Vokshi.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Unë do të doja t'i kthehesha përsëri ngjarjes që ngriti zonja Çupi, për të cilën ju bëtë një votim. Unë nuk e di pse e bëtë, sepse nuk ishin shteruar diskutimet për procedurë për atë çështje. Nuk është sporadike, dhe është e rëndë të thuash se është një ngjarje sporadike dhe ne do të presim derisa Komisioni i Ligjeve të marrë informacionin e duhur! Pse, ka nevojë që të reagojmë ne, si Kuvend, si parlament, që sot ta kishim çështjen e parë të rendit të ditës?!

Po e nis nga ngjarja e fundit, madje ministrja Spiropali duhet të ishte çuar e para dhe të kishte kërkuar që të diskutohej në këtë seancë për nënën lehonë, e cila ka lënë fëmijën 7-ditëshe, dhe jo vetëm kaq, por e ka lënë (dramë pas drame) me dy gjyshër të cilët nuk kujdesen dot. Jua them unë informacionin, se asnjëra prej jush nuk ka shkuar për të parë se në çfarë gjendjeje është familja. Një

mbesë 11 vjeçe ka lënë shkollën për t'u kujdesur për foshnjën.

Ermonela Felaj – Zonja Vokshi, cila është çështja procedurale?

Albana Vokshi – Më lër të flas, se e kam për procedurë!

Ermonela Felaj – Nuk mund të vazhdoni gjithë ditën me komente këtu, ku secili përpiqet të tregojë dhembshuri më shumë për rastin, pa e njohur fare ligjin!

Albana Vokshi – Ju duhet të kishit folur e para!

Ermonela Felaj – Cila është kërkesa juaj procedurale, zonjë? Se për këtë pikë u kërkuar debat, i cili nuk u kundërshtua, por u kërkuar të merrej informacion.

Albana Vokshi – A ka mundësi të mos më ndërprisni?

Ermonela Felaj – Ju lutem, kaloni te kërkesa! Cila është kërkesa juaj e re dhe e ndryshme nga kjo?

Albana Vokshi – Zonja Lindita Nikolla, Kryetarja e Kuvendit, ka sjellë një amendim të ligjit për dhunën në familje. Ai ligj duhet të ishte diskutuar dhe duhet të futeshin të gjitha ndryshimet ligjore për t'i mbrojtur gratë, sepse në ligjin që ka sjellë flitet vetëm për një komisionar, por nuk merret asnjë masë. Pse ndodh dhuna në familje? Sepse ne kemi një Kryeministër verbalisht të dhunshëm...

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Nuk keni kërkesë procedurale.

Për çështjen në fjalë, Kuvendi do të marrë informacionin që i nevojitet dhe në bazë të tij do të vendosë për veprimin që do të ndërmarrë.

Kush ka probleme për çështje të tjera të rendit të ditës?

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

E kemi thënë me dhjetëra herë që nuk mund të abuzohet me fjalën në emër të procedurës. Nëse nuk dini të bëni opozitë ndryshe, ky është problemi juaj, por të bëni opozitë me çështje të procedurës është krejt e pavend.

Është e qartë që nuk ka probleme me rendin e ditës, nuk ka probleme me procesverbalin, as me kalendarin dhe as me çështjet që u diskutuan. Kështu që fillojmë me rendin e ditës.

Fillojmë me interpelancën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, ju lutem, nuk do të ketë më çështje të tilla, sepse qartësisht po abuzohet!

Vazhdojmë me interpelancën.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, se Kuvendi vendosi me votim të mos bëjë debat për këtë çështje! U lutem kolegëve të ulen!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

E vendosi Kuvendi me votim, zonjë, para pak minutash.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Patjetër që e hodha në votim dhe gjithçka është e filmuar dhe e regjistruar rregullisht. Unë nuk mbaj përgjegjësi, nëse ju jeni apo jo të vëmendshëm për çfarë ndodh dhe për çfarë nuk ndodh në seancë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zonja Spiropali, keni 2 minuta kohë për replikë.

Elisa Spiropali – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Së pari dhe, mbi të gjitha, me forcë dua të them këtu në Kuvend, ashtu siç kam deklaruar dje (nuk prita ditën e Kuvendit për të bërë politikë, por reagoja dje për këtë çështje), që Diana Bahçja duhet liruar menjëherë. Gjykatësi që ka marrë kërkesën duhet ta lirojë sot, jo nesër, e para. Unë nuk e kuptoj se cili prokuror, cila prokurori, cili gjykatës apo cila gjykatë arreston, kërkon ndërrimin e gjobës me burgim për një nënë lehonë?! Këtë nuk e kuptoj, dhe nuk e kupton asnjë nga ne.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

E dyta, duhet që institucionet si Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, por edhe Këshilli i Lartë i Gjyqësorit të përshpejtojnë procedurat dhe të bëjnë të mundur që ajo grua të dalë nga burgu dhe të shkojë pranë fëmijës së saj. Këtu fillon dhe mbaron gjithçka. Nuk e kemi lënë këtë gjë për në seancë, për të bërë politikë. Unë kam folur me avokatin e gruas dhe jam në komunikim të vazhdueshëm me të. Kjo kërkesë është bërë. Gjykatësi duhet ta lirojë dhe më pas institucionet e reja të drejtësisë duhet të bëjnë një analizë për padrejtësitë sistemike, jo vetëm për rastin. Është e qartë se gratë dënohen më shumë, mbahen më gjatë në burg, ndërkohë që burrat, të cilët mund të jenë edhe të dhunshëm, mund të ushtrojnë dhunë dhe mund t'ua marrin jetën grave, dalin nga burgu apo për ta merret masë më e lehtë sigurie.

Kjo padrejtësi sistemike duhet të adresohet dhe nuk adresohet me propagandë por me ligje, me kontroll parlamentar nga komisioni dhe nga

parlamenti, si dhe me ndërgjegje të atyre prokurorëve dhe gjykatësve, që mbi të gjithë duhet të kenë dijen...

(Ministres Spiropali i ndërpritet fjala, pasi i ka mbaruar koha në dispozicion.)

Ermonela Felaj – Zonja Ministre, faleminderit, ka mbaruar koha për replikë!

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Zoti Spaho, nuk jua përmendi askush emrin, përkundrazi, në mënyrë krejt brutale, keni që nga fillimi i seancës që u ndërhyri kolegëve gjatë fjalës. Nuk mund të silleni kështu në Kuvendin e Shqipërisë.

Po, zoti Shehu.

Edmond Spaho – Më jepni fjalën për replikë ose për procedurë.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Shehu ka kërkuar fjalën për procedurë dhe shpresoj që fjala e tij të dëgjohet.

Tritan Shehu – Faleminderit!

Të nderuar kolegë,

Shkeljet e rënda të procedurës dhe të Rregullores këtu në parlamentin tonë po bëhen shkak edhe për dëmtimet politike dhe rajonale të çështjes kombëtare shqiptare.

Zonja drejtuese e seancës,

Deputetët kanë sjellë dhe vazhdojnë të sjellin materiale, propozime, kërkesa për diskutime, mocione me debate në parlamentin shqiptar, të cilat lidhen me çështje thelbësore kardinale të historisë shqiptare, me pasoja direkte në proceset që po ndodhin tashmë në Ballkanin tonë dhe në marrëdhëniet ndëretnike në Ballkan.

Ne kemi sjellë prej muajsh këtu një kërkesë brenda çdo standardi të Rregullores, brenda çdo standardi të procedurës së parlamentit, brenda çdo të drejte që ka deputeti dhe grupet e deputetëve për të diskutuar për një mocion me debat për gjenocidin serb në Kosovë dhe për konkluzionet përkatëse. Jemi në një moment historik në rajon, jemi në një moment kur po arrihen marrëveshje të mëdha dhe, pa dyshim, kujtimi i historisë, vënia e gishtit mbi kriminelët, vënia e gishtit mbi krimet do të shërbejnë që këto marrëveshje të ndërtohen në funksion të paqes, të bashkëjetesës rajonale dhe të të ardhmes së përbashkët europiane të rajonit tonë.

Pa dyshim, do të shërbejnë për të hequr mjegullat dhe shpifjet që hidhen mbi ata që luftuan për liri në Kosovë, mbi ata që u vranë, që

u martirizuan nga një gjenocid i pashembullt që u realizua mbi ta. Ndërsa, parlamenti shqiptar në këto momente eviton të diskutojë lidhur me një debat të tillë. Unë e kuptoj që dikur pengonte “Ballkani i Hapur”, por tashmë që Ballkani i Hapur “u varros” (nuk i ka mbetur, do të thosha, veçse një litar mbi varr) nuk keni pse t’i nxitoni ju edhe të tjerët; për hir të asaj nisme serbe kërkonit të mohoni faktet e mëdha historike, kërkonit të mos lejohej të diskutohej për ato krime. Ne duhet t’i kujtojmë, për të mos u përsëritur më.

Prandaj, unë kërkoj, siç është Rregullorja dhe procedura e parlamentit, së paku të hidhet për diskutim këtu, me mendimet pro dhe kundër, për të hapur debatin dhe atëherë votojeni si të doni. Po të doni edhe mund ta mbyllni debatin, por kërkesën nuk mund ta fusni në disa sirtarë dhe sot, pas kaq muajsh, nuk guxonit ta sillni në parlament, qoftë edhe për të marrë një vendim parlamenti. Turp!

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Zoti Spaho, për procedurë.

Edmond Spaho – Zonja drejtuese e seancës,

Unë nuk dua të bëj fare debat për atë çështje, por habitem kur e pranoni që është shkelur ligji dhe kërkon që të mblidhen të dhëna. Çfarë të dhënash do të mblidhen?! Ky ministri i Brendshëm dhe policët e tij, si dhe ky ministri i Drejtësisë që zgërdhiet sot, nuk duhet të rrinë këtu, por duhet të shkojnë dhe ta lirojnë atë grua. Pse? Sepse ligji thotë që nuk mund të arrestohet një nënë, e cila ka fëmijën nën 1 vjeç. Nuk ka këtu çfarë të diskutosh më tepër. Ministri i Brendshëm që e ka arrestuar, bashkë me ministrin e Drejtësisë, i cili bën drejtësi këtu, duhet të shkojnë dhe ta lirojnë me urgjencë. Kjo nuk është as çështje gjyqarësh, as çështje prokurorësh, as çështje që të mblidhen strukturat e Kuvendit, por me urgjencë duhet ta lirojnë, sepse i kanë vënë prangat në kundërshtim me ligjin...

(Deputetit Edmond Spaho i ndërpritet fjala.)

Ermonela Felaj – Zoti Spaho, po ju ndërpres fjalën sepse për këtë çështje, pavarësisht se nuk është sipas pëlqimit tuaj, por Kuvendi i Shqipërisë vendosi.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Zoti Spaho, ju lutem, uluni!

Uluni, sepse Kuvendi vendosi për këtë çështje, ndaj nuk mund të merren dhe të trajtohen këto çështje sipas dëshirës së secilit.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, lironi foltoren!

Zoti Spaho, ju lutem, lironi foltoren!

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Nuk do ta marrë fjalën as ministri i Drejtësisë dhe askush tjetër, në një kohë që Kuvendi e mori vendimin për këtë çështje.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Kuvendi e mori vendimin dhe për zhvillimin e seancës vendos Kuvendi.

Do të fillojmë me interpelancën e kërkuar nga zonja Ina Zhupa me ministren e Kulturës, zonjën Elva Margariti.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Jo, sepse Kuvendi vendosi.

Interpelanca kërkohet bazuar në nenin 96 të Rregullores së Kuvendit dhe ka për objekt çështjen si vijon: “Dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve lidhur me gjendjen aktuale, ruajtjen, mbrojtjen, vlerësimin, mirëmbajtjen dhe restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturore në Tiranë dhe në Durrës”.

Fillojmë interpelancën, duke respektuar minutazhin e përcaktuar në nenin 96 të Rregullores.

Fjalën e ka zonja Zhupa, për të parashtruar interpelancën.

Zonja Zhupa, keni 7 minuta kohë në dispozicion.

Ju lutem, afrohuni!

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

I diskutuam të gjitha çështjet e procedurës.

Ju lutem, kolegë, mësoni të respektoni Rregulloren pa krijuar vështirësi në punimet e Kuvendit të Shqipërisë.

Zonja Zhupa e ka fjalën.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, nëse keni një shqetësim të tillë drejttojuni Sekretariatit për Procedurat, Votimet dhe Etikën, që të marrë masën disiplinore përkatëse. Unë, tërheqjen e vëmendjes e bëra sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

Ju lutem, të futemi në çështjet e rendit të ditës!

Në qoftë se keni kaq merak të flisni për tema që nuk lidhen me rendin e ditës, mblidhemi dhe e ndryshojmë Rregulloren dhe diskutimet jashtë rendit të ditës i vendosim si pikë e parë të rendit

të ditës, siç ka qenë dikur, dhe në një orë i ezaurojmë të gjitha shqetësimet që keni, por nuk mund të pengohet zhvillimi seancës sepse dikujt këtu i teket të flasë për një çështje të caktuar, kur ndërkohë nuk zotërohet asnjë lloj informacioni zyrtar.

Ju lutem, mund ta merrnit fjalën në kohën kur u ngrit pretendimi dhe jo pasi Kuvendi mori vendimin!

Zonja Zhupa, filloni, ju lutem!

Ina Zhupa – Faleminderit, drejtuese e seancës!

Në fillim dua të bashkohem me shqetësimin e kolegëve.

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Mos u shqetëso, i nderuar, se interpelanca do të bëhet, se mezi po e pres, pasi e kam kërkuar që në nëntor. Skandali “McGonigal” e bëri të lumtur për disa ditë Elva Margaritin, por nuk i zgjati shumë se interpelanca është e detyrueshme të bëhet.

Arsyeja pse unë e kam kërkuar këtë interpelancë...

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Zoti Braçe, ju lutem, mos i ndërhyjni kolegës!

Ju lutem, mos krijoni situata të tilla në Kuvendin e Shqipërisë!

Nuk ka dëshirë askush t’u drejtohet kolegëve duke u ndërprerë fjalën, për sa kohë ata kanë të drejtë ta marrin fjalën.

Ndjesë, zonja Zhupa.

Ju lutem, mbani qetësi që të dëgjohet fjala e saj!

Ina Zhupa – Nuk ju shkon kjo *fake* opozitë tani.

Për sa i përket trashëgimisë kulturore, ne sot do të trajtojmë çështjen e trashëgimisë kulturore në lidhje me qytetin e Durrësit dhe me qytetin e Tiranës.

Ministrja Elva Margariti ka bërë disa deklarata publike, për të cilat unë sot e kam thirrur në interpelancë.

Unë do të doja të ndaja me ju arsyen pse e thirra në interpelancë.

(Dëgjohet një audio me zërin e ministres Margariti: “... Besoj biem dakord se, jo të gjithë do të donim të jetonim në qytetin e para 3 mijë vjetëve, sepse ne vetë jemi civilizuar dhe duam të jetojmë me të tjera komforte dhe duam të shikojmë të tjera elemente që mund të sjellin zhvillim edhe

për fëmijët tanë. Kur ne jetojmë në një qytet me pallate, nuk e di përse duhet të zgjedhim për fëmijët tanë që të jetojnë brenda rrënojave?)

Koncepti i ministres së Kulturës është “pse duhet të zgjedhim për fëmijët tanë që të jetojnë brenda rrënojave”, a thua se trashëgimia kulturore dhe pasuria kombëtare është bërë për të jetuar brenda tyre.

Koncepti i ministres është që duhet t’i mbulojmë dhe të ndërtojmë pallate, sepse kemi nevojë për të tjera komforte. Pra, në një vend tjetër, një ministre e Kulturës që bën një deklaratë të tillë jo vetëm do të ishte shkarkuar në sekondën e parë, por realisht nuk e di a do ta kishte të lehtë të jetonte më në atë vend, trashëgiminë e të cilit do të donte ta shkatërronte për hir të disa pallateve.

Kjo është ministrja e Kulturës, e cila jo vetëm vazhdon të jetë ministre e Kulturës, por planet e saj për kulturën i ka të lidhura vetëm me koncesionet. Pra, i vetmi program që ka ministrja e Kulturës për zhvillimin e trashëgimisë kulturore jo vetëm për Tiranën dhe Durrësin (meqenëse sot po flasim konkretisht për Tiranën dhe Durrësin) por për të gjithë Shqipërinë, është koncensionin. Ju e patë që e nisi nga zemra e trashëgimisë kulturore, nga Butrinti, sepse plani i saj i vetëm është koncensionin. Në qoftë se shkoni sot në Durrës, në hyrje të amfiteatrit keni të shkruar këtë pllakat: “Amfiteatri, shekulli II, monument kulture, mbrohet nga shteti”. Reforma që do të bëjë zonja Margariti, risia që do të sjellë në mënyrë të paligjshme zonja Margariti, është që ky pllakat të bëhet: “Amfiteatri, shekulli II, monument kulture, mbrohet nga privatë”, sepse planet e menaxhimit të trashëgimisë kulturore të miratuar nga Ministria e Kulturës (njëri kaloi edhe në këtë parlament), janë se si trashëgiminë kulturore t’ia japë privatit, se si trashëgiminë kulturore ta japë me koncension për interesa joshtetërore, jo për ta ruajtur, jo për ta bërë atë më atraktive, por për të pasuruar disa privatë, për të shkatërruar një zonë të caktuar, për të ndërtuar në ato zona, siç janë dy rastet që do të trajtoj gjerësisht sot, pjesa e zonës “A” dhe “B” në qytetin e Durrësit dhe Pallati i Brigadave në Tiranë. Në qoftë se duam të fillojmë me Tiranën, mjafton që ju të shikoni atë sheshin bosh, atë gropën e zezë që ka mbetur nga shkatërrimi i Teatrit Kombëtar.

Zonja Ministre foli 4 minuta kur erdhi në komision dhe lavdëroi Piramidën. Ajo tha se si duhen ruajtur vlerat e së shkuarës, sepse është e rëndësishme që t'ua tregojmë edhe fëmijëve tanë. Pra, nuk ishte e rëndësishme që t'ua tregonte fëmijëve Teatrin Kombëtar, atje ku kishin dhënë të gjithë kontributin e tyre dhe ku ishte historia e artistëve tanë të popullit, aty ku ishin rekuizitat e jashtëzakonshme të Teatrit Kombëtar, arkitektura e veçantë e tij, ajo që paraqiste një pjesë të historisë së Shqipërisë nuk ishte e rëndësishme. Por, kur vjen puna për të ruajtur objektet e diktaturës, patjetër ato janë të rëndësishme dhe jo vetëm i ruajmë, por krijojmë edhe të reja për të ushqyer nostalgjinë e komunizmit.

Bashkimi Europian, meqënëse e kemi edhe pikë tjetër të rendit të ditës, ka një raport për gjendjen e trashëgimisë kulturore, raporti i fundit i bërë, i vitit 2021. Me siguri ministrja nuk e di, sepse është nga ata ministra që di vetëm se çfarë duhet të japë me koncension, e ka cilësuar Shqipërinë si vend me rrezikshmëri të lartë për shkatërrimin e siteve dhe monumenteve kulturore, duke e vënë me pikë të kuqe. Pika e kuqe nuk është vënë as në vitin 2013, as në vitin 2014, as në vitin 2016, por është vënë në vitet 2020-2021, ku drejtpërdrejt zonja Margariti ka qenë ministre e Kulturës. Kjo është harta, mund t'jua vendos në dispozicion dhe në qoftë se ministrja ka dëshirë, mund t'ia vë në dispozicion edhe raportin.

Kjo është Shqipëria me disa, jo vetëm me një pikë të kuqe. Kjo është Shqipëria e shkatërrimit të identitetit dhe të trashëgimisë sonë kulturore. Sepse, nëse neve sot po na ikin shqiptarët dhe po shpopullohet vendi, ne duam të shkatërrojmë edhe trashëgiminë kulturore dhe çdo gjë që mund ta identifikojë Shqipërinë, që nesër, pasi të ikin shqiptarët e të vinë marokenët dhe algjerianët, të mos kenë asnjë problem që t'ia ndryshojnë edhe emrin, se ju keni shkatërruar çdo gjë që lidhet me Shqipërinë, me shqiptarët dhe me trashëgiminë kulturore.

Këto dy qytete që unë përmenda sot dhe që do t'jua shpjegoj edhe në pjesën tjetër, janë vetëm maja e Ajsbergut e asaj që ju keni bërë dhe thoni se UNESCO ka vetëm mendim rekomandues.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Në mbështetje të nenit 96, pika 5 të Rregullores, fjalën e ka ministrja e Kulturës, zonja Margariti.

Mund të jepni shpjegimet tuaja, zonja Ministre, në lidhje me objektin për të cilin është kërkuar interpelanca. Keni të drejtë të flisni 20 minuta.

Faleminderit!

Elva Margariti – Faleminderit, e nderuar drejtuese e seancës!

Të nderuar kolegë deputetë,

E kam thënë dhe do të vazhdoj ta përsëris gjithmonë se jam përherë falënderuese ndaj kujtdo që, edhe përmes artificash të panevojshme apo nga pamundësia për të gjetur një arsye ekzistence apo misioni politik, e vendos kulturën në qendër të vëmendjes në këtë foltore, duke na ofruar një mundësi më shumë për të folur për punët e mira që kemi bërë për kulturën.

Sot jam thirrur në këtë interpelancë për të folur për trashëgiminë kulturore, që qëllon të jetë një nga temat e preferuara, pasi është një nga sektorët ku kemi bërë më shumë punë, kemi punuar më fort dhe kemi pasur rezultate konkrete.

U bën vite tashmë që ne krahasohemi me veten tonë, sepse nuk mund të krahasohemi me 2013-ën, sepse i bie të krahasohemi me vitin zero. Por, herë pas here, na duhet ta kthejmë kokën pas dhe të kuptojmë se çfarë kemi bërë, ku duam të shkojmë dhe këtë ta artikulojmë qartazi, që të mund të kuptohet edhe nga ata që nuk duan të kuptojnë.

Teksa janë kthyer në pjesë të jetës sonë të përditshme, në mundësi punësimi dhe mirëqenieje për komunitetet lokale, unë do t'ju kujtoja thjesht: kur shkojmë në fundjavë në Korçë, kur vizitoni qendrën historike të qytetit të Vlorës, kur ngjitemi sokakëve të Gjirokastrës apo të Krujës, kur mblidhemi me miqtë në Pazarin e Tiranës, harrojmë se pikërisht këto janë hapësirat, të cilat kanë qenë zonat më të turpshme të qyteteve tona, të ngarkuara me baltë e baraka, duke fshehur pas harresën dhe vetë trashëgiminë kulturore. Nuk bëhet fjalë për zonat periferike, por zona në qendër, në zemër të qyteteve, por të shëmtuara, me pisllek, të cilat nuk të bënin asnjë lloj përshtypjeje dhe nuk u vrisnin sytë politikëbërësve.

Sa përmenda, është vetëm një pjesë shumë e vogël e farës së punës që është bërë pikërisht në 'erën tonë'; ndërkohë që, si një nga projektet

madhore të 'asaj ere' unë kujtoj kioskëzimin e çdo hapësire publike, pa kursyer këtu as monumentet e kulturës, kalatë dhe parqet arkeologjike, ku mbizotëronin më tepër kërpudhat e kioskave dhe fasadat, të cilat u rishfaqën vetëm pas shkuljes së këtyre kërpudhave.

Fatkeqësia e kombit mendoj se është pikërisht kujtesa e shkurtër. Janë të shumtë ata që kanë pushuar pranë fshatrave që janë ringritur, janë rijetësuar në brigjet e Jugut dhe kanë harruar se jo shumë larg, vetëm një dekadë më parë, kanë qenë në harresë. Kjo është mbresëlënëse, sepse pikërisht në kohë krize banorët e qendrave historike i besuan nismës më të re të qeverisë shqiptare, që është "bonusi i rijetësimit", duke investuar kursimet e tyre në pronat e familjes, duke i bërë objektet e blera apo të marra në përdorim objekte të vlefshme për funksione të reja, për t'i rigjallëruar.

Qytetarët, në gjithë këto vite, kanë parë punën e bërë në trashëgiminë kulturore dhe kanë filluar të kuptojnë që trashëgimia kulturore është një mënyrë e re e jetesës dhe e zhvillimit ekonomik. Kantieret që po lindin sjellin vende të reja punësimi për profesionistët, për studentët, të cilët po kualifikohen, janë hapësira të reja për gra dhe vajza, të cilat po hapin punishtet e tyre. Të gjitha këto po ndodhin në qendra historike, po ndodhin në zemrën e trashëgimisë kulturore.

Kjo interpelancë është kërkuar specifikisht për Tiranën dhe Durrësin dhe që të mos e kthej këtë fjalë në bezdi, dua t'ju përmend vetëm disa shifra, sepse tashmë është bërë e udhës që kërkesat për interpelancë apo dëgjesat nëpër komisione janë tejet të përgjithshme sa që kemi frikë se biem gati në leksione.

Në Tiranë dhe në Durrës numërohen 318 monumente kulture, ku përfshihen objekte kulturi, fortifikime, ndërtime inxhinierie, objekte të arkitekturës popullore dhe shumë të tjera, dhe vetëm në harkun kohor 2019-2022, me fondet e buxhetit të shtetit dhe të donatorëve kanë përfunduar kantieri restaurimi në mbi 20 objekte kulturore. Krahas punës së përditshme, patjetër vazhdon puna në kantieret e reja, ashtu siç shumë shpejt do të takohemi në sallën e koncerteve në Universitetin e Arteve, një sallë kjo, ku për dekada të tëra nuk kishte vënë dorë njeri dhe skena po shkërmoqej gjatë shfaqjeve. Ndoshta, kjo bie në vesh të shurdhët të atyre që nuk duan të

shohin trashëgiminë kulturore në çdo sofër të qytetit.

Mund ta kuptojmë fare mirë se në vitin 2013, kultura nuk shihej si prioritet i qeverisë, por thjesht si një ornament që zinte një zë të brishtë në buxhet, ndërkohë që ne kemi filluar restaurimin dhe dyfishimin e ambienteve të Galerisë Kombëtare të Arteve, ashtu siç po vijojmë me Mozaikun e Muzeut Kombëtar, me Teatrin e Kukullave, dikur parlamenti i parë shqiptar, i cili ishte harruar në vetminë e tij nga ndjeshmëria që kanë pasur në vitin 2013 për trashëgiminë kulturore. Ai ishte lënë në pikë të hallit që të rrënohej pa zhurmë, ashtu siç u la edhe Mozaiku i Tiranës, që meraklinjtë e trashëgimisë nuk e dinë se ku ndodhet dhe nuk do të habitesha aspak nëse do të ishte e kundërta.

Gjithashtu, të mos harrojmë Xhaminë e Et'hem Beut në zemër të Tiranës, që u zbulua pas restaurimit të objekteve të afreskeve. Për këtë investim kemi marrë shumë bekime nga besimtarët, patjetër edhe nga të gjithë dashamirësit e trashëgimisë kulturore, shqiptarë apo të huaj.

Për të ardhur ndoshta edhe këtu pranë, mjafton të kthejmë kokën pak në dalje të parlamentit dhe të shikojmë godinën e ish-të përndjekurve politikë, e cila ishte kthyer në një objekt të rrezikshëm për këdo që hynte, ndërkohë që sot është kthyer edhe ajo në një kantier restaurimi. Gjithashtu, edhe aneksit të Bibliotekës Kombëtare që, pavarësisht se ndodhet përballë parlamentit shqiptar, veç fanatikëve të librit dhe të historianëve të qytetit, askush nuk ia dinte ekzistencën, ndonëse është kaq afër me parlamentin ku ndodhemi sot. Shumë shpejt, ajo do të jetë një hapësirë dedikuar librit, të rinjve, dialogut, një hapësirë që patjetër do të mbajë një ngarkesë të rëndësishme të godinës së Bibliotekës Kombëtare.

Shumë pranë nesh ndodhen dy objekte monumente kulture, "Sarajet" dhe ish-"Shtëpia e Libohovitëve", të cilat jo vetëm i përkasin një periudhe të nderuar, por edhe dyerve të mëdha të Tiranës, me histori të lidhura posaçërisht me kulturën. "Sarajet" dhe ish-"Shtëpia e Libohovitëve" kanë shërbyer si godina për legatën amerikane, Bibliotekën Kombëtare, Institutin e Monumenteve të Kulturës dhe ishin destinuar që të zhdukeshin, kur njëriës iu vu flaka në mes të natës, ndërkohë që tjetra u la në mëshirë të fatit që

të rrënohej dhe të mos mbetej më asnjë shenjë monumenti.

Ky shtet, kjo qeveri i shpronësoi të dyja këto godina në zemër të Tiranës për t'i kthyer në muze: njëri etnografik, muzeu i qytetit dhe tjetri dedikuar një prej vlerave më të mëdha të shqiptarëve, që e kanë trashëguar brez pas brezi, Muzeu i Besës. Tashmë është hapur një konkurs ndërkombëtar dhe besoj se edhe ky komunikim i sotëm do të shërbejë dhe jam falënderuese që do ta shpërndajmë këtë informacion edhe sot.

Meqë jemi në zonë dhe na përmendnit shpesh Teatrin Kombëtar, po ju rikujtoj se godina ku ishte strehuar ky institucion nuk ka qenë ndonjëherë monument kulture as në erën tonë dhe as në erën tuaj, madje as para viteve '90. Asnjëherë ndonjë qeveri, madje as qeveria juaj, nuk nxori një vendim që ta shpallte monument kulture, përkundrazi e latë në mjerim të plotë dhe u kujtuat për të vetëm kur ju duhej një alibi politike. Askush nuk e mohon kujtesën që lidhet me atë hapësirë që i ka takuar Teatrit Kombëtar dhe që do të mbetet përherë e tillë, sepse bash në atë vend, me buxhetin e shtetit, do të ngrihet godina e re më ambicioze arkitekturore-kulturore ku nuk do të mungojë as kujtesa e institucionit.

Godina e Teatrit Kombëtar është, në fakt, një *deja vu* e stadiumit prej të cilit, veç fasadës së ngurtë që u integrua në objektin e ri falë projektit tuaj madhor të kioskëzimit para erës sonë, nuk kishte mbetur asgjë nga hija e projektit të Bozdos, por të parët që shijuan ndeshjet, madje edhe tubime politike të zhurmshme, ishin pikërisht ata që u ngjirën dhe hodhën gurë kundër projektit të ri. Kështu do të ndodhte edhe me projektin e Teatrit të ri Kombëtar dhe jam e bindur se do të ndodhë e njëjta zhurmë, dhe më pas do ta shfrytëzoni po njësoj për punët tuaja. Madje, unë uroj që të ndodhë kështu dhe jo të dalë fjala ime, sepse teatri është i të gjithëve, i artistëve, i spektatorëve, i komunitetit dhe nuk është vetëm i Tiranës, por i gjithë Shqipërisë.

Mund t'ju kujtoj edhe objekte më të vogla, thjesht për të freskuar memorien: "Shtëpinë muze të Sali Shijakut", një nga godinat e dëmuara nga tërmeti, por mund të shkojmë edhe në periferi, në ish-godinën e Kinostudios, fati i të cilës nuk dihej. Ne jo vetëm e restauruam, jo vetëm e kthyem në një godinë administrate, por sot, dita-ditës, nëse do të afroheni do të shijoni ndryshimin madhor që po ndodh nëpërmjet projektit të "Parkut të Artit",

një projekt ky me një hapësirë për komunitetin e artistëve dhe për komunitetin local; mund të ngjiteni pak më lart në Pezën e ringritur, kullë e cila u kthye në një simbol të tërmetit.

Ndërkohë, ne vazhdojmë punën tonë. Mund të kishim zgjedhur dhe të mos bënim asgjë, siç ishte praktikë e zakonshme deri në vitin 2013, por do të ishte e pamundur që të mblidhnim të gjitha sharjet, sepse e vërteta qëndron në faktin që sa herë bën punë, atëherë do të kesh edhe vëmendje.

Ndërsa Durrësi, që u përmend pak më parë, është qyteti ku janë ngritur më shumë kantiere restaurimi dhe jetësimi, falë mbështetjes së programit të BE-së, por edhe të fondit të ambasadorit amerikan, të fondacionit "Prince Claus", të Fondit Shqiptaro-Amerikan të Zhvillimit, që më duhet ta përsëris se na kanë mbështetur bujarisht të gjithë bashkë, falë vizionit të kësaj qeverie për trashëgiminë kulturore. Sot, sa për parantezë, nuk flasim për emrin e koduar të një shumëkatësheje kur flasim për "Kullën C" të ringritur, edhe pse kjo ka qenë një tjetër alibi politike e përdorur rëndom në debatet medietike.

Sot do të përurojmë "Kullën Veneciane" në Durrës, që është qendra më e re e informimit dhe interpretimit të historisë nëpërmjet teknologjisë. Gjej rastin t'ju ftoj (dhe falënderoj edhe një herë ata që më japim mundësinë të flas për trashëgiminë kulturore), sepse sot do të arrijnë të shohin një copëz të atij vizioni për të cilin kemi punuar gjithë këta vjet, sidomos pas tërmetit. Ndryshe nga çfarë mund të kishin dashur disa, ne nuk e kemi kthyer në restorant apo në kafene, nuk i kemi bashkëlidhur asnjë kioskë aty afër dhe nuk e di nëse kjo do të pëlqehet masivisht nga të gjithë ne që jemi prezent këtu në këtë sallë. Ne ia kemi rikthyer qytetit të Durrësit, ua kemi rikthyer fëmijëve, ua kemi rikthyer vizitorëve, të cilët nëpërmjet "Kullës Veneciane" sot mund të kenë një pikë informimi të re jo vetëm për Durrësin, por për të gjithë historinë e Shqipërisë. Ashtu siç po vazhdojmë me Muzeun Arkeologjik, i cili do të kthehet në epiqendrën e turizmit kulturor.

"Hamami i Vjetër" në Durrës është një tjetër kantier restaurimi. Me siguri keni vizituar edhe labirintet e amfiteatrit të Durrësit, që do të kthehet shumë shpejt në një kantier arkeologjik për të nxjerrë në dritë edhe pasuritë që fshihen nën tokë, por edhe për ta kthyer në simbolin e trashëgimisë kulturore, së bashku me "Forumën Bizantin", me "Banjat romake", si dhe me krijimin e shtigjeve

urbane, të cilat janë të gjitha pjesë e planit të menaxhimit të integruar. Pra, nuk shihet asnjë privatizim, nuk shihet asnjë koncesion, por shihet fuqizimi i Qendrës Muzeore Durrës, si qendra e re që do të menaxhojë të gjitha këto asete.

Qendra Muzeore Durrës është një institucion varësie i Ministrisë së Kulturës. Ju ftoj ta lexoni më me kujdes planin e menaxhimit dhe të kuptoni më qartë, pa ju errësuar sytë me koncesione, të cilat jetojnë vetëm në kokën tuaj. Kjo është ombrella e një plani menaxhimi të integruar, por edhe e një zhvillimi të pandalshëm ekonomik të qytetit, të cilin Durrësi e meriton.

Durrësi tashmë është një qytet i gjallë me shumë projekte dhe vizione të reja dhe patjetër amfiteatri do të jetë një nga ndalesat më të rëndësishme, si për zhvillimin e trashëgimisë kulturore, për kantieret e studimit të profesionistëve dhe, patjetër, e lidhur edhe me portin e ri, një mundësi e re ekonomike edhe për trashëgiminë kulturore.

Mund të shkojmë më tej: në kalanë e Bashrovës, e cila po restaurohet dhe do të marrë të gjithë vëmendjen që meriton si një nga kalatë e rralla fushore që kemi; në Muzeun Etnografik të Kavajës; në kalanë e Ishmit dhe në kishën e Shën Ndout në kepin e Rodonit (nuk e di nëse keni pasur rastin ta shikoni pas inaugurimit që iu bë, në përfundimin e punimeve pas restaurimit të dëmeve të tërmetit).

Mund të vazhdoj të flas shumë më gjatë dhe me më shumë tituj, por nuk dua të marr pa fund kohë nga koha juaj. Nuk e di nëse, për sa më sipër, ju duket shkatërrim apo ju duket punë e bërë me rezultate konkrete në trashëgiminë kulturore. Megjithatë, mendoj se çfarë thashë më sipër është me siguri ende pak, por unë dua t'i njoh vetes një meritë personale: ndoshta i mësova dikujt, që është deputet i zonës, se mund ta vizitonte pak më nga afër Butrintin, dhe uroj që nëpërmjet kësaj interpelance t'i kem dhënë edhe disa koordinata, qoftë edhe për aneksin e Bibliotekës Kombëtare, që është këtu pranë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Zonja Zhupa, keni 15 minuta kohë për të shprehur qëndrimin tuaj, nëse jeni e kënaqur ose jo me përgjigjen e dhënë nga ministrja e Kulturës.

Ina Zhupa – Zonja Margariti mban rekorde edhe si ministrja që nuk i përfundon dot arritjet e

ministrisë së saj në 20 minuta kohë, pra nuk arrin të ketë 20 minuta arritje për një ministri që e drejton nga muaji janar i vitit 2019, pasi aq të shumta janë arritjet, sa që i ngelen edhe 6 minuta kohë, të cilat mund të na i kishte dhënë neve, sepse unë kam shumë gjëra për të thënë.

Këto janë dy planet e menaxhimit: njëri është plani i menaxhimit të zonave A dhe B të Durrësit, ndërsa plani tjetër është menaxhimi i Pallatit të Brigadave.

Ju thatë: “Koncesionet janë në imagjinatën tuaj”. Në fakt, koncesionet janë në Gjykatën Kushtetuese sot, sepse e keni dhënë Butrintin me koncesion. Sigurisht që koncesionet nuk janë vetëm në imagjinatën time, pasi edhe institucionet e tjera kushtetuese e mendojnë si unë dhe kërkojnë shfuqizimin e tyre; mjafton t’ju përmend Presidentin e Republikës, Kontrollin e Lartë të Shtetit, 36 deputetët dhe Avokatin e Popullit. Të gjitha këto institucione mendojnë njësoj si unë, që është një koncesion në shkelje flagrante të Kushtetutës, të Konventës së Parisit dhe të çdo ligji të këtij vendi. Ndërkohë, të vetmit që e mendoni ndryshe jeni ju, që e keni dhënë dhe e keni marrë, Këshilli i Ministrave dhe vetë fondacioni që e ka marrë. Me kaq, njerëzit e kuptojnë se kush qëndron në anën e së drejtës.

Keni të drejtë që e përmendni Butrintin, sepse është “elefanti” në zonë.

A na e thoni dot sot se, çfarë ju tha Audrey Azoulay në takim tuaj me të? A mund të na thoni se si ka mundësi që vjen drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s në Shqipëri (për të gjithë ju, UNESCO është Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukimin, Shkencën dhe Kulturën), takon Kryeministrin Rama dhe ministrin Margariti, por nuk ka asnjë foto të saj, asnjë njoftim të saj?!

Zonja Margariti, kjo ka ndodhur sepse Butrinti është “elefanti” në zonë, që ju ka zhytur në paligjshmëri dhe sigurisht që do të fitojë, sado pará të kenë ata që e kanë marrë.

Ne i kemi parë amerikanët tuaj, fatkeqësisht, sepse arritjet të korruptonit dhe agjentin e FBI-së, ndaj mos i përmendni më, sepse ju i ndotni! Lejojini institucionet dhe shqiptarët, që i shikojnë këto, të thonë fjalën e tyre. Për ju nuk ka kombësi, kur vjen puna për korupsion. Ju i korruptoni të gjithë: amerikanë, europianë apo çfarëdo qofshin, sepse keni interesa të fortë financiarë, edhe pse

bëhet fjalë për shkatërrimin e trashëgimisë kulturore. Ky është realiteti.

Vjen këtu dhe flet për Teatrin Kombëtar. Mësoje që ishte pjesë e ansamblit historik dhe kishte mbrojtje; mësoje që “Europa Nostra” e shpalli në vitin 2020 ndër 7 vendet më të rrezikuara; mësoje, sepse kishte më shumë vlerë se Piramida! Nëse Piramida është monument kulture, mësoje se Teatri ishte me më shumë vlerë! Sigurisht, nuk mund t’i dish këto, sepse duhet të jesh ministre Kulture që t’i dish, duhet të të dhembë kultura, të të dhembë trashëgimia kulturore, identiteti, ai që ti dhe unë do t’ua transmetojmë fëmijëve tanë, që do të kalojë edhe përtej fëmijëve tanë, edhe për brezat e ardhshëm, për të kuptuar Shqipërinë, të qenurit shqiptarë, për të kuptuar veten e tyre.

A e dini ju, të nderuar qytetarë, se dikur në Institutin e Monumenteve të Kulturës drejtonin dhe punonin njerëz, si: Aleksandër Mexsi, Emin Riza, Gjerak Karaiskaj, Valter Shtylla dhe Apollon Baçe, ndërsa tani në Institutin e Monumenteve të Kulturës i cakton ministrja punonjësit sipas kritereve të njohjeve personale dhe jo të aftësive profesionale, të cilëve nuk u dëgjohet zëri?! Jo vetëm kaq, por arriti deri aty sa në reformën e saj të madhe në ligjin e koncesioneve të vitit 2018, për të cilin zonja tjetër është kumbara, të zhdukte edhe emrin e Gani Strazimit nga Instituti i Monumenteve. Pse? Sepse kanë aq tmerr nga njerëzit që kanë kontribuar dhe kanë dhënë për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, sa duan t’u zhdukin edhe emrin, sikur do t’i zinte frymën emri i një njeriu që kishte dhënë dhe kishte bërë për trashëgiminë kulturore; sepse ju do të bënit krejt të kundërtën dhe aty nuk duhet të ishte emri i një njeriu që nuk vepron si ju.

Sipas Kontrolli të Lartë të Shtetit, në dokumente zyrtare, të cilat besoj se ju duhet t’i keni dhe duhet t’i keni lexuar për të kuptuar gjendjen e monumenteve të kulturës, 122 monumente të kulturës janë plotësisht të shkatërruara, 884 kanë nevojë për restaurim, 98 objekte janë të tjetërsuara dhe 15 janë pa kartelë. Për mirëmbajtjen e tyre, problemet i gjejmë që te financimi i pamjaftueshëm buxhetor. Ju kishit rekord edhe si e vetmja ministre që, edhe pse i ulej buxheti, vinte në komision dhe thoshte: “Jam e lumtur që më ulën buxhetin”; e vetmja! Ndërkohë, ministrat duhet të shprehen: kërkojmë më shumë,

sepse këto janë në pamundësi dhe duhet të kemi më shumë. Jo, Elva Margariti ishte e lumtur, madje nuk e kishte problem edhe nëse do t’i jepnin më pak, sepse mendonte: “Çfarë do të bëjmë ne? Me koncesion do t’i japim.”!

Problemet i gjen te mungesa e harmonizimit të politikave midis Ministrisë së Kulturës dhe institucioneve të tjera në nivel qendror dhe vendor, por, mbi të gjitha, në vizionin dhe dashurinë që duhet të ketë një ministre e Kulturës për atë që menaxhon, për trashëgiminë kulturore. Këtë nuk jua jap dot unë me detyrim, sado t’ju vendos përpara dokumenteve. Detyra ime është thjesht të informoj qytetarët, t’ju kërkoj juve llogari dhe, sigurisht, t’ju demaskoj, sepse votat për më shumë nuk i kam sot, por, sigurisht, do t’i kem nesër.

Raportet e Tiranës

Do ta nis me Tiranën, e nderuar zonjë. Ju sot thatë se Tirana ka zhvillim të madh. E shikojmë zhvillimin gjithandej!

Në raportin e fundit kërkimor, të bërë nga qytetarët e angazhuar, vihet re se monumentet e kulturës janë zhdukur në Tiranë dhe citati më i rëndësishëm është: “Nëse do të shkatërroh një monument kulture, vendose në statusin e mbrojtur”. Statusi “monument kulture” ka sjellë degradim; degradimi ka sjellë heqjen e statusit “monument kulture” dhe më pas rilindjen atje të një pallati apo të një kulle. Monumenteve të kulturës u mungojnë protokollet e mirëmbajtjes, duke i lënë në degradim. Me kalimin e kohës, objekti bëhet i pabanueshëm dhe banorët e braktisin, siç e braktis edhe shteti, derisa nga ky degradim kalon edhe në degradim strukturor dhe vjen në shkatërrim. Pra, një plan i jashtëzakonshëm se si të shkatërrojmë monumentet e kulturës me ligj dhe me rregulla!

Vetëm në Tiranë, nga viti 2015 deri në vitin 2021, janë zhdukur jo pak, por 37 monumente kulture. Ja ku i keni! Nuk i dini ju këto?! Janë 37. Në një vend normal monumentet e kulturës jo vetëm mirëmbahen, por edhe shtohen, sepse ti mund të identifikosh gjëra të rëndësishme, të cilat mund t’i lartësosh për t’i dhënë vlerë historisë së kulturës, identitetit, ndërsa në Shqipëri bëhet e kundërta: edhe ato që janë degradohen dhe u hiqet statusi, që t’i hapet rruga një ndërtimi. Ky është realiteti, zonja Ministre. Të mos harroj t’ju jap edhe kërkesën.

Nga ana tjetër, për sa u përket projekteve, Bashkimi European ka dhënë 40 milionë euro për monumentet e trashëgimisë kulturore. I jemi falënderues, sepse, nëse nuk do të ishte Bashkimi European, ne ende sot në Durrës do të shikonim pasojat e tërmetit edhe në trashëgiminë kulturore. Sigurisht, ju nuk mund të mburreni me paratë e Bashkimit European, me të cilat edhe abuzoni; ju duhet të mburreni me punën tuaj; ju duhet të mburreni se si do të arrinit (nëse do të arrinit) ta mbronit, jo të thoshit se duhen mbuluar, duhen shkatërruar dhe duhen ndërtuar pallate.

A e dini ju, zonja Ministre (ju e dini, sepse e keni prezantuar), që në planin e integruar të zonave arkeologjike A dhe B i jepet me koncesion, njësoj si Butrinti, një privati, dhe privati është i njëjti si në rastin e Butrintit: AADF-ja, Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim? A e dini që shkatërrohen banesat e qytetarëve, që kanë një jetë aty? Këto banesa jo vetëm shkatërrohen, merren dhe aty nuk dihet çfarë do të ndërtohet, sepse këta do të thonë: “Turistët do të kenë nevojë të marrin një gotë ujë dhe të ulen diku” (siç thonë për Butrintin, për të ndërtuar në Butrint qendrën e vizitorëve, do të ndërtojnë edhe në Durrës, normalisht, sepse logjika është e njëjtë, përdërisa aktorët janë të njëjtë), por qytetarët, në një zonë me vlera të jashtëzakonshme turistike, ku pasuria dhe prona kanë vlerë tjetër, do të shpronësohen me vlera qesharake. Mjafton t’u referohemi të dhënave, ku vetë qytetarët thonë se shpërblimi është 500 euro për metër katror, sipas ligjit, ndërkohë që realiteti është 1000-1500 euro për metër katror, sepse shtëpitë janë në një zonë me vlerë turistike dhe në qendër të Durrësit. Çfarë bëni ju? I përzini ata për t’ua zënë tokën dhe të ndërtojnë disa të tjerë, me idenë që kështu mbrohen monumentet e kulturës. Kështu vidhet prona private, nuk mbrohen monumentet e kulturës. Monumentet e kulturës mbrohen vërtet, nëse ata njerëz largohen duke u dhënë paratë që u takojnë si dëmshpërblim, duke gërmuar në atë zonë, duke e hapur atë zonë, sepse atje ka ende gjëra për t’u zbuluar dhe jo për t’u mbuluar, siç thoni ju. Aty keni bërë një monstroozitet, siç është Veliera. Në Durrës mund të gësh mure antike brenda pallateve, që është e tmerrshme, dhe arkeologët shqiptarë vënë duart në kokë. Arkeologu Neritan Ceka, thotë: “Nuk kishte se si të ndërtohej pallat aty ku ishte godina, që ka qenë selia e Princ Vidit”, e ashtuquajtura më pas

“Shtëpia e Pionierit”, dhe të humbë një shans shumë i madh për t’u ruajtur të dyja monumentet: pallati i Princ Vidit dhe muri rrethues. Ceka thotë: “Skandali thellohet më shumë kur ndërton dhe të ashtuquajturën “Velierë” përballë murit rrethues”, sepse ju, zonja Ministre, nuk keni asnjë koncept për të ruajtur trashëgiminë kulturore, por keni koncept vetëm për ta dhënë me koncesion.

Pse ishte e nevojshme të parashikohej një plan i menaxhimit për Pallatin e Brigadave, për t’ia dhënë një privati, për të ndërtuar një hotel apo për të delimituar zonën brenda parkut të mbrojtur natyror, brenda parkut të liqenit? Pse ishte e nevojshme, kur shumë mirë, siç janë provat, Ministria e Kulturës në Itali, para se të ishit ju Ministre, ka ofruar fonde dhe projekte për ta ruajtur dhe restauruar pa kërkuar asgjë mbrapsht? Jo si modeli juaj: jap 2 milionë euro për të marrë një pasuri të paluajtshme, të jashtëzakonshme, si modeli i Butrintit, ku ai thotë: të jap 4 milionë euro, por ti në shkëmbim më jep një pasuri të paçmueshme; ti në shkëmbim më jep të ndërtoj; ti në shkëmbim më jep t’i marr unë paratë e biletave, paratë e restoranteve, gjithçka tjetër, dhe ta bëj si dua unë e të mos i jap llogari as Kontrollit të Lartë të Shtetit! Ky është modeli që keni edhe për Pallatin e Brigadave, edhe për zonën arkeologjike në Durrës; i njëjti model, të cilin i keni hapur rrugë me ligjin e trashëgimisë kulturore në vitin 2018. Meqenëse erdhi rasti, po ju them se keni 7 muaj që nuk e kaloni për miratim në komisionet parlamentare, por i kaloni seancat e komisioneve duke bërë një prezantim, më pas, pas 3 muajve, një prezantim tjetër, sepse e harruat prezantimin e parë, më pas një riprezantim me një relacion batakçi, që e kishit sjellë ju, dhe e shtyni. Ndërkohë, ai ligj është “thembra e Akilit”, sepse hap rrugën për koncesionet, hap rrugën për politizimin e tejskajshëm; ai ligj na ka katandisur këtu ku jemi, ku ju mund të thoni për çdo sit arkeologjik, për çdo monument kulture: “Nuk e bëj dot unë. T’ia japim privatit me koncesion për 10-20 vjet”, të cilin e zgjidhni ju pa garë, pa asgjë, duke shkelur çdo rregull dhe çdo normë.

Gjithashtu, prej 4 muajsh ju kam kërkuar informacion për Butrintin. Hera e fundit është data 14 shkurt, ku kam vënë në dijeni edhe Gjykatën Kushtetuese. Dijeni, zonja Margariti: harrojeni se mund t’i fshihni këto informacione, sepse do të keni detyrimin nga Gjykata Kushtetuese për t’i sjellë! Nëse stafi juaj nuk ju ka

vënë në dijeni për shkresën e fundit të datës 14 shkurt të këtij viti, do t'ju jap unë këtu një kopje, të firmosur edhe nga sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit. Ja ku e keni, me vulë! Në këtë mënyrë, ju nuk mund të thoni se nuk e dinim këtë informacion, sepse po jua jap publikisht.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Zonja Ministre, nëse dëshironi, sipas Rregullores, keni të drejtë të shpreheni për 3 minuta.

Elva Margariti – Janë shumë, por edhe mund të lexohen. E kuptoj që është voluminoze, është një punë pothuajse 1-vjeçare, por, nëse do të ishin lexuar, do të ishte kuptuar se plani i menaxhimit të integruar të Durrësit rekomandon Qendrën Muzeore Durrës si administratore, ndërsa Pallati i Brigadave rekomandon Ministrinë e Kulturës si administratore. Mjafton të lexosh. Gjithsesi, e mirëkuptoj.

Unë do të dëshiroja vërtet ta ngrinin debatin në nivelin e duhur dhe ta zhdukim njëherë e mirë nga kjo foltore zhurmën e kacavjerrjes mbi xhama. Më vjen keq që, si alternativë të ofertës suaj, prezantoni vetëm kundërshtimin e së resë nëpërmjet akuzave, të cilat nuk përfaqësojnë apo nuk reflektojnë realitetin, por veten tuaj. Ndaj çdo gjë ju duket sterrë, ndaj ju duken bukur 9 milionë eurot që kishte buxheti i Ministrisë së Kulturës për vitin 2013, kur vetëm Teatri i Operas dhe Baletit ka kushtuar shumë e më shumë se aq.

Është e vërtetë që trashëgimia kulturore kërkon jo vetëm dhembshuri apo atdhedashuri, por, mbi të gjitha, kërkon vizion, por juve ju mungon kjo, sepse edhe një “trashëgimi kulturore” si partia juaj, e privatizuar, arritët ta shndërroni në një relikë që jo vetëm nuk frymëzon, por veç paralajmëron se çfarë do të ndodhë, kur nuk ke asnjë ofertë moderne për elektoratin; çfarë ndodh kur opozitarizmin e konsideroni luks dhe jo përgjegjësi, dhe paralajmëron për hendekun e madh që krijohet ndaj elektoratit dhe mungesës së një debati bazuar në argumente dhe logjikë.

Ne e gjetëm sektorin e trashëgimisë kulturore vërtet si një mbetje të një vatre kulturore nga ato të kohës së komunizmit, dhe krijimtaria juaj, e thashë edhe pak më parë, e kapi kulmin vetëm kur kuptuat se mund të bënit lokale ose kioska pranë tyre. Dhe kështu e gjetëm, të populluar me kioska pothuajse në çdo kala. Në

fakt, mendoj se përpjekja më e arrirë deri në vitin 2013 për ruajtjen e trashëgimisë kulturore ishte pikërisht mungesa e çdo veprimi dhe lënia në harresë. Kjo është vërtet merita më e madhe! Në këtë prizëm nuk keni faj, sepse e kuptuat trashëgiminë kulturore shumë drejtpërdrejt, e kuptuat si një plaçkë të vjetër, të hedhur në një sënduk që nuk hapet kurrë dhe sot e quani fatkeqësi faktin që po investohet në të renë. Qasja jonë është ndryshe, është pro veprimit, është pro krijimit të modeleve që e çojnë përpara trashëgiminë kulturore, që nuk janë vetëm mure, troje, sepse trashëgimi kulturore nuk është vetëm guri i parë i vendosur nga njerëzimi, por është çdo shtresëzim i njerëzimit. Kjo kërkon besim tek identiteti i shqiptarit dhe besoj se keni një problem shumë madhor me identitetin, e keni sfidë të brendshme intelektuale...

Ermonela Felaj – Përfundojeni, ju lutem!

Elva Margariti – Nuk dua ta zgjas më tej dhe as t'u jap shembullin e krijimit të identitetit atyre që identitetin e kanë humbur; nuk dua ta përplas më fjalën time mbi mure dhe karrige.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zonja Zhupa, keni 3 minuta kohë për t'u shprehur.

Më pas do të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Faleminderit!

Ina Zhupa – Siç e patë, nuk morëm një përgjigje se çfarë u ka thënë drejtoresha e Përgjithshme e UNESCO-s, para shqiptarëve; më duhet ta di, sepse nuk e ka takuar si shoqe, por si ministre dhe për çështje publike.

Qasja që zonja Margariti dhe kjo qeveri kanë ndaj trashëgimisë kulturore është e barabartë dhe njësoj (mund ta gjeni në çdo manual) me qasjen që kanë pushtuesit në vendet që pushtojnë. Pushtuesit kanë këtë qasje, sepse duan të rënojnë çdo cep të identitetit, çdo cep të kulturës, duhet ta tjetërsojnë, të ndërtojnë mbi atë, për të krijuar kultin e vet dhe të pushtetit të ri që po rilind. Kjo është qasja që ka kjo qeveri ndaj trashëgimisë kulturore! Koka e kësaj qasjeje nuk është zonja Margariti, sepse në këtë rast është vetëm një ganxhë në të gjithë këtë qasje, por është vetë Kryeministri Edi Rama.

Kjo qeverisje, siç mund ta kuptoni, i shkatërron monumentet e kulturës, ia jep privatit me koncesion, vjedh fonde, i shkarkon dhe i

zëvendëson njerëzit që punojnë në trashëgiminë kulturore, ata që kanë vlera, me njerëz që kanë bërë *intership*-e dhe *followship*-e nga fondacione private, dhe i denigron profesionistët edhe publikisht. Kjo është qasja.

Nëse doni të dini qasjen tonë, shikoni prezantimet e dy kandidatëve për Tiranën dhe për Durrësin: Igli Cara dhe Belind Këlliçi, meqenëse na kërkuat shembull se si është modeli ynë, për të kuptuar se si ndryshon modeli juaj i shkatërrimit të trashëgimisë kulturore, i shembjes së trashëgimisë kulturore në mes të natës, në mes të pandemisë, i dhënies me koncesion të trashëgimisë kulturore në mënyrë të paligjshme dhe duke shkelur Kushtetutën, nga një model që u përgjigjet nevojave të qytetarëve dhe tregon se si qytetet kthehen në vende identitare, ku, që të vizitosh një qytet, të mos kesh veç kullën për të vizituar, të mos kesh koncesionin në emër të një privati, por të vizitosh identitetin. Ju nuk e kuptoni këtë, por qytetarët e Tiranës dhe të Durrësit, meqenëse interpelanca ishte për këto dy qytete, e kanë kuptuar, fatmirësisht, dhe shenjë e duhur do t'ju japin më 14 maj, ku masivisht do të votojnë për Igli Carën dhe Belind Këlliçin, nga koalicioni “Bashkë fitojmë”.

Bashkë do të dëgjohe mi në interpelancën e radhës, me humbjen tuaj të këtyre dy qyteteve, dhe për dëmet që keni bërë në trashëgiminë kulturore, por jo vetëm.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Këtu do të mbyllet kjo pikë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Siç u bë me dije në fillim të seancës, vendosëm që pikën 7 të rendit të ditës ta kalojmë si pikë të dytë të rendit të ditës, pasi kishte konsensus nga ana e dy bashkëkryetarëve të Këshillit për Integrimin.

Pra, do të kalojmë në diskutimet për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”.

Meqenëse ka një listë të gjatë diskutantësh, u lutem shërbimeve të njoftojnë kolegët që po fillojmë diskutimin e kësaj pike!

Duke iu referuar nenit 24 të Rregullores, projektligji do të prezantohet nga dy

bashkëkryetarët e Komisionit të Posaçëm, zonja Tabaku dhe zoti Balla.

Fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit fillimisht nga zonja Tabaku, e cila nuk do të ketë kufizim kohor për fjalën, sipas nenit 47, pika 1, të Rregullores dhe më pas do ta marrë fjalën zoti Balla.

Zonja Tabaku, fjala për ju!

Jorida Tabaku – Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Sot Kuvendi po diskuton punën disamujore të një komisioni të përbashkët për ligjin e ri për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit. Sikundër e kam theksuar në ditën e parë, u propozua ngritja e një komisioni me idenë që qëllimi real i këtij ligji nuk është plotësimi i tekave apo dëshirave personale të ndonjë individi, por përpjekja për t'i imponuar mazhorancës disa ndryshime, të cilat, në gjykimin tim, vetëm e rrisin rolin e Kuvendit.

Unë kam kaq vite në parlament dhe e di se sjellja e kësaj qeverie nuk do të ndryshojë nga një ligj që do të vijë këtu, apo se do t'i japë pak më shumë fuqi parlamentit në procesin e integritetit, por besoj se, si kryetare e këtij komisioni, më takon të përpiqem gjithmonë e më tepër për ta bërë këtë proces më transparent dhe më gjithëpërfshirës.

Nevoja për këtë ligj të ri lindi edhe si rezultat i sfidave që has Shqipëria në këtë fazë të re të procesit. Po kështu, ka për synim t'i paraprijë dinamikës së re dhe metodologjisë së re që Komisioni Europian ka paraqitur për Shqipërinë. Unë besoj se diskutimet e muajve të fundit dhe informimi i mangët në procesin e negociatave, duhet patjetër ta largojnë diskutimin e procesit të integritetit nga kolltukët e karriget e ftohta të qeverisë dhe ta bëjnë këtë një proces gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët.

Në të vërtetë unë besoj, ashtu si edhe Partia Demokratike ka dhënë kontributin më të madh në këtë proces, që ky duhet të jetë një proces i parlamentit shqiptar, jo një parlament i qeverisjes. Ndërkohë që flasim, megjithëse ka pasur shumë raportime në procesin e *screening*, megjithëse ka pasur shumë diskutime nga ana e qeverisë shqiptare, parlamenti shqiptar është lënë në errësirë totale në këtë proces, ashtu si dhe për shumë procese të tjera në fund të ditës.

Më lejoni të përmbledh shkurt disa ndryshime kryesore.

Së pari, parlamenti duhet të ketë mundësinë të kontrollojë qeverinë në çështjet e integritetit dhe, nëse është e nevojshme, ta nxisë në përshpejtimin e përbushjes së detyrimeve. Ky ka qenë një diskutim i vazhdueshëm i këtij parlamenti në 8 vjetët e fundit, ku ne më shumë kemi diskutuar për një datë që nuk arrihet, për një datë që nuk plotësohet se kur do të hapen negociatat, sesa kemi diskutuar për përmbajtjen e këtij procesi.

Së dyti, parlamenti duhet të informohet patjetër për pozicionin e vendeve anëtare për secilin nga 35 kapitujt e negociatave, që duhet të kenë një diskutim të gjerë në parlament. Nuk duhet të harrojmë në asnjë moment që ky ligj është ngritur mbi parimin e procesit të integritetit, mbi bazën e meritës, sikundër është përcaktuar qartë në platformën e zgjerimit që vetë Komisioneri ka prezantuar.

Së treti, anëtarësimi në Bashkimin Europian do të ketë një ndikim në jetën e qytetarëve shqiptarë, të cilët besoj se e konsiderojnë këtë si ndryshimin e vetëm dhe transformues për çdo shoqëri dhe për çdo ekonomi, me të drejta shtesë, por edhe me detyrime shtesë. Ndaj, deputetët e zgjedhur dhe parlamenti duhet patjetër të kenë mundësi të diskutojnë dhe të kuptojnë se cilat janë ndryshimet, përfitimet, detyrimet dhe sfidat e anëtarësimit. Deputetët duhet, gjithashtu, të jenë në gjendje t'u shpjegojnë qytetarëve se përse bisedimet e pranimit mund të mos përfundojnë me kapituj të caktuar dhe kush mban përgjegjësi, sepse sot qeveria diskuton po të njëjtat gjëra: luftën ndaj korrupsionit; Shqipëria sot vazhdon të diskutojë për zgjedhjet dhe për standardet e tyre që nuk plotësohen, sa herë që kjo mazhorancë është në qeverisje; Shqipëria sot diskuton për reformën në drejtësi, e cila është miratuar me konsensus nga ky parlament, por ligji në fund të ditës është më i fortë për të dobëtin dhe më i butë për të fortin.

Unë dua t'i përhëndes të gjithë kolegët që sot kanë mbështetur një rast specifik të një nëne, e cila ndodhet pas hekurave, megjithëse është në ditët e para pas lindjes së fëmijës së saj!

Për sa kohë Shqipëria zhvillon bisedimet për anëtarësimin, opsionet e saj të negociimit janë të kufizuara. Për këtë arsye, unë kam përdorur informacionin që ka pasur parlamenti gjerman.

Dua të falënderoj CDU-në, që ka vendosur ekspertin më të mirë në dispozicion, zotin

Falenski, për të dhënë ekspertizën e tij për këtë ligj, pikërisht mbi eksperiencën dhe avantazhin që ka parlamenti gjerman, që politikën e jashtme e ka *domain* të parlamentit!

Njëkohësisht, falënderoj edhe ish-kryenegociatorin e Malit të Zi, zotin Pejoviç, i cili ka dhënë kontributin e tij në këtë ligj!

Ne kemi arritur të ndërtojmë një model, ku fokusi do të jetë te Kuvendi dhe jo te qeveria. Pra, parlamenti dhe deputetët do të kenë të drejtë që, përpara çdo raundi të bisedimeve për anëtarësimin, të marrin nga qeveria informacione gjithëpërfshirëse, konfidenciale dhe të standardizuara, për pozicionet negociuese, për periudha të mundshme kalimtare dhe njëkohësisht për përafrimin me *acquis*-në. Këto duhet të jenë me shkrim dhe duhet të përbushin disa kritere teknike, për të krijuar transparencën e nevojshme për deputetët e këtij parlamenti, për anëtarët e Komisionit të Integritetit, por edhe për qytetarët, për çdo gjë që po ndodh me procesin e negociatave. Askush nuk ka pronësi në këtë proces, as qeveria, që sot është dhe nesër ikën. Ne duhet t'ia japim këtë proces parlamentit, duhet t'ua japim qytetarëve. Ky është një proces që duhet t'ia japim politikës, për arsyen e thjeshtë, që këto reforma duhet të qëndrojnë patjetër në kohë. Reformat gjysmake, të bëra vetëm nga një palë e politikës, dështojnë, siç kanë dështuar pjesa më e madhe e reformave që ka bërë kjo qeveri në mënyrë të njëanshme.

E përsëris, unë nuk mendoj se qeveria do të ndryshojë me këtë ligj, por ky është një instrument më shumë që ka në dorë ky parlament për të kërkuar llogari. Besoj se parlamenti mund ta ushtrojë më mirë të drejtën e tij për kontrollin e procesit të anëtarësimit dhe, nëse është e nevojshme, e nxit atë të veprojë më shpejt në përbushje të detyrimeve.

Në këtë parlament kemi diskutuar gjatë për të drejtën për komisione hetimore dhe për të drejtën që ka opozita për të ngritur komisione hetimore. E dini se cila ishte arritja e vetme në progresraport, që i njëjti parlamentit të Shqipërisë në detyrat e tij? Ngritja e një komisioni hetimor për inceneratorët, i cili i dha të drejtë opozitës të ushtrojë funksionin e saj mbikëqyrës dhe kontrollues. Po ashtu, janë kërkuar të paktën 3 komisione të tjera hetimore nga opozita, por nuk janë lejuar, megjithëse ligji e lejon. Gjykoj se këto vendime thjesht e zbehin rolin e parlamentit, e

nxjerrin funksionin ligjvënës të deputetëve jashtë kontekstit dhe njëkohësisht i japin më pak mundësi opozitës për t'u përfshirë në luftën ndaj korrupsionit, kriteri kryesor që ne duhet të zbatojmë.

Ne kemi shpenzuar mjaftueshëm energji, mjaftueshëm kohë, mjaftueshëm nerva dhe durim të qytetarëve shqiptarë në 8 vjetët e fundit, për një datë që nuk vinte kurrë vetëm si rezultat i mungesës së vullnetit politik. Siç thuhet edhe në progresraport, vullneti politik i qeverisë, megjithëse me fjalë ekziston kudo, duhet të tregohet me vepra. Besoj se ky ligj është një nga aktet që tregon se opozita e ka të gjithë mundësinë dhe potencialin, por duhet të ketë edhe të gjithë hapësirën për t'u përfshirë, pasi opozita nuk është në parlament si numër, por është shprehje e vullnetit të qytetarëve, e vullnetit të zgjedhësve për ta bërë procesin e integritetit një instrument ndryshimi.

Unë i kam bërë herë pas here thirrje qeverisë që ta përdorë këtë proces zgjerimi edhe si një *brain gain*, të zgjerojmë grupet e anëtarësimit dhe të shtojmë sa më shumë të rinj, të cilët sot, fatkeqësisht, po largohen masivisht, por këto thirrje kanë shkuar në vesh të shurdhër.

Gjithashtu, kam bërë thirrje të hapeshin patjetër grupet e negociatave për çdo kapitull, të kishte gjithëpërfshirje jo vetëm në nivel politik, siç po ndodh sot, por edhe në nivel teknik, me ekspertë që administrata publike i ka pasur në vite, gjatë qeverisjes së Partisë Demokratike, por edhe më parë, të cilët kanë dhënë kontribut dhe shpresoj të kemi ende mundësi ta zgjerojmë përfshirjen e tyre në procesin e negociatave dhe ky ligj të jetë një hap i parë për të rritur kapacitetet institucionale, edhe të administratës publike, që, fatkeqësisht, sot nuk është në nivelin e duhur.

Të gjithë e dinë se Shqipëria, ndryshe nga vendet e rajonit, është përballur më shumë me probleme dhe pengesa të brendshme në këtë proces, sesa me pengesa të jashtme. Në këtë proces pengesat e jashtme kanë dalë vetëm në 2 vjetët e fundit, nuk kanë qenë asnjëherë për faj të opozitës dhe Partisë Demokratike. Në asnjë progresraport dhe në asnjë raport të Komisionit European në 10 vjetët e fundit nuk njihet opozita si problem. Në të gjitha progresraportet paraardhëse, nga viti 2013 e në vijim, fjala "opozitë" lexohej të paktën 10 herë dhe besoj se për këto arsye, sot gjërat janë ndryshe.

Ne mund të kemi ndryshime për mënyrën se si i shikojmë gjërat, si duam të zbatohen ligjet apo për hapësirën që duhet të ketë ky proces dhe diskutimi i tij, por ndryshe nga gjithë vendet e tjera të rajonit, Shqipëria ka avantazh mbështetjen më të madhe të qytetarëve në këtë proces. Dhe, që të mos e bëjmë këtë proces të pakuptimtë për njerëzit, por ta bëjmë më praktik dhe më gjithëpërfshirës, besoj se të gjitha këto duhet të diskutohen në parlament.

Dua t'i falënderoj ekspertët që kanë punuar për këtë projektligj, i cili besoj se të gjithëve na jep një motiv për ta ndryshuar fokusin e diskutimit! Ne duhet të fillojmë të diskutojmë për çështje përmbajtësore dhe për luftën kundër korrupsionit, jo si një element abstrakt.

Dje të gjithë u njohëm me lajmet e fundit, që kryetari i Bashkisë së Bulqizës, bashkë me një grup të madh zyrtarësh, sot ndodhen pas hekurave. Opozita i ka denoncuar prej kohësh dhe nuk kemi pse të presim pa fund për t'u korigjuar, por drejtësia duhet të marrë një vendim, sepse jo çdo gjë që thotë opozita është e keqe në këtë vend. Besoj se nuk i përket opozitës të bëjë dorën e shtrirë, por i përket qeverisë. Le t'i marrim parasysh këto ndryshime si një mënyrë ndryshe për të funksionuar ky proces, t'i marrim parasysh si një mënyrë ndryshe për opozitën për të marrë më shumë informacion, për ta mbikëqyrur këtë proces dhe njëkohësisht të ketë vendimmarrje në diskutimet e procesit të integritetit, që të gjejmë një mënyrë për të tërhequr të rinjtë e të rejat nga vendime për t'u larguar masivisht, siç po ndodh vitet e fundit.

Unë shpresoj që ky ligj të mbështetet nga pjesa më e madhe e deputetëve të këtij parlamenti, të cilët, pa dyshim, ndryshe nga çdo parlament tjetër i rajonit, kanë pikëpamje më europiane dhe dëshirë më të madhe që të ngrenë mekanizma apo instrumente që t'i japin më shumë fuqi parlamentit.

Në 8 vjetët e fundit kemi shumë shembuj, ku megjithëse mazhoranca ka shtrirë dorën për përfshirjen e opozitës, kjo nuk ka ndodhur realisht. Unë shpresoj që kjo të ndodhë me këtë ligj, sepse, përpos të gjitha problemeve tona të ndryshme, në çështje të brendshme nuk kemi qenë asnjëherë pengesë, siç kanë qenë mazhoranca e sotme në opozitë, për procesin e integritetit.

Unë shpresoj që kjo të jetë edhe një thirrje për qeverinë shqiptare, për t'u tërhequr edhe nga

iniciativa që janë në shkëlqje të Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit, si: porti i Durrësit, aeroporti i Vlorës dhe shumë marrëveshje të tjera, të cilat duhet të jenë patjetër me garë, sepse këtë e kërkon edhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Gjithashtu, duhet të tërhiqet edhe nga diskutimet që janë qartësisht një vijë e kuqe për Komisionin European, si: ligji i amnistisë fiskale, pasaportat e arta dhe iniciativat që nuk ka pse të diskutohen nga parlamenti i Shqipërisë i vitit 2023. Nëse kemi vullnet politik për procesin e integritimit, duhet ta tregojmë me cilësinë e ligjeve që sjellim këtu, me fokusin që kanë ligjet, por edhe me ligjet që duhet të vijnë patjetër në interes të shumicës dhe jo të pakicës, siç janë iniciativat që përmenda.

Unë shpresoj në mbështetjen e kolegëve për ndryshimin e modelit se si funksionon sot marrëdhënia e parlamentit me mazhorancën dhe qeverinë në procesin e integritimit. Shpreh konsideratën më të lartë për të gjithë ekspertët e administratës publike, që kanë dije, njohuri dhe memorie institucionale për këtë proces, por, fatkeqësisht, ata janë lënë jashtë tij, edhe pse janë një potencial i jashtëzakonshëm për t'u përfshirë, dhe shpresoj në mbështetjen e kolegëve për këto ndryshime të vogla të ligjit të integritimit, duke e ditur që nuk e ndryshojnë mendësinë e qeverisë, por tregojnë filozofinë e Partisë Demokratike dhe filozofinë e së djathtës, pa asnjë kompromis, për procesin e integritimit që është për qytetarët dhe jo për qeveritarët.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Fjala për zotin Balla.

Gjithashtu, për ju nuk ka kufizim kohor për fjalën.

Më pas do të kalojmë te diskutimet.

Taulant Balla – Zonja Tabaku, mendoj se duhet të rakordosh mendimet, e nderuar, sepse nuk mund të dalësh këtu e të thuash: “Reformat e njëanshme të mazhorancës socialiste...” dhe më pas të përshëndesësh institucionet e drejtësisë së re, të cilat janë ngritur nga këto reforma të njëanshme.

E vërteta është se, kur ju ishit në çadër për të penguar ngritjen e institucioneve të vetingut dhe kushtëzoni votën tuaj për ngritjen e institucioneve të vetingut në drejtësi, ne prisnim

pikërisht në këtë sallë për të parë dhe për të marrë kontributin tuaj.

Unë bëj pjesë tek ata njerëz, të cilët mendojnë se reformat që vendi duhet të bëjë në rrugën e anëtarësimit në Bashkimin European, nuk mund të bëhen vetëm nga njëri krah i politikës. E përshëndes angazhimin e të gjithë anëtarëve të komisionit të posaçëm për të bërë të mundur sjelljen në Kuvend të këtyre ndryshimeve.

Po, është e vërtetë ajo që tha kolegja Tabaku: kemi një qasje ose një model tjetër të rolit të Kuvendit të Shqipërisë në këtë proces historik. Ka një traditë parlamentare, për ata që janë pak më të rinj në këtë sallë, tradita e filluar në vitin 2005 me ligjin “Zela”, ku ne ngritëm për herë të parë Komisionin për Integrimin European. 10 vjet më pas, në vitin 2015, kolegja Majlinda Bregu, zonja Tabaku bashkë dhe unë kemi hartuar një ligj të ri, mbi bazën e shëndoshë dhe eksperiencën e akumuluar në 10 vjetet e para, se si partitë politike duhet të lënë mënjanë interesat e tyre ditore afatshkurtra dhe çështjet e anëtarësimit të Shqipërisë duhen bërë bashkë. Mendoj se këtu ka një element që duhet ta themi: sot ka një debat brenda opozitës, që kush bashkëpunon për integrimin është tradhtar. Mendoj se ky debat është shterpë dhe i pavend, sepse, kush bashkëpunon për integrimin, nuk është tradhtar, përkundrazi, është atdhetar.

(Ndërrhyrje nga salla)

Vazhdo ti, vazhdo!

Në fund të fundit, ne bëjmë thjesht dhe vetëm ato që na thonë më shumë se 90%-shi i atyre që na kanë sjellë në këtë sallë dhe 10%-shi i mbetur janë ata që nuk e dinë, sepse 100% e atyre që e dinë se çfarë do Shqipëria, për këtë pjesë na duan të bashkuar, jo të ndarë, për atë që e donin që ditën e parë studentët: “Shqipëria si gjithë Europa”. Në këtë kontekst ka ardhur edhe kjo nevojë, e cila u mbështet nga kryetari i Komisionit të Integritimit European, nga nënkryetarja e komisionit dhe nga i gjithë grupi parlamentar i shumicës për të ngritur menjëherë Kuvendin në lartësinë e detyrës, në këtë fazë të re të procesit.

E nderuar zonja Tabaku, nuk është e vërtetë se qeveria nuk raporton, siç thatë ju. Qeveria ka sjellë raportin e 3-mujorit të fundit të vitit 2022, tetor – nëntor – dhjetor, më shumë se 80 faqe, në mos gaboj, dhe me cilësinë e raportimit përkundrejt Kuvendit. Po, është e vërtetë që për shkak të ndryshimit të bërë në ligjin e vjetër, ne

duhet të kishim zhvilluar debatin brenda 2-mujorit të parë të vitit. Në fakt, na mungon që nga viti 2020 një rezolutë e Kuvendit të Shqipërisë me konsensus për çështjet themelore dhe rolin që duhet të luajmë, por ne nuk duam të hyjmë në debatin tuaj të brendshëm, sepse, *po bëre mirë për Shqipërinë, je tradhëtar; nëse kontribuon për Shqipërinë, je tradhtar.*

Ligji i ka ndarë këto detyra. Për fat të mirë, jemi i vetmi vend në rajon që e kemi rregulluar me ligj këtë marrëdhënie dhe kjo është meritë e të gjithë atyre që kanë qenë që në vitin 2005 dhe më pas. Kur pamë se, në fund të fundit, ne shqiptarët kemi prirjen që duhet të shpikim rrotën sa herë të jetë e mundur, gjeja e parë që na vjen ndër mend është se si e kanë të rregulluar të tjerët. Të tjerët nuk e kanë të rregulluar me ligj, por një gjë po jua them: jam shumë i sigurt se ligjin që ne po miratojmë sot, do ta marrë si shembull Maqedonia e Veriut për ta futur në procedurën e vet dhe, po ashtu, jam i sigurt që vëllezërit e motrat tona të Kosovës do ta përdorin si model për të ndërtuar një marrëdhënie të mirë llogaridhënieje të qeverisë kundrejt Kuvendit.

Nëse do të isha sjellë si kryetar i grupit parlamentar të mazhorancës, do të thosha: pse duhet t'a kushtëzojmë kaq shumë qeverinë me afate, procedura, me dhënie agrimenti nga ana e Kuvendit përmes Komisionit të Çështjeve Europiane (sepse, pas ditës së sotme, nuk do të quhet Komisioni për Integrimin Europian, por Komisioni për Çështjet Europiane)? Do të flas më pas për nevojën e një përfaqesjeje tjetër dhe të gjithë ndarjes në komisione, përveç miratimit të këtij ligji sot. Në Komisionin për Çështjet Europiane, për ata që nuk ua shpjegoi dot zonja Tabaku, qeveria, para se të negociojë, duhet të sjellë një informacion dhe të marrë një opinion nga Komisioni për Çështjet Europiane. Kemi bërë pothuajse atë që ndodh në marrëdhënie mes Kancelarisë, qeverisë gjermane dhe Bundestagut gjerman.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mondi, rri, sepse ke rol tjetër!

Të kemi parashikuar edhe ty. Ti ke rol tjetër, do ta themi në fund. Edhe ti je parashikuar për një rol këtu, që nuk po e them tani.

Kjo është gjëja e duhur për të rritur udhëheqësinë që ka parlamenti në këtë proces. Qeveria ka detyrë ta bëjë dhe mos harroni që ka një element: ky është një proces negociatash. Ne

përcaktojmë një kuadër, brenda të cilit qeveria duhet të negociojë. Është një opinion, por, në fund, kemi parashikuar që qeveria të raportojë, sepse, kur shkon në negociata, duhet të negociosh për më të mirën, por duhet të negociosh, sepse në fund duhet t'i mbyllim 35 kapitujt dhe të bëhemi gati për të ratifikuar në secilin prej parlamenteve të vendeve anëtare marrëveshjen e aderimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Vëllezër dhe motra,

Edhe ju të opozitës,

Kemi kontekstin më të mirë, si ta doni, edhe politik, edhe gjeopolitik, që Shqipëria të ecë më shpejt. Para pak ditësh kemi përmbyllur procesin *screening* edhe për klasterin e dytë dhe mendoj se është një gjë e mirë, që duhet përshëndetur. Për fat të mirë, ka ndodhur e njëjta gjë edhe me Maqedoninë e Veriut, e cila ka mbyllur klasterin e dytë *screening*. Sot kemi Këshillin e Stabilizimit. Për këta që pretendojnë se flasin në emër të Brukselit, Brukseli flet vetë. Parafolësja tha se në 10 vjetët e fundit nuk ka asnjë fjalë për opozitën në raportprogreset. A doni t'jua lexoj raportprogresin se çfarë thotë për opozitën, për sherrnajën, luftën dhe zjarrin në selinë e Partisë Demokratike? Nuk dua të hyj në këtë temë, sepse është çështje juaja e brendshme, por mos merrni guximin të lexoni raportprogreset, sepse unë jam shumë krenar për rolin që ka luajtur Partia Socialiste e Shqipërisë kur ka qenë në opozitë.

A kemi bërë ne gabime? Natyrshëm që kemi bërë gabime. E mira juaj është të mësoni edhe nga gabimet tona, sepse nuk është herezi. Por, kurrsesi brenda Partisë Socialiste nuk ka pasur një palë që të akuzojë palën tjetër për tradhti ndaj atdheut apo tradhti ndaj moralit të opozitës në kontributin për integrimin europian. Kontributin për integrimin europian nuk jua kërkojmë ne, mos kujtoni se na e keni borxh neve, por ua keni borxh shqiptarëve.

Sa herë të jetë e mundur, jepni votën tuaj!

Kështu duhet të ndodhte edhe për Kodin Rrugor, që të mos qajmë mbrapa, por t'i dalim përpara. Është në turpin tonë, sepse po ta kishim miratuar Kodin Rrugor para 4-5 javësh, kur e kishim këtu, nuk do të ndodhte aksidenti me 3 të rinj. Me parashikimet në Kod, atij djalit të ri nuk do t'i lejohej ajo makinë. Me parashikimet që ka në Kod, nuk lejohet që një djalë i ri, që sapo ka marrë patentën, t'i kalojë 80 kilometra në shpejtësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Historia e opozitës me lotët...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Kolegë, ju lutem, mos ndërhyini nga vendi!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Zoti Xhaferraj, zoti Spaho, ju lutem mos ndërhyini nga vendi!

Taulant Balla – Zoti Xhaferraj, kam shumë respekt për ju, por këtë rol...

Ermonela Felaj – Ju lutem, ka një radhë të gjatë diskutantësh, ndaj mund të merrni fjalën dhe të bëni komentet tuaja. Kolegut mos i ndërhyini.

Taulant Balla – Zoti Xhaferraj, këtë rol e ka Mondit, të lutem mos ndërhy.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Këtë pjesë e mbulon Mondit, përse hyn ti këtu? Për këtë paguhet.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Ajo që ndodhi në mëngjes...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Nuk e kuptoni se shqiptarët qeshin me ne, kur ndodh ky teatri i përhershëm, kur çohet Albana Vokshi dhe qan me lot krokodili për një gjë që fajin e kemi të gjithë bashkë? Nuk e kuptoni se po e degradoni dita-ditës rolin e kësaj salle? Mjaft qamë mbrapa, e rëndësishme është të bërtasim përpara. Ndaj, kur e kemi mundësinë t'i bëjmë gjërat, duhet t'i bëjmë pa u kompleksuar. “Nuk e japim ne votën për Kodin, se do të dalë Saliu të na akuzojë se u shitëm”. Pse u shitët? Se nuk do të lejojmë të rinjtë të ecin mbi 80 kilometra? Patjetër që nuk duhet t'i lëmë. Këtë duhet ta miratojmë sot.

Pastaj ne kemi instrumente kontrolli sa të doni, edhe te ligji i ri ka instrumente kontrolli parlamentar sa të doni, të cilat për të mirën tonë dhe të keqen tuaj, nuk i mësuat asnjëherë.

Çohet një deputete dhe thotë: “Kërkoj një debat...”, po ka një nen Rregullorja që thotë: ose disa deputetë, ose kryetari i grupit parlamentar e paraqet në Konferencën e Kryetarëve. Ndërsa ajo e donte sot. Po si e doni sot?

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Dakord, prandaj e kam thënë shpesh se instrumentet e Kuvendit duhen vënë në punë urgjentisht, që t'ju mësojmë ligjin që po miratojmë.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Unë jam i sigurt që ligjin do ta miratojmë me konsensus.

Ermonela Felaj – Kolegë, a ka mundësi të mos flisni nga vendi? Nuk funksionon kështu Rregullorja e Kuvendit, si e mendojmë ne, zonja Dhurata.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Taulant Balla – E rëndësishme është që Rregulloren e Kuvendit ta respektojmë të gjithë njëjloj.

Kur çohemi dhe flasim për procedurë, kur ne duam të bëjmë një kërkesë, për shembull: bazuar në nenin kaq, lexohet neni dhe thuhet se çfarë kërkojmë, pastaj le të jetë përgjegjësia e Lindita Nikollës apo e Ermonela Felajt për respektimin e Rregullores. Ndërsa këtu vini gjysmë ore me vonesë dhe kërkon fjalën të thoni një gjë, sepse keni kërkuar... Ne prandaj e kemi vendosur në ligj. Lexojeni ligjin e sotëm, sepse çdo gjë është me afate.

Koha kur opozita mund të marrë peng çështjet e integritit, ka marrë fund. Ne kemi mësuar nga gabimet tona. Ne kemi thënë se të gjitha ligjet që lidhen me procesin kalojnë me procedurë dhe hyjnë menjëherë. Ne nuk mund të presim më.

Sot kemi bërë një diskutim në Konferencën e Kryetarëve, që është një turp i madh kush e merr vesh. Kanë ardhur përfaqësuesit e Bashkimit Europian dhe thonë: “këtë gjë e duam”. Njëri nga ne tha: “Jo, se ky ligj ka emërtesën e një ligji tjetër që kemi frikë. Duke qenë se kemi frikë...” pra nuk kanë lidhje fare, sepse janë dy gjëra të kundërta.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Kjo gjë duhet ngulitur mirë në mendje. Integrimi evropian, anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Europian është proces historik. Kush jep kontribut për këtë proces, e jep për Shqipërinë, nuk e jep as për këtë anë dhe as për anën tjetër, sepse shqiptarët nuk duan t'ia dinë për anët, se e kanë mendjen e ndarë.

Ne jemi me fat, sepse jemi i vetmi vend në rajon, edhe Kosova jonë, në fakt, edhe pjesa shqiptare e Maqedonisë së Veriut (lexojeni pak sondazhin e Institutit Republikan Amerikan kur bie fjala për integrimin evropian) ku 95% e popullsisë shqiptare janë në favor të këtij procesi. Kjo ka të bëjë me ADN-në e shqiptarëve, për të cilët, siç thoshte Naim Frashëri, (Naim Frashëri është zë yni edhe pse për ju nuk ka rëndësi nëse është apo jo rilindës, ju nuk e doni): “Dielli lind andej nga perëndon”.

Unë uroj që një pjesë juaja, nuk kam dyshim për një pjesë që i ka thënë Amerikës armike, që i ka thënë Britanisë së Madhe armike dhe po bëhet gati të shpallë armike edhe BE-në, sapo Bashkimi Europian të përqsasë politikën e tij të unifikimit të qëndrimit me SHBA dhe me Britaninë e Madhe për personat *non grata*, të mos i thotë haram edhe BE-së.

Një gjë të fundit kam: roli i secilit prej nesh, pavarësisht partive politike ku bëjmë pjesë, është një rol që nuk mbetet pa u vënë re nga ata që na votojnë, sepse ata që na votojnë janë gjyqtarët më të mirë. Thirrja ime sot për këtë ligj, që është një ligj shumë i mirë...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Po, zonja Tabaku, jam shumë dakord! Shumë mirënjohje për këdo që kontribuoi, si dhe për ekspertët, qofshin këta të propozuar nga e majta apo e djathta.

Natyrshëm, zoti Valenski është një personalitet tashmë në pension, por si ish-këshilltar i Komisionit për Çështjet Europiane në Bundestag, ka luajtur një rol të rëndësishëm, si dhe zoti Pejoviç, eksperti që kishim marrë ne. Unë gjej rastin të falënderoj edhe dy fondacionet: “Konrad Adenauer” dhe “Friedrich Ebert Stiftung”, si dy instrumente shumë të rëndësishëm të asistencës së punës së Kuvendit. Ndaj, po ju lutem edhe një herë: nuk është tradhti të punosh për Shqipërinë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla! Zonja Tabaku, keni kërkuar fjalën për çfarë? *(Diskutime nga salla pa mikrofon)*

Po, fjala për zonjën Tabaku për replikë.

Jorida Tabaku – Unë shpresoja që sot të paktën, zoti Balla t’i ikte vesit të vjetër për të mos e përmendur situatën e Partisë Demokratike sa herë ai ka nevojë dhe sa herë që atij i duhet. Punët tona ne i zgjidhim vetë.

Unë u kujdesa shumë, në fakt, që të mos përmend se sa letra ka nisur ish-opozita e djeshme kundër liberalizimit të vizave, sa herë është përmendur për integrimin në qarkun e Fierit, sa herë është penguar edhe Kodi Hekurudhor për t’u miratuar vetëm pse ishte pjesë e procesit të integritimit. Mund ta kisha bërë shumë mirë këtë gjë, pasi e njoh këtë proces dhe kam qenë në qeverisje në atë kohë, por refuzova ta bëj për vetë faktin që ne jemi ndryshe.

Ne procesin e integritimit, kur them “ne”, i referohem Partisë Demokratike, nuk e konsiderojmë si një proces që sot e përdorim për politikë sa herë që na duhet, por e konsiderojmë si një proces në të cilin Partia Demokratike, kur ishte në mazhorancë, bëri hapat më të mëdhenj dhe më konkretë për të gjithë qytetarët shqiptarë. Sot është turpi i politikës, në fakt, i kësaj qeverie, që për 9 vjet kemi diskutuar vetëm “u hapën apo nuk u hapën negociatat”. Për 9 vjet, në vend që të punonim për qytetarët shqiptarë, në vend që sot të adresonim sfidat që kanë vendet e tjera të rajonit, prej mungesës së vullnetit politik të qeverisë në ndodhemi këtu ku jemi.

Shpresoja shumë që sot në diskutimet e këtij ligji, zoti Balla t’i ikte kësaj retorike të vjetër që e bën përherë sa herë ka nevojë, si kryetar i grupit të mazhorancës, kur ka diskutime dhe debate në Partinë Demokratike.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Në progresraport asnjëherë nuk është shprehur asnjë fjalë që opozita, Partia Demokratike, po pengon procesin e integritimit, ndërkohë që për ju është shprehur me qindra herë dhe kjo është një njollë që ju duhet ta mbani.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Tabaku!

Fjala për zotin Spaho për replikë.

Edmond Spaho – Taulant, kur nuk është Edi këtu, ti je më i madhi, por përpiqu të përmirësosh pak ligjërimin, se nuk i afroresh as Elisës!

Ne vërtet kemi ligj, por nuk kemi integrim; bota nuk ka ligj, por ka integrim. Ne kemi një ligj edhe për atë gruan në Shkodër, por sot ajo është në burg nga paaftësia e policisë, në radhë të parë dhe nga paaftësia e drejtësisë, në radhë të dytë.

Ne kemi ligjin edhe për komisionet hetimore, e kemi edhe në Kushtetutë, por nuk krijohen pasi nuk të lë Edi dhe nëse i krijon, ai ta shkul veshin, sepse parlamenti nuk është i pavarur. Ligj ne kemi pasur edhe për integrimin, nuk është ky një ligj i ri, por kemi 10 vjet që nuk kemi bërë një hap përpara. Ligj kemi edhe për hajdutët, që të mos marrin fonde buxhetore, por edhe kur ikin në arrati, ti përsëri vazhdon t’i paguash. Pse? Sepse nuk ka shtet, është regjim personal i Edi Ramës. Edhe ky ligj, që ti po e mburr kaq shumë, do të jetë një vrimë në ujë. Ti nuk ke kurajën të vish këtu dhe t’i thuash të

vërtetën popullit shqiptar, por e gënjen, sepse je i paaftë për të thënë të vërteta.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Spaho!

Në bazë të nenit 73, pika 2, të Rregullores, përpara se të fillojmë diskutimin në parim të projektligjit, kolegë deputetë, keni të drejtë t'u bëni pyetje të dy nismëtarëve që prezantuan projektligjin. Në fakt, vetëm zoti Balla është në sallë për të respektuar këtë të drejtë tuajën.

Fjalën e ka kërkuar zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj – Zonja drejtuese e seancës,

E para, dëshiroj të them se është gjë shumë e mirë që Kuvendi investohet për një ligj kaq të rëndësishëm në këto momente.

E dyta, fakti që ky projekt ka ardhur këtu si produkt i konsensusit midis mazhorancës dhe opozitës, është shumë pozitiv.

Duke i hedhur një sy ligjit, në nenin 4 të tij, ku flitet për përbërjen e Këshillit Kombëtar, konkretisht në germa “f” dhe “g”, është parashikuar të jenë pjesë e këtij këshilli vetëm Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, ndërkohë, në variantin e riformuluar, në pikën 2, germa “a”, janë shënuar titullarët e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, që raportojnë dhe informojnë Kuvendin në cilësinë e të ftuarit.

Nuk e di a parashikohet apo jo në ligjin bazë, por prokuroria dhe gjyqësori janë dy pjesë të sistemit që vetërregullohen, vetëqeverisen dhe në krye të tyre kanë dy organe shumë të rëndësishme, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Këshillin e Lartë Gjyqësor.

Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme nuk janë pjesë e institucioneve të parashikuara administruese të sistemit nga pikëpamja e qeverisjes së plotë të tij dhe nga pikëpamja e politikave. E mira e të mirave, në sugjerimin tim, është të jenë të dy këshillat, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, kurse Prokurori i Përgjithshëm dhe drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme mund të jenë të ftuar, por jo drejtpërdrejt anëtarë të këtij këshilli.

Nuk e di nga janë nisur, ndaj do të doja një përgjigje për këtë gjë dhe nëse mund të shikohet kjo zgjidhje në rregullimet që do të bëhen.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Fjalën e ka zoti Balla.

Taulant Balla - Në projektligjin që keni përpara paraqiten vetëm ndryshimet, kurse pjesa tjetër e ligjit që nuk ndryshohet do të vazhdojë të jetë e njëjtë. Edhe kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, edhe kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë anëtarë të Këshillit Kombëtar të Integritetit. Në ligjin e vitit 2015 ka qenë parashikuar vetëm Prokurori i Përgjithshëm, por duke qenë se me ndryshimet që sollti reforma në drejtësi u krijua edhe Prokuroria Speciale Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, pas shumë konsultimeve që janë bërë përgjatë gjashtë muajve, nga kolegët anëtarë të komisionit u vlerësua edhe përfshirja e drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Gjithsesi, bie dakord me zotin Xhafaj, që qeveritë e dy pjesëve të rëndësishme të drejtësisë, të prokurorisë dhe të gjykatës, janë Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Pas 15 minutave ne do të kemi mbledhjen e Këshillit Kombëtar të Integritetit, ku kryetari i Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor do të jenë dy folësit në emër të institucioneve të pavarura, bashkë me folësit e tjerë në takimin që do të kemi me Komisionerin për Zgjerim, zotin Varheli.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Balla!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka.

Vazhdojmë me diskutimet në parim.

Fjalën e ka zonja Gjonaj, dhjetë minuta në dispozicion. Të përgatitet zoti Mediu.

Etilda Gjonaj – Dua ta filloj fjalën aty ku e la zonja Tabaku, e cila tha se ndryshimet që ne kemi bërë në këtë projektligj janë të vogla. Në fakt, nuk është kështu, sepse këto janë ndryshime shumë të mëdha dhe të rëndësishme për shkak se kanë ndryshuar mentalitetin në funksionimin dhe zhvillimin e diskutimeve dhe pjesëmarrjes në procesin e integritetit evropian. Nëse ne si mazhorancë nuk kemi menduar në asnjë moment gjatë hartimit të këtij projektligj për rolet që do të ketë secili përfaqësues i grupit parlamentar, pavarësisht nëse është shumicë apo pakicë, unë jam e bindur që opozita nuk do ta kishte bërë këtë gjë nëse do të ishte në vendin tonë.

Prandaj, unë mendoj se këtu ka një ndryshim mendësie, të cilin do të duhet ta kemi të gjithë sidomos kur diskutohet për procesin e integritetit evropian. Kanë kaluar 7 vjet nga miratimi i këtij ligji të veçantë mbi rolin e Kuvendit në procesin e

integritimit europian, si ndër të vetmit në vendet e rajonit, ashtu siç edhe kolegët e thanë paraprakisht, dhe kjo ishte arsyeja pse u konsiderua e nevojshme që të rishikoheshin dispozitat dhe parashikimet ligjore të këtij ligji. Pas pothuajse 15 mbledhjeve të komisionit *ad hoc*, orëve të gjata të konsultimeve dhe dëgjësive me grupet e interesit, takimeve me të gjithë ambasadorët e vendeve të Bashkimit Europian, shoqërinë civile, ekspertët vendas dhe të huaj, ashtu siç u përmendën edhe nga kolegët parafolës, arritëm në finalizimin e këtij varianti, i cili është konsideruar më i miri për vetë faktin se është një projektligj i dakordësuar nga të gjithë anëtarët e komisionit *ad hoc*. Objektivi kryesor i këtij procesi është roli i shtuar i Kuvendit dhe për rrjedhojë forcimi i zërit të qytetarëve nëpërmjet nesh, përfaqësuesve të tyre.

Për plotësimin e ndryshimeve të këtij projektligji, që është qëllimi kryesor, ne kemi synuar të fuqizojmë pozitat e strukturave të Kuvendit, sidomos Komisionit për Çështjet Europiane, të cilat janë një vlerë e shtuar për ta çuar agjendën europiane përpara, duke lehtësuar kështu konsensusin për miratimin e ligjeve, që janë kriteret për hapjen dhe mbylljen e negociatave, si dhe për hartimin e pozicioneve negociuese.

Vlen për t'u theksuar se ky reformim që i kemi bërë rolit të Kuvendit në procesin e integritimit europian është një hap i rëndësishëm drejt gjithëpërfshirjes, rritjes së pjesëmarrjes të të gjithë aktorëve politikë dhe veçanërisht opozitës parlamentare, të cilët do të jenë aktorë të barabartë në tryezën e diskutimit të procesit të përafritimit të legjislationit, por njëkohësisht edhe të procesit të diskutimit të pozicioneve negociuese për çdo *benchmark*, për çdo kapitull dhe për çdo kriter që Komisioni Europian do t'i vendosë Shqipërisë.

Një ndër parimet kryesore që ka shoqëruar paketën është parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve, duke njohur kështu përgjegjësinë e Këshillit të Ministrave dhe strukturave negociatore si ushtruese të pushtetit ekzekutiv, për ndjekjen dhe administrimin e procesit të negociatave, por edhe atë që konsiderohet procesi politik, që ndiqet dhe që është detyrë dhe përgjegjësi kryesore e Kuvendit.

Ashtu siç e përmenda pak më sipër, Shqipëria është ndër vendet e vetme dhe të parat që, së bashku me Maqedoninë e Veriut, duhet të

përshtatet me kërkesat e reja të metodologjisë së zgjerimit, shumë të vështira, duke mbajtur parasysh edhe rreziqet që paraqet ky proces sfidues, që lidhet me mekanizmin e kthimit në rast të mosavancimit në mënyrë progresive. Për këtë arsye, është ndjekur një metodologji e posaçme në hartimin e këtij projektligji, e paraprirë nga analiza e modeleve të suksesit të vendeve të ndryshme të rajonit, për të cilën jemi ndihmuar nga Instituti Parlamentar, por edhe nga konsultimet intensive që kemi bërë me ekspertët vendas dhe ndërkombëtarë.

Konkretisht, pa u ndalur në nenet një për një, dua të rendis disa prej elementeve kryesore të këtij reformimi të rolit të parlamentit, si një vlerë e shtuar në përmbushjen dhe përshpejtimin e këtij procesi në kuadër të integritimit europian. Komisioni për Çështjet Europiane, i përshtatur si në emërtim ashtu edhe në përgjegjësi me komisionet homologe në parlamentet e tjera europiane, merr vendin e merituar në këtë hallkë të procesit ku ndodhemi. Në rast se më herët është parë si një komision i dorës së dytë, në vazhdim do të jetë një ndër mekanizmat kryesore të Kuvendit në këtë proces.

Komisioni për Çështjet Europiane do të ketë përgjegjësi të reja për diskutimin e pozicioneve negociuese, përpara se të paraqiten nga strukturat negociatore shqiptare në Komisionin Europian. Komisioni për Çështjet Europiane, pas shqyrtimit të pozicioneve negociuese, do t'i dërgojë ministrit përgjegjës një raport të posaçëm me rekomandimet për pozicionin përkatës, ku ministri i parashikuar në dispozitë ligjore do të jetë i detyruar t'i japë shpjegime Komisionit për Çështjet Europiane, pse nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet që janë paraqitur nga ky komision.

Në këtë mënyrë garantohet zbatimi i parimit *checks and balances*, por njëkohësisht do të përfaqësohet më mirë zëri dhe interesi i qytetarëve në strukturat europiane. Për të mbrojtur pozitën e palës shqiptare nga rrjedhja e informacionit mbi pozicionet negociatore, por nisur edhe nga eksperiencat e vendeve të tjera, si Mali i Zi apo Kroacia, tashmë është përcaktuar që çdo anëtar i Komisionit për Çështjet Europiane është i detyruar të nënshkruajë deklaratën e konfidencialitetit për të mos shpërndarë informacion mbi pozicionet negociuese për

çështje të ndryshme, praktikë që ndiqet në të gjitha vendet që janë në këtë proces.

Gjithashtu, janë forcuar kompetencat e Komisionit për Çështjet Europiane dhe Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian për monitorimin e zbatimit të kritereve apo atyre që konsiderohen “*benchmark*”. Po ashtu, ministri përgjegjës ka detyrimin të raportojë pranë komisionit një herë në tre muaj për ecurinë e negociatave, në funksion të transparencës dhe rritjes së llogaridhënies nga ana e qeverisë.

Veprimtaria e komisionit do të rritet në kuadër të shqyrtimit të marrëveshjeve të integritimit, por edhe ato me karakter financiar, që lidhen me vendet anëtare të Bashkimit Europian, si një përgjegjësi plus që i jepet Komisionit për Çështjet Europiane.

Për herë të parë kemi përfshirë një procedurë, e konsideruar e përshpejtuar, për projektligjet që synojnë përafrimin me *acqui*-në, si një mekanizëm përshpejtues. Ky është një mekanizëm shumë i vlerësuar edhe nga ana e Komisionit Europian, i prezantuar për herë të parë në janar të këtij viti, për shkak të efektivitetit dhe transparencës, por njëkohësisht edhe si një garanci për priorizimin nga ana e Kuvendit të përafrimit të legjislacionit.

Për sa i përket Këshillit Kombëtar të Integritimit Europian, ai vazhdon të mbetet një organ këshillimor me zë më të fortë për sa i përket monitorimit të zbatimeve të kritereve, por, gjithashtu, i garantohet roli i tij si një platformë e gjerë informimi dhe konsultimi. Jemi të vetëdijshëm që shoqëria civile dhe grupet e interesit kanë një rëndësi shumë të madhe në procesin e integritimit europian.

Për këto arsye, risi në këtë reformim të rolit të Këshillit është edhe krijimi i kësaj platforme sa më të hapur, duke mos kufizuar tashmë pjesëmarrjen e aktorëve të shoqërisë civile në tre përfaqësues, por duke e lënë të hapur dhe duke u dhënë mundësinë të gjithë aktorëve të shoqërisë civile, të gjitha organizatave dhe të gjitha grupeve të interesit të marrin pjesë në diskutimet, konsultimet dhe mbledhjet që zhvillon Këshilli Kombëtar i Integritimit Europian.

Përpos një rëndësie të madhe politike, procesi i integritimit është ligjor dhe në momentin e këtyre ndryshimeve ka një përgjegjësi dhe peshë në pozicionet negociuese, që do t'i sjellin nesër vendit statusin e merituar për të qenë anëtar.

Për këtë arsye, kërkoj mirëkuptimin e Kryetares së Kuvendit, kryetarëve të grupeve parlamentare, anëtarëve të Byrosë, që, ashtu sikurse ky ligj ka bërë një ndryshim në nivelin politik të mekanizmeve për integritimin europian, të shoqërohet kjo edhe me miratimin e ndryshimeve administrative në rritjen e burimeve njerëzore dhe ekspertizën profesionale të tyre për t'iu përgjigjur kompleksitetit dhe seriozitetit të këtij procesi.

Gjithashtu, duke iu bashkëngjitur dy kolegëve parafolës, mendoj se do të ishte në nderin e kujt do në këtë sallë, që beson së paku në procesin e integritimit europian, ta tregojë këtë besim sot me votë. Sot është mundësia edhe për kolegët e opozitës të tregojnë me votë që përmendja e fjalëve “integritimi europian”, nuk ka asnjë vlerë nëse ky projektligj nuk votohet në mënyrë unanime nga të 140 deputetët e kësaj salle.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Gjonaj!

Fjalën e ka zoti Mediu! Të përgatitet zonja Zhupa.

Fatmir Mediu – Të nderuar kolegë deputetë,

Qëllimi i ndryshimeve të këtij ligji sot është forcimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë me një proces jashtëzakonisht të rëndësishëm, jo thjesht për ne si deputetë, por për qytetarët shqiptarë, për të realizuar atë që kanë ëndërruar: integritimin europian. Nëse do të gjejmë sot konsensusin për ta votuar, është e rëndësishme të gjejmë konsensusin edhe për ta implementuar, sepse shpesh kemi miratuar me konsensus ligje, por kemi çaluar në implementimin e tyre. Që të mos ecim me shprehjen “lum ne për atë që dëgjojmë dhe mjerë ne për atë që shikojmë” dhe për ta bërë këtë parlament funksional dhe europian, e para, le t'u krijojmë mundësinë shqiptarëve që të kenë zgjedhje të lira dhe të ndershme, në mënyrë që të zgjedhin përfaqësuesit e tyre në këtë Kuvend dhe në institucione të tjera pikërisht nëpërmjet votës së tyre.

E dyta, si parlament kemi detyrimin të vazhdojmë të punojmë për një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse, në mënyrë që t'i japim mundësi edhe asaj gjysme jashtëzakonisht të rëndësishme të shqiptarëve që jetojnë në diasporë që, jo vetëm

të votojnë, por të kenë edhe të drejtën që të përfaqësohen në Kuvendin e Shqipërisë.

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit është ngritur nga çdo institucion i rëndësishëm europian apo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më e rëndësishme për ne si deputetë në radhë të parë, por edhe për qytetarët, është respektimi i Kushtetutës dhe ligjeve të vendit tonë. Ajo që na kërkohet ne si deputetë të këtij Kuvendi është të kuptojmë rolin që ka Kuvendi, rëndësinë e tij dhe të mos vazhdojë të jetë një apendiks i qeverisë, që ul dhe ngre dorën sipas qejfeve që ka qeveria apo, për më tepër, të mos kthehet vendi i një debati absurd, ku qytetarët jo vetëm nuk gjejnë veten, por neveriten prej tij.

Ky proces i rëndësishëm, sa politik aq edhe ekonomik, kërkon kuptim, mirëkuptim, konsensus, por edhe transparencë. Ky konsensus duhet të sigurohet këtu në parlament nga të gjitha forcat politike, jo thjesht me deklarime pro integritit europian, por duke rritur rolin kushtetues të parlamentit dhe përgjegjshmërinë tonë si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë. Duhet që parlamenti të vendosë përballë përgjegjësisë dhe detyrimit për të konsideruar vendimet e tij, raportimin në Kuvend dhe në Komisionin e Integritit, të gjitha institucionet qeverisëse. Që parlamenti ta fitojë këtë rol kushtetues, të nderuar kolegë deputetë (e kam ngritur këtë shqetësim edhe në Komisionin e Posaçëm), duhet të ketë mekanizmat dhe mundësitë për ta kuptuar dhe për t'u asistuar në proces. Shembujt që ne morëm nga Gjermania apo Mali i Zi tregojnë qartë që parlamenti kthehet në funksionin që duhet, nëse ka ekspertizën e nevojshme, që deputetët të kuptojnë procesin, partitë politike dhe grupet parlamentare të mos jenë formale thjesht për të votuar, por të përfshihen në një debat racional.

Gjithashtu, ka nevojë për ekspertizë teknike që ky parlament të fuqizohet me njohjen e legjisllacionit, me debatin për legjisllacionin apo për iniciativa të ndryshme. Pa i dhënë këtij parlamenti kapacitetet dhe ekspertizën e nevojshme teknike, unë nuk mendoj që ne do të jemi pjesë e qenësishme e këtij procesi. Gjermania dhe Mali i Zi, të cilat u përmendën këtu, janë vende europiane, por edhe në proces kanë treguar që pikërisht mbi këtë lloj logjike të ekspertizës teknike kanë arritur të funksionojnë në nivelin që duhet.

Ne duhet të rrisim rolin e Kuvendit në procesin e integritit, duke mos e konsideruar këtë thjesht si një ekskluzivitet të qeverisë shqiptare, por si pronë reale të publikut. Dhe përfaqësuesit e parë të qytetarëve, të publikut, janë deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Për fat të keq, sot ka një mungesë të plotë informacioni dhe transparence në lidhje me negociatat, në cilën fazë jemi, kuptimin e tyre dhe ku qëndrojnë pozicionet tona negociuese. E përsëris, pa një mbështetje dhe ekspertizë, nuk mund të shkojmë atje ku presim të shkojmë.

Forcimi i rolit të Kuvendit nuk është thjesht një privilegj që po e kërkojmë nga qeveria në këtë proces, por është i lidhur ngushtë me detyrimin tonë kushtetues për kontrollin e qeverisë. Komisioni për Çështjet e Integritit Europian duhet të kthehet në garantuesin e dialogut ndërpartiak në procesin e integritit me interes kombëtar, mbi atë politik. Besoj se me këtë projektligj, Kuvendi i Shqipërisë mund të garantojë një proces negociues dhe qeveria të jetë po ashtu e detyruar të ndjekë arsyetimin dhe vendimin e parlamentit.

Parlamenti nuk është parashikuar të ketë rol bllokues, por kjo nuk do të thotë që qeveria mund ta anashkalojë rolin e tij. Në dakordësi ndërmjet pozitës dhe opozitës për kapituj të veçantë apo për elemente në procesin e negociatave, qeveria është e detyruar dhe duhet të jetë e detyruar të marrë parasysh qëndrimin dhe mendimin e Kuvendit të Shqipërisë. Rëndësia e këtij rregulli, e mirëkuptimit politik në Shqipëri, i cili ka ekzistuar në gjithë këto vite dhe ekziston, ka një vlerë të veçantë në këtë proces të rëndësishëm; sepse kjo dakordësi në parim, duhet të kthehet në një marrëdhënie konkrete në këtë Kuvend, në këto procese, duke pasur një Kuvend funksional.

Kështu, parlamenti duhet të marrë rol kryesor në procesin e integritit dhe të jetë më i dobishëm në debatin për tema të caktuara të interesit të shqiptarëve. Ky debat duhet zhvilluar këtu në parlament dhe hapur, në bashkëpunim me shoqërinë civile.

Po kthej edhe disa përgjigje, sepse edhe pse duam të arrijmë në konsensus, përsëri e tregojmë me gisht njëri-tjetrin.

Kolegë deputetë, e djathta, opozita, ka qenë frymëzuesja e procesit të integritit europian që në fillim të pluralizmit politik në Shqipëri. Asnjëherë nuk ka hezitur për të mbështetur apo

për të qenë protagoniste e këtyre proceseve. Kujtoj këtu procesin e nënshkrimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ku u përfshimë të gjithë pa përjashtim, por edhe në aktet finale të miratimit të këtij projektligji. Edhe procesin e integritit të Shqipërisë në NATO nuk e pamë asnjëherë të njëanshëm, por si proces bashkëpunimi që u interesonte dhe u intereson shqiptarëve.

Edhe akti i sotëm që po bën opozita për ta mbështetur këtë ndryshim në ligj tregon qartësisht se e djathta shqiptare kërkon një proces të shqiptarëve dhe jo një proces të qeverisë apo të opozitës, një proces në shërbim të interesit tonë kombëtar, për t'u bërë sa më shpejt pjesë e Bashkimit Europian.

Prandaj, le ta kuptojmë njëri-tjetrin edhe në diferencat tona. Kjo është më shumë sesa politikë, sepse kjo marrëdhënie vlen për shqiptarët, për interesin tonë kombëtar, ndaj duhet të votojmë jo vetëm për ta miratuar, por sidomos për zbatimin dhe implementimin e ligjit në shërbim të procesit të integritit europian.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Mediu!

Fjalën e ka zonja Zhupa. Të përgatitet zoti Berisha.

Ina Zhupa – Faleminderit!

Në radhë të parë, më vjen mirë që kemi kohë për të folur, sepse herën e fundit që u diskutua mocioni me debat për procesin e integritit, u limitua koha dhe numri i folësve. Më vjen mirë që këtë herë e keni zbatuar Rregulloren, duke qenë se është baza e funksionimit të këtij parlamenti.

Ligji që ne do të votojmë sot, për të cilin nuk kemi ndonjë kundërshtim, kërkon që Kuvendi të ketë më shumë mundësi kontrolli. Në letër nuk na kanë munguar mekanizmat e kontrollit, por na ka munguar zbatueshmëria, sepse me arrogancën e kartonëve, e mandateve të blera dhe vjedhura, ju i keni mohuar të drejtën opozitës. Me arrogancën e një mazhorance që nuk pyet për Rregulloren, që nuk pyet për Kushtetutën, që nuk pyet për ligj, jo më larg sesa para tre ditësh ju e shkelët Rregulloren duke mos zhvilluar seancë për çështjet e zgjedhësve. Në fillim të kësaj seance unë ju drejtova me kërkesë për ta zhvilluar atë seancë sa më shpejt, por ju nuk më dhatë një përgjigje, vetëm thatë se e anuluar meqenëse deputetët tuaj nuk ishin.

Në cilën pikë të Rregullores së Kuvendit thuhet që mund ta lini pa zhvilluar një seancë parlamentare për problematikat e qytetarëve? Në cilën pikë të Rregullores thuhet që opozita nuk ka mundësi të flasë këtu pas Javës së Gjelbër, për 4 orë siç e kërkon Rregullorja, duke respektuar edhe proporcionet e grupeve parlamentare?

Ashtu siç do të miratojmë këtë ligj sot, nesër do të jemi përsëri në të njëjtën situatë, sepse me forcën e kartonëve ju nuk do t'i lejonin ata të vijnë.

Vazhdojmë me rastin tjetër konkret. Siç e kërkon Rregullorja e Kuvendit, shtatë deputetë të një komisioni mund të kërkojnë seancë dëgjimore. Me firmat e shtatë deputetëve në Komisionin e Edukimit, kam paraqitur kërkesën për seancë dëgjimore për çështjen e Butrintit me ekspertët Neritan Ceka, Apollon Baçe, Agron Alibali. Çfarë ndodhi? Përgjigjen e keni me audio dhe video. Nën kryetari i komisionit tha: “Unë nuk vij dhe ti nuk ke kuorum për ta zhvilluar mbledhjen”. Ligji u miratua, u kthye përsëri për shqyrtim dhe kjo seancë nuk u zhvillua kurrë, sepse ju i shkëlqeni të drejtat që na kanë dhënë Rregullorja dhe këto ligje.

Po ju jap shembuj konkretë për të kuptuar që mungon vullneti politik për t'i zbatuar ligjet. Ligji që ne bëjmë sot, nuk do të ketë vlerë nëse ju do të vazhdoni me këtë vullnet politik.

Në tetor të vitit 2022 kam kërkuar seancë dëgjimore me Akademinë e Shkencave, me kryetarin jolegjitim të Akademisë dhe kryesinë e Akademisë, për çështje të rëndësishme të projekteve madhore, si: Fjalori, Enciklopedia, Historia e Shqipërisë dhe mënyrën si funksionon shkenca në Shqipëri.

Tani jemi në muajin mars. Cila Rregullore më ndalon mua të bëj seancë dëgjimore me institucionet e pavarura, në këtë rast Akademinë e Shkencave? E shpikni ju, duke mos thirrur për të dhënë llogari një njeri që nuk duhet të ishte fare në atë pozicion, një njeri që, edhe kur thirret për buxhetin, nuk ka guxim të vijë vetë, por dërgon gjithmonë kancelarin si zëvendësues, sepse është i paligjshëm dhe tmerrohet nga llogaridhënia përpara Kuvendit, sepse nuk është mësuar, se vjen nga modeli sovjetik dhe është ish-ministri i fundit i diktaturës.

Sa europiane është dhe sa na afron ne me procesin e integritit dhënia me koncesion e portit të Durrësit, duke shkelur Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit? Kjo gjë është e shkruar e

zeza mbi të bardhë. Sa e respektoni ju Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit, kur portin e Durrësit ia keni dhënë pa garë një kompanie *offshore*, kurse Bashkimi European nuk është informuar dhe kompanitë europiane nuk kanë hyrë në garë, në qoftë se vërtet doni të ndërtoni një model të ri të portit të Durrësit? Sa europiane është që neve na u deshën dy muaj për të realizuar një mocion me debat me Kryeministrin, i cili është konstatuar nga drejtësia amerikane se ka korruptuar agjentin e FBI-së në Shtetet e Bashkuara të Amerikës? Bëmë dy muaj betejë parlamentare për një të drejtë kushtetuese që na e jep Rregullorja dhe në fund Kryeministri juaj bëri një monolog këtu, duke mos zbatuar Rregulloren, e cila thotë që ai duhet të jetë prezent gjatë mocionit me debat.

Sa europiane është dhe sa na ndihmon ne në procesin e integritetit kur ministra dhe deputetë, të cilëve sot po u bastisni shtëpitë në mënyrë po aq arrogante sa qeverisni, kapen në përgjime se kryejnë veprimtari të paligjshme? Si ka mundësi dhe sa është në përputhje me Rregulloren, me Kushtetutën që sot ne nuk kemi mundësi të ngremë një komision hetimor për çështjen “Rama-McGonigal”, edhe pse e kanë kërkuar 44 deputetë me firmë, ndërkohë që Rregullorja e detyron Kuvendin ta ngrejë këtë komision? Pse nuk e bën? Nuk ka asnjë arsye të ligjshme për të mos e bërë, përveç arrogancës së kartonëve, të cilët do t’i përdorni edhe në rastin e Komisionit për Çështjet Europiane, siç do të quhet tani, sa herë që do të kërkohen ministrat, sa herë që do të kërkohet llogari për procesin e integritetit, sa herë që do të kërkohet përballje me institucione të larta shtetërore, për ta çuar atë në kalendat greke, për të mos i dhënë kuorumin e nevojshëm mbledhjes së komisionit.

Kur doni të shkëlqeni Rregulloren, marifetet janë të shumta, por janë të gjitha të paligjshme, sepse janë në shkelje flagrante të Rregullores.

Sa herë kemi kërkuar ne masa ndëshkimore ndaj jush dhe nuk është marrë asnjë? Jo sepse nuk e keni shkelur Rregulloren, por sepse nuk e lexoni me syzet e ligjshmërisë, e lexoni me syzet e politikës, me syzet e urdhrave politikë!

Ju doni që ne sot të besojmë se ky ligj i ri, që do të miratojmë, do të ketë fat të ndryshëm nga Rregullorja e Kuvendit? Do të ketë fat të ndryshëm nga Kushtetuta e këtij vendi? Jo, të njëjtin fat do të ketë, do të shkelet në mënyrë të

vazhdueshme me arrogancën e një pushteti që nuk jep llogari!

Por prapë ne do ta votojmë, sepse mendojmë se e kemi detyrim ndaj qytetarëve shqiptarë që të votojmë sa herë që parlamentit i shtohen kompetencat, që të votojmë sa herë vëmë një tullë të mirë në procesin e integritetit dhe në mekanizmat e llogaridhënies, sado që ju nuk i zbatoni, sepse, siç e tha me të drejtë zoti Mediu, mund të tregohen me raste konkrete kur qeveriste Partia Demokratike se si përfshiheshin edhe në votimin e ligjeve, edhe në marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit, edhe në rrugën për anëtarësim në Bashkimin European, ndërkohë që sot ndodh e kundërta, arroganca e një pushteti që nuk jep llogari për asgjë.

Ambasadorja e Bashkimit European, me shumë elegancë, disa herë madje, ju ka kërkuar edhe publikisht llogari për fondet e Bashkimit European.

“Ku janë fondet e Bashkimit European?” - thoshte ambasadorja në kongresin tuaj të Arsimit, kur vjen puna te ndërtimi i shkollave apo te baza materiale e tyre.

“Ku janë fondet e Bashkimit European?”, kur vjen puna te procesi i rindërtimit.

“Ku janë fondet e Bashkimit European?”, kur vjen puna tek trashëgimia kulturore. Me shumë elegancë jua ka thënë diplomatja.

Megjithatë, ju bëni veshin shurdh dhe nuk i ktheni përgjigje...

(Bie gongu.)

...se si edhe në këtë rast, edhe me fondet e Bashkimit European, ju bëni gjithçka për t’ua dhënë klientëve tuaj, bëni gjithçka për t’i fryrë.

Ndërkohë, për ta mbyllur, meqenëse edhe koha e diskutimit është e limituar, ne do të jemi gjithmonë në krah dhe do të qëndrojmë gjithmonë me vlerat më të larta euroatlantike jo vetëm në krah të Bashkimit European, por edhe të partnerëve tanë strategjikë, si Shtetet e Bashkuara të Amerikës, qoftë edhe për të kërkuar që në këtë vend të zbatohen Kushtetuta dhe ligjet e vendit!

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Zhupa!

Fjalën e ka zoti Berisha.

Të përgatitet zoti Gjikhuri.

Sali Berisha – Zonja drejtuese e seancës,
Zonja deputete,
Zotërinj deputetë,

Të dashura qytetare dhe qytetarë, që ndiqni këtë seancë,

Tema e këtij momenti në rend dite është një projektligj që ka të bëjë me rritjen e rolit të parlamentit në procesin e integritimit evropian.

Natyrisht, si një forcë politike e vendosur për të mbështetur totalisht dhe pa rezerva çdo akt, vendim, ligj në funksion të këtij procesi, ligji ka mbështetjen tonë të plotë ndonëse me vetëdije të plotë se ky ligj, ky akt, është thjesht një letër e vdekur dhe e pavlerë, pasi ju jeni dhe veproni çdo ditë, çdo javë e çdo muaj në kundërshtim me parimet më themelore të këtij procesi.

Por unë, para se ta argumentoj këtë që thashë, dua të ndalem në dy ngjarje tragjike traktatër net më parë: në krye të detyrës, teksa punonte për të mbajtur mbesën e vogël, bie nga breshëritë e banditit të qeverisë, e kriminelit të qeverisë, një nënë, një gjyshe, një punonjëse, Mimoza Paja. Nën breshëri, plagosen pesë të tjerë.

Kjo është absolutisht vepër e nxitur nga politika e narkoqeverisë shqiptare, jo vetëm se banda, e cila u sulmua, ishte nën mbrojtjen e plotë të qeverisë, se i dyshuari për vrasje ishte liruar nga të gjitha detyrimet me ndërhyrje politike nga lart, por edhe për faktin se ju keni shpallur si platformë dorëzimin e rendit në duart e krimit.

Platforma që kreu i krimit në Shqipëri, po përdor termat në latinisht *caput meduse*, Edi Rama, shpall dhe mbron publikisht “t’i hanë kokën njëri-tjetrit”, nuk do të thotë asgjë tjetër veçse: vrisni sa të doni njëri-tjetrin.

Është strikt licencë për të vrarë njerëzit njëri-tjetrin dhe kjo licencë në një vend, i cili e ka dënimin me vdekje të ndaluar me Kushtetutë, është një akt-akuzë e rëndë për atë që e lëshon dhe e dorëzon rendin në duart e krimit.

Por, nga ana tjetër, shprehja “t’i hanë kokën njëri-tjetrit” është njëkohësisht asgjësim tërësor i ligjeve të vendit. Dhe pikërisht, i hanë kokën njëri-tjetrit. Në këtë platformë, vrasës të tjerë shkrehën breshëri dhe vranë një nënë në banak, plagosën pesë të tjerë ulur në tavolinë, sepse kjo është platforma e Edi Ramës.

E dënoj këtë standard që nuk ka asgjë të përbashkët me shtetin ligjor, me Kushtetutën, me kodet e vendit!

E dënoj këtë standard, i cili përputhet 100% me rregullat e mafies dhe të shpellave të saj!

Unë dua t’ju them se pardje, për herë të parë, u zgjova në mëngjes dhe u mora me Facebook-un, kontrollova Facebook-et e këtyre ministrave që janë pas shpinës sime. Mendova se do të ishin tronditur nga lajmi tjetër, përmes të cilit njoftohej se një nënë lehonë, me fëmijë 8-ditësh, ishte marrë nga një bandë policësh dhe ishte burgosur, sepse nuk kishte paguar një gjobë prej 250 mijë lekësh.

Nuk gjeta asnjë fjalë, zonja ministre, asnjë keqardhje ndaj kësaj zonje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

As nga ju që po flisni mbrapa shpinës sime.

Çfarë nuk kishit publikuar, me jelekë, me gjerdanë ari e të tjera, me sofa plot e stërplot, kurse për nënën lehonë në burg, me fëmijë 8-ditësh në shtëpi, asnjë fjalë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju, zonja të nderuara, mos harroni se jeni nëna, jeni bashkëshorte!

Ju nuk duhet të verbohemi nga paratë në këtë mënyrë. Mos harroni se përfaqësoni gratë dhe vajzat, pa diskutim, dhe nuk duhet kurrsesi para ju t’ju errësojë në këtë mënyrë që ju të bëheni kaq të pandjeshme!

Zonja dhe zotërinj, unë jam sot këtu për të denoncuar përsëri Edi Ramën për bllokimin që i bën parlamentit.

Prej nëntë muajsh, unë kam dorëzuar në parlament amendamentin për heqjen e parashkrimit për kryeministrat dhe ministrat për efekt të korrupsionit. Edi Rama e bllokoi. E bllokoi, sepse ka vjedhur.

Në rast se nuk ka frikë nga vjedhjet e tij, le ta sjellë amendamentin që ta votojmë. Ju jeni në pushtet, unë jam në opozitë. Ju keni “SKAP-in”, unë nuk kam asgjë përveçse të drejtën time.

Pse ju nuk e sillni ligjin këtu? Më thoni pak, pse qeveria nuk e sjell ligjin? Sepse i dalin sarajet e Surrelit, të ndërtuara nga themelet dhe 2 kate nëntokë me 500 metra katrorë oborr, në një kohë kur kishte gjithsej 3800 *Deutsche Mark*-at, të deklaruara në Komisionin e Deklarimit të Pasurive.

Nuk e sjell ligjin, sepse është pallati në park, i ndërtuar pa asnjë faturë, pa asnjë të dhënë!

Nuk e sjell, sepse ka firmosur fap-fap-fap e pam-pam-pam për 420 milionë euro, për t’i vjedhur me Agaçin dhe linjën e tij, edhe me Ahmetajn e tij!

Nuk e sjell, sepse po grabit 5 miliardë euro pasuri publike përrallore në portin e Durrësit!

Nuk e sjell, ka frikë dhe tmerr, sepse Amant Josifi...

Ku është kjo ministrja e Jashtme? Nuk është këtu?

...këshilltari i Olta Xhaçkës, ortaku i Olsit, ka vjedhur me *bitcoin*, me *call center*-a 2,2 miliardë euro; po shkon dhe po i fsheh në Dubai!

Nuk e sjell, sepse po vjedh pasuritë, buxhetin e shtetit, kryetari i një organizate kriminale që ka vjedhur 123 miliardë lekë në nëntë muaj, sipas Kontrollit të Lartë të Shtetit!

Nuk e sjell, por unë i betohem atij se nëni i parë që do të votohet pas ardhjes në pushtet të Partisë Demokratike, do të jetë ky nen dhe le të shkojë në Karaibe, le të shkojë ku të dojë, por ai do të bëhet përgjegjës për të gjitha këto vjedhje!

(*Ministri Manja futet në sallë.*)

Erdhi dhe ky badigardi i tij tani. Po, se edhe ky e di, prandaj nuk e sjell ligjin, se është kriminel elektoral dhe krimet elektorale janë absolutisht të pafalshme, plus të tjera.

(*Bie gongu.*)

Ndaj, mos miratoni ligje, kur ju...

Ermonela Felaj – Mbaroi koha. Ju lutem!

Sali Berisha – Mbarova.

Se i vë edhe shpejt ti aty. Seç bën atje, ti e di vetë atë punë.

Ermonela Felaj – Zoti Berisha, keni folur 10 minuta dhe kaq është koha maksimale për të folur për çdo deputet.

Kështu që, ju lutem, uluni!

Sali Berisha – Dakord. Unë nuk kam nevojë për asnjë sekondë më shumë.

Ermonela Felaj – Mendova se do të flisnit për integritimin, por nuk folët asnjë minutë rreth tij.

Sali Berisha – Kaq kisha.

Këto janë arsytet përse nuk sillni ligjin.

Ermonela Felaj – Fjalën e ka kërkuar zonja Spiropali.

Elisa Spiropali – Më vjen mirë që doktor Berisha është lodhur aq shumë nga faqja e tij e zezë, sa që ka filluar t'i hedhë sytë edhe nga faqet tona të bardha.

Dhe, patjetër që, kur në *Facebook* vetëm nxin, vetëm shpif për vendin tënd, vetëm deformon të vërtetat, do të fillosh të kundrosh edhe nëpër faqet e ministreve dhe të ministrave. Por duhej t'i kishte parë mirë, sepse ne kemi reaguar me të gjithë forcën që na jep jo vetëm kjo

karrige, që nuk është dhe nuk do të jetë kurrë jona, është e përkohshme. Vetëm ai e mendon këtë karrige si të përhershme.

Sepse jemi nëna, jemi gra, me ndjeshmërinë më të lartë; unë personalisht, po edhe shumë të tjera, kryetarja e Komisionit të Ligjeve, po ashtu, kemi komunikuar me të gjitha institucionet e drejtësisë së re, për të bërë të mundur lirimin e menjëhershëm të asaj gruaje që është larguar nga foshnja e saj pakditëshe.

Edhe një herë, gjej rastin këtu, edhe pse e bëra në mëngjes, t'i bëj thirrje gjykatësit që ka marrë kërkesën nga avokati i kësaj gruaje, i Diana Bahçjes, ta lirojë menjëherë, sepse ia jep ligji këtë të drejtë!

Madje u bëj thirrje prokurorëve, gjykatësve, në daçi edhe policisë, që në raste të tilla jo vetëm të shohin ligjin, që e kanë e zeza në të bardhë, se nuk mund të arrestohet një grua e tillë, por edhe t'i thërrasin ndërgjegjes së tyre për të parë se si në sistemin tonë të burgjeve gratë dënohen më gjatë dhe rrinë më shumë në burg për krime...

(*Ndërrhyrje pa mikrofon*)

...të ngjashme. Pra, kur...

Jo, jo, prit, se ministri i Drejtësisë e ka bërë këtë punë. Studimet e tyre po përmend unë këtu.

(*Deputeti Berisha ndërhyrje pa mikrofon.*)

Pra, kur gratë që janë të pambrojtura konsiderohen të dobëta, gjykohen më gjatë edhe për shkak të mentalitetit patriarkal që nuk zotëron vetëm shoqërinë, por patjetër reflektohet edhe në sistemin e drejtësisë.

Ndërkohë, burra që kanë dhunuar e kanë vrarë, marrin masa më të lehta sigurimi, dalin më shpesh nga burgjet. Këtë të vërtetë duhet ta përmbysim me drejtësinë e re, por ne nuk jemi as prokurorë, as gjykatës, as satrapë, as arrestojmë njerëz, as u japim urdhra gjykatësve për të bërë ç'duam ne. Ama, ne kërkojmë, me të drejtën e ligjit dhe me të drejtën tonë këtu, si ministra dhe deputetë, mbi të gjitha si ministre, që kjo të ndodhë dhe të ndodhë sot, jo nesër, ajo grua duhet të lirohet!

Ashtu siç në rastin e gruas në moshë, që u vra në një lokal në zonën e "Don Bosko"-s, duke rritur mbesën e saj (familjen e së cilës e njoh personalisht dhe kam dhimbje të madhe dhe të thellë për rastin), nuk mundet që kriminelin t'u shpëtojë rretave të drejtësisë, që këta plumba të mos kapin gra, burra e fëmijë të pafajshëm.

Prandaj, e kemi forcuar sistemin e drejtësisë. Prandaj kemi bërë ndarje përfundimtare nga kontrolli politik mbi sistemin e drejtësisë, një kontroll, doktor, që, fatkeqësisht, e ngritët dhe e mbajtët në këmbë ju, me të gjithë forcën që ju jepte autoriteti juaj personal dhe si Kryeministër!

Keni bërë çmos që në sistemin e drejtësisë të mbanit njerëz të paaftë, të mbanit njerëz me kurse, të mbanit njerëz që nuk ishin për atë punë, por ishin besnikë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni bërë çmos që në atë sistem të mbanit njerëz të korruptuar dhe, patjetër, që kjo shoqëri i ka vuajtur pasojat e tentakulave tuaja nëpër prokurori, gjykata dhe kudo tjetër!

A është sistemi i drejtësisë perfekt? Jo, nuk kemi një shoqëri perfekte, nuk kemi një sistem drejtësie perfekte. Jemi larg prej saj. Ama, jemi duke dëshmuar se po i mbajmë duart larg nga sistemi i drejtësisë, se ne nuk pengojmë askënd, as të bëjë drejtësi, as të hetojë, as të arrestojë zyrtarë nga më të lartët, ajo që nuk ndodhte në kohën tuaj, sepse krimi dhe pushteti kishin imunitet.

Badigard nuk kishin Ulsiun, kishin ata që kishit vënë ju në sistemin e drejtësisë. Badigardët e krimit të pandëshkueshmërisë dhe të padrejtësisë ishin prokurorët dhe gjykatësit tuaj. Kjo është ndarja që ne kemi bërë.

E meqenëse përmendët ligjin “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit”, më lejoni t’ju kujtoj që sot përfaqësuesi i lartë i Bashkimit Europian është në Tiranë dhe po takon Kryeministrin e këtij vendi, me respektin më të lartë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...atë që nuk e bëjnë dhe nuk do ta bëjnë më kurrë me ju, Doktor...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...më vjen keq, nga partneri ynë strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, te Mbretëria e Bashkuar dhe, ndoshta, formalisht edhe Bashkimi Europian.

Ky është ndryshimi i madh mes nesh, ne punojmë me mjetet që na ka dhënë vota e qytetarëve, ajo për të cilën ju po bëni gjithçka që ta keni, por sa më shumë përçani, sa më shumë ndaheni, sa më shumë luftoni për pushtetin tuaj familjar dhe personal, aq më pak vota do të ketë opozita e këtij vendi! Aq më shumë do ta tkurrësh opozitën, aq më pak mundësi do t’i japësh

alternativës në këtë vend për të ekzistuar dhe për të na konkurruar!

Shihemi më 14 maj. Uroj të jeni të dyja palët në ato zgjedhje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Ministre!

Ju lutem, zoti Berisha, uluni, se ka një radhë për të dhënë fjalën!

Do t’ia jap fjalën zotit Manja...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...dhe pastaj do të shikoj për fjalën tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, patjetër, zonjë, sepse foli dhe ka kërkuar replikë ministri i Drejtësisë dhe ka të drejtë! Dakord?

Kështu që, mos ndërhyini, se unë po e ndjek seancën me vëmendje!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk i marr udhëzimet nga ju, por shoh se çfarë ndodh dhe, natyrisht, Rregullorja e ka të përshkruar qartë. Nuk ka pse të reagoni tani nga vendi për çdo gjë.

Fjalën e ka ministri Manja, për replikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ermonela Felaj – Ju lutem!

Përdorët shprehje fyese ndaj ministrave, përfshirë atë të Drejtësisë, i cili ka kërkuar fjalën për replikë dhe do t’ia jap fjalën për replikë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

E kam shumë shkurt, në fakt.

(Deputeti Berisha ndërhy nga vendi, pa mikrofon.)

Zoti Berisha, kur më etiketon ti si “kriminel elektoral”, ma beso, më bën nder!

Tani, kur etiketon dikë “kriminel”, raporti është me drejtësinë. Unë kam qenë dhe jam gati të shkoj para drejtësisë. Po ti, a je i gatshëm që për 32 vjet e kusur për akuza e fakte konkrete të shkosh para drejtësisë? Këtë pyetje kam për ty.

Dakord?

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Ministër!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Berisha, për çfarë e keni kërkuar fjalën?

Replikë mbi replikë, nuk ka.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Repliko i Berisha me ministrat, me të dy ministrat.

Repliko i Berisha. Mori përgjigjen. Replikë mbi replikën, nuk ka.

Kështu që, zoti Berisha, lirojeni foltoren, sepse qartësisht nuk keni të drejtë për ta marrë fjalën!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju lutem, nuk përmendët emër, por thatë: “Edhe kjo që po flet mbrapa meje” dhe qartësisht iu referuat ministres Spiropali. Dakord?

Zoti Berisha, të jemi *fair* me ato që thatë dhe të jemi pak...

Ju lutem, nuk keni të drejtën për të marrë fjalën!

(Deputeti Berisha ndërhyr nga vendi pa mikrofon.)

Fjalën e ka zoti Gjijnuri. Koha në dispozicion është 10 minuta.

Të përgatitet zoti Leskaj.

Damian Gjijnuri – Mirëdita!

Në fakt, për çudi, ky parlament sot për këtë projektligj që ka të bëjë me integrimin, duhej të kishte një ton, një mesazh tjetër, aq më tepër që sot kemi në vizitë shefin e diplomacisë europiane, që jep mesazhe progresi, mesazhe të së ardhmes europiane të Shqipërisë, gjë që normalisht duhej të reflektohej në këtë Kuvend nga të gjitha palët politike. Por, fatkeqësisht, kemi edhe këtë “vulëhumburin” që gjithmonë, sa herë i humbet vula, i ngrihet më shumë zëri, që, fatkeqësisht, i kthehet edhe fantazma e vetë vdekjes. Siç duket, dilema makbethiane për ato krime që ka kryer ndër vite, në Gërdec apo jo shumë kohë më parë me vrasjet e “21 Janarit”, kjo fantazmë vdekjeje, i ringjallet shpeshherë Shqipërisë, e mban peng këtë vend fatkeqësisht dhe kjo është për të gjithë shqiptarët, nuk është problemi i debatit tonë politik.

Ne mund të bërtasim këtu, jemi palë politike, por ku po shkon ky vend kështu? Ç’është ky dialog politik? Ç’është kjo dëshirë e zjarrtë për të kthyer vazhdimisht tension, për ta paraqitur vendin si vendin e zi të Europës, pikërisht nga ata njerëz që kanë përgjegjësi direkte për shumë e shumë vite për mënyrën se si e kanë qeverisur këtë vend dhe tani vijnë e sfidojnë përsëri me të njëjtat metoda që u burojnë nga e kaluara e tyre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, kjo është ajo që shqiptarët nuk duhet ta pranojnë dhe të gjithë duhet të gjykojnë. Shqipëria ka të metat e saj, ka një trashëgimi historike jo shumë për t’u krenuar. Për shkak të pozicionit të saj gjeopolitik, historia nuk ka qenë shumë me fat për ne. Ama, në fund të fundit, ne duhet të bëjmë çmos të gjithë për ta bërë atë një vend më të mirë, se ndryshe ky vend nuk ka të ardhme. Nuk ka të ardhme duke i nxjerrë sytë njëri-tjetrit apo duke risjellë fantazmat e vdekjes, apo duke bërë thirrje për dhunë. Kurrë, asnjëherë si këto!

Në fund të fundit, Shqipëria është një vend i vogël, që duhet të udhëhiqet nga parimi i bashkimit dhe i së ardhmes drejt Europës, por pikërisht ne jemi të parët që e shembim këtë. Këta njerëz, që normalisht e kanë mbaruar misionin e tyre në politikë, nuk kanë pse të sjellin gjithmonë në këtë Kuvend këto lloj retorikash vdekjeje dhe fantazmash. Kjo është fatkeqësi, aq më tepër të ketë gojë dikush të flasë për drejtësinë apo për të hequr ato që quhen “limitet e parashkrimit”, njeriu që nuk zbatonte as vendimet e drejtësisë për të ekzekutuar vendimet që ishin ndaj zyrtarëve të saj.

Si mund të flasësh ti për parashkrim, kur ti nuk zbaton as vendimet që janë në fuqi? Harroni që drejtorët tuaj firmosnin nga arresti në shtëpi, drejtonin institucionet më të rëndësishme të shtetit?

Harroni se ç’bëtë me oficerët e Gardës, kur dolën urdhrat e arrestit nga drejtësia? I negocionit njësoj sikur shkëmbenit pengje. Kjo është drejtësia që ju kishit në mendje? Pikërisht kjo është drejtësia e kontrolluar.

Jo të gjithë janë të lumtur me drejtësinë. Patjetër, drejtësia ka shumë probleme si drejtësia që ishte atëherë, që, praktikisht, erdhëm në pikën që pati një konsensus të madh kombëtar që duhet dhe ka nevojë për një reformë në drejtësi, sepse u nxi aq shumë ajo drejtësi, sa që realisht asnjë nuk besonte më aty.

Patjetër, drejtësia ka probleme edhe tani. Është një proces i vështirë, jo të gjithë jemi të lumtur, njerëzit kanë frustrim, por të mos harrojmë një gjë: ka ndodhur një gjë e madhe që, përgjithësisht, pak herë politika heq dorë, politika ka hequr dorë nga drejtësia. Mazhoranca ka hequr dorë nga instrumentet e saj.

Dikur drejtësia kishte instrumente të tilla që politika mund të ndikonte në promovimin e

gjyqtarëve dhe të prokurorëve, sepse i tillë që ndërtuar sistemi.

Si mund të akuzosh një mazhorancë, e cila me vullnetin e saj hoqi dorë nga një gjë, për të cilat vendet e tjera bëjnë luftë për ta kontrolluar? Jo më larg sesa... Shikoni ngjarjet në Izrael. Unë nuk dua të bëj krahasime, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

...atje po bëhet një betejë e fortë politike për kontrollin ose jo të drejtësisë. Ndërkohë, mazhoranca socialiste, me dëshirën e saj, e nxitur dhe e inkurajuar nga partnerët perëndimorë, mori iniciativën për të reformuar drejtësinë dhe për të ndryshuar Kushtetutën e Shqipërisë, ku patjetër edhe ju u bashkuat me zor. Ju, që flisni tani për statusin e parashkrimit, ishit ata që kundërshtonit reformimin!

E pra, pikërisht për shkak të asaj reforme ne tashmë kemi një drejtësi të re, nga e cila politika ka hequr dorë. Nuk e ka më nën kontroll. Shpeshherë edhe njerëzit tanë nuk e pëlqejnë këtë. Neve na thonë... (ne jemi politikanë, e dimë, takojmë shumë njerëz): si ka mundësi, thonë, vetëm njerëzit tuaj? Si ka mundësi, keni pushtetin, si mund të goditen zyrtarët tanë? Çfarë u bë me gjithë atë të kaluar të errët berishiane, e shumë e shumë krime që ai i ka në kurriz të tij dhe të shqiptarëve? Pikërisht pra, kjo është drejtësia dhe politika ka hequr dorë.

Mund të duket dobësi, por për mendimin tim është gjëja e duhur, pasi qeveria nuk mund të marrë përsipër të bëjë punën e drejtësisë.

Kështu që, normalisht, të gjitha ato akuza që hidhen këtu janë të tepërta.

Duhet të shikojmë edhe themelin. Gjithçka është politikë e ditës. Këtu vërtet gjithmonë akuzohet dhe shahet çdo njeri, që është “kriminel, hajdut, i korruptuar”, kjo dihet, këta janë terma që vazhdimisht janë përdorur rëndom, por lërin organet e drejtësisë të bëjnë punën e tyre.

Vullneti politik duket sa ti heq dorë nga ajo që ke në dorë. Në qoftë se ti mundohesh ta kesh atë në dorë dhe ta mbash edhe më fort, si dhe të ushtrosh presion duke forcuar pozitën tënde ndaj një pale më të dobët, dhe në këtë rast ndaj një pushteti që nuk duhej të të takonte, atëherë mund ta gjykoni këtë mazhorancë. Por kur ajo ka hequr dorë nga ndërhyrja në drejtësi, sepse ju e dini shumë mirë që mazhoranca nuk ka mundësi të ndikojë për asnjë emërim në drejtësi sot, sepse të gjitha emërimet vijnë nga organe që vetëqeverisen

dhe politikës nuk i mbetet gjë tjetër veçse të gjejë konsensus në raste të caktuara (gjë që është shumë e vështirë në këtë sallë, sepse fjala “konsensus” këtu është antiKrisht, anatemë), pra asnjë nuk mund të flasë këtu për konsensus dhe për dialog. Ama, lërin organet e drejtësisë të bëjnë punën e tyre dhe ky është hapi i vërtetë drejt integritit që këtu të ketë një pushtet që vërtet të meritojë respektin e qytetarëve dhe që praktikisht e ka vënë qeverinë shqiptare në pozitën që, sado vërtet mund të duket e dobët, ajo është në pozicionin e duhur për të hequr dorë nga një pushtet që nuk i takon.

Kjo është arsyeja përse sot, edhe në Tiranë vijnë zyrtarë të lartë europianë, kjo është arsyeja pse qyteti i Tiranës, kryeqyteti i Shqipërisë, u kthye në një qendër të rëndësishme të një samiti ndërkombëtar, gjë që nuk ka ndodhur ndonjëherë më parë, pikërisht sepse Shqipëria paraqet stabilitet.

Unë e di që fjala “stabilitet” duket si një gjë e parëndësishme, sepse njerëzit mendojnë: ku është demokracia ideale? Pa stabilitet nuk ka zhvillim dhe as institucione demokratike.

Ama, Shqipëria, falë Zotit dhe falë punës së kësaj qeverie, po falë edhe shumë rrethanave të tjera, sot është vendi më stabil nga pikëpamja institucionale dhe demokratike në Ballkanin Perëndimor. Vendet e tjera kanë vështirësi të qeverisin, nuk kanë një qeveri të tyren, ecin me qeveri tranzitore, nuk kanë mazhoranca të qëndrueshme, kanë kriza të brendshme, kanë probleme që ngrihen edhe nga jashtë.

Ke vende të tjera më të mëdha, si Serbia, që kanë një pozicion sa me Perëndimin, aq edhe me Rusinë, dhe kanë pozita të vështira. Atëherë, përse të mos e mëkojmë ne? Pse të mos e mbajmë mirë këtë status të Shqipërisë? Pse të mos punojnë të gjitha palët që statusi dhe prestigji i Shqipërisë të rritet siç duhet, për të pasur më shumë investime, për të pasur më shumë forcim të institucioneve?

Nuk ka demokraci pa zhvillim ekonomik, harrojeni këtë!

Sulmoni çdo gjë që lidhet me biznesin për një arsye. Kaq gjë e kupton çdo njeri. Një vend që është i varfër, do të jetë gjithmonë pjesë e tensionit politik.

Nuk mund të vijë demokracia e kulluar aty ku ka varfëri. Harrojeni!

Demokracia do të vijë aty ku ka zhvillim ekonomik dhe pa këtë të fundit, nuk ka

institucione të konsoliduara. Merrini ligjet dhe përkthejini sa të doni, merrini praktikat ndërkombëtare e përkthejini nga anglishtja në shqip, por asnjëherë nuk do të kthehet në atë kulturën demokratike që duam të gjithë!

Duhet të vijë zhvillimi ekonomik, gjë që do të sjellë edhe emancipimin shoqëror, edhe modernitetin e kësaj qeverie dhe vërtet ne do të ndihemi europianë, por në fillim, fatkeqësisht, duhet të largohen disa që kanë 30 vjet, e thashë, që i vërtiten këtij vendi vazhdimisht, duke mos sjellë asgjë të mirë; edhe ato pak gjëra të mira që kanë bërë i fshiu historia, sepse u mbeti vula e humbur dhe emri i keq. Pikërisht, kjo duhet të fillojë e para.

Unë mendoj se zgjedhjet që janë përpara, do të jenë një mundësi e mirë që ai popull i heshtur, racional, të cilin, pavarësisht se ne mundohemi ta anatemojmë duke thënë që u shitka, u bleka, që s'kupton, që është i varfër apo që e manipulon qeveria, ka një koshiençë dhe me votën e tij të fshehtë do të dijë të vlerësojë se cilët janë ata që duan të mirën e këtij vendi dhe cilët janë ata që u mbetën ferra nëpër këmbë.

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja, zonja Nikolla)

Lindita Nikolla - Fjala për zotin Bujar Leskaj.

Të përgatitet zonja Klotilda Bushka.

Bujar Leskaj – E nderuar zonja Kryetare,

Me thënë të drejtën, kur merr fjalën këtu në Kuvend, duhet të jesh shumë i kujdesshëm, se në fjalimet tuaja, të deputetëve të mazhorancës, ka shumë hipokrizi, po kalohet masa, ka inflacion demagogjic. Megjithatë, kjo është puna juaj.

Unë dëshiroj të flas për projektligjin që është paraqitur “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian””. Ky projektligj në thelb kërkon të ripërmasojë në rritje rolin e parlamentit në procesin e integritetit. Pavarësisht qëllimit të mirë për një dinamizëm dhe ritëm më të lartë në rrugëtimin integruar të vendit, qëllim të cilin e përshëndes, duke vlerësuar veçanërisht punën e bashkëdrejtueses të Komisionit Parlamentar të Integritetit, zonjës Tabaku, projektligji rrezikon të realizojë vetëm disa ndërhyrje kozmetike në mundësitë reale që Kuvendi ka për të nxitur, përshpejtuar, mbikëqyruar dhe monitoruar me

efektivitet futjen e vendit në familjen e madhe europiane, objektivin tonë madhor.

Për mendimin tim, kjo ndodh për disa arsye dhe unë po e nis nga rimmëtimi që ju i bëni Komisionit të Integritetit Europian me këtë amendament. Ju kërkon që nga Komisioni i Integritetit Europian ta quani “Komisioni i Çështjeve Europiane”. Ky emërtim ka ardhur si propozim që në vitin 2004, me vendimin nr. 166 të Kuvendit, pasi që edhe në Rregulloren e Kuvendit është vendosur krijimi i këtij komisioni. Çfarë kuptimi ka ndryshimi i emërimit? Faktin që struktura kryesore përgjegjëse e parlamentit shqiptar, Komisioni i Integritetit Europian, do të ndryshojë në emërtim qëllimin kryesor që ka, integritetin europian.

Me çështjet europiane po merremi prej 30 vjetësh tashmë, madje jemi marrë prej qindra vjetësh. Sot misioni, jo vetëm i Kuvendit, por i mbarë shoqërisë sonë, duke përfshirë forcat politike, qeverinë, institucionet e pavarura, shoqërinë civile, mediat e të tjera, është integrimi sa më i shpejtë i vendit në Bashkimin Europian dhe i tillë, sipas misionit dhe qëllimit, duhet të qëndrojë edhe emërtimi i komisionit parlamentar “Komisioni i Integritetit Europian”, sepse integrimi është kryefjala, është kryeqëllimi.

Ne duhet të përzgjedhim në qasjen tonë drejt komisionit sugjerimet dhe frymën e sjellë nga eksperti gjerman Hans-Joachim Falenski, kur cilëson se vendimet dhe propozimet e Komisionit Parlamentar të Integritetit Europian duhet të kenë fuqi detyruese, në atë masë sa jo vetëm t'i mbikëqyrë, por edhe të shprehë vullnet mbi qëndrimet dhe pozicionet negociuese të qeverisë. Madje, po ky ekspert shprehet se kapacitetet e Kuvendit duhet të rriten dhe të fuqizohen duke qenë përpara procesit të negociatave. Por, a do të arrijmë të jemi të suksesshëm në këtë përzgjedhje? E ngre këtë pyetje për faktin se, kur opozitës nuk i mundësohet të ngrejë një komision hetimor për skandalin “McGonigal”, apo dy-tre të tillë që janë kërkuar, që është një e drejtë kushtetuese e saj, përmes artificash se gjoja Rregullorja parlamentare për ngritjen e komisioneve hetimore është në rishqyrtim, si mundet që Komisioni i Kuvendit për Integritetin Europian të lejohet nga qeveria të vendosë veton mbi vendimmarrjen qeveritare për integritetin, apo që projektpozicionet negociuese për kapituj të caktuar të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit

të miratohen nga Komisioni i Integritimit Europian (janë 33 të tilla, të ndara në 6 porta) dhe që strategjia e negociimit dhe pozicionet përkatëse negociuese të paraqiten në komision, të diskutohen në parlament, kur tashmë ju e keni shndërruar parlamentin në një shtojcë, në një noter të rëndomtë të qeverisë?

Ne duhet të kemi mirë parasysh rigorozitetin dhe risitë e metodologjisë së re të zgjerimit të Bashkimit Europian, të cilat u miratuan në prill të vitit 2020 për të rritur besimin te procesi dhe për ta bërë sa më real dhe dinamik procesin e integritimit. Kjo metodologji i jep një rol më të madh monitorimit sistematik nga shtetet anëtare të procesit të negociatave.

Po ashtu, metodologjia e re e zgjerimit parashikon një proces më të qartë vlerësimi, duke përcaktuar konkretisht pasojat pozitive që sjell progresi në sferën e negociatave, por edhe ato negative nëse nuk konstatohet progres. A jeni ju të aftë që të diskutoni edhe për pasojat negative, për regresin? Në rastet e pasojave negative, Komisioni Europian propozon masa proporcionale që sanksionojnë stanjacionin serioz ose të tejzgjatur ose regres në zbatimin e reformave. Negociatat mund të pezullohen në fusha të caktuara, të pezullohen të gjitha ose edhe të rihapen kapitujt e përfunduar. Përfitimet nga një integrim i afërt mund të pezullohen, siç është përfitimi nga programet e financuara nga Bashkimi Europian.

Metodologjia e re e zgjerimit e vitit 2020, të cilën unë jam i bindur se ju nuk e keni në vëmendje, ka sjellë ndryshime thelbësore, duke krijuar një kuadër tërësisht të ri për sa u përket negociatave, përmes një fokusi më të madh te reformat themelore, si shteti i së drejtës, funksionimi i institucioneve demokratike, administrata dhe ekonomia. Metodologjia kërkon që këto reforma të mos jenë vetëm projektim i një angazhimi politik, por realizimi në praktikë i premtimeve politike. Pikërisht, këtu ju cedoni si mazhorancë: në realizmin në praktikë të premtimeve politike. Për fat të keq, gjykoj se asgjë e tillë realisht nuk do të ndodhë. Nuk ka asnjë garanci që kjo qeveri që kemi, të dëgjojë zërin e opozitës, të institucioneve të pavarura dhe të shoqërisë civile, përfshirë edhe komisionin në fjalë, i cili drejtohet nga një përfaqësuese e opozitës, për veprimet kryesore në procesin e integritimit europian. Mjafton të përmend

shembullin më të freskët, propozimin e zonjës Kryemadhi. Ju nuk keni kurajën të pranoni një propozim të thjeshtë të deputetes së opozitës, zonjës Monika Kryemadhi, për përfshirjen e përfaqësuesve të partive parlamentare në Këshillin Kombëtar të Integritimit. Pra, krahas partnerëve të tjerë që janë pjesë e tij, si shoqëria civile, sindikatat, academia dhe të tjera, të jenë edhe përfaqësuesit e partive politike. Përse? Kur ju tani po e përmirësoni ligjin sipas konceptit tuaj. Por ju çdo përmirësim e doni, jo që të dëgjohet zëri i opozitës, por përkundrazi të sfumohet, të latohet.

Unë gjykoj që edhe sot nuk jeni vonë për propozimin e zonjës Kryemadhi për ta miratuar në amendamente, në rast se është paraqitur si propozim për plotësim në këtë draft të përgatitur nga ju.

Fuqizimi i rolit të Kuvendit të Shqipërisë është kërkuar me forcë dhe me insistim edhe nga projektrezoluta e Parlamentit Europian, nga Komisioni i tij i Marrëdhënieve me Jashtë, në faqen 6 të rezolutës me nëntemën “Zotime ndaj futjes në Bashkimin Europian, e përgatitur dhe e publikuar në datën 7 mars 2023 nga një komisionere, e cila është përfaqësuese e të majtës në Parlamentin Europian.

Projektrezoluta përfaqëson një nga dokumentet më të ashpra të viteve të fundit për Shqipërinë, ku Parlamenti Europian mban shënim mungesën e progresit në liritë themelore të qytetarit dhe kritikon me forcë qeverinë për nismat e saj të projektligjit për amnistinë fiskale dhe për pasaportat e arta, në këmbim të investimit në Shqipëri nga sipërmarrës të huaj, gjoja strategjikë.

Parlamenti Europian përmes një projektrezolute që është në procedurat e miratimit, e cila shumë shpejt do të shndërrohet në rezolutë në bazë të praktikave të tij, ka kritikuar qeverinë shqiptare për përsheptimin e procedurave të dhënies së pasaportave të arta për të huajt në Shqipëri, ka ritheksuar problemet me prokurimet publike, si dhe degradimin e lirisë së medias dhe të konkurrencës së lirë.

Projektrezoluta e ka shprehur qartë shqetësimin për pasaportat e arta të përgatitura nga qeveria në këmbim të investimeve nga investues të huaj strategjikë, një pjesë e të cilëve shumë të dyshimtë, si skemë e papajtueshme me normat e Bashkimit Europian dhe politikën e tij të

vizave. Në një kohë kur ju gjithë ditën flisni dhe ne të tjerët flasim për integrimin europian dhe orientimin e shoqërisë sonë dhe mbarë ekonomisë së vendit drejt vendeve të Bashkimit Europian, ju, edhe portin e Durrësit, këtë urë lidhëse mijërvjeçare të Shqipërisë me Perëndimin, ia jepni një arabi, pavarësisht se kush është ai, pavarësisht problematikave që ka ky projekt apo edhe riskun që ka për politikën tona të sigurisë.

Përmes raportueses së tij për Shqipërinë në Komisionin e Marrëdhënieve me Jashtë, Parlamentin Europian shpreh shqetësimin për mungesën në sigurinë e lirisë së shprehjes dhe lirisë së medias.

Sot, pas disa muajsh sulmesh të paprecedenta, gjithnjë selektive ndaj një biznesi të caktuar që suporton edhe media, ju keni bërë tashmë që përfaqësues të konsiderueshëm të mediave të rrjetit “Panorama”, “Balkanweb” dhe televizionit “News 24” apo dhe të tjerë të shprehjen të shqetësuar, duke bërë që gazetarët t’u drejtohen drejtuesve të BE-së për kërcënimin real që vjen nga qeveria.

Ju jeni qeveria që këshilltarët mediatikë dhe patronazhistët tuaj po i bëni gjoja përfaqësues të shoqërisë civile, fitues pa garë reale të thirrjeve të AZHBR-së dhe agjencive të tjera shtetërore, si dhe përfitues të dhjetëra milionë lekëve të taksapaguesve shqiptarë.

Ja përse ndryshimet e propozuara në këtë projektligj, për fat të keq, janë thjesht kozmetike dhe përbëjnë një të kuq buzësh për qeverinë, që të mburret në Parlamentin Europian në Bruksel, të mburret edhe sot në takim, se ka fuqizuar rolin e parlamentit në procesin e integritimit. Kjo është një fasadë, është fasada “më e madhe”, “më rrëzëlluese”, “më madhështore” që ju keni ngritur dhe keni krijuar për qytetarët shqiptarë.

Megjithatë, në fund mendoj se në nenet e ligjit në fjalë, të amendamentit që ju keni bërë, komisioni përzgjedhës duhej të kishte përfshirë, konkretisht te neni 11 apo edhe te neni 12, te kompetencat dhe përgjegjësitë e Kuvendit për Çështjet Europiane dhe detyrimin, përgjegjësinë e deputetëve për të informuar qytetarët. Ne duhet të shkojmë te qytetarët. Ne duhet t’u flasim atyre për negociimin, për negociatat për kapitujt që hapen, kapitujt që do të rrezikojnë. Ne të gjithë duhet t’u flasim si deputetë të popullit dhe jo deputetë të partive. Pse e theksova këtë? E theksoj, sepse po të shikosh relacionin e paraqitur nga komisioni

përkatës, në harkun kohor të dy javëve ky projektligj është vendosur në faqen e uebit të Kuvendit për t’u komentuar dhe për të marrë sugjerime nga qytetarët shqiptarë, por ka pasur zero interes. Ka pasur zero interes, sepse edhe ajo pjesë e shoqërisë civile që ju angazhoni, për fat të keq, në masën më të madhe vendoset në shërbimin tuaj apo është pjesë e shoqërisë civile, që në raste të caktuara është shumë e deformuar në veprimtarinë e saj në procese të caktuara. Ju dhe përfaqësuesit e komisionit keni vendosur këtu përvojën që keni marrë nga shtete të caktuara të BE-së apo jo të BE-së dhe përmendni shtete të tilla si Kroacia, Estonia, Mali i Zi, Maqedonia, Sllovakia dhe Rumania.

Lindita Nikolla – Ju lutem, mbaroni, se keni kaluar 2 minuta!

Bujar Leskaj – Shumë mirë bëni, por ju merrni përvojë edhe nga Serbia. Çfarë përvoje mund të merrni ju nga Serbia për integrimin në BE? Çfarë përvoje kanë marrë anëtarët e komisionit në diskutime nga Serbia, nga një shtet thellësisht armiqësor me Shqipërinë dhe Kosovën? Ju e keni vendosur këtu (një pjesë e anëtarëve të komisionit, jo pjesa e anëtarëve të opozitës apo edhe ekspertët e shoqërisë civile), me qëllim që të vazhdoni akoma me pikturimin e procesit të Ballkanit të Hapur, proces i cili shkon në kundërshtim me progresin e Berlinit dhe me interesat e kombit shqiptar.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Etjen Xhafaj.

Të përgatitet zoti Oerd Bylykbashi.

Etjen Xhafaj – Shumë faleminderit!

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Projektligji, të cilin besoj se do ta votojmë të gjithë sot njëzëri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”, është produkt i një komiteti, i një komisioni të posaçëm parlamentar, i cili është ngritur në vitin 2020 me miratimin e të dy krahëve politikë të këtij parlamenti për të kryer specifikisht një tur të gjatë konsultimi me kuadrin ligjor ndërkombëtar, kryesisht të huazuar nga vendet e Bashkimit Europian, me aktorët kryesorë në Shqipëri, me shoqërinë civile, emrat e të cilëve janë edhe në relacionin, me ekspertët që janë

pyetur, të cilët nuk kanë qenë vetëm ekspertë të maxhorancës, por kanë qenë edhe ekspertë të opozitës, si dhe me entitete të ndryshme, të cilat janë përfshirë në këtë proces konsultimi.

Duke u ndalur te disa nga diskutimet që u bënë sot më herët, kur thuhet gjithë kohës që mburremi me ligjet, unë besoj se ky është një ligj për të cilën kemi dhënë kontribut të dy krahët, pasi është akorduar për ato gjëra që supozohet të vihen në detyrë, për atë që është procesi më madhor për të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilin e mbështesin në masën dërrmuese, mbi 96%. Kështu, pra, nuk është nevoja të bëjmë sikur është ligji i njërit krah apo vetëm i krahut tjetër, është i të dy krahëve politikë. Pak më herët u tha se hapat më të mëdhenj në procesin e integritit europian janë hedhur në kohën kur qeveriste Partia Demokratike dhe ajo që thuhet rëndom se në 10 vjetët e fundit nuk është bërë asnjë gjë në këtë drejtim. Në fakt, edhe sot në mes të Tiranës është duke u zhvilluar mbledhja e parë e Këshillit të Stabilizim-Asociimit jashtë Brukselit, e cila do të vijojë me një mbledhje në Shkup. Kjo është mbledhja e 12-të për Shqipërinë dhe është tregues për një proces që ka avancuar, i cili nga 17 korriku ka shpallur edhe hapjen e negociatave, i cili më 6 dhjetor në Tiranë mblodhi përfaqësuesit e të gjitha vendeve të Bashkimit Europian, përfaqësuesit më të lartë të tyre, të cilët për herë të parë nga një kryeqytet jashtë vendeve të Bashkimit Europian i folën Bashkimit Europian, gjithë botës dhe të gjitha vendeve që kanë një synim.

Po ashtu, Procesi i Berlinit që u përmend edhe më parë, këtë vit do të zhvillohet në Tiranë. Avancimi me grupkapitujt, pra klasteri i parë dhe klasteri i dytë sa i përket procesit *screening* ka avancuar dhe është përmyllur me sukses. Pra, kemi një avancim në këtë proces. Në qoftë se kemi qenë ndonjëherë më afër Bashkimit Europian, ndoshta kemi qenë më herët, në vitet '90, por e dimë të gjithë se çfarë ndodhi me atë vagon dhe se si ndodhi që nga i pari përfundoi i fundit. Pronësia mbi autorësinë e negociatave është një pronësi që në këtë sallë duhet të jetë e të gjithëve, e të 140-ve, sepse është një nga ato prioritetet bazike, primare për të gjithë qytetarët që përfaqësojmë ne. Prandaj, sa herë duam të sulmojmë reformat strukturore, që nuk janë bërë aq shumë sa do të donim ne, duhet të shikojmë që ky është thjesht një hap tjetër. Ato reforma strukturore na kanë sjellë në këtë pikë, ku u hapën

negociatat dhe ku po vazhdon zhvillimi i institucioneve, sepse demokracia mbështet tek institucionet. Nuk mund të vazhdojë gjithmonë koncepti që institucionet janë institucione vetëm kur bëjnë atë që është në agjendën politike të opozitës. Sigurisht, janë emra të përveçëm, të padëshiruar nga opozita që mendojnë kështu, sa herë institucionet bëjnë diçka që bie përkundër saj. Kjo sepse jemi në një moment shumë kritik në historinë e zhvillimit dhe ecjes drejt integritit europian të shqiptarëve. Jemi në vitin kur i kemi shpallur negociatat, kur kemi avancuar me negociatat dhe jemi përpara një procesi shumë kritik për të treguar avancim, përpara zgjedhjeve të 14 majit. Me këto zgjedhje ne duhet të tregojmë progres përpara institucioneve europiane, jo të tregojmë njëri-tjetrin me gisht për shkelje të bëra apo të menduara dhe të mos vazhdojmë me baltë kundër njëri-tjetrit, por të gjithë krahët e politikë së bashku, pavarësisht ku janë dhe si i kanë mundësitë, të bëjnë pjesën e tyre për ta çuar përpara këtë proces.

Ato që parashikon ky projektligj, janë të përfshira edhe në konkluzionet e dokumentit që kemi shqyrtuar përpara dyjavësh, sjellë këtu nga Këshilli Kombëtar i Integritit Europian, edhe në pjesën e konkluzioneve, edhe në pjesën e hapjes së tij. Sigurisht, roli i diplomacisë parlamentare, siç e dimë të gjithë, është një rol tepër i rëndësishëm në këtë proces. Roli i Kuvendit po ngrihet, qoftë me ato që janë kompetencat shtesë që i shtohen komisionit tanimë të quajtura "Komisioni për Çështjet Europiane", siç janë raportimi çdo 3 muaj, monitorimi nga afër i të gjitha proceseve dhe i të gjitha avancimeve të negociatave sa u përket klasterave apo grupkapitujve, qoftë sepse parashikon edhe një përfshirje me të gjerë nga shoqëria civile, nga të gjithë aktorët, si dhe nga grupet e interesit. Këto grupe preken në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo vetëm në momentin e integritit, por edhe nga raportimi dhe përafrimi i legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Europian, duke filluar nga shoqatat e biznesit te prodhuesit, deri te pjesa akademike, universitetet dhe sindikatat. Kështu, pra, këto grupime duhet të jenë pjesë e qenësishme e këtij procesi për të krijuar një avancim të përbashkët, për të ngritur dhe për të rritur kapacitetet institucionale që janë thelbi qoftë në ngritjen, qoftë në forcimin e institucioneve.

Gjithashtu, duke qenë të gjithë përfaqësues bashkë të ndryshme dhe komunitetesh të ndryshme, unë besoj se ne duhet të kemi një fokus të veçantë të bashkitë e vogla, siç janë, për shembull, bashkitë që unë përfaqësoj këtu Kavaja dhe Rrogozhina, të cilat për sa u përket burimeve njerëzore dhe kapaciteteve për të tërhequr fonde, për t'u zhvilluar projekte dhe për t'i impelmentuar ato me sukses, kanë nevojë për një punë shumë të madhe. Jam i bindur se kjo nuk varet fare nga cila palë është mazhorancë apo opozitë, për sa kohë që projekte, si *trilateral-et* apo *crossbord-et* mund të sjellin zhvillim.

Ky projektligj ka 17 nene që parashikojnë se si do të sanksionohet dhe do të vendoset në veprim i gjithë ky kuadër ligjor. Duhet të kujtojmë edhe një herë që Shqipëria është vendi i parë, i cili po e sanksionon me ligj rolin e parlamentit në procesin e integritimit. Synimi kryesor i projektligjit është gjithëpërfshirja. Pra, çfarë na ndan, na ndan, por përpara Brukselit, për atë që është aspirata e njerëzve që ne përfaqësojmë, duhet të jemi të gjithë bashkë. Pavarësisht ndryshimeve në kuadrin negociator dhe me futjen e ritmit të ri (ritmi ku nuk hapen dhe mbyllen kapitujt, por negocohen në grupkapituj në klastera), për ne është shumë e domosdoshme që t'i bëjmë edhe pak më shpejt hapat, por ama asnjëherë duke kompromentuar cilësinë e ligjeve dhe të zbatimit të tyre me atë që është shpejtësia me të cilën këto ligje duhet të implementohen për t'u përafuar me *acquis communautaire*.

Projektligji synon, gjithashtu, një kalibrim të qëndrimeve politike, *vis a vis* institucioneve dhe kuadrit ligjor, i cili, sigurisht, do të duhet të jetë në rakordim të plotë me ligjet e Bashkimit Europian duke shtuar në këtë rast monitorimin parlamentar për të gjitha kriteret dhe masat, të cilat janë duke u negociuar, duke folur për një rol më aktiv dhe bashkëpunues të të gjitha institucioneve parlamentare, por veçanërisht për rolin e deputetëve. Besoj shumë fort që të gjithë bashkë duhet ta votojmë këtë projektligj për të mos e lënë integrimin europian të Shqipërisë dhe të shqiptarëve rrugëve të sherreve politike, si dhe për të mos i lënë shqiptarët rrugëve të Bashkimit Europian.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Të përgatitet Flutura Aça.

Fjala për zotin Oerd Bylykbashi.

Oerd Bylykbashi – Të nderuar kolegë,

Ligji që po diskutojmë sot sigurisht që do të votohet, jo për faktin se është bërë me konsensus në një komision të posaçëm, por për faktin se fundja çdo përpjekje për të shtuar disa rregulla plus në procesin e integritimit europian, në atë që është supozimi se do të rrisim fuqinë e parlamentit për kontrollin e procesit të integritimit, ia vlen të provohet. Unë besoj se, si ju të mazhorancës, si ne të opozitës, ata që e kanë hartuar dhe ata që do të votojnë sot, por më shumë ata që na dëgjojnë nga jashtë kësaj sale e dinë shumë mirë që ky ligj nuk mund të jetë as luan pa dhëmbë, madje do të përfundojë si një mace pa dhëmbë. Në fund fare, parlamenti ka vlerë për aq sa është në gjendje të ushtrojë realisht kontrollin dhe trysinë mbi një mazhorancë, mbi një qeveri, se mazhoranca jeni ju. Në fund të fundit, kontrollin e parë e bën qeverisja, vetë mazhoranca. Ju duhet të keni frikë për këtë mënyrë qeverisjeje, se humbisni zgjedhjet, por, për sa kohë ju nuk guxonin as të ngrini kokën kur ju flet Kryeministri, kjo nuk ekziston.

Po mirë, sa besojmë te ky ligj, te këto ndryshime? Ligji, në fakt, është i vitit 2015. Bëhen gati 8 vjet që ne e kemi këtë ligj, kemi edhe Këshillin e Integritimit, kemi të gjitha proceset gjithëpërfshirëse dhe gjithëpërfshijmë ata që duam ne në atë këshill, pra ata që doni ju, sepse ai këshill nuk duhet të jetë asgjë më shumë sesa një platformë ku të flisni dhe të tregoni se ç'keni arritur. Po shqiptarët e dinë shumë se çfarë keni arritur ju në integrimin europian. Pasi u mor statusi i vendit kandidat, pak muaj pasi ju kishit ardhur në pushtet, për shkak se zgjedhjet nuk ishin më problem për Brukselin, për shkak të një pune që kishte bërë qeveria përpara, qeveria e Partisë Demokratike, gjithë vitet e tjera ndenjët në *status quo*, nuk lëvizët asnjë centimetër. Ndërkohë, plasi lufta në Ukrainë dhe ndër të tjera, edhe për arsye gjeostrategjike, u hapën negociata edhe me Shqipërinë që ne të ecim përpara. Të jetë për ju, nuk kishte shans të ecej përpara. Kujtoni vetëm sa herë ka hapur shampanjë Kryeministri për hapjen e negociatave; vetëm aq, dhe kuptoni se sa bosh ishte ajo histori.

Tani nuk ka kontroll më të lartë për procesin e integritimit sesa pushteti i parlamentit për të ushtruar kontroll mbi qeverinë, mbi zullumet e qeverisë dhe instrument më të fortë se komisionet hetimor, nuk ka në këtë parlament. Në fund të

fundit, ligjet i miratoni vetë, shumicën e keni vetë dhe bëni ligjet që doni ju. Edhe këtë ligj, nëse do të kishte qenë i fortë dhe do të rriste realisht pushtetin e parlamentit, ju nuk do ta votonit.

Po kthehem edhe një herë te komisionet hetimore. Janë dy komisionet hetimore që ju refuzoni t'i ngrini përkundrejt vendimit të Gjykatës së Kushtetuese. Pra, ju nuk pyesni fare për këtë pjesë. Kështu, pra, i bie që me këtë ligj ne do të kompensuakemi instrumentin kushtetues të kontrollit parlamentar nëpërmjet komisioneve hetimore! Të gjithë e dimë që është bosh e gjithë kjo.

Kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese. Ia kërkuam Gjykatës Kushtetuese: Merr dhe zbato dispozitën me sanksionin e vetëm të drejtpërdrejtë që ka Kushtetuta mbi deputetët, që është heqja e mandatit kur janë në konflikt interesi. Deputetja ministre u gjend në flagrancë, por Gjykata Kushtetuese nën presionin tuaj vendosi të bënte një pingpong, pasi mund ta merrte çështjen dhe ta shqyrtonte aty për aty. Ç'ndodhi? Jo më larg se dje e morët dhe e futët çështjen përsëri në kalendat greke.

Po e them edhe njëherë, është sanksioni i vetëm, i drejtpërdrejtë i Kushtetutës mbi një deputet; nuk ka tjetër, të tjerat janë me ligje, por edhe atë e merrni, e tresni, e holloni derisa të harrohet. Ju flisni për kontrollin e parlamentit mbi qeverinë dhe procesin e integritetit që bën qeveria, që do ta kontrollojë ky ligj.

Ne do ta miratojmë sot këtë ligj, por për shkak të interesit kombëtar, për integritetin në Bashkimin Europian, a ka kontroll më të lartë mbi qeverinë për mënyrën si punon se sa procesi zgjedhor? Jo më larg se sot në mëngjes në një tryezë të organizuar nga shoqëria civile dhe partnerët ndërkombëtarë, diskutohej për integritetin e procesit zgjedhor, flisnin për gjëra që, në fakt, ishin krejt anash asaj që po ndodh sot në procesin zgjedhor. Të gjitha janë gjëra të rëndësishme financimi, ndjekja penale e të gjitha me radhë, por procesi zgjedhor, ai që detyron një qeveri të qëndrojë drejt, që të mos guxojë të bëjë korrupsion, të shkelë të drejtat e tjera, sepse zgjedhësit të heqin nga pushteti, është totalisht i shpartalluar. Sot, jo vetëm kemi manipulim nga ministria e Brendshme për 1 milion e 280 000 zgjedhës, të cilëve u është ndryshuar qendra e votimit (që ende nuk janë thyer mbrapsht në qendrat e tyre të votimit, edhe pse e kemi ngritur

këtë çështje), por kemi edhe një problem tjetër, problemin që ju po përpiqeni të inxhinjeroni opozitën. Në vitin 2001 u tha: "Mazhoranca çmontoi dhe rimontoi rezultatin e zgjedhjeve me KQZ-në dhe me gjykata". Ajo që po ndodh sot, është që mazhoranca, përveçse po përpiket të kontrollojë zgjedhësit se kush duhet të votojë dhe kush jo, po përpiket të çmontojë dhe të rimontojë opozitën, në mënyrë që të ketë nën kontroll zgjedhësit dhe të ketë kontroll të opozitës. Pra, ta caktojë ajo se kush garon, në mënyrë që të mos ketë probleme për rezultatin e zgjedhjeve, sepse, kur ke dikë përballë, duhet t'i manipulosh votën, por kur nuk ke asnjëri përballë, ç'problem ke me rezultatin? Duhet ta shtysh vetëm për pjesëmarrje, siç u përpoqën në vitin 2019.

Pra, ne kemi ligje shumë herë më të fuqishme se ky që po bëjmë sot, dhe përsëri nuk bëjnë fajde. Pse? Sepse kontrolli absolut i Kryeministrit mbi pushtetet, përfshirë gjyqësorin, është ai që po shkatërron praktikisht çdo aspekt.

Rikthehi përsëri te procesi zgjedhor. Bashkimi Europian ka një nga legjislacionet më të ashpra, më të forta për sa i përket mbrojtjes së të dhënave. Edhe ne e kemi të përcaktuar në Kushtetutë, kemi edhe ligje, kemi edhe një institucion të pavarur, që s'është i pavarur, i cili s'ka këllqe t'i qëndrojë përpara Kryeministrit për sa i përket mbrojtjes së të dhënave të shtetasve. Skandalet kanë filluar herët, nuk është më histori patronazhistësh, është nivel tjetër, është 2,0, është aktivisti. Del Kryeministri, dalin zyrtarë të Partisë Socialiste dhe mbrojnë një akt kriminal, ndërsa SPAK-u dhe prokuroria e zakonshme nuk lëvizin. Po të mos harrojmë që OSBE-ODHIR-i e ka thënë këtë gjë, që duhet të ketë ndjekje dhe sanksione, ndëshkime për të dhënat e zgjedhësve që keqpërdoren. Aktivisti nuk është thjesht të dish se ku e ka shtëpinë X apo Y zgjedhës, por është një platformë për kontrollin e zgjedhësve, jo platformë për kontrollin e votave. Është dhe kriminale, përveçse në kundërshtim me çdo lloj standardi. Dhe ne flasim për procesin e integritetit. Në lidhje me këtë që folëm, sigurisht që do të ketë kallëzim penal të detajuar, e këtu do të ketë njerëz që do të mbajnë përgjegjësi për këtë çështje. Kjo përgjegjësi do t'i ndjekë gjatë, pavarësisht buzëqeshjeve të kolegut tim. Për këtë arsye, duhet të kuptojmë se pse raporti i ODIHR-it thotë: "Është cenuar liria dhe sekretet e votës". Sado

mbrojtje të ketë kushdo, sikleti i tij do të qëndrojë në atë padi penale që do të depozitohet.

Tani, për ta mbyllur, nuk ka asnjë çudi që raporti i reporterit për BE-në, ngre alarm sa i përket medias e dhunimit të hapësirës së medias, që flet për mënyrën se si ju ricikloni parane në ekonomi dhe se jemi në listën gri të pastrimit të parave. Kjo ndodh sepse është politikë qeveritare. Flet për azilantët, dhe ju e dini se në Britaninë e Madhe është problem aspekti kriminal. Sigurisht, sepse ju e kriminalizoni shoqërinë, siç bëtë edhe me kanabisin këtu. Në fund fare, ndodh edhe që në mesin e emigrantëve të ketë nga ata që duan të bëjnë atë lloj zullumi që kanë bërë.

Nuk mbarojnë problemet që ju liston Bashkimi Europian. Ndërkohë, përballë këtij raporti keni këto amendamente, që do t'i votojmë sot, sepse në fund fare do të jetë thjesht një aspirinë, sepse, nëse parlamentit i ka rënë pushteti për të kërkuar edhe atë që është instrumenti i vet kushtetues, aq më pak ka mundësi që ky ligj të ketë efekt në tetë apo dhjetë vitet në vijim.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Flutura Aça.

Përgatitet zonja Albana Vokshi.

Flutura Aça – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në fakt, do t'i drejtohesha zonjës Felaj, sepse me të pata një incident në mëngjes, por po e ndryshoj, sikundër ndryshova edhe fjalën për sot. Ndërsa shkruaja fjalën time, zonja Felaj nuk ndodhej në sallë, por sigurisht që do ta marrë vërejtjen time.

Siç kam vënë re shpesh e më shpesh, zonja Felaj ka njëfarë kënaqësie kur na ndërpret fjalën ne deputetëve. Më duket sikur lutet mbrëmjeve, para se të gdhijë e enjtja, që të mungoni ju, zonja Nikolla, në mënyrë që ta shijojë atë teatrin e saj shpeshherë të dhunshëm, që ndonëse në miniaturë, më duket tamam si një teatër prej xhelati. Kjo lloj kënaqësie është një sindromë e njohur, e studiuar tashmë nga etërit e psikanalizës, por nuk duhet të jetë tokë për një zonjë që drejton një parlament demokratik. Siç e shihni, nuk mund të më akuzoni dot se nuk po i përmbahem rendit të ditës, sepse po flasim për integrimin dhe rolin e parlamentit në procesin e integritimit, proces ku neni numër 1, neni numër 101, neni numër 1001 është fjala e lirë, gjë që siç kam vërejtur, juve që jeni në pushtet ju shkakton kruidjtje në lëkurë. Nga

kjo nuk shëroheni dot, por mbase do të jetë koha që do ta shërojë këtë vend.

Po e përsëris: shenjtëria e fjalës së lirë në këtë parlament është shkelur hapur ditën e hënë, më 13 mars 2023, gjë që më jep gjithë të drejtën ta shpall se sjellja malinje për pengimin e Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në dëgjuesën për çështjen e dekomunistizimit të shoqërisë shqiptare, është vetëm një zgjatim i censurës botërisht të njohur komuniste të natyrës zhdanoviane, për të cilën fola dhe nuk u lashë të mbaroja deri në fund në procedurë. E di, do më thonin: ç'bëri PD për këtë gjë?! E di se është e pafalshme që institucionet e dhunës e të persekutimit u shkatërruan, duke prishur kësaj dëshmitë e një gjenocidi të pashembullt mbi dhë, por kjo sjellje e disa dekadave duhet të marrë fund. Ne duhet ta shohim të vërtetën në sy, siç bën e gjithë bota e qytetëruar dhe siç kanë bërë pothuajse të gjitha vendet e ish-kampit komunist në të shkuarën e tyre diktatoriale. Nuk është nevoja për hakmarrje, po për purifikim shoqëror.

Që t'i rikthehem fjalës, që duket sikur e lëndoi shumë zonjën Felaj, pra fjalës “furrik”; në dijeninë time, si njeri që jam marrë gjithë jetën me fjalën, kjo nuk është një fjalë që përfshihet në fjalët e turpshme. Furrik do të thotë një vend i vogël, i ngushtë, ku herë-herë fshihen njerëz të vegjël, si ata personazhet e Murakamit që dilnin nga goja e dhisë barrsë, që jetonte në kohën e subjektit distopik të veprës “1984”, në fakt të dhisë së zezë me emrin Diktaturë.

Meqenëse jemi këtu, e ftoj median ta vizitojë këtë furrik dhe të gjykojë vetë se ç'kushte klaustrofobike vendosim ne për mbarëvajtjen e këtij parlamenti. Madje, e ftoj median të vijë e të vizitojë zgëqin ku rri Garda, këtu në parlament, së cilës ne i kalojmë përbri dhe as që e kthejmë kokën për të parë kushtet e tyre, por i thërrasim të vijnë këtu dhe i rreshtojmë, që të mbrojnë nga gëlasat politike elementë të këtij furriku politik. Madje edhe vetë ky parlament është pak a shumë i tillë, sipas pamjes dhe raportit në hapësirë që ka me kryeqytetin. Nisur dhe nga fjalët e specialistëve dhe urbanistëve, disa prej tyre kanë filluar ta quajnë edhe si haurin e xhamisë përbri.

Kaq për furrikun. Po i kthehem çështjes sime.

Zonjë e nderuar,

Zotërinj të nderuar të kësaj salle,

Të nderuar shqiptarë,

Ditën e hënë, në këtë institucion është konsumuar një krim kushtetues, një shkelje e hapur e Rregullores së parlamentit, në mos një akt penal. Në të dyja sallat e mëdha të Kuvendit të Shqipërisë, salla që përdoret për të ftuarit kur nuk i zënë dhomat e ngushta të komisioneve, u fikën audio dhe videoja, u ndërpre transmetimi i drejtpërdrejtë për publikun. Pra, u sabotua hapur dëgjesa e planifikuar ditë më parë me të gjithë aktorët lidhur me temën e dekomunistizimit për diskutimin e projektligjit “Për ndërgjegjësimin e kujtesës kolektive, ekspozimin, ndëshkimin publik të regjimit totalitar komunist”, si iniciativë e një grupi të deputetëve të opozitës. Por më e keqja është se detyruan punonjësit e shërbimit IT që të bëheshin pjesë e censurës, duke i vënë në një pozitë të dhimbshme për sa i takon mënyrës se si u përdorën dhe u keqpërdorën këtu. Asnjëra prej sallave nuk funksiononte, kur, në fakt, sapo ishin përdorur, u përdorën edhe të nesërmen, po përdoren edhe tani drejtpërdrejt për Këshillin e Integritimit. Madje, pak minuta para se të ftuarit të ishin larguar, për çudi të gjitha u ndreqën.

Nëse ndokush ka dyshime në lidhje me këto që po them, le të kërkojë verifikimin e tabulateve të telefonave të punonjësve të shërbimit dhe do të lexojë se nga kush, kur dhe ku u dha urdhri për censurë. Meqenëse jemi drejtpërdrejt me sinjal nga salla e Këshillit të Integritimit, tregojani tani zotit Oliver Varhely-i krimin e ditës së hënë, ndonëse dekomunistizimin e keni kusht në progres-raport. Thojani krimin tuaj njeriut që vetë është tani nën akuzë, për shkak të një pëshpërime që është dëgjuar të dalë nga goja e tij, nga receptorët ambientale të Parlamentit Europian.

Integrimi europian i një vendi si yni, para së gjithash do të thotë reflektim mbi të shkuarën e dhunshme, ndjesë ndaj viktimave të gjenocidit komunist, përulje ndaj vuajtjes së shqiptarëve në ato pesë dekada fyerjeje e përçudnimi historik. Po ajo që më trondit ende nga ajo ditë është sjellja e të ftuarve, një pjesë e ish-të përndjekurve politikë, fisnikëria e tyre, pranimi e mirëkuptimi për turpërimin që më kish ndodhur mua personalisht, që po i ndodhte komisionit parlamentar, që po i ndodhte parlamentit dhe shtetit në përgjithësi. Ishte divinë dhe shumë prekës. Sjellja e tyre më shtyn ta shoh edhe më qartë profilin tuaj prej bastardësh të diktaturës. Pse e them këtë? Sepse e di si po silleni me zonjën Diana Baçja, lehonë

disaditëshe. Në sjelljen ndaj saj nuk ka asgjë demokratike, nuk ka asgjë njerëzore, sepse e di si u trajtua vajza-viktimë para disa muajsh në Librazhd, sepse e di si silleni me zonjën Dukate në gjyqet e saj në Fier, se si tallet gjyqtari, i cili e ul në gjyq pranë vrasësve të të birit; jo vetëm i lejon vrasësit të tallen me nënën, por e përzënë nga salla gruan, kur ajo ankohet për sjelljen e vrasësve të të birit në sallën në gjyqit.

Kjo, kolegë të nderuar, është vazhdim i së njëjtës monstër të pashpirt, vrasëse, që vjen nga forca e pushtetit. Dhe siç thotë një mendje e mençur: “Forca tërheq njerëz me moral të dyshimtë, në mos të ulët.” Po, po, njerëz me moral të ulët.

Ju as zverdhjeni e as skuqeni për atë që ka ndodhur të hënë në Komisionin Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, sepse nuk keni pasur kohë të shkoni as në Spaç, as në Tepelenë, as në Qafë-Bar, as në qelitë e Burrelit. Shkoni të paktën në vendin e Dëshmisë dhe të Kujtesës, në Shkodër, të shihni qelinë e Marie Tucit dhe të patër Zef Pllumit. Shkoni, që të bëheni njerëz më të mirë. Atëherë do ta kuptoni dhe do të bëni katarsis për jetët e ndërprera nga gijotina komuniste, për varret pa emër, për 6 mijë të pushkatuarit, për 65 mijë shqiptarët e keqtrajtuar dhe 35 mijë të burgosurit. Atëherë do ta kuptoni se fjala e lirë nuk do leje në një atdhe demokratik, se e drejta nuk do *pass* dhe liria nuk do licencë, sepse në ditën që liria do të kërkojë licencë, atë ditë diktatura është shumë afër, siç kam lexuar të thuhet diku.

Dhe për ta mbyllur, me keqardhje them se nisur nga ngjarja e ditës së hënë, që do të hyjë në turpet e këtij parlamenti, diktatura nuk është shumë afër, por është këmbëkryq këtu, me bekimin tuaj, me sjelljen tuaj djallëzore në këtë parlament.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit, zonja Aça!

Lejomëni t’ju them se në lidhje me situatën e krijuar ditën e hënë në komisionin tuaj, unë jam vënë në dijeni vetëm sot, në mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve. Pa dashur t’i shmangem asnjë përgjegjësie, ju kërkoj ndjesë dhe ju siguroj se bashkë me ju do të nxjerrim të gjitha përgjegjësitë përse nuk ka funksionuar audioja atë ditë.

Faleminderit!

Fjala për zonjën Albana Vokshi!
Përgatitet zonja Monika Kryemadhi.

Albana Vokshi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të lirohet menjëherë Diana Baçja! Ky do të ishte mesazhi që sot duhej të na kishte bërë bashkë, të gjitha zonjave deputete, nga të gjitha krahët e politikës, si dhe zonjat ministre.

Kisha shumë shpresë se ne sot mund të dilnim me një kërkesë të përbashkët, t'u drejtoheshim institucioneve përkatëse të gjitha gratë së bashku, nga të gjitha kahet e politikës, t'i drejtoheshim Presidentit, madje-madje të ishim bashkuar për të paguar edhe gjobën e Dianës, nëse duhej. Nga informacionet që kam marrë nga bashkia Shkodër, nga zonjat anëtare të Lidhjes Demokratike të Gruas, Shkodër, që e kanë kontaktuar familjen dhe po mundohen të sigurojnë disa ndihma, situata është e mjeruar. Është një familje që jeton në mjerim të skajshëm. Diana e burgosur me furgon, me pranga, me policë të armatosur, si të ishte një kriminele, me një fëmijë të porsalindur, vetëm shtatëditësh, për një gjobë në lidhje me të cilën as që ishte vënë në dijeni, për një padrejtësi që i ishte bërë, për një gjyq i cili nuk kishte respektuar të drejtat e saj, siç thonë edhe avokatët. Pra, ishte kryer një gjyq, duke i mohuar të drejtën për t'u prezantuar, për t'u mbrojtur, për më tepër pa u vënë në dijeni.

Pra, sot, thirrja jonë e përbashkët, e të gjitha zonjave, duhej të ishte: "Të lirohet menjëherë Diana Baçja!" Por ne, as sot nuk u bëmë bashkë. As sot, zonjat deputete të Partisë Socialiste nuk dolën nga ai gardhi i oborrit që u ka vënë Edi Rama. Madje, për ironi të fatit, zonja kryetare e Kuvendit, e cila ka prezantuar në komisionet tona një projektligj pikërisht për amendamente në ligjin "Për dhunën në familje", as ajo nuk ka reaguar. E kontrollova Facebook-un vetëm pak më parë: asgjë. heshtje. Heshtje nga të gjithë. Heshtje edhe nga Elisa Spiropali, e cila është edhe drejtuese politike.

Është për të ardhur keq, por nuk po përfaqësoni as interesat e grave, as interesat e vajzave, as interesat e atyre që dhunohen, as të grave që vriten prej bandave që mbrohen nga shteti. Në fakt, unë e kam thënë shpeshherë dhe vazhdoj ta them: dhuna fillon nga parlamenti e nga qeveria, prandaj në gjithë shoqërinë shqiptare mbizotëron dhuna. Ne kemi një Kryeministër të dhunshëm: të dhunshëm verbalisht, të dhunshëm

psikologjikisht, të dhunshëm fizikisht, institucionalisht. Ai është shembulli që marrin edhe burrat, edhe djemtë, të cilët ushtrojnë më pas dhunë nëpër familjet e tyre. Pra, dhuna fillon nga këtu. Prandaj, edhe zonja kryetare mund ta marrë atë draftligjin, mund ta punojmë së bashku, të ulemi e të hartojmë një draft, i cili realisht të mendojë për gratë, të cilat dhunohen. Është rast flagrant ky i Diana Baçes, sepse dëshmon për një shtet ligjor që nuk funksionon. Nuk mund të vihet drejtësi mbi bazën e një padrejtësie kriminale të bërë ndaj Diana Baçes. Është një rast që tregon se drejtësia bën padrejtësi, një rast për të cilin pranohet se është shkelur ligji. Të gjithë pa përjashtim e pranojnë, por Diana vazhdon të jetë në burg.

Prandaj, kërkoj të gjenden të gjitha modalitetet që Diana Baçja të shkojë pranë fëmijës së vet, për të cilin kujdeset kushërira e saj njëmbëdhjetëvjeçare, që është detyruar të braktisë edhe shkollën, gjë që përbën një tjetër dramë. Gjyshërit janë të sëmurë. Janë gjashtë vetë që jetojnë në 30 metra katrorë, njëri prej tyre invalid, por qeveria nuk është interesuar as për të pyetur se çfarë bën kjo familje. Madje-madje, foshnja nuk ka as rroba për t'u ndërruar, nuk ka as batanije për t'u mbuluar.

Tri gra u vranë pak ditë më parë, njëra prej të cilave shtatzënë, por ky mbetet një fakt që askush nuk e përmend. Pra, nuk janë tri gra që janë vrarë, por janë katër, katër qytetarë. Tri gra të plagosura nga njerëz të cilët dalin nga burgu, ndonëse dihet se janë të dhunshëm, ndonëse kanë vrarë, ndonëse kanë përdhunuar, ndonëse kanë paralajmëruar vrasje. Dalin të lirë dhe me kallashnikov në dorë bëhen vrasës serialë.

Vetëm dy ditë më parë, një grua gjashtëdhjetë vjeçe mbeti e vrarë në "Don Bosko". Ajo grua punonte me orë të zgjatura për të mbajtur mbesën e saj. U vra në një luftë bandash. 135 gra të vrara gjatë viteve të qeverisjes së Edi Ramës, shumica me urdhër mbrojtjeje, por që nuk i mbrojtën. 1900 raste dhune më shumë se në 2013-ën të evidentuara. 1400 urdhra mbrojtjeje më shumë se në 2013-ën, por që prapëseprapë nuk po i mbrojnë dot gratë. 135 gra të vrara nga dhuna në familje që nga viti 2014. Kjo shifër nuk përfshin vrasjet e fundit.

Të nderuar qytetarë,

Çdo ditë qeverisjeje e Edi Ramës është shumë vjet larg Europës. A e dini cila është

dëshmia më e qartë? Është largimi i qytetarëve. Një milion të larguar gjatë viteve të qeverisjes së Edi Ramës. Mbi 80% e qytetarëve që ikin, janë nën moshën 35 vjeç, pra ikën rinia. Ikin, sepse nuk besojnë se Shqipëria është apo do të bëhet ndonjëherë pjesë e familjes europiane. Ikin, sepse nuk kanë siguri jete. Ju e shihni si vriten njerëzit në mes të ditës. Ikin, sepse nuk kanë siguri arsimimi cilësor e të barabartë; ikin, sepse nuk kanë siguri shërbimi shëndetësor; ikin, sepse nuk kanë mundësi punësimi; ikin, sepse nuk kanë asgjë. Shteti punon vetëm për veten e vet. Ikin, sepse në Shqipëri nuk ka liri të votës dhe qytetarët nuk e shprehin dot të lirë vullnetin për të zgjedhur qeveritarët e tyre. Ikin, sepse në Shqipëri ligjet bëhen për oligarkët me lidhje të ngushta me Kryeministrin. Ikin, sepse nuk funksionon konkurrenca e lirë. Ikin, sepse tenderët paracaktohen dhe korrupsioni e klientelizmi përcakton se kush i fiton paratë publike.

Sot po flasim për një projektligj, të cilin sigurisht që i gjithë grupi parlamentar i Partisë Demokratike do ta votojë pro, por ku jemi ne me plotësimin e kriterëve për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian? Mund t'i referoheni raportit të Isabel Santos. Është e majtë. Lexoni raportin për të kuptuar se ku është Shqipëria në lidhje me hapat drejt integritit europian. E ka theksuar shumë qartë, që nuk është plotësuar pothuajse asnjë kriter i vendosur. Mund t'i referohemi nenit 2, nenit 3, nenit 4, të cilët flasin në lidhje me nevojën për transparencë, përgjegjshmëri dhe gjithëpërfshirje në procesin e anëtarësimit, për përfshirjen e dimensionit parlamentar.

Po ku kemi ne dimension parlamentar gjithëpërfshirës, kur Kryetarja e Kuvendit, në shkelje të Kushtetutës, në shkelje të disa neneve të Rregullores, thotë se nuk do të bëhet seancë, duke i mohuar çdo deputeti mundësinë që të përfaqësojë zonën e vet elektorale, hallet dhe problemet e qytetarëve. Si mund të flitet për dimension parlamentar gjithëpërfshirës, kur me forcën e kartonit rrëzohen komisione hetimore të kërkuara nga opozita, në një kohë që nuk kanë as tagër. Pra shkelen ligjet me të dyja këmbët, shkelet Kushtetuta, shkelet Rregullorja. Pra, jemi shumë larg. Çdo ditë me Edi Ramën, ne jemi vite larg integritit në Bashkimin Europian.

Dua t'i referohem pikës 9 të raportit të Isabel Santos: “Shpreh shqetësimin për aspekte të projektligjit “Për amnisti fiskale” dhe shtetësinë e

propozuar nga skema e investimeve, që janë të papajtueshme me normat e BE-së”.

Pika 10: “Bëj thirrje për veprime të vazhdueshme për të reduktuar kërkesat e pabazuara për azil, duke trajtuar rrjetet kriminale të trafikimit, duke rritur bashkëpunimin me agjencitë e drejtësisë.”

Pika 11 trajton problemin e Portit të Durrësit, detyrimin e autoriteteve për të garantuar transparencë, konkurrencë për prokurimet publike, kontrata qeveritare, procesin e privatizimit, ndihmën shtetërore, procedurat e koncesionit.

Pika 14: “Shpreh shqetësimin e madh për shantazhimin, kërcënimin, mungesën e sigurisë së jetës së gazetarëve.”

Po ashtu, pika 15 kërkon edhe pavarësinë e RTSH-së apo të Autoritetit të Mediave.

Pra, jemi shumë larg. Çdo ditë me Edi Ramën në qeverisje shqiptarët janë me vite larg integritit në Europë. Por ne do të jemi këtu dhe nuk do të ndalemi, do të bëhemi bashkë, sepse bashkë fitojmë, derisa çdo i ri, çdo grua, çdo burrë të jetojë krenar në atdheun tonë. Do të jemi në këmbë, do të jemi bashkë, sepse bashkë fitojmë. Do t'i dalim zot Shqipërisë, do t'u dalim zot fëmijëve, do t'u dalim zot familjeve tona. Bëhemi bashkë, sepse bashkë fitojmë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Kryemadhi!

Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

Monika Kryemadhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar kolegë,

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, ligji për të cilin diskutojmë sot “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian”” është një ligj që ka kaluar në mars të 2015-ës, si propozim i tre partive politike parlamentare, të cilat e shikonin ngritjen e Këshillit të Integritit Europian me një rol të rëndësishëm për të mbikëqyrur e për të kontrolluar veprimtarinë e qeverisë dhe ecurinë e procesit të integritit europian.

Në fakt, procesi i integritit europian nuk ka ecur me ato ritme që ne të gjithë do të donim. Ne e dimë dhe jemi të qartë se ngadalësimet që kanë ndodhur herë pas here, qoftë me marrëveshjen e

Stabilizim-Asociimit, me marrjen e statusit kandidat apo dhe mbas hapjes së negociatave, kanë qenë momente të vështira, të cilat i kanë kushtuar jo vetëm jetës politike shqiptare dhe ekonomisë, por mbi të gjitha brezave të rinj.

Për hir të së vërtetës, procesi i integritit europian është një proces shumë i rëndësishëm në gjithë jetën ekonomike, politike, shoqërore të Shqipërisë, sepse Shqipëria është një vend, i cili çdo sekondë të jetës së saj, të ardhmen e ka të lidhur me integrimin në Bashkimin Europian. Çdo realitet tjetër do të ishte mjaft i hidhur për Shqipërinë. Mundësitë për ta asimiluar Shqipërinë në realitete të tjera, të cilat janë larg Bashkimit Europian, po shtohen çdo ditë e më shumë, gjë që ka ardhur si rezultat i kriminalizimit të shoqërisë, si rezultat i kriminalizimit të administratës, si rezultat i kriminalizimit të shoqërisë, në të cilën ne sot funksionojmë, sidomos kur kemi parasysh vendosjen gjithnjë e më shumë të kontrollit që Kryeministri ka mbi mediat, mbi ekonominë, mbi arsimin, mbi shëndetësinë, mbi shoqërinë, mbi mendimin e lirë dhe mbi fjalën e lirë.

Një nga problemet më të mëdha që kemi sot, është fakti se ne akoma nuk ndjehemi të bindur nëse do të jemi pjesë e Bashkimit Europian apo jo, pavarësisht se 99 % e shqiptarëve besojnë se janë pjesë e Europës dhe e adhurojnë të qenit pjesë e Europës. Nga ana tjetër, ne shikojmë se çdo ditë e më shumë po largohemi, duke vazhduar me amnistinë fiskale, dhe Kryeministri thotë se amnistinë fiskale nuk e anuloi. Për momentin e ndaloj çështjen e pasaportave të arta, që janë kushte të cilat e cenojnë sadopak, për të mos thënë shumë, këtë proces që ka rëndësi të jashtëzakonshme për Shqipërinë dhe shqiptarët.

Dua të kthehem pak te Këshilli Kombëtar i Integritit, që është struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin europian, e ngritur pranë Kuvendit, që nxit dhe garanton bashkëpunimin midis forcave politike, institucioneve publike e shoqërisë civile, si dhe që siguron rritjen e transparencës në vendimmarrje për çështjen e integritit europian. Ky është misioni i ligjit, për të cilin ne kemi votuar në mars të 2015-ës.

Në fakt, Partia e Lirisë është përjashtuar nga Këshilli i Integritit, ndonëse në ligj është e shkruar e zezë mbi të bardhë në lidhje me përfaqësimin e forcave politike. Kjo ose është keqdashësi nga Kuvendi, ose injorancë e stafit,

sipas të cilit forcat politike nuk ishin koncept juridik. Uroj që të ketë qenë një lajthitje momentale, nervozizëm momental, apo keqdashësi momentale politike, po e quajmë, ndaj përfaqësuesit të Partisë së Lirisë në këtë Këshill Kombëtar të Integritit Europian.

Megjithatë, unë kam paraqitur një iniciativë, prej së cilës nuk tërhiqemi deri në momentin kur të marrim përgjigje zyrtare nga bashkëkryetarët e Këshillit Kombëtar të Integritit Europian. Kjo, duke pasur parasysh se në Këshillin Kombëtar mund të marrin pjesë shoqëri civile pa identitet, pa ditur se me çfarë parash financohen, çfarë statusi kanë e të tjera me radhë, ndërkohë që partia e tretë parlamentare, e cila përfaqësohet me 107 mijë vota, por që me një Rregullore që del përmbi ligjin, nuk i jepet e drejta për të marrë pjesë në këtë Këshill Kombëtar.

Dëgjova të thuhet se kemi një avancim të mendimit europian në mazhorancë. Në fakt, uroj që të jetë ky avancim i mendimit europian në mazhorancë për procesin e Berlinit, i cili do të mblidhet së shpejti në Tiranë. Do të doja të dija se cili është mendimi i Ministrisë së Jashtme dhe i qeverisë shqiptare në lidhje me iniciativën e Kryeministrit tonë të "Open Balkan". A do të vazhdojë më me iniciativën e "Open Balkan", apo do të tërhiqet prej saj?

Rritja e kontrollit të parlamentit për procesin e integritit europian është diçka shumë e rëndësishme, sepse është një proces që duhet të vazhdojë. Jo se i jep rol parlamentit, por sepse ashtu duhet të ndodhë, pasi në fund të fundit parlamenti është institucioni më i rëndësishëm, i cili kontrollon qeverinë por edhe të gjitha proceset e tjera. Nëse ne do të kemi një parlament inekzistent, thjesht për të bërë një proces që të kemi këshilla politike, roli i të cilave nuk është as vendimmarrës, as zbatues, por vetëm këshillues ose dekorues, atëherë roli i parlamentit tonë nuk do të jetë ai që duhet. Mbas këmbënguljes edhe të ekspertëve të huaj për përfshirjen e të gjitha forcave politike, mendoj se përfshirja e të gjitha forcave politike është shumë e rëndësishme, sepse në fund të fundit, janë pikërisht forcat politike ato që marrin përgjegjësinë e tyre politike e ligjore me elektoratin, me statutet, me programet, por edhe angazhimin e tyre politik. Uroj që ky ligj ta kthejë Këshillin Kombëtar politik në një institucion të rëndësishëm kontrollues, por dhe të nxisë qeverinë shqiptare në procesin e negociatave,

proces që në të vërtetë është shumë i vështirë, për të cilin Shqipëria është totalisht e papërgatitur për negociatorët dhe statusin e saj, ndaj dhe do t'i duhet një punë shumë e madhe.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Tritan Shehu.

Të përgatitet zoti Vangjel Dule.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Ne po diskutojmë një element të rëndësishëm, thelbësor në demokraci, dhe pa dyshim parësor për zhvillimet politike e integruese të Shqipërisë: për rolin e parlamentit. Herën e kaluar u paraqitën dy raporte, sot është një projekt ligjor në lidhje me forcimin e këtij roli, në këtë mënyrë ne shkojmë të kënaqur nëpër shtëpitë tona, duke thënë se e realizuam detyrën që kishim. A është e vërtetë? Absolutisht jo.

Së pari, sipas meje ky është një ligj i përciptë, jo obligues dhe jo i përshtatshëm me atë që duhet të bëjë parlamenti. Pse ndodh kjo? Sepse është bërë nën diktatin e kësaj mazhorance, e cila ka vetëm një qëllim: të minimizojë e të dobësojë rolin e parlamentit, meqenëse në parlament është edhe opozita vetë.

Së dyti, sikundër e thashë edhe herën e kaluar, unë i kërkoja bashkëkryetares së Këshillit të Integritetit që në këtë periudhë të hiqte dorë nga paraqitja e raportit, duke e gjetur këtë gjë krejtësisht të papërshtatshme me momentin dhe kohën që po kalon ky parlament. Pse? Sepse për të kaluar një ligj të tillë, që të mund të forcojë rolin e parlamentit, duhet të kemi një parlament demokratik, që zbaton Rregulloren, që respekton dinjitetin e deputetëve, që respekton opozitën, që i jep opozitës ato të drejta që duhet të ketë në një parlament të një vendi që aspiron të bëhet anëtar i BE-së. A ndodh kjo gjë në parlamentin tonë? Jo! Po ndodh e kundërta. Jemi kokëposhtë në të gjitha këto elemente, në qëndrimet dhe në veprimet e këtij parlamenti. Është një parlament ku nuk ka Rregullore. Kush thotë se ky parlament ka Rregullore, gabon rëndë ose është si struci, ose është pjesë e atyre që kërkojnë që parlamenti të mos ketë Rregullore, sepse këtu nismat e deputetëve, kur nuk i pëlqejnë mazhorancës, futen në sirtar, siç e thashë edhe në fillim, edhe nisma shumë të rëndësishme, që lidhen me ngjarje thelbësore historike të një kombi, siç është

gjenocidi serb në Kosovë. Këtu mohohet e drejta e një numri të përcaktuar të deputetëve nga Rregullorja dhe nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të krijuar komisione hetimore, siç është çështja e kërimit të komisionit hetimor për korrupsionin që u bë me McGonigal-in nga Kryeministri për ta përdorur si instrument dhe si mjet kundër opozitës shqiptare, ku nuk patën asnjë argument. “Jo, nuk duam ta bëjmë!”, - thanë.

Këtu merret për bazë një paçavure e një falsifikatori të këtij parlamenti, që e ka vendin atje dhe sot nuk është këtu, dhe zyrtarizohet ajo për përjashtimin e deputetëve të PD-së nga grupi parlamentar, gjë për të cilën edhe vetë deputetët e PD-së thonë se nuk është diskutuar as në grup, jo më që është e pabazuar në Rregulloren e parlamentit. Pse? Sepse kërkohet të shkatërrohet opozita dhe të ketë pastaj një pseudopozitë, një fasadëopozitë, një patericë të Kryeministrit dhe të mazhorancës, për ta përdorur në mënyrën më qesharake, më të shëmtuar të mundshme kundër demokracisë.

Pastaj themi që të bëjmë një ligj për rolin integrues të parlamentit. Të lutem, çfarë roli integrues të tillë mund të ketë parlamenti, kur ky parlament nuk ka rol demokratik brenda tij, nuk respekton parimet demokratike, nuk respekton parlamentarizmin?! Elementi thelbësor i Europës demokratike është parlamentarizmi, ta dini mirë këtë gjë! Elementi thelbësor i Europës demokratike është parlamenti, respektimi i rregullave, i Kushtetutës, nuk ka tjetër! Pra, si mund t'i japim një rol këtij parlamenti në integrimin e Shqipërisë, kur vetë ky parlament nuk respekton rregullat europiane të funksionimit të parlamentit?! A ka mundësi një gjë e tillë? Jo, është farsë. Prandaj, as kjo iniciativë nuk mund të pille ndonjë ligj tjetër “më të mirë” se ky.

Absolutisht, së pari duhet të rregullojmë marrëdhëniet tona këtu, duhet të rregullojmë funksionimin e parlamentit, demokracinë në parlament, rolin e deputetit, dinjitetin e deputetit, duhet të bazohemi te një opozitë e vërtetë dhe jo te një pseudoopozitë, e krijuar me paterica dhe e mbajtur, e ruajtur si gjethe fiku për regjimin.

Të nderuar kolegë, unë shtroj një pyetje: ky Kryeministër e do integrimin e Shqipërisë, apo jo? Jua them qartësisht: nuk e do, është kundër procesit të integritetit, sepse integrimi dhe Europa janë të papajtueshme me regjimet, me autokratët.

Ky Kryeministër dhe ky regjim e kanë fytyrën nga Lindja, nga autokratët lindorë, ku kanë aleatët e mëdhenj, ku kanë bashkëpunëtorët e mëdhenj, ku kanë ata, me të cilët bëjnë trafiqe. Atje i kanë. Nuk mund të jetojë regjimi dhe autokracia në Perëndim, në Europën e Bashkuar. Prandaj mos kujtoni se e do atë. Janë të gjitha fasadë, siç është fasadë edhe ky ligj që është sjellë sot këtu, siç është fasadë edhe aktiviteti i këtij parlamenti, gjoja për integrimin, sepse realisht nuk mund të ketë autokraci në Perëndim, nuk kanë jetë, ambienti e tyre është Lindja. Atje i thërret *richiamo della foresta* autokratët. Kështu ndodh. Prandaj u shpik “Ballkani i hapur” i Vuçiçit, si një kordon umbilikal i Rusisë nëpërmjet traktatit të Euroazisë, të firmosur nga Vuçiçi, por që fatmirësisht dështoi, u gropos. Iu përplas në surrat autorëve dhe tellallëve. U detyruan të tërhiqen, nuk po e përmendin më, kurse deri dje dëgjonim vetëm lavde. Nuk u krijua “Ballkani i hapur”, sepse nuk funksionoi Procesi i Berlinit. Jo! Kush e thotë këtë gjë, nuk thotë realen. U krijua pikërisht për të mos funksionuar Procesi i Berlinit, për ta minuar atë dhe përfundoi atje ku ka përfunduar. Nëse ky regjim do Perëndimin, pse nuk respekton atë që i ka premtuar Italisë që të votojë për “Ekspo 30”-n, që do të bëhet në Itali? Premtim ky edhe me një notë verbale nga Ministria jonë e Jashtme. Pse tani është kthyer fytyra nga Arabia Saudite?! Çfarë ka ardhur nga Arabia Saudite në Shqipëri? Ka ardhur diçka. Jua them unë që ka ardhur diçka. Korrupsioni është baza e këtij regjimi për të blerë dhe për të shitur, për të dyja bashkë.

E lexuat artikullin e ambasadorit italian për “Ekspo 30”-n? Dha një sinjal të qartë, me shumë të drejtë, për rolin e Italisë, për vendin që meriton të ketë Italia, aq më shumë nga Shqipëria. Kurse ne presim ngarkesën nga Arabia Saudite dhe tashmë zhbëjmë atë që kemi premtuar edhe me nota verbale. Pse? Sepse ky regjim fytyrën e ka nga Lindja, nuk e ka nga Perëndimi, nuk e ka nga partnerët. Është një lojë e tëra ajo.

Më vjen mirë që Kryeministri deklaroi se hoqi dorë nga “pasaportat e arta”, u detyrua dhe i tërhoqi. Ishte një vepër kriminale ndaj këtij vendi. Po ashtu është vepër kriminale ajo që tha përsëri sot, që do të sjellin në këtë parlament ligjin për “kanabisin mjekësor”. Nuk ka kanabis mjekësor. Jua them unë këtë gjë. Është një vepër kriminale dhe do ta pësojmë siç e pësoi Maqedonia e Veriut

me atë vendim, me atë ndryshim që bëri dhe ra në një gropë që akoma nuk po del dot. Pse? Sepse ashtu janë disa interesa, sepse e tillë është politika e tyre. Jam i bindur që ky parlament do ta rrëzojë edhe atë ndryshim, sepse kërkon votim të cilësuar, kërkon të ndryshohet Kodi Penal. Ky parlament nuk mund të bëjë të tilla vepra kriminale, aq më shumë një numër deputetësh këtu, por unë besoj se të gjithë nuk do ta lejojnë kriminalizimin e Shqipërisë. Të gjitha këto, ku çojnë ujë? Çojnë ujë në largimin e Shqipërisë nga BE-ja. Kurse për Shqipërinë ka vetëm një rrugë, vetëm një mundësi, vetëm një mbijetesë: anëtarësimi në BE, që është rruga perëndimore. Nuk ka tjetër. Të gjitha të tjerat të çojnë në shkatërrim, të çojnë në fatalitete të historisë sonë, që nga perandoria otomane deri te regjimi komunist.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Vangjel Dule.

Të përgatitet zoti Petrit Vasili.

Vangjel Dule – E nderuara Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë e deputete,

Të nderuar qytetarë,

Sot diskutojmë për një projektligj të rëndësishëm jetike për procesin strategjik të integritetit të vendit tonë në BE. Bëhet fjalë për rolin e organit sovran në republikën parlamentare, që është parlamenti, Kuvendi, dhe si organ sovran është burimi, por edhe organi që i bën bilancin aktivitetit të çdo institucioni tjetër në Republikë. Për rrjedhojë, duke e konsideruar në drejtimin e duhur nismën ligjvënëse, e konsideroj të pakët për nga kontributi që sjell. Hapi është i ndrojtur, është i vogël dhe nuk do të sjellë ndryshimet rrënjësore që kërkohen në realitetin tonë. Ekspertiza është për t’u vlerësuar, nga më cilësoret, sjell frymë, sjell edhe germë, veçse nuk merret parasysh situata politike dhe institucionale në vendin tonë, sepse ne nuk jemi në situata normale, jemi në anormalitet institucional dhe politik. A na kanë munguar ligjet? Jo, kurrë! A jemi ne të ngadaltë në prodhimin e ligjeve? Asnjëherë! Ne kemi rekorde. Ne kemi ndryshuar Kushtetutën brenda natës dhe kodet me shumicë të cilësuar brenda paradites. Kjo na mungonte?! Çfarë na mungon? Na mungon fryma europiane në funksionimin e institucioneve tona të mbështetura në legjislacion. Pse, nuk kemi pasur ne ligje, të cilat kërkojnë që të gjitha institucionet të japin llogari në Kuvend?

Kryeministri nuk denjon, nuk pranon, në mënyrë të përsëritur sfidon, quan “kopsht zoologjik” një pjesë të anëtarëve të këtij Kuvendi. Çfarë ndryshon me këtë ligj? Si e kufizon? Si e imponon që të respektojë detyrimet e tij kushtetuese? Kështu edhe në drejtime të tjera. Çfarë do të prisja nga ky ligj? Përtej, e përsëris, germës së ligjit që po sjell, unë prisja të sillte sanksionimin e një mekanizmi, atij që quajmë *legal binding*, ligjërisht të detyrueshëm, që do ta sillte realisht qeverinë në pozitë e llogaridhënies përpara organit sovran, që është Kuvendi. Këtë nuk e bën.

Më lejoni modestisht të sjell dy variante, që mund të garantonin një rol më të madh të Kuvendit. Për shembull, është rasti i Senatit dhe i Kongresit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kryetari i Komisionit të Politikës së Jashtme të Senatit dhe të Kongresit, pavarësisht nëse janë apo jo në parti të Presidentit apo janë në parti opozitare të Presidentit, kanë të drejtën e vetos në vendimet madhore të politikës së jashtme dhe për të kapërcyer këtë veto Presidentit i duhet vendimmarrje e jashtëzakonshme, gjë që ndodh rrallë herë. Ky është mekanizëm kontrollues.

Së dyti, a mund t’i japim ne kompetenca të tilla Këshillit Kombëtar të Integritit? Mund t’i japim dhe do të ishte realisht funksional. Përse? Sepse nuk është ajo që tha përfaqësuesi i Partisë Socialiste në prezantimin e projektligjit. Unë në këtë Kuvend gjatë gjithë këtyre viteve, që jam i pranishëm, nuk kam dëgjuar asnjë koleg, nga asnjëri krah politik, pavarësisht se kanë qenë në pushtet apo në opozitë, që të jetë skeptik për integrimin europian të vendit tonë. Në kushte të tilla është pa risk, pa kosto që ne të krijojmë mekanizma të tillë kontrollues, të cilët do të garantojnë mbarëvajtjen e procesit të integritit.

Diskutojmë, zonja të nderuara, zotërinj të nderuar, por qëllimisht i rikthehem edhe një herë, zonja të nderuara, në një situatë mjaft të rëndë, kur një fëmijë i porsalindur është pa mamane e tij në momentet që po flasim, dhe një grua që porsa ka lindur, nuk e ka fëmijën e saj në krahë. Është tragjike nga çdo këndvështrim. Dhe ne, duke demonstruar në mënyrën më cinike distancën tonë nga realiteti i jetës së qytetarëve të vendit, do të kërkojmë që Komisioni i Ligjeve të informohet, që pastaj të na informojë dhe kështu me radhë. Ku jemi?! A e konceptoni se si reagojnë?! A mendoni se si na perceptojnë bashkëqytetarët tanë, që na kanë besuar t’i përfaqësojmë këtu? Le t’ia japë

secili përgjigjet vetes. Por e dini përse ndodh kjo? Në demokracinë liberale, ose më qartë, demokracinë liberale mbështeten në një raport të drejtë midis detyrimeve dhe të drejtave. Ne në këtë parlament flasim vetëm për detyrime të qytetarit. Dëgjoni oratorinë, sidomos të kolegëve të mazhorancës, duke filluar nga kreu i tyre: “pranga, prokurorë, gjykatës, polici”, dhe me të gjitha nismat në favor të këtyre organizmave, që janë imponuese të ligjit dhe të detyrimeve, kemi qenë shumë bujarë. Mirë kemi bërë, kur ka qenë në masën dhe në drejtimin e duhur, por është edhe aspekti tjetër: të drejtat. Kush do të flasë për të drejtat dhe sa interesohemi ne, si organ legjislativ i Republikës, për organet e mbrojtjes së të drejtave? Ku janë sot? Institucionin e Avokatit të Popullit e kemi lënë vakant mbi një vit. Përse? Sepse nuk duam një Avokat të Popullit, duam një avokat të partisë -shtet. Ku janë institucionet e tjera, të mbrojtjes së të drejtave, që, kur cenohet, qoftë edhe në mënyrë hipotetike imazhi i kreut të mazhorancës, nuk lënë podium dhe mikrofon pa rrëmbyer?! Ndërsa sot heshtni. Kemi nevojë krahas organeve ligjzbatuese, edhe për organet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të minoriteteve, të fëmijëve, të grave, të konsumatorit, për mbrojtjen e të dhënave të qytetarëve. Nuk mund të bëjmë një sistem të njëanshëm që vetëm detyrimet t’ua imponojmë me dhunë, me hir dhe me pahir dhe nga ana tjetër nuk merret asnjë masë për të respektuar të drejtat e qytetarëve. Nuk ka republikë parlamentare, nuk ka demokraci liberale që mbështetet në pranga dhe në vargonj, mbështetet në liri, në të drejta, në sistem vlerash dhe këtu duhet të tregojmë zotësinë dhe aftësinë si Kuvend që të ngremë këtë sistem, sepse është e kollajtë të ngresh sistemin represiv.

Ju falënderoj!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Petrit Vasili.

Të përgatitet zonja Elda Hoti.

Petrit Vasili – E nderuar Kryetare e Kuvendit,

Të nderuar shumë të paktë, kolegë deputetë, Është shumë e qartë qoftë duke parë podiumin mbrapa, qoftë edhe këtë përpara, se cila është pesha, vlerësimi dhe meraku i madh që kanë për procesin e integritit europian.

Sot kanë sjellë një nismë, që nuk është as më shumë dhe as më pak, ashtu sikurse thonë anglezët

“a tick on the box”. Pra, të bëjnë një shënim që i janë bërë disa ndryshime një ligji të caktuar.

Por pyetja e madhe është kjo: cili është raporti i kësaj mazhorance me integrimin europian, me vlerat europiane, me ato që ndajnë mazhorancat që u kanë besuar mekanizmeve të errëta për të qëndruar në këmbë me ato që duan ta ndërtojnë qenien e tyre në pushtet mbi vlera të vërteta europiane, demokratike dhe pluraliste? Raportet dhe faktet flasin qartë. Raporti i kësaj mazhorance me Europën është një raport hipokrit në pamje, por armiqësor në realitet. Ne kemi dëgjuar këtu pa pushim, kemi parë në shumë foltore brenda dhe jashtë Shqipërisë një Kryeministër, i cili vetëm anatemon, bën gjithçka për të demonizuar Europën, për të prishur raportin e shqiptarëve me Europën, duke e paraqitur pa zemër, pa shpirt, një Europë, e cila është në krizë dhe këto kriza asaj ia zgjidh Edi Rama; një Europë që duhet të mësojë nga kjo mazhorancë, por që nuk ka nevojë të marrë mësim. Meqenëse kjo Europa është me këto probleme të mëdha, atëherë le të bredhim me nxitim drejt Lindjes. Këto janë të vërtetat, sepse raporti me Europën nuk ndërtohet me hipokrizitë apo demagogjitë që u hodhën edhe këtu rëndom. Është shumë e thjeshtë.

A ka gjithëpërfshirje?! Vetë nisma e deputetes Kryemadhi flet më së qarti se cili është raporti i këtyre me gjithëpërfshirjen. Këta e kanë problem që forcat politike, të cilat ndodhen në parlament, të jenë në vendimmarrje. Nuk i shqetëson nëse është organizata joqeveritare më e fundit, me 3 veta apo 5 veta; ajo e ka një vend atje, kurse për të gjithë të tjerët gjithëpërfshirja është një dimension i pakapërcyeshëm.

Dialogu... Ku bëhet fjalë për dialog?! Kjo sallë ka parë që janë miratuar në mënyrën më të marrë, më të çmendur lloj-lloj nismash, edhe nga ato që Gjykata Kushtetuese i rrëzon, megjithëse janë lajmëruar si të tilla. Çfarë do të thotë?! Do të thotë që i gjithë procesi (minimalisht europian) për shqyrtimin e ligjeve, pasi vendi ka bërë disa hapa për të ecur përpara (formalisht janë hapur disa negociata për anëtarësim), është nga më primitivët, nga më përjashtuesit, i cili vetëm dialog, vetëm diskutim të gjerë politiko-profesional nuk nënkupton. Njëra nismë trajtohet në mënyrën më banale, më vulgare se tjetra, duke pasur moton: “Kemi ditën e radhës, do të bëjmë miratimin e radhës, ani se nuk ka nevojë për

debate.” Nuk është ky procesi europian i ligjëbërjes. Ndaj edhe ligjet janë për faqe të zezë, disa prej tyre edhe janë rrëzuar nga Gjykata Kushtetuese, megjithëse nga kjo pikëpamje për këta as Gjykata Kushtetuese nuk është institucion. E mendoni ju për europianizimin, kur vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk zbatohen! Mendoni se çfarë koncepti primitiv, tribal kanë këta për shtetin! Antishteti është mënyra me të cilën këta ecin përpara.

Po cili është raporti me Europën?! Shumë i thjeshtë. Edhe në një projektrezolutë të para disa ditëve flitet për lirinë e medias, për lirinë e informacionit. Por çfarë mund ta ketë europiane një mazhorancë, e cila ka probleme me lirinë e medias, e cila, kur ishte në opozitë, është çjerrë për këtë liri, ndonëse ka pasur një dominim të medias mjaft të bollshëm?! Sot e paraqesin si problem të jashtëzakonshëm. Pak minuta më parë Komisioneri, që kishte ardhur, tha: “Presim hapa në luftën kundër korrupsionit.” Normalisht, është një vend që ka primatin e vendit të parë për korrupsion, një vend që shpopullohet për shkak të korrupsionit, një vend, i cili mendon për të gjitha gjërat e tjera, por nuk sheh që alternativat dhe oportunitetet pafund që ka t’i kthejë në të mira materiale. Fantazia shkon në dy drejtime: lëviz nga kanabisi mjekësor tek amnistia e pasaportave të arta.

Po, mirë, dreqi ta hajë, kemi pasuri natyrore, kemi një relief të jashtëzakonshëm, kemi dete, lumenj, liqene. Kemi oportunitete pafund me një popullsi të vogël, e cila mpaket, zvogëlohet. Po këtu lëviz fantazia, nga kanabisi tek amnistia, amnisti-kanabis, kanabis-amnisti?! Nuk shkoni përtej.

Në ndërtim pastrojmë paratë. Rimë në listën gri, në listën e errët të pastrimit të parave. Trekëndëshi është: kanabis-amnisti- pastrim parash. Vetëm këtu. Po çfarë bën ky trekëndësh?! Ky vret çdo shpresë, i detyron njerëzit të largohen, se nuk kanë mundësi. Në këtë trekëndësh interesat e një njeriu, që punon me punë të ndershme, janë të vrara, të asgjësuar. Janë faktet e mia?! Jo, janë fakte publike. Këto fakte janë në të gjitha raportet europiane. I keni në raportet e Departamentit të Shtetit, i keni edhe në aferën e fundit Amerikë – Shqipëri me *McGonigal-in*, ku vetëm komunikimi i fëlliqur, i errët dhe me poshtërsi ecën përpara.

Pse ju tremb procesi i freskët, transparent europian? Pse nuk lejoni që të diskutohen ligjet?

Pse i bllokoni? Sot keni një ligj. Në shtator keni ngritur një komision të posaçëm për të parë ligjin. Që në mars zonja Kryemadhi ka depozituar një amendament. Po e keni vetë në dorë ju parlamentin: kur të doni i futni, kur të doni, nuk i futni: “E kemi tonin parlamentin, qeverisjen e kemi tonën, buxhetin e shtetit e kemi pronën tonë”. Ju nuk ambientoheni dot që nuk keni asgjë pronë, por jeni menaxhuesit e radhës. Nuk jeni ju pronarë të taksave të shqiptarëve. Janë të shqiptarëve taksat. Nuk jeni pronarë të parlamentit. Sigurisht, keni përfaqësim, por nuk mund t’i uzurponi dhe t’i zaptoni të drejtat e të tjerëve. Po, more, edhe qeveria, edhe ai deputeti, edhe 20 mijë zgjedhës kanë të drejtë të propozojnë një nismë dhe të merret me radhë, të shikohet e para. Por jo: “Le të rrinë edhe 2 vjet. Mos i merrni fare në dorë”. Jepet urdhri me arrogancën e madhe të këtyre trimave të mëdhenj. “Le të rrinë atje, punë e madhe se nuk i marrin! Çfarë u bë? Tonat futini për dy javë, bam-bam”. Këto janë të vërtetat. Ja edhe kjo nismë që është sot, këtë histori ka, është depozituar që në mars të një viti më parë. Fillon tjetra në shtator, ecën: “Nuk ka problem, se jemi vetë, e kemi vetë në dorë, nuk na ndalon njeri”. Po kështu ndodh për të gjitha nismat e opozitës. Proces europian është ky? Europianizohet parlamenti? Po bëni kontroll? Por çfarë do të kontrolloni? Nuk e prodhoni ju lëndën e parë, e prodhon qeveria. Po çfarë do të prodhojë qeveria në një proces që bëhet gjithmonë e më i komplikuar, më i vështirë, më teknik në të gjitha pikëpamjet? Cili është vizioni juaj? Vizioni juaj është prioriteti numër zero.

Kishit një ministri të Integritimit, kishit një infrastrukturë burokratike, në kuptimin më të mirë të fjalës, që synonte, mëtonte të zhvillohej, të aftësohej, gjithsesi procesi është shumë i komplikuar sesa aftësimi. I fut vizën: nuk ka Ministri të Integritimit. Një vend që e ka procesin jetik të vetin, duhej ta kishte më të madhen, më të mirën, më të komplikuarën, të mbushur me specialistët më të mirë, me një mijë kontrata të tjera dhe me konsulencë jashtë e brenda. Çdo departament në ministri duhej të ishte zmadhuar, të ishte përforcuar, të ishte bërë teknik, sepse na pret një proces shumë i komplikuar. Kapitujt nuk janë si këto punët këtu, se këto votohen menjëherë, nuk i keni problem, por kapitujt nuk i votoni dot, se nuk i keni ju në dorë: o do të përmbushen, ose nuk përmbushen. Nuk ka më

bolshevizma me kapitujt, se i hap e rrinë atje dhe nuk i hyjnë në punë as drejt, ndonëse ju nuk doni t’i mbyllni ndonjëherë. Edhe po t’i hapni, nuk do të doni t’i mbyllni. Kjo është e vërteta e procesit të integritimit. Vullneti për integrimin është zero, sepse nuk duhet të ecë ky proces. Nuk duhet të ecë kurrë ky proces që të na japë alibinë: “Që ajo Europa nuk do të na kuptojë, na pengon. Ne jemi gati për t’u martuar, por nuk na marton ajo”, me tëra llojet e budallaqeve që janë thënë në këtë drejtim, ndërkohë që kriteret janë shumë të qarta. Prandaj, Europa ka thënë: “Hiqni dorë nga praktikat e errëta e të pista! Dëgjoni!” Por ju bëni arrogantin dhe detyrohet Europa që të shkojë në gjykatat ndërkombëtare për çështjet të caktuara dhe për ato që shkelni ju, qoftë për lirinë e medias. Edhe kur komisionerët flasin dhe ju kërkuan të mos e prishnit Teatrin Kombëtar, ju nuk ktheheni mbrapa, se jeni trima të mëdhenj. Pra, do të thotë: sot ky ligj është një ligj formal. Nuk kemi asnjë vështirësi për t’ju thënë po, por ka zero efekt në raport me një qeveri që prodhon antieuropianizëm nga mëngjesi deri në darkë.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zonjën Elda Hoti.

Të përgatitet zoti Edmond Spaho.

Elda Hoti – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të dashur qytetarë, në fakt, së paku sot doja të konstatoja progres në raport me ecurinë e Shqipërisë drejt BE-së. E doja sot për shumë arsye, për të qenë personalisht e gatshme të kontribuoj për vendin tim si deputete e parlamentit të Shqipërisë, por fatkeqësisht është e pamundur.

E para, mjaft është shkatërruar dhe është lodhur ky popull nga propaganda e kësaj qeverie! Mjaft iu nxi faqja Shqipërisë në artikujt ndërkombëtarë si vendi i “botës së shtatë” e jo “të tretë”, me një Kryeministër të përfshirë në çdo aferë të mundshme korruptive! Mjaft i është mbyllur dera Shqipërisë nga partnerët ndërkombëtarë për shkak të aksioneve të papërgjegjshme dhe të turpshme të këtij kabineti qeveritar!

Jo më larg se dy ditë më parë Shqipëria bëri xhiron e botës në faqen e parë të medias prestigjioze teksa, krahas fotos së Kryeministrit, shkruante: “Drogë, spiunë dhe kamera”. Një kryqëzim për situatën politike dhe skandalet në vend, ku është lakuar emri i Kryeministrit, Edi

Rama. A ka gjë më të shëmtuar se, teksa propagandon çdo ditë në vendin tonë me idenë se po mashtron qytetarët e tu, shfaqesh si kriminel në mediet e botës?!

Nuk do të sjell këtu citime nga artikulli. Po ia kursej vetes, edhe qytetarëve, atë panoramë të pështirë të publikuar për vendin tonë dhe e gjitha kjo falë qeverisjes më të keqe në rajon dhe në Europë.

Të dashur qytetarë, teksa ne jemi duke zhvilluar këtë seancë parlamentare, pak metra më tej u zhvillu mbledhja e Stabilizim-Asociimit, ku diplomatët europianë u siguruan personalisht të vinin dhe t'ia përplasnin në sy Kryeministrit regresin dhe hapat mbrapa që ka bërë Shqipëria në integrimin e vendit. Po i referohem dokumentit konkret. Ky raport është fakt i pakontestueshëm. Po sjell këtu pikat më kryesore, me urgjencën më të madhe për reagim, në mënyrë që të shmangim rikthimin e vizave. "Emigrimi është një shqetësim serioz për BE-në, që kërcënon me rikthimin e vizave, të merren masa urgjente," thuhet në raport. Skandalozë! Duhet një reagim urgjent për këtë situatë. A ka më fytyrë kjo qeveri?! Po si ka mundësi që papërgjegjshmëria shkon deri në këtë fazë?

Raporti vijon: "Bashkimi Europian kujton se lufta kundër krimit të organizuar mbetet një prioritet kyç për Shqipërinë." Kërkesa dhe thirrja për reagim është thënë hapur dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë në mes të Tiranës. Mendoni tani se sa larg integritet jeni! Analizoni tani që, teksa ne flasim për BE-në, vetë BE-ja vjen këtu dhe jua përplas në fytyrë se ku e keni katandisur ju Shqipërinë. E bindur se makineria e propagandës do ta fshehtë realitetin dhe do ta tjetërsojë qëndrimin e diplomatëve të Bashkimit Europian, po paraqes edhe një argument tjetër shqetësues që parashtrohet në raport. BE-ja kujton se funksionimi i duhur dhe pavarësia e institucioneve demokratike janë elementet thelbësore të një demokracie funksionale dhe një kusht kyç për anëtarësimin në BE. Çdo vendi i kërkohet që jo vetëm ta përfaqësojë legjislacionin e tij me atë europian, por edhe ta zbatojë atë.

Ne e aspirojmë BE-në, por BE-ja nuk i lë qytetarët e vet të nënshtrohen apo të vriten në mënyrë mizerable. BE-ja kërkon standarde të forta në shumë aspekte, duke përfshirë këtu edhe rëndësinë që i jepet gjinisë femërore. Këtu po masakrohen çdo ditë vajzat dhe gratë, si të ishin

armiqtë e vendit, por askush nuk po mban përgjegjësi. Kriminelët ecin të lirë, por ju burgosni një grua që kishte një fëmijë të sapolindur. Në cilin vend të botës ndodh kjo?! Si guxonin t'ia privoni lirinë një nëne, e cila duhej të ushqejë dhe të kujdeset për fëmijën e saj?

Fatkeqësi që shtetin ligjor dhe të së drejtës po e mposhtin kriminelët vrasës! Fatkeqësi që ky vend po bëhet një vend i frikshëm për të jetuar vajzat dhe gratë!

Urime, zoti Kryeministër, meqenëse keni shprehur dëshirën për të hyrë në histori, jo vetëm që keni hyrë në historinë e Shqipërisë, por keni hyrë edhe në historinë e botës si një ndër kryeministrat më të korruptuar, me vizionin më të keq, që i humb identitetin një shteti, por shqiptarët do t'jua japin përgjigjen më 14 maj për gjithçka që ju i keni bërë Shqipërisë!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Edmond Spaho.

Të përgatitet zoti Dashamir Shehi.

Edmond Spaho – Faleminderit, zonja Kryetare!

Në të vërtetë ky projektligj është i rëndësishëm, dhe do të duhej të kishte vëmendjen e të gjithëve, për sa kohë që jemi përkushtuar drejt integritet europian. Kur sheh realitetin në vendin tonë dhe rezultatet e kësaj mazhorance pas 10 vjetësh në qeverisje, kupton se edhe ky ligj është si një prej qindra ligjeve që kemi miratuar gjatë kësaj periudhe, të cilat nuk i kemi zbatuar. Prandaj edhe në një replikë që pata me zotin Balla, e cilësova, ndoshta edhe me një fjalor pak vulgar, "një vërë në ujë", sepse, pavarësisht optimizmit të mazhorancës, nuk ka për të sjellë asnjë efekt në përsheptimin e procesit të integritet. Mund të gëzohemi sot dhe të themi që po mbahet Këshilli i Stabilizim-Asociimit, ka ardhur zoti Borrell-i dhe zoti Varhely-i, të themi që zhvilluam këtë takim para një muaji dhe do të zhvillojmë një tjetër pas disa muajsh, por, po të kthehemi te realiteti shqiptar, do të mbërrijmë tek ajo që tha kolegu Dule, se tjetër gjë është ligji dhe tjetër realiteti. Nëse ligji është për Norvegjinë, realiteti në Shqipëri është si në ndonjë fshat të humbur afrikan.

Mund të më kundërshtoni, por mjafton t'i referohemi rastit të asaj gruas që përfundoi në burg për të kuptuar gjendjen në të cilën janë institucionet shqiptare. Këtu nuk mund të themi se

dështoi vetëm policia e ministrit të Brendshëm, që i takon qeverisë, apo dështoi ministri i Drejtësisë, i cili nuk është në gjendje të bëjë drejtësi, por këtu kanë dështuar të gjitha hallkat, nga e para tek e fundit. Kjo ndodh për shkak të politikave të kësaj mazhorance, e cila prej 10 vjetësh i ka degraduar të gjitha institucionet. Çfarë mund të thuash, për shembull, për prokurorinë, për atë prokuror që propozon dhe arrin ta dënojë atë grua, sepse ka ikur nga shtëpia e burrit, i cili, më falni për shprehjen, e rrihte si gomari në duhan çdo ditë?! Çfarë të bënte ajo e shkreta? Pastaj kemi gjykatësen, që për më tepër është edhe grua, e cila bie dakord dhe e dënon. Gjykata liron ata që sjellin drogë nga Amerika e Jugut me qindra kilogramë, ose i lë në arrest shtëpie, ndërsa këtë të shkretën e dënoi me gjobë, e cila iu kthye në burg. Kujt i vendos gjobë 2 milionë e 500 mijë lekë?! Një familjeje që nuk ka bukë për të ngrënë.

Pastaj kemi policinë, e cila është një polici injorante, dallkaue, ordinere dhe bandite që shkon e merr në shtëpi, pa e njohur ligjin fare, dhe e fut në burg. Po ata të Drejtorisë së Burgjeve që e pranojnë të hyjë në burg, kur ligji thotë se nënës me fëmijë, që nuk ka mbushur moshën 1 vjeç, i pezullohet zbatimi i vendimit?

Kemi edhe një shoqëri civile mjerane, për të ardhur keq, që harxhon miliona fonde, por nuk ngre zërin; nuk doli njeri. Pse? Sepse është e varfër. Institucionet kanë degraduar, sepse e kanë mendjen te paratë. Prokurori do para, e shikon rastin se sa lekë do të përfitojë. Gjykatësi e shikon rastin se sa lekë do të përfitojë, po ashtu edhe polici. Avokati i Popullit nuk dihet ku është. As zoti Balla nuk e di se kush do të jetë Avokat i Popullit.

Pse ndodhin këto? Të vijë komandanti i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë me 130 mijë euro në makinë... Këtu kemi të bëjmë me narkoshtet, pavarësisht se juve nuk ju pëlqen. Kërcet kallashi te “Don Bosko” dhe vritet fukaresha tjetër që bënte dy punë për të mbajtur familjen.

Ja, pra, ky është shteti, të cilit po i japim ligjin për përshpejtimin e procesit dhe rritjen e bashkëpunimit për integrimin evropian. Po ku të bashkëpunosh këtu?! Si të bashkëpunosh? Me kriminelin, me hajdutin, me të korruptuarin?

Mburreni pastaj që doni formën europiane. Forma europiane është këtu në këtë qeveri, ku kemi 10 gra dhe vetëm 2 janë burra, kurse gratë

në realitetin shqiptar i vrasin, i presin, i rrahin dhe i futin në burg, duke qenë edhe me fëmijë të vegjël. Pra, edhe ajo që në pamje duket si politikë gjinore e jashtëzakonshme e Shqipërisë, *top of the top*, kampione e Europës, ja sesi ka bastarduar, kur asnjëra nuk ngrihet të thotë një fjalë, përkundrazi, duartrokitën këtu kur u tha që po mblidhen provat. Çfarë provash do të mbledhin më? Prova është e qartë: është shkëlur ligji. Shkoni dhe lirojeni me shpejtësi dhe jo t’i bëni thirrje gjykatës. Kush arrestohet në mënyrë të padrejtë, duhet liruuar.

Tani flasim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ai është tjetër, është burrë mbi burrat. Prandaj i këndojnë këngë atij. Çfarë të bëjë ligji, kur urdhri politik nuk lejon që partia të regjistrohet në zgjedhje? Tani po fillojnë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qaji hallin edhe atij tjetrit që bërtiste gjithë kohës kundër PD-së dhe e trajtonte si një konflikt të brendshëm dhe i ra në kurriz. Kur të kthehet që të shikojë për të gjetur ndonjë që mund ta ndihmojë, nuk ka më, sepse të gjithë kanë ikur. Prandaj, duhet ta ngremë zërin.

Çfarë të presësh nga ligji i integritit, kur Edi Rama me urdhrin që i jep gjykatës, cakton se opozitë do të jenë këta dhe se në zgjedhje do të regjistrohen këta, ndërsa ata të tjerët nuk i regjistron, pavarësisht se përfaqësojnë pjesën dërrmuese të elektoratit të djathtë? Çfarë të presim ne nga ky ligj, kur ju blini shefin e kundërinteligjencës dhe e përdorni për avantazhe politike në vendin tuaj? Çfarë të presim nga ligji, kur ju vidhni zgjedhjet? Të presësh pastaj që institucionet të kryejnë punën e tyre si duhet!

Tani po na flisni se do të rritet pavarësia e parlamentit! Si do të rritet? A do ta ngrini zërin ju kundër amnistisë fiskale, sepse amnistia fiskale do të vijë? Bashkimi Europian thotë: “Jo, nuk duhet miratuar”. A do ta ngrini zërin ju? A ka ndonjë burrë këtu? Jo. A do ta ngrini zërin për komisionet hetimore? Nuk do ta ngrini dot. A do ta ngrini zërin për portin e Durrësit? Nuk e ngrini dot. A do ta ngrini zërin për legalizimin e kanabisit? As për këtë nuk e ngrini dot zërin. Pra, ligji është zero me bisht, në kushtet kur ju nuk guxonin të kundërshtoni “lartmadhërinë” e tij.

(Bie gongu.)

Të lutem, zonja Kryetare, nuk ju marr më shumë kohë se një minutë! Për t’ju treguar se ku

jemi katandisur: sikur të kishte ardhur që në mëngjes Borrell-i bashkë me Varehly-in dhe të kishin shkuar në Tepelenë të shpallja zonë e mbrojtur e Vjosës që të dëgjonin këngën: “Kryeministri i Shqipërisë, si dhuratë e Perëndisë. Ku nuk të ka shkuar fama, ti je burrë që nuk do reklama.” E shihni, apo jo se çfarë arritjesh dhe se si këndon mazhoranca?! Unë ju jap një sugjerim, rreshtin e fundit mos e thoni: “Ti je burrë që nuk do reklama”, por ti je burrë që nuk bën më nëna.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për ministrin Manja.

Ulsi Manja – Faleminderit, e nderuar Kryetare, që po ma jepni mundësinë të jap edhe unë një përgjigje, të cilën nuk pata mundësi ta jepja në pjesën e parë të zhvillimit të punimeve të kësaj seance!

I dashur koleg, edhe unë bashkohem me shqetësimin për ngjarjen që ka ndodhur, por ndryshe nga ju, pa ndërhyrë në pavarësinë e sistemit gjyqësor, unë e kam ngritur shqetësimin aty ku duhet ngritur. Shpresoj që gjyqtari, i cili e ka marrë çështjen, të ngrihet në lartësinë e detyrës një orë e më parë, të zbatojë, as më shumë e as më pak, parashikimet që ka Kodi i Procedurës Penale dhe të urdhërojë pezullimin e ekzekutimit të atij vendimi.

Kam qenë unë ai që ka kërkuar në këtë sallë që në këtë parlament të ketë një mocion me debat për dhunën në familje dhe e kam kërkuar vazhdimisht, por ju e kishit mendjen të bënit një mocion me debat për rastin “McGonigal”, se përpara hallit të qytetarëve shqiptarë dhe të dhunës në familje kishit hallin e Amerikës.

Kur flet për dështim, i nderuar koleg, ke dështuar ti dhe opozita jote, sepse nuk keni ushtruar dhe vazhdoni të mos e ushtroni një instrument shumë të rëndësishëm, që jua ka dhënë Rregullorja e Kuvendit: atë të kontrollit parlamentar. Kur të vijnë institucionet e drejtësisë të raportojnë në komisionet e Kuvendit këtu në sallë, mos e braktisni sallën dhe të dilni në kafe apo të shkoni të pini raki e verë në lokalet rreth e rrotull Kuvendit (këtë e keni zakon ju), por kërkojuni llogari përfaqësuesve të organeve të drejtësisë këtu për dhunën në familje, për gjendjen e kriminalitetit, për krimin e organizuar dhe për luftën ndaj korrupsionit. Kur vijnë këtu Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, drejtuesi i SPAK-ut dhe Prokurori i Përgjithshëm, gjysma e kësaj

salle është bosh, sepse juve nuk ju interesojnë hallet dhe problemet e qytetarëve shqiptarë, por halli i atij *non grata*-ës që e keni në mes të sallës dhe ju ka marrë peng të gjithë. Keni një refren dhe, sa herë që ndodh një gjë, ju e shfrytëzoni për politikën e ditës së tij. Kjo ka ndodhur edhe në rastin e kësaj fatkeqes që, le të themi, është aktualisht në burg padrejtësisht, në zbatim të një vendimi gjyqësor, por kjo është çështje e drejtësisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, more, jo. Koha kur ministrat e Drejtësisë nxirrnin apo futnin njerëz në burgje, ka përduruar një ditë me zotin Berisha. Dakord?! Kjo është e vërteta. Ka përduruar bashkë me zotin Berisha. Unë e di që ti bilbilin e ke dorëzuar në Muzeun Kombëtar, por të sugjeroj që ta marrësh bilbilin, sepse e qaje atë punë. Bilbilin i bie shumë mirë, këtyre të tjerave u bie në qafë kot.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Zoti Dashamir Shehi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po, zoti Balla, për replikë.

Taulant Balla – Dëgjova edhe zotin Dule, edhe zotin Spaho, të cilët u ankuan për moszgjedhjen e Avokatit të Popullit nga ana e Kuvendit. Minimalisht do ta quaja këtë një lapsus frojdian të një anëtarit të opozitës. Ky është i vetmi institucion, doni apo nuk doni ju, që jua kemi lënë juve, opozitës, për pasojë të një tradite të pashkruar. Kur bëme Kushtetutën së bashku dhe më pas, kur filloi implementimi i saj, u krijua institucioni i Avokatit të Popullit, të cilin e kemi respektuar gjithmonë, që me zotin Dobjani, më pas erdhi radha jonë, me zotin Totozani, pastaj në vitin 2017, si pjesë e një marrëveshjeje politike të 17 majit, me zotën Ballanca, tani mirëpresim propozimin tuaj. E patë se çfarë ndodhi në dhjetor?! Ju tërhoqët firmat, për ata që i kishit firmosur vetë. Ti, zoti Spaho, sapo ke firmosur, më thanë. Uroj që t'i qëndrosh firmës që ke hedhur deri në fund këtij procesi! Ju për firma e për vula nuk ka burrë nëne që ju merr më në konsideratë, por e rëndësishme është që ky proces të ecë përpara.

(Ndërhyrje nga salla)

Ju thashë që për çështje bravash, vulash dhe firmash, kështu do të përfundoni gjithë jetën, nëpër gjykata, si ai që ia zuri shtëpinë diku dhe tjetri e çoi në gjykatë. Kështu do të vazhdojë puna juaj. Sa për Avokatin e Popullit, bujrrëm, por jo ti,

sepse ti ke një problem shumë të madh, se me ty është *non grata* dhe Avokati i Popullit nuk mund të bëhet nga *non grata*.

Lindita Nikolla – Zoti Dashamir Shehi nuk është.

Konsiderohet që është tërhequr nga diskutimi.

Zoti Agron Shehaj nuk është.

Konsiderohet që është tërhequr nga diskutimi.

Këtu mbyllet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Vijojmë me projektligjin “Për bletarinë”.

Ministrja Krifca do ta paraqesë projektligjin me kohë të pakufizuar.

Frida Krifca – E nderuar Kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar bletarë, sot sjellim një ligj shumë të rëndësishëm dhe të kërkuar prej kohësh nga komuniteti i bletarëve, nga shoqatat e bletërritësve, nga konfederata e bletarëve. Ky ligj mbron bletën, prodhuesit e mjaltit në vendin tonë, por, në fakt, mbron edhe konsumatorët dhe është një ligj, të cilit i ka ardhur koha për t’u realizuar. Ky projektligj është ndërtuar në bashkëpunim të plotë me të gjitha shoqatat e bletarëve për t’iu përgjigjur problematikave të tyre dhe një përputhjeje më të mirë me praktikën e BE-së. Me anë të këtij projektligji tregojmë rolin e veçantë të bletarisë në mjedis, në bujqësi, në ekonomi dhe për krijimin e të ardhurave për bletarët dhe për fermerët.

Bletaria është një sektor i rëndësishëm i bujqësisë së vendit tonë, që shërben si burim për prodhimin natyral dhe me vlera mjaft të larta ushqyese e mjekësore. Pjalmimi apo polenizimi ndikon në rritjen e prodhimit të shumë kulturave bujqësore, ndikon në mbajtjen e florës së pyjeve dhe të kullotave, duke e ripërtërirë natyrën si hallkë të zinxhirit ekologjik. Bletaria mbështet dhe ofron shërbime të tjera, si turizmi i bletëve, apiturizmi apo apiterapia në shëndetësi, si dhe ndihmon në monitorimin e ndotjes së mjedisit.

Bletaria karakterizohet nga shumëllojshmëria e kushteve dhe e rendimenteve të prodhimit, si dhe nga shpërndarja e shumëllojshmëria e operatorëve ekonomikë, si në fazën e prodhimit, ashtu edhe në fazën e tregtimit. Në vende të ndryshme të BE-së, dhe jo vetëm, por edhe në vendin tonë, vitet e fundit për të përmirësuar prodhimin dhe tregtimin, duke pasur parasysh rritjen e incidencës në shëndetin e

kolonive të bletëve të llojeve të caktuara, të pushtimeve të koshereve, në veçanti të përhapjes së sëmundjes së varrozës dhe të problemeve që ajo ka shkaktuar në reduktimin e prodhimit të mjaltit, lindi nevoja për një kontroll më të mirë të bletëve.

Po ndalem një moment të flas pak për çfarë kemi bërë vitet e fundit për sektorin e bletarisë, i cili ka pasur një zhvillim të konsiderueshëm. Sot numërohen rreth 400 mijë zgjoje bletësh në vend. Gjatë 10 vjetëve të fundit numri i zgjojeve të bletëve është rritur mbi 70 për qind, duke e rritur ndjeshëm edhe nivelin e prodhimit të mjaltit.

Ne kemi qenë në krah të këtij komuniteti prodhuesish të mjaltit gjatë gjithë kohës. Këtë e vërtetojnë shifrat e mbështetjes, të cilat kanë qenë në rritje nga viti në vit. Nga viti 2013 dhe deri në vitin 2022 ne e kemi rritur me 10 herë numrin e fermerëve të mbështetur në skemën kombëtare. Po kështu, krahasimisht me të njëjtën periudhë, nga viti 2013 deri në vitin 2022, e kemi rritur me 15 herë fondin e dedikuar për bletarinë (nuk po flas për periudhën e përparshme, ku bletaria nuk konsiderohej dhe nuk mbështetej fare). Ky sektor është mbështetur me një vlerë prej rreth 1 miliard lekësh për rreth 1 milion zgjoje. Ndërkohë, bletaria është edhe një ndër sektorët që mbështetet nga programi IPARD për investime të ndryshme në mbështetje të infrastrukturës që nevojitet për këtë sektor. Konkretisht, mund t’ju them se, nëse në vitin 2011 kishim 127 bletarë të mbështetur me rreth 15 mijë koshere, në vitin 2022 kemi 2682 bletarë të mbështetur me 290 mijë koshere. Pra, diferenca është tejet e madhe, për shkak të vëmendjes që ne kemi pasur ndaj këtij sektori për ta rritur prodhimin. Kështu, vetëm në vitin 2022 ne i kemi dhënë një mbështetje pothuajse 100 për qind listës së atyre që kanë aplikuar. Jemi të bindur se mbështetja e këtij sektori, përveç efektit pozitiv që ka në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e performancës së tij ekonomike, patjetër që ka një efekt më të rëndësishëm dhe strategjik në performancën ekonomike të të gjithë sektorit bujqësor në vend.

Pavarësisht dinamizmit dhe rëndësisë, sektori deri më sot nuk kishte një ligj që t’i rregullonte në mënyrë të plotë dhe shteruese të gjitha problemet e bletarisë në lidhje me marrëdhëniet me shërbimin veterinar, me pushtetin vendor, me territorin, me shtegtimitet e kontrolluara dhe me sigurinë e prodhimeve të

bletës që kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore. Projektligji që paraqesim sot jo vetëm i trajton në mënyrë kapilare çështjet e mësipërme, por edhe mbron zhvillimin në territor të një specijeje jetike për polenizimin e kryqëzuar, pra për vijimësinë e jetës.

Sot, me anë të këtij projektligji, promovojmë bletarinë cilësore, instrumentet e skemës së cilësisë, emërtimet e origjinës, treguesit gjeografikë, specialitet tradicionale të garantuara dhe standardet e etiketimit, duke i rritur kështu vlerën tregtare prodhimit të mjaltit në vendin tonë. Gjithashtu, projektligji synon të ketë detyrime edhe për bletërritësit, duke filluar që nga regjistrimi i detyrueshëm me kushte për rritjen, për transportin, për cilësinë e produkteve, për nevojën për trajnime apo për mbajtje të regjistrit të bletarit. Këto masa rritin sigurinë ushqimore, por edhe besimin e konsumatorit te produkti që prodhohet në vendin tonë.

Projektligji parashikon detyrimin që fermerët e prodhimeve bujqësore do të kenë për të njoftuar përmes njësive administrative spërkatjet apo përdorimin e produkteve të mbrojtjes së bimëve në momente të caktuara të vitit, duke marrë masa, në mënyrë të tillë që bletarët të kenë mundësinë t'i spostojnë kosheret dhe të mos dëmtohen kolonitë e bletëve. Nga ky detyrim dhe nga një zbatim korrekt i tij synojmë që t'i minimizojmë dëmtimet eventuale të bletëve, të cilat janë konstatuar gjatë viteve të fundit. Produktet e bletarisë, pas rritjes së nivelit të gjurmueshmërisë, do të jenë një vlerë e shtuar për fermerët që mbarëshojnë bletë, për konsumatorin shqiptar, por edhe për konsumatorin europian për të tashmen dhe për të ardhmen.

Ne kemi shkuar edhe më tej këtyre rregullimeve. Për bletarinë do të ketë një program të dedikuar të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ministrisë së Mjedisit për zhvillimin e bletarisë. Ky do të jetë një program 3-vjeçar, i cili mundëson bashkërendimin me shoqatat e fermerëve, me shoqatat e bletërritësve, federatën e bletërritësve, organizatat në mbrojtje të konsumatorit apo edhe me grupe të tjera të interesit. Ne integrojmë për herë të parë me këtë projektligj bashkëveprimin midis Ministrisë së Bujqësisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore me aktorët e sektorit të bletarisë për hartimin e programeve 3-vjeçare të zhvillimit të bletarisë. Këto programe do të synojnë: promovimin dhe

mbrojtjen e produkteve shqiptare të bletëve; zgjerimin e produkteve me emërtim origjine, duke ecur në shembullin pozitiv të mjaltit të “Bedunicës” në Përmet, që tashmë është produkti i parë i mjaltit i regjistruar, si “specialitet tradicional i garantuar”. Pra, bletërritësit dhe shoqatat e tyre do të luajnë një rol të rëndësishëm në hartimin e politikave, do të kenë një ndikim në vendimmarrje, gjithashtu, do të kenë edhe vetë hapësira për vendime që lidhen me administrimin e interesave të përbashkëta. Ata do të punojnë me Autoritetin e Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe me pushtetin vendor për vendosjen e parqeve të bletëve në kullota të caktuara për shtegtime apo edhe për çështje të tjera.

Studimet e fundit tregojnë se konsumatorët shqiptarë janë të gatshëm të paguajnë rreth 50 përqind më shumë për mjaltin, i cili është i prodhuar brenda vendit dhe po kaq më shumë për një produkt që është i sigurt dhe që vjen nga një zonë e certifikuar. Kjo do të thotë rritje e mirëqenies ekonomike për bletarët tanë.

Pra, me anë të këtij projektligji ne u vëmë në dispozicion operatorëve të sektorit të gjithë kuadrin ligjor për ta kthyer këtë gatishmëri të konsumatorëve shqiptarë në produkte me kosto më të larta për të gjeneruar më shumë të ardhura për vetë fermerët. Ne synojmë të rritim formalizimin e sektorit dhe forcimin e mëtejshëm të sistemit të gjurmueshmërisë së produkteve të bletës, si dhe marrëdhëniet e këtij sektori me sektorët e tjerë të bujqësisë.

Në mbyllje të fjalës sime, dua të theksoj se për hartimin e këtij projektligji janë përdorur jo vetëm praktikatat e mira të shprehura në legjislacionin e BE-së, por kemi parë edhe praktikatat e vendeve të rajonit, për shkak të karakteristikave të ngjashme të klimës, gjeografike, territoriale, të cilat janë më afër dinamikës në Shqipëri.

Dua të falënderoj sinqerisht Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, si dhe Komisionin për Integrimin Europian, të cilët bashkëpunuan me ne në një mënyrë shumë konstruktive, për të pasur një produkt edhe më të pasur, duke dëgjuar dhe duke dialoguar edhe me grupet e interesit dhe më pas duke e votuar unanimisht në Komision.

Të nderuar deputetë,

Për argumentet e paraqitura më sipër, si dhe për nevojën që ka sektori për këtë rregullim, ju ftoj ta miratoni këtë projektligj!

Faleminderit dhe punë të mbarë të gjithë bletarëve!

Lindita Nikolla – Hapim diskutimin për projektligjin. Fjala për zotin Laert Duraj. Të përgatitet zonja Hatixhe Konomi.

Laert Duraj – E nderuar zonja Kryetare, Të nderuar kolegë,

Në vitin 1990 në Shqipëri kishte vetëm 89 mijë koshere, ndërsa sot rreth 400 mijë të tilla, për të cilat kujdesen afërsisht 12 mijë bletarë. Nga puna e tyre e përkushtuar ne arrijmë të prodhojmë rreth 5000 tonë mjaltë në vit, një shifër kjo mjaft e konsiderueshme. Ritmi i rritjes duket shumë premtues, falë edhe mbështetjes direkte që Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, nëpërmjet agjencive të ndryshme, ofron për sektorin. Konkretisht, vetëm në vitin 2022 kanë përfutur mbi 2700 bletarë nga kjo ndihmë direkte. Megjithatë, ne ende nuk kemi një akt ligjor, që t'i rregullojë në mënyrë të detajuar të gjitha hapat që ndiqen, duke filluar nga regjistrimi, transporti, shtegtimi, mbrojtja dhe kontrolli i produkteve të bletarisë.

Pikërisht, për të përmbushur këtë boshllëk, po paraqitet sot ky projektligj, i cili, veç të tjerash, synon edhe përshtatjen me *acquis*-in përkatës të BE-së, që e bën të domosdoshëm miratimin e një ligji të posaçëm për bletarinë.

Nga ana tjetër, vetë shoqatat e bletarëve kanë ushtruar një presion të vazhdueshëm për rregullimin ligjor të veprimtarisë së këtij sektori, të bindur se vetëm në këtë mënyrë tregu do të bëhet më konkurrues, falë perspektivës që ofrojnë planet rregulluese. Gjithashtu, mjedisi do të jetë më i mbrojtur, bletarët, amatorë apo profesionistë, më të ndërgjegjësuar dhe konsumatori final më i informuar.

Kështu, ky projektligj, që vjen sot në Kuvend, është varianti final, i cili vijoi pas orëve të tëra diskutimesh në Komision, midis përfaqësuesve të Ministrisë, Federatës së Bletarëve dhe kolegëve të Komisionit. Sigurisht, këtu nuk mund të parashikohen zgjidhjet e sakta të çdo problemi, por gjithçka është konceptuar në mënyrë të tillë që të adresohet në mënyrë profesionale zgjidhja e tij nëpërmjet akteve nënligjore, të cilat do të pasojnë këtë projektligj. Me qëllim që ky adresim të jetë edhe më efikas,

përfshirja e shoqatave lokale të bletarëve u bë më e qartë dhe më e plotë, falë disa ndryshimeve dhe shtesave që Komisioni i bëri variantit fillestar të propozuar, ndryshime që e bëjnë pa dyshim më të mirë këtë projektligj.

Të nderuar kolegë, e quaj me vend të ndaj me ju faktin që në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin mjaft projektligje janë përmirësuar falë diskutimeve profesionale dhe efikase nga të gjithë deputetët, pavarësisht përfaqësimit politik. Si një shenjë normaliteti, disa prej tyre kanë kaluar me konsensus të plotë. Ligji për vreshtarinë është një shembull mjaft i mirë, të cilit do t'i shtohet edhe ky projektligj për bletarinë, të cilin ju ftoj ta votojmë të gjithë sot!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala është për zonjën Hatixhe Konomi. Të përgatitet zoti Edmond Spaho.

Hatixhe Konomi – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Sot po diskutojmë projektligjin “Për bletarinë”, objekt i të cilit është përcaktimi i rregullave për ushtrimin e aktivitetit të bletarisë, si veprimtari me interes jetësor, kombëtar, e dobishme për ruajtjen e mjedisit natyror, ekosistemit dhe bujqësisë. Pra, për herë të parë sektori i bletarisë na vjen sot me një kuadër të rregulluar ligjor, i cili përcakton rregullat për mbarështimin e bletëve, transportin, shtegtimin, riprodhimin e tyre, si dhe përpunimin, etiketimin, magazinimin dhe tregtimin e produkteve të bletarisë. Gjithashtu, projektligji përforcon rregullat e gjurmueshmërisë dhe u shton vlerë produkteve të bletarisë.

Bletët janë insekte shumë të rëndësishme për jetën në planetin tonë. Me aktivitetin e tyre ato kontribuojnë në të gjithë zinxhirin tonë ushqimor, pasi ndërmjet tyre kryhet pjalmimi dhe bletët kontribuojnë në ripërtëritjen e natyrës dhe në ruajtjen e ekosistemit. Ekspertë të fushës bëjnë thirrje për të ruajtur bletët, si një aset mjaft i rëndësishëm i jetës. Humbja e bletëve çdo vit dhe trajtimi jo i mirë i tyre për një sërë arsyesh bëjnë që kjo çështje të kthehet në një shqetësim për shumë vende anë e mbanë globit, ndaj gjithnjë e më tepër shtohen thirrjet dhe bëhet apel për ta ruajtur këtë insekt.

Sektori i bletarisë është kontribues i rëndësishëm në sigurimin e rezervave ushqimore. Bletaria është, gjithashtu, një sektor i rëndësishëm i bujqësisë që shërben si një burim prodhimesh natyrale me vlerë të lartë ushqimore dhe mjekësore. Jo më kot Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara e shpalli 20 majin si Ditën Botërore të Bletëve, me qëllim sensibilizimin e opinionit publik për rëndësinë e këtyre pjalmuesve, për kërcënimet me të cilat ato përballen, si dhe kontributin e tyre për zhvillimin e qëndrueshëm.

Vitet e fundit sektori i bletarisë në vend ka marrë një vëmendje të veçantë, si me skemat e vazhdueshme të subvencionimit, ashtu edhe me mbështetje dhe trajnime të vazhdueshme për bletarët. Kapaciteti prodhues në vend ka ardhur duke u rritur. Nga viti 2013 e këtej ka pasur një dyfishim të kapacitetit të prodhimit, tregues tepër i mirë për komunitetin e bletarëve, të cilët prej vitesh e kanë kërkuar këtë kuadër rregullator. Më në fund, sot mund të themi se e kemi përmbushur premtimin për këtë komunitet prej 12 mijë bletarësh, ku rreth 3 mijë prej tyre kanë mbi 50 koshere. Kjo nismë do t'i japë fund mungesës së monitorimit të bletës, shtegtimeve të pakontrolluara, si dhe trajtimit pa kriter të sëmundjeve të tyre, me pasojë humbjen e kolonive të bletëve.

Gjithashtu, ky ligj parashikon masa administrative, kur aktiviteti ushtrohet në informalitet, duke mos e raportuar atë, kur nuk zotërohet certifikatë e gjendjes shëndetësore të bletëve apo kur nuk njoftohen inspektorët, në rastet e dyshimeve për sëmundje me karakter përhapës. Ky ligj do të ndikojë, gjithashtu, në zgjerimin e sektorit të bletarisë, si dhe do të rrisë konkurrueshmërinë e tij. Hartimi i këtij projektligji erdhi si një kërkesë e vazhdueshme e Federatës së Bletërritësve të Shqipërisë dhe e shoqatave lokale.

Jo më larg se dje, në një takim që zhvillova me disa anëtarë të shoqatës së bletarëve të qarkut të Beratit mora edhe një herë mbështetjen dhe entuziazmin e tyre, që më në fund puna dhe angazhimi i tyre po merr formalizmin e kërkuar prej kohësh, mbrojtjen, si dhe mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e një pune aq delikate dhe aq të rëndësishme, jo vetëm në këndvështrimin ekonomik, por edhe për vetë jetën në tokë. Vëmendja kushtuar këtij sektori ndër vite

po kulmon sot me miratimin e këtij projektligji, u shprehën 10 anëtarë gjatë takimit, dhe pa diskutim kjo na gëzon të gjithëve. Ndër të tjera bletarët shprehin edhe kërkesën për projekte në mbrojtje të bletës autoktone, si dhe për mbështetje në transportin e koshereve.

Të nderuar kolegë,

Për sa më sipër, ju ftoj të gjithëve ta mbështesim këtë projektligj!

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Zoti Spaho nuk është. Konsiderohet se është tërhequr. Zoti Braçe nuk është. Konsiderohet se është tërhequr nga diskutimi. Zoti Tritan Shehu nuk është, po njësoj. Fjala është për zotin Arben Pëllumbi.

Arben Pëllumbi – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Pa dashur të bëj specialistin për bletarinë dhe për bletën, por në rolin e kryetarit të Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, i cili ka një gamë të gjerë në fushën e diskutimeve të veta, dëshiroj të falënderoj të gjithë kolegët, të cilët dhanë një kontribut në përmbylljen me konsensus të këtij projektligji, i cili, për hir të së vërtetës, ishte nga projektligjet më të konsultuara me grupet e interesit. Nga krahu tjetër, dua të falënderoj edhe propozuesit që ishin konsensualë në pranimin e propozimeve, të cilat erdhën dhe u rakorduan në diskutimet që ne patëm.

Sigurisht, më vjen mirë, sikurse e tha edhe zoti Duraj, që ky është i dyti projektligj në këtë sektor, të cilin Komisioni ynë e kaloi me konsensus dhe besoj se edhe sot do t'i kemi votat e të gjithë kolegëve, duke dhënë kështu një shembull të mirë që ky sektor, pra sektori i bujqësisë, po ecën në rrugën e duhur, në rrugën e zhvillimit, dhe rezultatet që kemi arritur në rritjen qoftë të prodhimit vendas, qoftë të eksporteve kanë një bazë të shëndoshë edhe për të ardhmen.

Projektligji “Për bletarinë” është një hap konkret për një mbështetje serioze në zhvillimin e sektorit, i cili për herë të parë normohet dhe do të funksionojë me një ligj të veçantë. Siç u tha edhe nga kolegët, draftimi i tij ka qenë një kërkesë e kahershme nga i gjithë komuniteti i bletarëve, por, njëkohësisht, vjen edhe si një nevojë e përafritmit të legjislacionit tonë me atë të Bashkimit

Europian, për një zhvillim të qëndrueshëm të sektorit të bletarisë.

U përmendën statistikat, por më lejoni t'i them edhe unë, sepse realisht meritojnë të përmenden. Sot kemi një komunitet me rreth 12 mijë bletarë në të gjithë vendin. Ndërkohë, prodhimi i mjaltit ka shënuar një rritje në rreth 5200 tonë në vit dhe, pikërisht, kjo rritje e prodhimit duhet të gjejë një mbështetje ligjore dhe të saktë, në mënyrë që filozofia me të cilën ne kemi filluar këtë mandat, në lidhje me prodhimet shqiptare në përgjithësi, por në mënyrë të veçantë ato bujqësore, pra marka "Made in Albania", realisht, të njohë ato ritme dhe ato kërkesa, për të cilat ne kemi investuar të gjithë.

Në fjalën e saj, ministrja përmendi se ka një tendencë të konsumatorit për ta kërkuar prodhimin shqiptar, për ta kërkuar mjaltin shqiptar dhe, sigurisht, është i predispozuar të paguajë edhe diçka më shumë, vetëm ta ketë të certifikuar në zona të garantuara dhe ta ketë të ambalazhuar ashtu siç duhet, ndaj besoj se ky ligj vjen pikërisht në ndihmë të kësaj filozofie.

Më lejoni t'ju them shkurtimisht se çfarë të reje sjell për komunitetin e bletarëve ligji, të cilin ne sot po e diskutojmë dhe do ta votojmë. Janë përcaktuar rregulla dhe kushte për regjistrimin, për transportin, për mbrojtjen ndaj përdorimit të produkteve veterinarë. Janë përcaktuar rregulla për etiketimin, për përpunimin dhe për ruajtjen e produkteve të bletarisë, si dhe për kontrollin e cilësisë, të gjurmueshmërisë së këtyre produkteve, sipas programeve 3-vjeçare.

Gjithashtu, janë përcaktuar edhe detyrimet që kanë strukturat përgjegjëse shtetërore, shoqatat e bletërritësve dhe të bletarëve për mbrojtjen e bletëve, për masat e parandalimit të dëmtimit të tyre, për mbajtjen e regjistrit të trajtimeve mjekësore e të tjera.

Qëllimi final i të gjitha këtyre ndërhyrjeve ligjore është mbrojtja e racës së bletëve nga popullata tipike autoktone vendase ose e zonave kufitare, certifikimi i produktit shqiptar, por, njëkohësisht, garantimi i mbrojtjes së mjedisit dhe prodhimeve agropjore.

Pa dashur të zgjatem, nuk do ta lija pa përmendur faktin se në ligj janë vendosur disa përcaktime të rëndësishme, të cilat lidhen me mbështetjen e sektorit të bletarisë, duke nisur nga promovimi dhe mbrojtja e produkteve shqiptare te programet e kërkimit dhe të eksperimentimit,

stimujt për të rinjtë në bletari dhe deri te mbështetja e bletarëve në zonat malore të pafavorizuara.

Të nderuar kolegë, jo pak herë kemi debatuar për çështje që na ndajnë, kemi pikëpamjet dhe projektet tona politike, por besoj që, siç e thashë edhe në fillim të fjalës sime, ky është një projektligj, i cili realisht meriton të mbështetet, sepse në fund kontribuon në një sektor dhe për një grup njerëzish, të cilët janë pa ngjyrë të kuqe apo blu, janë të ëmbël si mjalti.

Ju falënderoj dhe ju ftoj ta votojmë atë!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Këtu mbyllet diskutimi për projektligjin.

Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës, projektligjin "Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë".

A ka pyetje? Nuk ka.

Atëherë fillojmë diskutimin me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarët. Zoti Balla, fjala është për ju, pa kufizim kohor.

Taulant Balla – Unë në fjalën time, në një prej çështjeve të rendit të ditës, e preka edhe çështjen e Kodit Rrugor. Uroj, besoj dhe shpresoj që opozita të jetë në sallë deri në momentin e votimit, për t'i mbështetur këto ndryshime, tek të cilat shtoj edhe vlerësimin maksimal për të gjitha propozimet që kanë ardhur nga opozita dhe që janë marrë në konsideratë nga komisioni përgjegjës, ai për Vepërimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Mendoj se ne duhet të bëjmë gjithçka, duke rregulluar ligjet, kodet, për të ulur numrin e aksidenteve dhe për të rritur kontrollin. Propozimet që unë bëra, natyrisht, jo të gjitha janë marrë në konsideratë në formën e propozuar, sepse e vërteta është që konsensusi duhet gjetur gjithmonë duke u tërhequr nga një pjesë e propozimeve, duke pranuar dhe duke dëshmuar gatishmëri për të shkuar në atë konsensus. Sa kohë që edhe opozita, por edhe ne, ngremë gjithmonë shqetësimin e rasteve të aksidenteve rrugore, të cilat vijnë si pasojë e shkeljeve të parashikimeve të Kodit Rrugor, mendojmë dhe besojmë se gjithmonë ka vend për përmirësim.

Edhe pse nuk u mor parasysh në formën e propozuar, unë vazhdoj t'i mbetem besnik nevojës për të vënë limite shpejtësie për të gjithë të patentuarit për herë të parë. Ka qenë dhe mbetet një prej çështjeve që ka marrë në konsideratë

praktika të aplikueshme në disa prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe ku, më së shumti, lëvizin shqiptarët me automjete, siç janë Italia, Franca dhe Belgjika, të cilat kufizojnë shpejtësinë për 3 vitet e para të marrjes së lejes së drejtimit, si dhe kufizimet që aplikohen edhe në Gjermani, edhe në Spanjë, për periudhën e provës së drejtimit të mjetit nga drejtuesit e rinj.

Nuk e thashë në fillim, por po e them tani. Nevoja për këto ndryshime dhe arsyeja pse e mora unë iniciativën lindën në momentin kur filluam bisedimet me palën gjermane për njohjen e lejeve të drejtimit në Gjermani. Ka qenë një prej shqetësimeve kryesore për të gjithë qytetarët shqiptarë, të cilët jetojnë dhe punojnë në Gjermani, që leja e drejtimit e marrë në Shqipëri të mund të përdoret prej tyre. Dua t'i kujtoj sot kësaj salle se në angazhimet që ka ndërmarrë Shqipëria përpara palës gjermane, edhe pse pala gjermane e firmosi marrëveshjen e njohjes së dyfishtë të lejeve të drejtimit, ne jemi shumë larg mbajtjes së fjalës (do ta quaja unë) me palën gjermane. Ka shkuar shumë më shumë kohë nga sa u angazhuam, që këto ndryshime të reflektoheshin, por ndryshimet që solli opozita, në pjesën më të madhe të tyre, përsëri e kanë përmirësuar dhe kanë sjellë edhe disa çështje që ne i kishim thënë. Ka qenë Kryeministri Rama, i cili shpeshherë ka përmendur çështjen e kontrollit apo të postbllloqeve të policisë nëpër cepa rrugësh, e cila mendoj se ka qenë dhe mbetet një prej çështjeve që duhet adresuar.

Një problematikë tjetër është ajo e fuqisë motorike të automjeteve, që merren nga ata që sapo janë patentuar apo që kanë një moshë të re. E thashë në mëngjes dhe po e rithem, se nëse nuk do të ishim vonuar me këto ndryshime, një aksident mund të ishte ndaluar, mund të ishte parandaluar, sepse e vërteta është që kemi një numër të madh të aksidenteve me makina të fuqisë motorike të lartë nga djem të rinj. Mendoj se ndryshimet shkojnë në këtë drejtim dhe besoj se efekti do të jetë i menjëhershëm.

Lidhur me çështjet e tjera, besoj që në Komision është rënë dakord. Të gjithë drejtuesit e automjeteve deri në 70 vjeç, të cilët duan të pajisen me një leje drejtimi apo duan të rinovojnë lejen ekzistuese, ta marrin me një afat. Edhe kjo është diçka e mirë, ndërkohë që mos harroni se kemi bërë edhe vlefshmërinë administrative prej 15 vjetësh për të gjitha patentat, të cilat, në

përputhje me direktivën e Bashkimit Europian dhe sipas lejeve të drejtimit të kategorive AM, A1, A2, A, B, B1 dhe BE mund të lëshohen me një vlefshmëri deri në 15 vjet.

Nuk dua t'u marr shumë kohë kolegëve deputetë për parashtrimin e të gjitha ndryshimeve të tjera. Gjej rastin t'i falënderoj dhe ju e dini se po të falënderosh këtej nga krahu juaj, të gjithë ata që do të falënderohen prej meje, më pas do të shpallen tradhtarë, por e vërteta është se gjej rastin ta falënderoj Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin për një kulturë krejtësisht tjetër, për sa u përket diskutimit dhe pritjes për të gjetur zgjidhje për ato që janë halle. Në fakt, të gjitha çështjet që janë këtu, edhe çështjet e propozuara nga kolegët Kastanja dhe Alibeaj, në mos gaboj, janë çështje që duhen mbështetur, gjejnë vend, zgjidhin halle, por edhe parandalojnë aksidente dhe rreziqe.

Unë e them shpesh dhe nuk hezitoj ta them që, përpara se të na bien partitë politike këtu, na kanë sjellë qytetarët dhe detyra jonë është t'i respektojmë ata që na kanë sjellë. Besoj dhe shpresoj se në fund të kësaj seance do ta votojmë Kodin Rrugor, me të gjitha ndryshimet dhe propozimet tona, sikurse ka konkluduar në raportin përfundimtar në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

Na qoftë mbarë!

Faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr nënkryetarja, zonja Felaj.)

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Balla!

Cili nga kolegët propozues të Partisë Demokratike dëshiron ta prezantojë projektligjin? Në fakt, nismëtari është zoti Alibeaj, por besoj se dikush do ta bëjë këtë gjë. Zoti Gështenja, fjala është për ju dhe koha për të folur është pa kufizim, meqenëse jeni nismëtar.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Të nderuar qytetarë,

Në fakt, ne sot po diskutojmë një projektligj, i cili është më tepër teknik, ndaj, për të thënë të vërtetën, do të kërkoja nga të gjithë kolegët, si të mazhorancës, edhe të opozitës, të zhvishemi për një moment nga kostumi politik. Bëhet fjalë për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”.

Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë është miratuar me ligjin nr.8378 në vitin 1998.

Nga ajo kohë dhe deri më sot kanë ndodhur ndryshime të shumta në infrastrukturë dhe në transportin rrugor të vendit tonë, të cilat kanë imponuar nevojën për ndryshime ligjore të këtij Kodi.

Kështu, nga viti 1998 e në vazhdim rezulton se Kodi Rrugor është amenduar plot 7 herë me akte ligjore dhe me një vendim të Gjykatës Kushtetuese, megjithatë nevoja për rishikim vazhdon të mbetet aktuale. Në një moment të dytë, e kam shprehur edhe në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, do të dëshiroja që ky Kuvend të mund ta rivlerësonte mundësinë për një rishikim tërësor, nga A-ja te ZH-ja, të këtij Kodi, duke u ofruar përdoruesve të rrugës një legjislacion modern, në përputhje me standardet më të larta europiane dhe ndërkombëtare.

Propozimet e bëra nga ana jonë për këtë projektligj synojnë, pikërisht, një harmonizim të terminologjisë ligjore, për shkak se shumë emërtime apo terma të përdorur në këtë Kod, tashmë nuk janë më relevantë. Kjo po sjell vështirësi apo keqinterpretime gjatë zbatimit të Kodit.

Nga ana tjetër, propozimet tona adresojnë edhe disa problematika të krijuara për shkak të shtimit të numrit të automjeteve, të trafikut të rënduar, të mungesës së vendeve të parkimeve apo të lehtësimit të procedurave administrative. Këto propozime synojnë të lehtësojnë përdoruesit e rrugës nga detyrimet e panevojshme, duke u kujdesur që në çdo çast dhe në çdo rast të garantohet parimi i sigurisë së lartë i lëvizjes në rrugë.

Po ashtu, për zgjidhjen e problematikave të caktuara kemi vlerësuar se zgjidhja më e përshtatshme për qytetarët apo për bizneset nuk janë sanksionet me gjoba apo sanksionet e tjera administrative, por janë sensibilizimi, edukimi dhe bashkëpunimi me përdoruesit e rrugës.

Disa deputetë të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, unë, zoti Bushati, zoti Flamur Hoxha, pasi bëmë një vlerësim të kujdesshëm të parashikimeve aktuale të Kodit Rrugor, të problematikave të adresuara nga qytetarët apo nga biznese të ndryshme, si dhe në konsultim me ekspertë të fushës, përgatitëm disa propozime, shtesa dhe ndryshime në këtë Kod Rrugor. Ndryshimet kryesore konsistojnë si më poshtë.

Kemi propozuar në projektligj uljen e vlerës së gjobave me 50% të vlerës së përcaktuar në Kodin Rrugor aktual, kjo për të qenë në përputhje me standardet europiane, pasi sot ne i kemi gjobat maksimale sa gjashtëfishi i pagës minimale, çka do të thotë se kemi gjoba që fillojnë minimalisht me 250 lekë të rinj deri në 2 milionë lekë të vjetër, gjë anormale për një vend me ekonomi si e vendit tonë.

Kemi propozuar heqjen e shërbimeve policore rrugore stacionare, të ashtuquajturat “postblloqe”, në të gjitha akset kombëtare.

Kontrulli i mjeteve propozohet të kryhet, sipas nenit 11 të këtij Kodi, vetëm nëpërmjet identifikimit të shkeljeve me pajisje teknologjike dhe vetëm me ndalimin dhe shoqërimin e mjetit në një pikë kontrolli në kushte sigurie dhe jo ashtu siç ndodh sot në rrugët dhe akset kombëtare, ku polici del me dylbi pas ferrave dhe gjobit qytetarin. Pra, kjo formë, ky model, duhet të marrë fund, pasi jemi në vitin 2023.

Kemi propozuar të sanksionohet në Kodin Rrugor që, minimalisht, 50% e posteve të parkimit në akset rrugore të bashkive të vendit të jenë publike, pa pagesë, pasi sot, kryesisht në Tiranë, por kjo vlen edhe për bashkitë e tjera, kemi shumë poste që duhet të ishin publike, por që janë me pagesë dhe nuk janë në shërbim të qytetarëve. Gjithashtu, kemi kërkuar të merren masa për të garantuar zona parkimi pa pagesë për të gjithë banorët rezidentë pranë banesave të tyre.

Për të gjithë qytetarët shqiptarë, me banim jashtë shtetit ose të huaj, që kalojnë në Shqipëri me automjete të importuara përkohësisht ose të reja, të cilët kanë përmbushur formalitetet doganore, duhet të lëshohet një leje 30-ditore nga 15-ditore që është në Kodin Rrugor aktual.

Gjithashtu, kemi propozuar që pezullimi i lejes së drejtimit, në rastet kur kundërvajtësi jep pëlqimin, duhet të konvertohet me pagesën e një shume të barabartë me dyfishin e masës administrative maksimale të parashikuar në normën e shkelur.

Shpejtësia maksimale e qarkullimit në autostrada të jetë jo më shumë se 130 kilometra në orë, kjo duke iu referuar standardeve europiane dhe në përputhje me standardet e projektimit të miratuar tashmë me vendim qeverie.

Gjithashtu, kemi propozuar rritjen e afatit të kohës së pagesës së gjobave, pa penalitete dhe me një ulje 50% të vlerës, nga 5 ditë, që është në

Kodin aktual, në 15 ditë, jo nga momenti i marrjes së gjobave, por nga momenti i regjistrimit të gjobës apo nga momenti kur gjoba ka marrë një vendim të formës së prerë.

Këto janë propozimet, që mendojmë se u vijnë në ndihmë qytetarëve dhe shqiptarëve.

Ftoj të gjithë kolegët që, përtej ndasive, t'u shërbejë ky rast, ky model, që ne kemi pasur në Komisionin për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, falë një pune më shumë se 3-mujore, ku kemi rrahur mendime dhe jemi dakortësuar për këtë projektligj, i bindur se ai nuk i shërben politikës, por u shërben qytetarëve. Do të kërkoja nga mazhoranca që këtë model ta kishte dhënë, të paktën për ne si opozitë, edhe për reforma të rëndësishme, siç është reforma territoriale, e cila nuk i shërben politikës, por u shërben qytetarëve, apo reforma zgjedhore, e cila nuk i shërben politikës, por u shërben qytetarëve. Ky duhet të jetë modeli i këtij parlamenti.

Ju faleminderit dhe na shkoftë mbarë!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Gështenja!

A ka pyetje nga kolegët për nismëtarët? Jo.

Atëherë, fjalën e ka kërkuar zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, zonja Balluku.

Belinda Balluku – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Pa dyshim, ky është një projektligj shumë i rëndësishëm për të gjithë ne. Është një projektligj që duhet të gjejë një konsensus të gjerë, pasi Shqipëria tashmë ka infrastrukturën e duhur për të pasur një Kod Rrugor modern, i cili duhet t'u përgjigjet të gjitha zhvillimeve që tashmë ne kemi në vendin tonë.

Sot, ashtu siç të gjithë e dini, kemi ndërtuar një infrastrukturë të denjë për çdo vend evropian, bajpasët e Fierit, Vlorës, Shkodrës dhe Tepelenës, rrugën Kardhiq-Delvinë, Unazën e Madhe, ku një pjesë e mirë e saj tashmë ka përfunduar dhe po vazhdojmë me lotet e tjera për ta përmbyllur të gjithë këtë proces në vitin 2024, por edhe korridoret e rëndësishme.

Sapo kam ardhur nga një takim me Komisionerin Varhelyi, i cili sapo më ka konfirmuar edhe një herë se Korridori i 8-të tashmë është i miratuar nga Bashkimi European, nga Komisioni dhe nga të gjitha forumet e tjera dhe është thjesht çështje ditësh për t'u bërë publik.

Me miratimin e këtij Korridori, pra më në fund si pjesë e 10-D, ne do të kemi mundësi që të gjitha projektet tona, qoftë ato infrastrukurore, siç janë bajpasi i Elbasanit, bajpasi i Librazhdit apo hekurudha që do të lidhë Durrësin me Rrogozhinën dhe Rrogozhinën më pas me Pogradecin për t'u lidhur me Maqedoninë e Veriut janë të gjitha projekte europiane, të cilat do të mbështeten edhe me fondet e Bashkimit European.

Sigurisht, të gjitha këto zhvillime infrastrukurore që janë mbështetur nga qeveria shqiptare, si dhe puna që është bërë nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga ARRSH-ja nuk mbeten vetëm te ndërtimet e rrugëve, por edhe te zhvillimet e tyre teknologjike, ashtu siç është dhe rasti i ngritjes së Qendrës së Monitorimit, e cila do të nisë me 200 kilometrat e parë për të monitoruar të gjithë lëvizjet e trafikut, ku komponentët do t'i ofrohen edhe Policisë së Shtetit për sigurinë, por edhe urgjencës, edhe zjarrfikësve dhe sigurisht do të jetë një qendër ku do të kontrollohet trafiku, fluksi i tij dhe ndarja nëpër autostradat moderne që ne tashmë kemi. Kjo Qendër do të jetë një strukturë e re koordinuese, ndërinstucionale ku të gjithë aktorët do të kenë mundësi ta marrin informacionin në kohë reale për t'u ofruar qytetarëve ndihmën apo për t'u dhënë atyre drejtime të ndryshme për shkak të trafikut, të rëndësës apo gjithçka tjetër.

Gjithashtu, vitet e fundit qeveria shqiptare, përmes Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe DPSHTRR-së, një nga ndërmarrjet më të suksesshme që ne kemi nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, i ka kushtuar rëndësi të veçantë edhe reformës së modernizimit të sektorit të transportit, duke nisur nga emetimi i lejeve të drejtimit, të cilat merren brenda ditës dhe duke harruar atë kalvar të gjatë kur duhet të rrije në radhë për orë të tëra dhe të prisje për muaj të tërë që të merrje lejen e drejtimit.

Ndërkohë, këtu vlen të përmendet një rritje e kontrollit të cilësisë, i cili i është kthyer shtetit pas një kontrate të gjatë koncensionare, që as nuk i ka bërë investimet e duhura dhe i ka përdorur qytetarët në mënyrën e gabuar. Sot ky proces i është kthyer shtetit dhe DPSHTRR-ja e kryen këtë proces në kushtet më të mira.

Po ashtu i është kushtuar një vëmendjen e veçantë reduktimit të procedurave burokratike,

ashtu siç thashë, pra uljes së kohës së aplikimeve dhe të dorëzimeve të të gjithë dokumentacionit. Nga ana tjetër, ky modernizim i automotorizimit ka sjellë edhe një interes më të madh te qytetarët, duke ngritur tashmë edhe një krenari tjetër për vendin, që janë automobilat e vjetër. Përmes një programi të quajtur prej kohësh tashmë, “Retro”, të cilin kemi pasur fatin ta shikonim edhe në Tiranë gjatë Ditës së Verës, është kthyer edhe në një atraksion për të gjithë qytetarët.

Kështu që, me të gjithë infrastrukturën moderne që kemi, gjithë automatizimin që kemi sjellë për sa u përket proceseve të transportit, të gjitha planet që kemi për të ardhmen për sa i përket edhe transportit urban dhe atij ndërqytetas, për flotat, të cilat duhet të jenë flota hibride për ta ndotur sa më pak ambientin dhe gjithçka tjetër që është në planet, në reformat e qeverisë kemi një Kod të ri Rrugor, i cili do të ndikojë në sjelljen e drejtuesve të automjeteve për t'i bërë sa më afër të gjitha parimeve të Bashkimit Europian. Unë do t'ju thosha se është një nevojë imediate për ta votuar këtë projektligj dhe për t'i dhënë mundësi Shqipërisë që të gjitha këto investime si në infrastrukturë kritike, ashtu edhe në burime njerëzore të kthehen dhe të përdoren nga qytetarët të bazuar mbi një Kod Rrugor të mirëstuduar dhe të koordinuar me të gjitha palët.

Unë jam e bindur se ky kontroll do të jetë në lartësinë e duhur, duke krijuar klimën e përshtatshme për një lëvizje sa më të mirë dhe të sigurt përgjatë gjithë infrastrukturës rrugore të vendit tonë.

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Balluku!

Viojmë me listën e diskutantëve.

Fjalën e ka zoti Pëllumbi.

Të përgatitet zoti Sula.

Arben Pëllumbi – E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, jemi pikërisht sot në këto diskutime këtu në seancë, sepse realisht kemi një transformim të madh të të gjithë rrjetit rrugor infrastrukturor, por edhe të kulturës me të cilën përdoruesit e mjeteve dhe të rrugës operojnë çdo ditë. Gjithsesi, përtej gjithë kësaj, janë disa shqetësime, të cilat ne, anëtarët e Komisionit të Veprimtarive Prodhuese, jemi përpjekur t'i

materializojmë në këto ndryshime që po propozojmë.

Ndryshimet filluan si një propozim i zotit Balla, rreth muajit qershor të vitit të kaluar dhe vazhduan me propozimin e kolegëve të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, sikurse e tha edhe zoti Gështenja. Me vendim të Konferencës së Kryetarëve, të dyja nismat, duke pasur të njëjtin objekt, u bashkuan dhe u shqyrtuan për disa muaj në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit me tendencë arritjen e një rezultati konsensual në ndihmë të qytetarëve.

Më vjen shumë mirë, sepse kishim vite që diskutonim për një problem, i cili na ka tronditur jo pak herë kur aksidentet me pasojë humbje jete të adoleshentëve dhe të fëmijëve kanë ndodhur kryesisht në Tiranë dhe ne kemi qenë të paafte të kufizonim mundësinë që ata t'u jepnin mjeteve motorike me fuqi të madhe.

Ne sot e kemi sjellë këtë propozim, ku pikërisht pjesë e propozimit të zotit Balla është kufizimi i fuqisë motorike për 2 vjet për të gjithë të sapopatentuarit, në 55 kilovat për ton apo 65 kilovat për ton, kur kjo është hibride, duke marrë parasysh edhe peshën e baterisë së makinës. Besoj se po bëjmë një gjë shumë të mirë edhe për prindërit, që shpesh ndoshta ndodhen edhe nën presionin e fëmijëve për t'u plotësuar disa nevoja të caktuara. Tashmë ky Kod nuk do t'i lejojë më ata (besoj se do ta votojmë këtë Kod sot dhe këto ndryshime do të bëhen realitet), që t'i ngasin këto makina të fuqishme, të cilat falë mungesës së eksperiencës mund të kthehen në një armë të dëmshme për ata vetë, por edhe për qytetarët e tjerë.

E dyta, që dëshiroj të theksoj, është pikërisht fakti që ne propozojmë disa ndryshime në nenin 124, pjesë e propozimit të zotit Balla, në nenin 12 të këtij projektligji, ku u vijmë në ndihmë qytetarëve, iniciativë kjo e nisur, siç e tha edhe zoti Balla, nga bashkëbisedimet dhe konsultimet me qeverinë gjermane kur bëmë njohjen reciproke të patentave për të zgjatur afatet dhe vlefshmërinë e një lejeje drejtimi. Sot e kemi 10 vjet, deri në 50 vjeç, ndërsa ne do ta bëjmë 15 vjet, deri në 70 vjeç. Pra, deri në 70 vjeç të gjithë qytetarët pajisen për 15 vjet me një leje drejtimi, duke bërë të mundur që të paraqiten më pak herë në sportele, të aplikojnë më pak herë dhe të kenë më pak shpenzime për këtë leje drejtimi, si dhe duke e lineuar këtë gjë me legjislacionin e Bashkimit

European dhe vendet e zhvilluara të tij. Nuk është se ne jemi duke bërë një shpikje, por ky është një realitet që e kanë shumica e vendeve të Bashkimit European.

Krahas kësaj, do të bëjmë edhe një ndryshim të moshës së pajisjes me disa leje drejtimi për disa kategori të caktuara (këtu kam parasysh pronarët e autoshkollave apo mësuesit e autoshkollave), të cilat në moshën 65-vjeçare duhet ta lënë atë detyrë, ndërsa ne po u japim mundësinë që ta vazhdojnë deri në moshën 70-vjeçare, por nga krahu tjetër edhe kategorive të caktuara lejesh drejtimi u japim mundësinë që të mund të punojnë, qoftë edhe për kategori më të ulëta, deri në moshën 70-vjeçare.

Nga krahu tjetër, kemi rënë dakord që kurset e ndihmës së shpejtë, të cilat sot bëhen pranë Kryqit të Kuq Shqiptar, të mund të bëhen pranë autoshkollave, sigurisht përsëri nga Kryqi i Kuq Shqiptar, dhe në këtë mënyrë mund të kursejnë kohë të gjithë ata që do të kryejnë një kurs të caktuar dhe ta bëjnë pranë autoshkollave.

Sigurisht, një propozim i rëndësishëm, që gjen materializim në këtë propozim që vjen, është fakti se ne sot përmes këtij kodi shqiptar rrisim shpejtësinë maksimale në Republikën e Shqipërisë. Sot është e sanksionuar 110 kilometra në orë dhe propozohet të shkojë në 130 kilometra në orë. Sigurisht që kjo është shpejtësia maksimale që vendoset në Kod, por më pas do të jetë Autoriteti Rrugor Shqiptar, i cili do të përcaktojë nëse një rrugë e caktuar i plotëson ose jo parametrat për ta pasur këtë shpejtësi maksimale. Ne sot i japim mundësi këtij Autoriteti që, falë investimeve serioze që janë bërë dhe do të vazhdojnë të bëhen, siç i përmendi edhe Ministrija, të mund të kenë në Kod të sanksionuar një shpejtësi, e cila është shpejtësi maksimale në shumicën e vendeve të Bashkimit European.

Një element shumë i rëndësishëm, që do të doja ta theksoja në fjalën time, janë ndryshimet që kemi bërë në lidhje me sigurinë e fëmijëve apo të bashkudhëtarëve të atij që përdor një mjet. Kemi bërë shumë ndryshime në lidhje me mënyrën se si do të udhëtojnë fëmijët nëpër mjete, duke vendosur mjete të caktuara, të sigurta, me rrip sigurimi, duke ulur moshën nga 4 vjeç në 3 vjeç dhe si do të përdoren këto gjëra, si dhe duke bërë edhe një ndryshim në lidhje me përdorimin e vendit të parë të makinës, të cilin e kishim deri në

12 vjeç, ndërsa sot e kalojmë në 1,5 metra gjatësi. Pra, një fëmijë pavarësisht moshës, në qoftë se nuk është 1 metër e gjysmë nuk mund të udhëtojë në vendin e parë të makinës, sepse në këtë rast mund të krijohet probleme të caktuara.

Siç e theksoi edhe zoti Gështenja, më vjen shumë mirë që e kemi arritur këtë lloj konsensusi. Në lidhje me vendparkimet publike, ne kemi rënë dakord që në çdo rrugë dhe në çdo zonë bashkitë e vendit nuk mund të përdorin më shumë sesa 50% të hapësirës publike për parkingje me pagesë, duke u siguruar kështu qytetarëve 50% tjetër për parkingje pa pagesë. Ajo që është shumë e rëndësishme, e cila vjen edhe në kuadër të modernizimit të Policisë së Shtetit, në këtë rast të Policisë Rrugore, është pikërisht fakti që në këtë Kod ne sanksionojmë që Policia Rrugore nuk mund të kryejë më kontrolle në rrugë, siç e ka bërë deri tani, ku polici të del me një tabelë, dhe kur je në shkelje apo me shpejtësi të lartë, të ndalon në mënyrë jo të përshtatshme, duke krijuar në këtë rast edhe një mundësi më shumë për aksident. Në këtu sanksionojmë që Policia Rrugore, në këtë rast dëshiroj të falënderoj edhe drejtuesit më të lartë të Policisë Rrugore, të cilët kanë bashkëpunuar me komisionin për arritjen dhe gjetjen e një konsensusi të përbashkët për këtë çështje, do të bëhet me mjete teknologjike dhe ndalimi do të bëhet në kushtet e sigurisë, të shoqërimit dhe në një vend të sigurt, duke shmangur kështu mundësinë për të pasur aksidente, por në njëfarë mënyre edhe për të hequr atë që deri më sot është konsideruar një lloj mënyre apo kontrolli abuziv, por qoftë për të hequr edhe prezencën e policisë me uniformë nga rrugët kombëtare, duke dhënë edhe në këtë rast shembullin e një vendi, i cili realisht zhvillohet dhe shkon drejt rrugës së tij europiane. Në shumicën e shteteve europiane, ku ne kemi udhëtuar, nuk kemi parë ndonjë prezencë të policisë në rrugët kombëtare.

Nga krahu tjetër, kemi arritur të bëjmë edhe një ndryshim në lidhje me gjobat. Po, kemi arritur një konsensus. Sot gjobat brenda 5 ditëve kanë një ulje prej 20%, por ne e dimë që rritja e teknologjisë dhe vendosja e gjobave, qoftë edhe me mjete teknologjike, nuk të mundëson që ti të informohesh në kohën e duhur për gjobën që mund të kesh marrë, kështu që ne kemi arritur një konsensus që gjobat do të fillojnë të aplikohen, ose data kur fillon gjoba të aplikohet është dita kur

ajo regjistrohet si e tillë dhe brenda 15 ditëve qytetari ka të drejtë që të shkojë të paguajë me një ulje të detyrimit ndaj gjobës prej 50%, duke dhënë kështu një shembull. Ideja nuk është që ne të gjobisim apo të ndëshkojmë, por që t'i edukojmë qytetarët, sepse në fund fare qëllimi është që të mos kemi ose të kemi sa më pak aksidente që të jetë e mundur dhe jo të mund t'i ndëshkojmë qytetarët.

Për këto ndryshime, që ne i kemi diskutuar për një kohë të gjatë, duke marrë parasysh edhe shumë nga shqetësimet që kemi pasur të gjithë bashkë si përdorues të mjeteve dhe të rugës, mendoj se do të kemi mbështetjen e të gjithëve kolegëve në këtë sallë, që t'i kalojmë këto ndryshime në shërbim të të gjithë atyre që na kanë sjellë këtu.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Pëllumbi!

Zoti Sula, fjala është për ju.

Të përgatitet zonja Bushka.

Dashnor Sula – Faleminderit, zonja drejtuese e seancës!

Sigurisht, ky diskutim dhe debat që po bëhet sa i përket Kodit Rrugor ka vlerën e tij. Unë mendoj dhe gjykoj që nga mënyra se si flitet këtu, në këtë aulë të parlamentit, sa i përket Kodit Rrugor, duket sikur gjërat në këtë vend janë shumë normale. Unë mendoj se nuk janë normale dhe këtë duhet ta kemi të qartë që të gjithë.

Po e filloj me aksidentet rrugore. Aksidentet rrugore në Shqipëri në periudha të caktuara kohore, sidomos në periudhën e pushimeve verore dhe dimërore, kur vijnë edhe emigrantët, janë bilance lufte në Shqipëri, sepse të mos harrojmë, jo më larg se 1 javë më parë, nuk është mbushur java, te rrethrotullimi i TEG-ut humbën jetën 3 rinj, 2 të reja dhe 1 i ri tjetër. Këtu, teksa flitet për mjetet motorike të cilindrave të larta, po jua them, sado që ju ta bëni këtë ndryshim në Kodin Rrugor, të jeni të bindur (unë jam i bindur), se do të reflektohet për pjesën më të vogël të disa drejtuesve të automjeteve, por jo për pjesën më të madhe të drejtuesve të automjeteve të reja, të cilët janë djem të baballarëve politikanë, biznesmenë apo të atyre që kanë shumë para dhe pushtet, janë të privilegjuar, ashtu siç janë të privilegjuar çdo ditë në Tiranë dhe nëpër rrugët e Shqipërisë. Politika që ju trumbetoni sot kap fukarenjtë, atë pjesë që është e pambrojtur, ata që bëjnë shkelje

të vogla, ndërsa, po e them në kuptimin e plotë të fjalës, “të fortët” e Tiranës dhe të Shqipërisë apo gangsterët e Shqipërisë nuk i ndalon dhe i ka zero shanset që t'i ndalojë.

Jo më larg sesa dje, vura re, në një moment teksa po vija nga Elbasani në drejtim të Tiranës, mjete që e kanë timonin në krahun e kundërt, siç janë ato angleze apo të shteteve të tjera me timonin ndryshe nga pjesa tjetër e Europës, mjete me fuqi motorike të jashtëzakonshme, që kalonin me një shpejtësi të jashtëzakonshme. Madje, ju kemi arritur deri atje sa anashkaloni edhe emrat e targave të këtyre mjeteve, ku një ndër to më ka bërë shumë përshtypje, “Droga 63”, targa angleze.

Si qarkullon ai mjet këtu në Shqipëri?! Nuk e shikon asnjë polici?! Benz i tipit të fundit, me targë “Droga 63”! Ju, madje i stimuloni, me atë zotin Gonxhe tuajin, ju u bëni edhe targa personale e shumë gjëra të tjera, ndërsa për njerëzit e thjeshtë, të cilët me zor i paguajnë lejet e qarkullimit, keni rritur edhe patentën apo taksat e tjera. Ky është realiteti. Pse ndodh kjo? Kjo ndodh sepse (është shumë e thjeshtë, miqtë e mi), ne duhet ta dimë, pjesa më e madhe e njerëzve të caktuar, të cilët kanë pushtet politik dhe pushtet biznesi këtu në Shqipëri, janë personat që kryejnë trafikime të drogave të forta. U ka dalë nami shqiptarëve në të gjithë botën, jo më në Europë. Këtë nuk e them unë, por e thonë të gjithë dhe janë të shqetësuar EUROPOL-i dhe të gjitha agjencitë ligjzbatuese.

Së fundi, ju e dini shumë mirë, madje nuk ka mbushur as javën, se DEA ka hapur këtu në Shqipëri një zyrë për të pasur jo më një komunikim që e kishte nëpërmjet Athinës, por në Shqipëri, se është një fenomen jashtëzakonisht shqetësues që tupa apo njerëz të caktuar, interesa apo grupe të caktuara dhe biznese, të cilët zgjohen si biznese të ndershme, bëjnë trafikim të kokainës dhe të drogave të forta dhe të gjitha paratë, të gjithë e dimë, investohen në Shqipëri.

Po ju them se nga një bisedë, e cila është bërë publike në një nga mediet shqiptare, një urbanist nga Korça kishte biseduar me një djalë pa mbushur ende 23 vjeç, i cili kishte 83 apartamente në qytetin e Tiranës, se punonte në Londër. Si ka mundësi që një djalë i ri, pa punuar kurrë gjatë jetës së tij në Shqipëri, pa përfunduar as studimet dhe gjëra të tjera, të ketë 83 apartamente?! Ndërsa një çift, një i ri apo e re, që punojnë në punë të

shtetit, i kanë shanset zero të blejnë një banesë në Shqipëri. Si shpjegohet që Bashkia e Tiranës vetëm gjatë 4 vjetëve të fundit ka dhënë 6 milionë metra katrorë leje ndërtimi në Tiranë? Si shpjegohet që vetëm për vitin 2022, Bashkia e Tiranës ka dhënë 2 milionë metra katrorë leje ndërtimi në Tiranë? Si shpjegohet që Banka e Shqipërisë e ka kaluar Euribor-in në 4,5% nga 1,5% që ka qenë, duke rritur të gjitha kreditë? Po, mund ta verifikosh. Dakord, mund të jetë edhe gabim, por ka një rritje të tillë të Euribor-it, pa diskutim, si dhe të përqindjes së interesave dhe marrja e kredive nga persona, të rinj dhe të reja, të cilët krijojnë familje për herë të parë, është e pamundur këtu në Shqipëri. Pra, ky është realiteti, ndërsa ne këtu vijmë e flasim sikur jetojmë në një realitet krejt ndryshe.

Sigurisht, të nderuar miqtë e mi, këto nuk i them unë, se po të flasë opozita, po të flasim ne, thuhet që ju shpifni, flasim në gjuhën shqipe apo në gjuhë të huaj, dhe shajmë Shqipërinë. Jo. Ju të gjithë e keni ndjekur dhe e keni parë artikullin e fundit, i shkruar të "Financial Times", që për hir të së vërtetës është një media superprestigjioze, të cilën e lexojnë njerëz që merren me ekonomi apo me politikë dhe e dinë fort mirë që një shkrim i shkruar në "Financial Times" ka një problematikë jashtëzakonisht të madhe. Kjo gazetë ka shkruar shumë qartë dhe saktë. Deri në vitin 2013, "Financial Times" i bënte jehonë edhe Kryeministrit Rama dhe qeverisë së Partisë Socialiste, e cila erdhi me premtimin e fortë se do të luftonte korrupsionin dhe bandat në Shqipëri, në një kohë që kjo nuk është e vërtetë, sepse të gjithë e dimë që krimi këtu çdo ditë lulëzon. Jo vetëm persona të caktuar dhe individë me rekorde kriminale, por edhe banda kriminale, që janë të përditshëm në aktivitetin e tyre, qoftë në ato të vrasjeve me pagesë apo në aktivitete të tjera, por që janë kthyer në personat që u japin para me fajde biznesmenëve, të cilët e kanë të pamundur të përballojnë biznesin e tyre në ndërtim, sepse dalin të falimentuar, duke pasur parasysh që sot çmimet e ndërtimeve janë jashtëzakonisht të larta, gjë, që e kam thënë edhe herë tjetër.

A ka logjikë ekonomike që një metër katror banesë këtu (ato që kemi ne këtu në krah, te Lana apo në vend tjetër në Bllok) të jetë 3 apo 4 mijë euro? Të mos llogaritësh sa është për një dyqan! Këto janë ato paratë e drogës dhe të trafikimeve që ndodhin.

Unë e them dhe kam një shpresë të plotë që hapja e zyrës së DEA-s së Shteteve të Bashkuara të Amerikës këtu, do sjellë atë që ka ndodhur dhe në Kosovë. Në Kosovë, vetëm për politikanët, arritën të shkonin rreth 250-300 denoncime, duke dhënë efektin e tyre. Edhe në Shqipëri do të ndodhë e njëjta gjë. Duke mos pasur besim tek organet ligjzbatuese shqiptare, te policia, prokuroria apo qeveria, sigurisht, Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë të detyruara të hapin zyrën e DEA-s në Shqipëri, sepse janë të shqetësuar sa i takon trafikimit të drogave të forta dhe korrupsionit në Shqipëri. Të jeni të sigurt se do të vërshojnë denoncimet e qytetarëve dhe informacionet që ata kanë për personat e korruptuar, të politikës apo kudo. Atë fondin sekret që ka DEA për ta shpenzuar, nuk ka për ta shpenzuar, sepse do të jetë falas dhe anonimati do t'u ruhet të gjithë personave.

Po vazhdoj më tej. Media britanike u ka kushtuar një artikull jashtëzakonisht të zgjeruar shqiptarëve. Të gjithë e dimë se trafiku i klandestinëve apo i drogave të forta që hyjnë në Mbretërinë e Bashkuar, nuk goditet në origjinë. Dhe, duke mos u goditur në origjinë, si dhe duke pasur parasysh dobësinë e organeve ligjzbatuese këtu në Shqipëri, sidomos Policisë së Shtetit, dhe inkurajimi që u japin elementë të caktuar të politikës shqiptare, trafikantët përfitojnë. Po të mos kenë mundësi që këto para, të cilat i fitojnë në këto vende, t'i investojnë këtu në mënyrë informale, t'i investojnë sidomos në imobiliare, sigurisht, do të ishte më pak i mundur edhe trafikimi i drogave në Mbretërinë e Bashkuar dhe në vende të tjera.

Të njëjtin shqetësim të madh e ka edhe Zvicra, po të kemi parasysh që Zvicra është një shtet me norma shumë të larta të rregulluara, me një shtet ligjor të fortë; edhe atje është jashtëzakonisht shqetësuese situata sa i përket trafikimit të drogave dhe kriminalitetit që importohet dhe lëviz në Europë, por kokat janë në Shqipëri.

Unë po ju them, duke u nisur nga përvoja dhe eksperiencia ime, këtu është edhe zoti Naço, si ish-prokurorë në Prokurorinë e Përgjithshme, që kemi pasur marrëdhënie me antimafien italiane, se që nga periudha 1997-2000 ka qenë një shqetësim jashtëzakonisht i madh elementi kriminal me aktivitet të paligjshëm në drejtim të Italisë dhe të vendeve të tjera, ndërsa sot ka kaluar

në një stad jashtëzakonisht të lartë. E gjithë kjo ka ndodhur për një arsye shumë të thjeshtë, sepse ata fitojnë para andej dhe vijnë e investojnë në Shqipëri dhe këtu syri mbetet qorr për të gjitha organet ligjzbatuese shqiptare, duke filluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, të cilat merren me persona që bëjnë biznes...

Ermonela Felaj – Ju lutem, përfundojeni fjalën!

Dashnor Sula – Mbarova.

...dhe nuk merren me ata që i kanë para syve, të cilët ndërtojnë dhe investojnë para të pista dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave nuk e kap një gjë të tillë.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zot Sula!

Në fakt, fjalën sipas listës së përditësuar të diskutantëve duhet ta kishte zonja Bushka, por ajo nuk ndodhet në sallë, kështu që menjëherë pas zonjës Bushka fjalën për këtë projekt e kam unë.

Faleminderit, kolegë!

Unë besoj, sot e gjithë ditën, se përgjegjësitë tona lidhen, së pari, me reagimin për çështjet e interesit publik. Do të dëshiroja shumë që ne të ishim të thelluar në çdo çështje të interesit publik, që çmujmë se duhet ngritur në këtë sallë të Kuvendit.

Së dyti, përgjegjësia jonë lidhet me të shkruarit, ne jemi ligjvënës, pra ne vendosim për ligje dhe ka shumë rëndësi kujdesi që ne angazhojmë në shkrimin e ligjeve, në kalimin apo miratimin e përmbajtjes së çdo projekti këtu, pavarësisht peshës specifike që mund të ketë secili.

E pra, Kodi Rrugor përfaqëson një ligj të cilësuar. Është një ndër ato ligje të rëndësishme, i cili, sigurisht, nuk mund të ndryshohet dhe as nuk mund plotësohet, nëse nuk ka konsensus të më shumë se numrit që ka një mazhorancë e caktuar në Kuvend, pra duhet një shumicë e cilësuar që të miratohen ndryshimet në Kodin Rrugor.

Unë besoj se është arritur konsensusi për miratimin e disa ndryshimeve të propozuara në Kodin Rrugor. Vijnë të jetë i rëndësishëm, sepse tregon edhe një herë që brenda kësaj sale ka njerëz të predispozuar që, kur vjen fjala për çështje të interesit publik, të rëndësishme apo për çështje që na takojnë neve dhe të gjithë qytetarëve, sepse tekefundit edhe ne qytetarë jemi, duhen lënë mënjana retorikat politike. Besoj

se ajo që duhet të kemi më shumë në vëmendje është të sigurohemi se kemi ofruar ekspertizën më të mirë profesionale në fushë.

Për hir të së vërtetës, ndryshimet e propozuara në Kodin Rrugor, qoftë ato të bëra nga kolegët e opozitës, qoftë ato të bëra nga kolegët e mazhorancës, janë ndryshime që kanë angazhuar diskutime të deputetëve të disa komisioneve parlamentare. Komisioni i Ligjeve ka qenë komisioni që është angazhuar në diskutimet lidhur me këto ndryshime, po kështu edhe Komisioni i Sigurisë Kombëtare dhe Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese.

Për shkak të *background*-it dhe asaj që parashikon rëndësia në lidhje me hierarkinë e akteve, unë do t'ju thosha se duhet të kishte qenë Komisioni i Ligjeve komisioni përgjegjës për miratimin e të gjitha ndryshimeve. Kjo mbase do të na kishte eliminuar edhe disa konsiderata, të cilat unë do t'i ndaj me ju, duke shpresuar se deri në momentin e votimit ne të kemi mundësi që realisht të reagojmë dhe të shkruajmë një gjë siç duhet.

Ndryshimet pa dyshim që i vlerësoj. Siç jua thashë, nuk bëj dot asnjë dallim dhe nuk paragjykoj dot asnjërin prej kolegëve që kanë punuar për të sjellë këto ndryshime në Kodin Rrugor. Është normale që ato të bëhen në një ligj të tillë.

Po sjell në vëmendjen e të gjithëve dhe të publikut se Kodi Rrugor daton që në vitin 1998, pra është miratuar përpara Kushtetutës, por që prej asaj kohe e deri më sot kuptohet se legjislacioni ynë ka pësuar ndryshime të shumta dhe të ndjeshme. Po ashtu, ne i jemi futur një rrugë të re, siç është rruga e integritetit evropian dhe kjo na detyron të jemi të kujdesshëm që jo vetëm në këtë ligj, por edhe në ligje të tjera, të mundemi të ndërhyjmë kohë pas kohe dhe t'i adresojmë ndryshimet e duhura.

Në fakt, ndryshimet që bëhen këtu janë përgjithësisht të kësaj natyre, janë ndryshime që tentojnë të sjellin terminologjinë e re. Për shembull, reforma administrative që ka ndodhur në vitin 2015, sigurisht, e imponon që këto ndryshime të fitohen dhe të përmenden në të gjitha ligjet. Në fakt, kjo ka ndodhur me propozim të kolegëve të opozitës, por unë besoj se shqetësimi më i madh i tyre ka qenë në drejtim të rritjes së sigurisë rrugore. Kur flasim për Kodin Rrugor, besoj se natyrshëm na vjen në mend se

bëhet fjalë për një ligj, i cili ofron ose kërkon të sigurojë standardin më të lartë të përdorimit të rrugës, sepse rruga përdoret edhe nga këmbësorët, por po ashtu edhe nga drejtuesit e mjeteve. Nëpërmjet parashikimit të të drejtave dhe detyrimeve të secilës kategori, ne parandalojmë sa të jetë e mundur, sigurisht, edhe duke ndërhyrë në mënyrë të herëpashershme. Ndodhin aksidente rrugore, që, fatkeqësisht, shpeshherë shoqërohen me dëme të rënda për shëndetin ose me humbje të jetës së njerëzve. Unë besoj se ngjarjet e ditëve të fundit nuk kanë lënë askënd indiferent, ato vazhdimisht na kujtojnë që rruga vazhdon të mbetet e pasigurtë. Kjo tregon se secili nga komisionet duhet ta diskutojë këtë çështje sipas përgjegjësi që ka dhe të ofrojë mundësinë e përmirësimeve të tjera në ligj. Komisioni i Sigurisë, në fakt, vazhdimisht e ka ngritur problemin e pikave, të atyre që quhen *hotspot*-e në rrugë, që përbëjnë shkak për aksidente rrugore, dhe i ka kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve në Shqipëri të reagojë. Gjithashtu, në komision është ngritur shqetësimi për tabelat e sinjalistikës. Nganjëherë tabelat e sinjalistikës shënojnë kufizime shpejtësie ose shpejtësi, të cilat me kalimin e kohës janë të papërshtatshme. Kolegët në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese dhe propozuesit nismëtarë e kanë pasur parasysh këtë moment kur janë përpjekur të njësojnë normat e kufirit të shpejtësisë së lejuar, me ato të vendeve të BE-së. Të them të drejtën, dy ndryshime që unë i gjej më me vend, janë: kufizimi i shpejtësisë për drejtuesit për herë të parë, të cilët për tre vjetët e parë pas marrjes së patentës janë të detyruar të ecin me shpejtësi të kufizuar, dhe moslejimi i drejtimit prej tyre i mjeteve me fuqi motorike të lartë. Janë ndryshime të duhura, besoj se do të japin efektet e veta dhe, në njëfarë mënyre, do të eliminojnë premisat e ndryshme për korrupsion që krijohen gjatë zbatimit të ligjit, pasi është diskutuar gjatë, të paktën për rastin e fundit, ku kishte 5 herë ndërhyrje nga autoritetet e qarkullimit rrugor, por, ndërkohë, të ndjerit nuk i ishte hequr patentat. Mendoj se ky kufizim, që tashmë do të shkruhet edhe në lejen e drejtimit, është i duhur.

Gjithashtu, pashë propozimin që bëhet për vendparkimet me pagesë dhe ato pa pagesë. Edhe ai është propozimi i duhur, sepse u imponon autoriteteve lokale, bashkive, që e gjithë sipërfaqja që u vihet në përdorim për parkimet, të

mos shkojë në favor vetëm të atyre që paguajnë për të pasur një parkim, por të ketë një ndarje proporcionale, që, siç e kam parë unë në projektligj, është një ndarje e drejtë 50% me 50%. Kjo është një gjë shumë e mirë, sepse ne si qytetarë dhe banorë kërkojmë që zonat ku banojmë të njihen si zona rezidenciale për sa u përket çështjeve të parkimit. Unë nuk mendoj që kjo është një gjë e pavend, patjetër që është një gjë me vend, sepse problemet për vendparkimet ndodhin gjithandej.

Tani unë premtova se do të bëj dy vërejtje: së pari, vërejtja ime ka të bëjë me dy nene të projektligjit, me nenet 7 dhe 8. Unë mendoj se, fakti që nuk ka kaluar në Komisionin e Ligjeve, ka lejuar të ndodhë një lloj cedimi, të cilin juristët që janë në këtë sallë, nuk mendoj se nuk do ta kuptonin dhe do ta lejonin. Verifikimi i pronësisë së mjeteve nuk është një veprim që duhet të ndodhë para punonjësve të drejtorisë ose autoritetit të shfrytëzimit rrugor, sepse kjo vjen në kundërshtim të hapur me Kodin Civil. Ndryshimi i pronësisë, qoftë me pagesë, qoftë i dhuruar, qoftë i dhënë në përdorim, qoftë i dhënë me qira, të formalizohet nëpërmjet kontratave dhe kontratat marrin vlerë nëse notifikohen para noterit, përndryshe konsiderohet një veprim juridik absolutisht i pavlefshëm dhe kjo nuk duhet të ndodhë. Pra, unë e kuptoj dëshirën për të hequr burokracitë apo për t'u mundësuar drejtuesve të mjeteve t'i kryejnë këto veprime në mënyrë të shpejtë, por këtë nuk mund ta bëjmë në emër të një ligji që rregullon një marrëdhënie të veçantë dhe që ka prioritet ndaj këtij ligji sa i takon marrëdhënies që rregullon.

Çështja e dytë, për të cilën dua të ndërhyj, është ajo që ka të bëjë me verifikimin e mjeteve bujqësore. Unë nuk e kuptoj pse deri më sot këtë verifikim të mjeteve bujqësore, nëse janë në përputhje me standardet ose jo, e ka kryer drejtorja ose autoriteti rrugor, ndërsa tani kërkohet ta bëjë një shërbim i licencuar?! I licencuar nga kush? Nga vetë drejtorja. Kjo nuk bën sens. Prandaj, do t'ju ftoja që këtë ta rishikonim, sepse vlerësoj se edhe ndërgjegjësimi ynë në drejtim të atyre shërbimeve që jepen në *outsourcing*, ka ndryshuar. Vetë shembulli i kolaudimit të automjeteve, ato që ndodhnin në kolaudimin e mjeteve në Shqipëri, do të na bëjnë të jemi pak më të kujdesshëm.

Për të gjithë ata kolegë që nuk e kanë parasysh, do të doja t'ju thosha se ne e dhamë për 10 vjet me koncesion shërbimin e kontrollit fizik të automjeteve në Shqipëri, dhe, nëse koncesionari përfitoi pothuajse 23 milionë euro gjatë 10 vjetëve të operimit këtu në Shqipëri, shteti shqiptar nuk mori as 1 milion euro; të gjitha qendrat që na lanë në dispozicion, ishin të pavlefshme, jashtë funksionimit dhe jashtë standardeve; po kështu, edhe pjesa që lidhej me IT-në është e papërdorshme dhe e dalë jashtë funksionit. Është një gjë e mirë që funksioni doli jashtë kontrollit, mbaroi, dhe ne vendosëm që këtë shërbim të rëndësishëm, që pa dyshim është një standard që lidhet me sigurinë rrugore, ta ofrojmë tashmë një ent shtetëror.

Por nuk gjej arsye, ndoshta propozuesit që do të marrin fjalën më vonë do të japin arsye, por unë sinqerisht nuk i gjej arsyet pse shërbimin e kontrollit të mjeteve bujqësore nuk duhet ta mbajë vetë autoriteti rrugor, por duhet ta japë tek të tretët.

Ndërkohë, ju ftoj që këtë nen ta shikojmë seriozisht, sepse unë nuk besoj që Kuvendi i Shqipërisë të lejojë gabime të rënda të kësaj natyre! Nuk do të ishte në nderin e asnjë juristi këtu, më së pari, të mos e kishte këtë lloj reagimi.

Faleminderit për vëmendjen!

Sipas listës së diskutantëve, fjalën e ka zoti Braçe.

Të përgatitet zoti Tritan Shehu.

Erion Braçe- Faleminderit!

E nderuar drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, do të doja ta filloja ndryshe këtë fjalë timen, por, për të theksuar edhe më fort këtë që zonja Felaj ngriti si shqetësim këtu, do ta nis pikërisht te ky shqetësim. Shikojmë se mjetet bujqësore po përhapen gjerësisht në fshat, falë edhe mbështetjes që ka ardhur nga masat fiskale: ato hyjnë pa TVSH, pa taksë doganore, por qoftë edhe falë mbështetjes që ka dhënë qeveria ose programet IPARD, për pajisjet e bujqve me mjete bujqësore. Natyrisht që mjetet bujqësore nuk janë më ato të vjetrat, nuk është më ai standard që ka qenë ose që ne kemi trashëguar, nuk janë më ato mjete që shqiptarët i kanë blerë të përdorura në çdo treg të hapur të vendeve rreth e qark nesh, por janë mjete të reja, të viteve të fundit dhe meritojnë të trajtohen njëlloj, siç trajtohen edhe autoveturat,

sa i takon standardit të sigurisë nga pikëpamja e kushteve teknike të tyre.

Kështu që, është e tepërt që ky shërbim të konsiderohet barrë nga drejtorja përgjegjëse dhe të jepet te cilido që ofrohet për të ofruar shërbimin e kontrollit teknik të tyre privatisht. Unë nuk e kuptoj, pse ne duhet të kemi dy standarde, veçanërisht në çështjet e sigurisë? Të them të drejtën, unë, në çështjet e sigurisë, më tepër i besoj shtetit se cilitdo privat; e kam thënë këtë 10 vjet më parë, ditën kur në këtë parlament u miratua koncesioni i kontrollit teknik të automjeteve, një koncesion që nuk bëri asgjë tjetër veçse transferoi korrupsionin nga njëra dorë në një dorë tjetër. Tashmë që zhvillimet e teknologjisë kanë përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Transportit Rrugor, shërbimet atje janë më të kontrolluara, natyrisht me kosto shumë më të lirë se i ofron një privat, dhe që është një standard që e kemi provuar. Në fakt, sapo shërbimi ka kaluar nga shteti te privati, gjëja e parë që është bërë janë rritur kostot e shërbimit, që kanë rënduar mbi kurrizin e qytetarëve. Unë mendoj se në sektorin e bujqësisë, çdo kosto e shtuar natyrisht i bën dëm ekonomisë bujqësore dhe blegtorale. Kështu që, edhe unë jam kundër propozimit të bërë në projektligj që ky shërbim të dalë nga shërbimi publik dhe t'i jepet një privati për të ofruar shërbime për mjetet bujqësore.

Së dyti, nëse ka një problem dhe shqetësim real, që duhen adresuar, ka të bëjë me personat që ngasin mjetet bujqësore. Thuajse çdo muaj, për të mos thënë edhe me një frekuencë më të afërt në kohë, çdo dy javë, ndodh një aksident shumë i rëndë ku gjithmonë e pësojnë ata që ngasin mjetet bujqësore. Nuk është njësoj si të ngasësh një autoveturë, si të ngasësh një autokombajnë, nuk është njësoj si të ngasësh një makinë të lartë, si një traktor që punon tokën, sepse aty një gabim elementar të merr jetën. Edhe në rrugë një gabim ta merr jetën, por, kur dihet se në këtë sektor nuk ka shpejtësi të madhe, sepse mjetet bujqësore punojnë me një procedurë të caktuar, me një shpejtësi të caktuar, me një shpejtësi fare minimale, për t'i shërbyer tokës, natyrisht që është e tepërt të ketë aksidente. Shpesh nuk gjenden traktoristë dhe në traktor hip kushdo, madje edhe një fëmijë, dhe po të shkonin në fshat e gjeni gjerësisht këtë gjë. Unë mendoj se edhe këtu duhet një kontroll i shtuar për ata që marrin patentat për të ngarë këto mjete. Këtu po, duhet

kontrolli i shtuar me qëllim që të parandalojmë aksidentet. Në kushtet kur jemi të kufizuar nga krahu i punës, veçanërisht në fshat, në kushtet kur kemi gjithnjë e më pak njerëz të specializuar, veçanërisht në fshat e për punët e bujqësisë, patjetër që na duhet të sigurojmë jetën e këtyre njerëzve. Kjo është themelore.

Unë këto dy gjëra kisha sa i takon shërbimit të kontrollit teknik të mjeteve bujqësore dhe pajisjes me leje drejtimi të atyre që i ngasin këto mjete. Nuk kam parë dhe nuk kam gjetur shkolla, ku të rinjtë duhet të mësojnë të ngasin këto mjete. Fluksi i madh është për të marrë patenta, kryesisht për autovetura, por, po me ato patenta pastaj ata ngasin edhe mjetet bujqësore, që kanë një procedurë të veçantë ngasjeje, sepse nuk mund ta bëjë kushdo, nuk mund t'i ngasë kushdo dhe nuk mund ta punojë tokën kushdo.

Së dyti, patjetër që ne bëjmë mirë që ndryshojmë legjislacionin; kemi nja 4-5 muaj përpara, që janë muajt e turizmit dhe që janë muajt me fluks të lartë mobiliteti jo vetëm të vendasve, por janë kryesisht të njerëzve që vijnë në Shqipëri qoftë për arsye familjare, qoftë edhe për arsye të turizmit. Të gjithë këta njerëz janë mësuar me standard komplet tjetër të ngarjes së makinës e të respektit përkundrejt rregullave të qarkullimit rrugor dhe natyrisht edhe me standard tjetër infrastrukture dhe standard tjetër shpejtësie, të vendeve të BE-së ku ata jetojnë. Këtu nuk përshtaten dot dhe mospërshtatja e tyre me rregullat që ne kemi, natyrisht që ka sjellë si pasojë aksidentet me numër të lartë viktimash. Kështu që, ne bëjmë mirë që e përshtatim legjislacionin. Kemi bërë mirë, gjithashtu, që kemi filluar të pajisim me teknologji të kontrollit në rrugë, punonjësit e Policisë Rrugore, por, nganjëherë, shumë më tepër se polici në rrugë vlen shembulli, i cili fillon nga ata që merren për modele në shoqëri. Ne, kategoria jonë e deputetëve, kryetarëve të bashkive, pra e të zgjedhurve, jemi një lloj modeli dhe natyrisht duhet të fillojë nga ne, si përdorues të rrugës dhe si përdorues të automjeteve, por edhe nga ne si prindër të fëmijëve, që shpesh sillen me hijen e mamit ose të babit deputet ose deputete, ministër ose ministre, kryetar bashkie e kështu me radhë apo babit e mamit biznesmenë. Që ata fëmijë të mos përdorin makina të cilindrave të larta, nuk mjafton ky ligji që është këtu.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Kur ndërhyra unë pak më parë reagoje, po a e shikon se çfarë bën ajo aty, ajo atje në fund fare?

Pra, që ata fëmijë të mos ngasin makina të cilindrave të larta, nuk është thjesht punë e policisë, nuk mund t'i ndjekë polici, se aq policë kemi ne për t'i gjurmuar nëpër rrugë. Që ata fëmijë të mos mbajnë makina të cilindrave të larta, duhet ta japim ne shembullin të parët. A ka mundësi që ne të ulim cilindrata e makinave tona? T'i ulim. Bëmë një politikë fiskale, me të cilën e bëmë taksën e tyre më të lartë, që nga pikëpamja ekonomike ta frenonim këtë lloj tendence për të rendur pas makinave të cilindrave të larta. Mirë për vete që nuk u ndikuam nga kjo, por nuk kemi ndikuar as për fëmijët tanë, edhe ata lëvizin me makinën e mamit dhe të babit, me cilindrata të larta. Kështu që është themelore, jetike, të japim ne shembullin të parët. Është turp, sinqerisht është turp, që, kur ne grumbullohemi të gjithë, gazetarë apo çdokush që kalon aty merret me cilindrata e makinave që kemi ne. Dhe pse s' duhet ta mbajë makinën e një cilindrave të lartë një fëmijë, ai fëmija që humb jetën atje?! Pra, përgjegjësia duhet të fillojë me ato që shërbejnë si modele. Është e thjeshtë ta godasësh policin, t'i turrësh policin, është e thjeshtë fare ta bësh përgjegjës policin, nganjëherë, për shkak të njëmijë e një gjërave, është e thjeshtë edhe ta blesh policin. Kjo ndodh, si në rastin e pak ditëve më parë që u arrestuan se merreshin pikërisht me këtë gjë. Por është edhe më e thjeshtë të sillemi ne si model për shoqërinë, mbi të gjitha të sillemi si model për familjet tona. Po bëmë ne këtë, patjetër që do të na ndjekin pas edhe të tjerët. Patjetër, nëse e kërkoj këtë për vete, e kërkoj edhe për të pasurit tanë, se janë ata modeli "kokë e makinë". Është shumë kollaj të thuash që rrugët tona janë të ngushta, që nuk i mbajnë kaq shumë makina e të tjera me radhë, por është shumë më e kushtueshme të zgjerosh rrugët dhe është më pak e kushtueshme të kufizojmë ne veten me prezencën tonë "kokë e makinë" në rrugë. Thuhet se ka ardhur koha të jetojmë shëndetshëm dhe shëndeti buron nga ato që na ka dhënë Zoti, nga këmbët, nga lëvizja natyrale, pastaj te lëvizja artificiale me makina.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Zoti Gështenja.

Kolegë, a mund t'i konsumoni bisedat jashtë sallës? Zoti Çela, ndjesë, nuk kam dëshirë

të bëj këtë lloj ndërhyrjeje, por jeni duke penguar edhe kolegët e tjerë.

Lefter Gështhenja - Faleminderit!

E mora fjalën për të mos krijuar një tollovi në opinionin publik, por për t'ju qartësuar të paktën, qoftë ju që prekët dy çështje, por edhe kolegun tim, zotin Braçe, lidhur me dy pikat që ngritët si shqetësim. Nuk është e vërtetë, sepse në draftin final nuk qëndron asnjëra nga këto që ju cituat, qoftë kjo e kolaudimit të mjeteve bujqësore: ka qenë një propozim i tillë, por, kur ne si komision u informuam se për kolaudimin e mjeteve bujqësore shkon tek drejtorja dhe e bën në vend, (sepse propozimi ka qenë që mjetet bujqësore, zetori, autokombajna, të mos shkojnë nga Divjaka në Fier apo nga Përrenjasi në Elbasan, por të bëhen në pika, siç është në të gjithë botën, në pika servisi të licencuara nga drejtorja), ka rënë si pikë, nuk ekziston te drafti final.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka edhe një problem, zoti Braçe, për të qenë të sinqertë me njëri-tjetrin, në *e-mail*-in që i ka ardhur çdo deputeti, nuk është drafti final, por variantet e propozuara nga secila palë. Kjo vlen për stafin e administratës (jo për mua dhe për ju), që duhet të jenë të kujdesshëm në çdo rast, sepse është hera e disatë që ndodh kjo, që drafti final nuk është në *e-mail*, por janë raportet që ne kemi diskutuar në komision.

Në draftin final nuk ekziston edhe ajo që thatë ju, zonja drejtuese e seancës, lidhur me ndryshimin e pronësisë. Pra, është rrëzuar, nuk është, edhe pse opinionin publik duhet të dijë që, sot që ne flasim, drejtorja e transportit rrugor e realizon këtë proces. Pra, të mos themi që është në kundërshtim me ligjin e të tjera. Sot, në fakt, kështu bëhet, ndërrimi i pronësisë bëhet te drejtorja, pa shkuar te noteri.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Unë iu referova një dokumenti parlamentar, siç është raporti, nëse është ashtu, nuk ka nevojë të ndërhyjmë, të paktën te neni 7, sepse në nenin 7 të projektligjit thuhet qartësisht se paraqitet fizikisht dhe nuk ka nevojë për akt të shkruar të regjistrojë ndryshimet e pronësisë. Pra, të paraqitesh fizikisht me kontratën e bërë te noteri, jam krejt dakord, nuk kam asnjë problem, por të pretendosh të zëvendësosh noterin me punonjësën e autoritetit rrugor, kjo nuk duhet të ndodhë, kjo është flagrante. Juristët nuk do ta pranonin dot këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk e di si zbatohet, nëse zbatohet, sigurisht, ka vend për përgjegjësi penale. Ligji, siç është sot, është shumë mirë në këtë pikë. Unë atë i propozova, që nenin 7 të projektligjit, nenin ku ka ndërhyrë, ta lërë ashtu siç është. Ky ishte propozimi im për ju dhe besoj se isha më se qartë në atë që thashë, sepse nuk mund të ndodhë, nuk ka asgjë politike këtu. Ja unë do t'ia jap fjalën zonjës Dhurata, që e di që më kërkon ndërhyrje për këtë pikë.

Dhurata Çupi – Duke qenë se ju, si drejtuese e seancës, e adhuron procedurën, unë ju kërkoj, zonja Felaj, ta ktheni këtë ligj, që, së pari, të diskutohet në Komisionin e Ligjeve. Është e pazakontë të miratohet këtu një kod i padiskutuar në Komisionin e Ligjeve. E mora fjalën në fund, për shkak se do të flas te projektligji tjetër.

Së dyti, jam dakord me atë që thatë se neni 7 ndryshon nenin 93. Nëse ju më lejoni, unë do ta lexoj: “Në rast ndryshimi pronësie të mjeteve rrugore, ose në rastin kur u jepen në përdorim të tjerëve ose lidhen marrëveshje me të drejtëblerjeje, palët paraqiten pranë degës përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor për të bërë regjistrimin e ndryshimit të pronësisë ose ndryshime të tjera. Për kryerjen e regjistrimit mjafton prania fizike e palëve...”. Kjo, në fakt, është totalisht e papranueshme dhe sigurisht e pakoduar, lidhur edhe me Kodin Civil dhe ligje të tjera të noterisë.

Së dyti, që të jemi transparentë, se unë nuk e dëgjova të thuhet këtu, por, së pari, nuk ka kaluar në Komisionin e Ligjeve, së dyti, ne diskutojmë këtu një Kod Rrugor vetëm disa ditë pas një aksidenti tragjik, ku është shokuar mbarë opinionin shqiptar, ku shpejtësia ishte shkak i aksidentit, dhe ne rrisim shpejtësinë nga 120 në 130 kilometra në orë, ndërkohë që rrugët janë këto që janë. Ne sot përshtatim shpejtësinë me kriteret europiane, por nuk përshtatim rrugët. Rrugët janë të njëjtat, zonja Felaj, kështu që rritja e shpejtësisë nga 110 në 120, nga 120 në 130, është e papranueshme. Edhe qytetarët shqiptarë nuk e pranojnë, të jeni të sigurt. Dhe, nga ana tjetër, përgjysmojmë jobat.

Ermonela Felaj – Zonja Çupi, ju lutem, përfundoni!

Dhurata Çupi – Është totalisht e papranueshme që sot, kur rrugët nuk

kontrollohen, kur aksidentet shtohen, ju rritni shpejtësinë, ulni gjrobat.

Ndërkohë, Kodi nuk është diskutuar fare në Komisionin e Ligjeve sa i takon të paktën përshtatshmërisë me kodet e tjera, prandaj unë ju kërktoj, zonja drejtuese e seancës, ta ktheni këtë Kod, të ndjekë procedurën normale të kalimit në Komisionin e Ligjeve. Shpresoj se do t'i qëndroni kësaj që kërktoj.

Ermonela Felaj – Unë besoj se mund ta gjejmë gjuhën me kolegët tanë, se kolegët tanë janë ata që i kanë bërë këto propozime dhe mund të kujdesemi që të shkruajmë gjënë e duhur, por deri atëherë do t'u kërktoj shërbimeve të kujdesen për të ofruar draftin e saktë të ndryshimeve në mënyrë që të mos bëjmë diskutime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, pikërisht për atë.

Do të doja t'ju jepja fjalën zoti Lika, por për çfarë e keni kërkuar, për diskutime? E kam listën e diskutantëve përpara dhe ju nuk figuroni të jeni i regjistruar.

Ramadan Likaj – Jo, nuk jam i regjistruar për diskutim, por thjesht për procedurë.

Unë besoj se të dy grupet, si mazhoranca edhe opozita, kemi punuar shumë për të arritur në këtë draftpropozim dhe unë mendoj se nuk është e nevojshme sot të ridiskutohet që Komisioni i Ligjeve duhet ta kishte riparë, për sa kohë që diskutimi i këtij projektligji ka zgjatur pa fund derisa kemi arritur në një marrëveshje të tillë. Pra, unë nuk mund të mendoj kurrësi të ridiskutohet, dhe të mendohet se Komisioni i Ligjeve duhet ta rishohë. Besoj se ka pasur kohën e mjaftueshme. Ne kemi pasur dakordësinë e plotë nga të dyja palët dhe unë mendoj se, si mazhoranca, edhe opozita, sot duhet t'i japin përfundimisht votën këtyre ndryshimeve, të mos zgjaten pa fund, sepse shqiptarët e presin një gjë të tillë.

Për sa kohë ne jemi të vetëdijshëm të gjithë, sepse udhëtojmë çdo ditë kudo, nëse ne, të gjithë së bashku, e kemi marrë këtë nismë dhe kemi krijuar këtë dakordësi, pse duhet të diskutojmë sot pa fund për një gjë të tillë? Ju jeni të vetëdijshëm edhe për diçka tjetër: para Vitit të Ri kemi dashur ta kalojmë në parlament këtë projektligj. Besoj se jeni në dijeni për këtë, zonja drejtuese, si anëtare e Komisionit të Ligjeve. Besoj se po. Ndaj them që, ishte edhe kërkesa e kolegëve tonë të mazhorancës, ta votonim po atë ditë dhe shqiptarëve t'u jepnim një Kod të ri Rrugor. Ndaj

them që është në nderin e të gjithë parlamentarëve sot që ky projektligj të kalojë sa më shpejt.

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Likaj!

Besoj se ne e kemi arritur atë lloj konsensusi dhe le t'u qëndrojmë gjërave që na bashkojnë, rregullimet e vogla mund t'i bëjmë, sepse Rregullorja na e jep atë të drejtë në momentin e votimit, sikurse i bëri dhe zoti Gështenja ndërhyrjet sqaruese.

Folësi i fundit është zoti Tritan Shehu, por unë nuk e shoh në sallë, kështu që konsiderohet se ka hequr dorë nga diskutimi.

Mbyllet këtu ky diskutim.

Kalojmë në projektligjin: “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë”. Referuar nenit 73, pika 2, të Rregullores, a keni pyetje për nismëtarin? Nuk ka pyetje.

Fjalën e ka ministri i Brendshëm, zoti Çuçi, i cili flet për prezantimin e kësaj marrëveshjeje, pa kufizim kohor.

Bledar Çuçi – Faleminderit!

E nderuara drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë,

Para se të flas për rendin e ditës, doja të bëja një sqarim për një shqetësim që ngriti deputeti Sula, por edhe për opinionin publik, në lidhje me atë që e quajnë zyrë të DEA-s në Shqipëri.

Së pari, ajo nuk është zyrë, por është një person që DEA ka caktuar të jetë permanent në Tiranë. Deri sot, ne bashkëpunonim me DEA-n nëpërmjet zyrës rajonale që ajo ka në Athinë. Dhe, si rezultat i intensifikimit të bashkëpunimit që kemi pasur sidomos dy vjetët e fundit me këtë zyrë, dhe, si nevojë për të qenë përditë në një nivel bashkëpunimi të sinkronizuar me agjencitë ligjzbatuese shqiptare, ku kryesore është Policia e Shtetit, por edhe SPAK-u, të gjithë pra, edhe agjencia, edhe DEA, edhe Policia e Shtetit ranë dakord që të ishte një person permanent rezident në Shqipëri për të bashkëpunuar me Policinë e Shtetit dhe me SPAK-un.

Ju them me bindje të plotë që viti i kaluar ka qenë kulmi i nivelit të bashkëpunimit me agjenci të tjera ligjzbatuese europiane dhe amerikane. Në vitin 2022 policia shqiptare ka realizuar 22 operacione të përbashkëta, ku një pjesë e tyre kanë qenë të suksesshme, dhe kanë qenë me DEA-n amerikane.

Së dyti, në lidhje me numrin që ju ka shqetësuar apo lajmërimin, ajo është e koordinuar plotësisht me Policinë e Shtetit dhe me SPAK-un, sepse informacionet e rëndësishme që përbëjnë indicie për të shkuar më tej në një proces hetimor, do të ndahen në kohë reale me Policinë e Shtetit dhe me SPAK-un. Kështu që, nuk është për t'u shqetësuar për prezencën permanente të një zyrtari të DEA-s në Shqipëri, madje ai ka edhe një zyrë në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Pra, nuk është për t'u shqetësuar, por është shenjë e një niveli më të lartë të bashkëpunimit me DEA-n amerikane.

Tani sa i takon rendit të ditës, nisma të tilla si Procesi i Berlinit ose "Ballkani i Hapur" synojnë, siç e dimë të gjithë, një lëvizje të lirë të mallrave, të kapitalit dhe të njerëzve. Që kjo lëvizje e lirë të arrijë qëllimin e kërkuar, pa diskutim çdo hapje duhet shoqëruar me siguri. Paralelisht me të gjitha proceset e hapjes që kemi bërë në Ballkanin Perëndimor me shtetet e Ballkanit Perëndimor, ne, si Ministri e Brendshme kemi filluar të ngremë urat e bashkëpunimit në nivelin e ministrive të Brendshme, për të krijuar klimën e sigurisë për këtë qëllim. Pavarësisht se me Maqedoninë e Veriut ne kemi një sërë marrëveshjesh, prapë besoj se realiteti i krijuar në Ballkanin Perëndimor dikton për marrëveshje të reja në fushën e sigurisë. Sot kemi sjellë pikërisht marrëveshjen për krijimin e task forcave të përbashkëta midis Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë. Kjo marrëveshje ka ardhur si rezultat dhe pasojë e identifikimit, siç e thashë, të nevojave për më shumë siguri, në kushtet e hapjes më të madhe midis dy vendeve dhe si një hallkë shtesë për parandalimin e krimeve të ndryshme, sidomos të atyre me natyrë ndërkufitare.

Sigurisht që ne kemi pasur një bashkëpunim shumë intensiv me Maqedoninë e Veriut. Për statistikë, për ta ndarë me publikun, mund t'ju them se vetëm për vitin 2022 kemi konstatuar 38 raste, si vepra penale me Maqedoninë e Veriut, në fushën e kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror dhe 10 raste për kontrabandimin e mallrave. Këto, si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë me policinë dhe me agjencitë ligjzbatuese të Maqedonisë së Veriut.

Kështu që marrëveshja për task forcat e përbashkëta mbetet një instrument më tepër në arkitekturën e bashkëpunimit prej tri dekadash që ne kemi pasur me Maqedoninë e Veriut. Synimi

është të krijojmë një instrument të bashkëpunimit sa më të drejtpërdrejtë ndërmjet policive të të dy vendeve, dhe pikërisht task forca këtë rol do të luajë, për të hequr dhe për të tejkaluar të gjitha barrierat administrative që lindin në këto raste.

Një moment i rëndësishëm i marrëveshjes mbetet, sigurisht, edhe shkëmbimi i informacionit mes dy policive që, për ata që e njohin procesin e hetimit, është me rëndësi jetike. Kjo marrëveshje parashikon pikërisht shkëmbimin e informacionit të të dhënave personale, si dhe ato të klasifikuara për rastet specifike të kapura nga task forcat që do të ngrihen si rezultat i kësaj marrëveshjeje.

Pa dashur të ndalem në teknikalitete të marrëveshjes, e cila ka pasur një diskutim të gjerë edhe në komisionet parlamentare, dua të theksoj se për një sërë veprash penale të ndryshme kërkohen veprime të koordinuara dhe të sinkronizuara mes policisë së të dy vendeve.

Siç e dini, veprimtaritë kriminale në shumë raste nuk njohin kufij as gjeografikë, as politikë, kështu që bashkëpunimi në aspektin operacional është i domosdoshëm, që ne të kemi rezultate sa më të larta në luftën e vazhdueshme me krimin.

Të nderuar kolegë,

Si dy vende të NATO-s dhe si dy vende që tashmë i kanë hapur negociatat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian, ne e dimë shumë mirë se siguria është parakushti mbi të cilin garantohej zhvillimi dhe progresi i çdo shoqërie. Në këtë kuptim është vlerë e shtuar çdo përpjekje që ne bëjmë për të adresuar më mirë sfidat që lidhen me sigurinë dhe luftën kundër krimit e paligjshmërisë.

Kështu që mbetem besimplotë, që miratimi i kësaj marrëveshjeje, që i hap rrugën krijimit të një instrumenti shumë të rëndësishëm siç është task forca e përbashkët midis dy vendeve, do t'i japë një impuls të ri punës së dy policive, kur është fjala për goditjen e krimit ndërkufitar, trafikut të drogës, kontrabandimit të mallrave, të njerëzve e të tjera.

Kështu që ju ftoj që, në traditën e mirë të krijuar në miratimin e marrëveshjeve, të gjithë së bashku ta votojmë edhe këtë marrëveshje.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën e ka kërkuar zonja Tabaku, për pyetje.
Jorida Tabaku – Zoti Çuçi, ju dëgjova me shumë interes. A ka të njëjtën procedurë DEA me

të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, si me Shqipërinë? Kanë të njëjtin akses qytetarët shqiptarë në zyrat e DEA-s, kontakte të drejtpërdrejta me to, apo jo?

Bledar Çuçi - Faleminderit!

Besoj se e kishit fjalën për numrin e telefonit, apo jo, se për prezencën...

(Ndërhyrje pa mikrofon nga salla)

DEA ka zyra të gjera rajonale në të gjithë Europën, si zyra permanente. Në Shqipëri, siç e sqarova, ka ardhur një person për të qenë në kontakt të vazhdueshëm, të drejtpërdrejtë, ditor me Policinë e Shtetit dhe me SPAK-un.

Për momentin e dytë, për numrin e telefonit, përgjigjja është po. Sigurisht që ka qenë një nga pikat e diskutimit edhe para se të shpallej ky numër; agjencitë ligjzbatuese amerikane e përdorin gjerësisht si një instrument për të marrë informacion jo vetëm për çështjet e drogave, por edhe të korrupsionit, të krimit të organizuar edhe në vende të tjera.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Për Ballkanin Perëndimor drejtojuuni zyrës përkatëse, se unë nuk jam kompetent për të ditur...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Unë po ju them se DEA dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese amerikane në shumë vende të botës e aplikojnë si instrument për të marrë informacion jo vetëm për drogat, siç ju thashë, por edhe për krime të tjera që lidhen me korrupsionin dhe me krimin e organizuar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera, që të mos bëjmë debat?

Zoti Xhaferraj, fjala për ju.

Ferdinant Xhaferraj – Kam një koment të shkurtër, para se të dal te pyetja. Ne duhet të jemi të sigurtë me qytetarët shqiptarë. Kemi një situatë shumë të rënduar, që ka qenë shqetësim i institucioneve ligjzbatuese amerikane, kryesisht jo vetëm për trafikun e drogës, por edhe për larjen e parave në Shqipëri, që është në përmasa shumë më shqetësuese se në vendet e tjera të rajonit. Kemi bërë hapa pas dhe kemi kaluar në listën gri vite më parë. Në këtë konceptim i kanë thënë DEA-s (vend unik në Ballkanin Perëndimor, është një praktikë e përdorur në vendet e Amerikës Latine), që të vendosë një numër *WhatsApp*-i me prefiks amerikan për qytetarët shqiptarë. Në Greqi ata kanë pasur zyrën qendrore që mbulonte të gjithë Ballkanin, që nuk ka të bëjë fare, ndërsa për

Ballkanin Perëndimor jemi unik, ku, nisur nga shqetësimi i larjes së parave, kanë vendosur një numër kontakti për qytetarët shqiptarë. Kjo është e vërteta dhe vetëm duke e pranuar atë buron informacioni i parë, që qeveria ka filluar ta marrë seriozisht këtë problematikë, ndryshe, do të vazhdoni të lëvizni siç keni lëvizur gjithnjë dhe, nga një numër kontakti, në të ardhmen do të vijë një paketë numrash kontakti.

Ermonela Felaj – Zoti Ministër, fjala për ju!

Zoti Xhaferraj, mund ta përsërisni pyetjen, ose nëse e kishit pyetje retorike pastaj...?

Ferdinant Xhaferraj – Sqarova pse nuk u përgjigj ministri.

Ermonela Felaj – Dakord.

I mbaruam pyetjet. Fillojmë me listën e diskutimeve.

Fjalën e ka zoti Koçi.

Të përgatitet zonja Çupi.

Petro Koçi – Kjo puna e DEA-s, me larjen e parave, ishte kryevepër fare! Është e çuditshme se si ne shqiptarët jemi kaq mjeshtër për të kërkuar përktihime gjërash dhe fenomenesh, ku gjithmonë do të gjejmë “djallin” pas dhe ky “djall” është patjetër me origjinë shqiptare!

Ai është një moment shumë praktik për DEA-n dhe është një model që besoj se duhet ta ndjekin në përgjithësi organizatat apo institucionet ligjzbatuese shqiptare, për të bashkëpunuar me publikun në fushën e luftës ndaj një krimi kaq të rrezikshëm, siç është ai i trafikut të drogës. Duhet pranuar se, fatkeqësisht, ka rrjete shqiptare në rrjetet ndërkombëtare të drogës. Besoj se është një veprim shumë i zgjuar i DEA-s, që fije të luftës ose fije të këtyre organizatave të zbulohen edhe duke qenë prezente në Shqipëri, po themi, jo nga vendi i origjinës së krimit, por i origjinës kombëtare të shumë protagonistëve të këtyre rrjeteve, fatkeqësisht, po që nuk ngarkojnë patjetër shtetin shqiptar. Moralisht, kuptohet, nuk ndihemi krenarë të kapet një shqiptar që merret me trafik droge në Britani, në Ekuador apo diku tjetër, por duhet të dini edhe një gjë: amerikanët “nuk kalojnë nga Kina” për të dëshmuar diçka, dhe DEA ose SHBA-të, në qoftë se s’do të kishin besim tek autoritetet shqiptare, e kanë krenarinë dhe “guximin” për ta thënë këtë troç dhe nuk ka nevojë ta bëjnë indirekt, duke hapur një zyrë këtu për të kuptuar pastaj shqiptarët se si është e vërteta. Unë mendoj se është diçka shumë e mirë,

që dëshmon kredibilitetin e marrëdhënieve që kanë institucionet ligjzbatuese shqiptare me ato amerikane.

Dua të them edhe diçka tjetër, që lidhet me pozicionin tim si nënkryetar i Komisionit të Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik. Dua të falënderoj këtu në parlament zotin Auron Tare, i cili ka ndërhyrë te muzeu përkatës britanik, lidhur me origjinën e disa monedhave, që ishin përshkruar si nga Butrinti dhe që në emërtesën përkatëse konsiderohej sikur Butrinti ishte në Greqi. Me këtë ndërhyrje është bërë i qartë identiteti i Butrintit në Shqipëri. Kështu që do t'ju lutesha të ma lejoni edhe këtë tejkalim nga rendi i ditës!

Për sa i përket projektligjit që kemi në rendin e ditës, jam dakord me ato që tha ministri. Është e vërtetë që hapja e kufijve, “Ballkani i Hapur”, këto marrëdhënie kaq intensive të përditshme, të përminutshme me vendet fqinje, përfshirë edhe me Maqedoninë e Veriut, nisur edhe nga fakti që aty banojnë shqiptarë si një bashkësi shtetformuese dhe jo thjesht një minoritet, kuptohet që kanë rritur edhe hapësirën e veprimit të krimit. Dihet që shpejtësia e veprimit të krimit është rritur dhe unë mendoj se marrëveshje të tilla, siç kjo për ngritjen e task forcave mes policisë shqiptare dhe asaj të Maqedonisë së Veriut, e rrisin mundësinë për të qenë më praktikë në luftën ndaj krimit.

Kemi vënë re se mediet, sidomos në kronikat e zeza, shpeshherë përshkruajnë faktin që kriminelë të ndryshëm gjejnë strehë te vendet fqinje, madje edhe origjina e krimit vjen nga vendet fqinje. Domethënë, akte të ndryshme, atentate, shpesh edhe me dimensione makabre, kryhen nga grupe kriminale apo individë kriminalë, që nuk janë nga vendi ku zhvillohet ngjarja, por nga vendet fqinje.

Ndaj dua ta përsëris këto marrëveshje, që ka një dimension shumë praktik, pasi është shumë e nevojshme që ne të shkëmbejmë informacione të përditshme me agjencitë homologe, lidhur me natyrën e krimit, me autorët e krimeve, me vendin, me kohën kur ndodhin krimet e të tjera. Gjithashtu, në përshkrimin e natyrave të reja të krimit, në përgjithësi ka nevojë për informacion në fushën e legjislacionit të rregulloreve, të natyrës së hetimit, të ndjekjes së ngjarjeve të caktuara jo vetëm për të rritur profesionalizmin në radhët e policive përkatëse,

por sidomos për të qenë më të suksesshëm në hetimin e ngjarjeve dhe të personave të caktuar.

Edhe në Komisionin për Politikën e Jashtme, që ishte komision për dhënie mendimi, kjo projekt marrëveshje kaloi me konsensus të plotë dhe unë jam i bindur që krijimi i task forcave do të sjellë shumë sukses në luftën ndaj krimit. Është shumë e nevojshme për të shkëmbyer informacion edhe në fushën e ekspertizës mjekoligjore, edhe në etapa të ndryshme të hetimit për ngjarje të caktuara, për autorë krimesh të caktuar. Unë besoj se ajo që është arritur deri tani me marrëveshjet e tjera, me këtë marrëveshjeje do të shënojë suksese të tjera.

Rajoni ynë është i hapur dhe mendoj se këto janë zgjidhje shumë praktike, të domosdoshme, institucionale dhe ligjore. Besoj se edhe ndonjë shqetësim, që mund të ketë lidhur me shkëmbimin e të dhënave personale, nuk qëndron, sepse të gjithë janë të detyruar të respektojnë legjislacionet përkatëse në fushën e respektimit dhe të ruajtjes së të dhënave personale. Është e qartë se kur bëhet fjalë për krime dhe për kriminelë, legjislacioni është gjithmonë i hapur, kështu që le ta mbështesim konsensualisht edhe në seancë miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Koçi!

E vazhdon diskutimin zonja Çupi.

Të përgatiten zonja Dhima dhe zoti Isuf Çelaj.

Dhurata Çupi – Faleminderit, zonja Felaj!

E vërteta është vetëm një, nuk mund të ketë disa të vërteta. Edhe pse deputetët e të dyja palëve thonë, sipas tyre, të vërtetat e veta, unë po lexoj mesazhin e ambasadës amerikane: “Agjencia e SHBA-ve Kundër Narkotikëve njofton një linjë të re sinjalizimi për Shqipërinë. DEA nxit këdo që ka informacion në lidhje me trafikun e drogës ose pastrimin e të ardhurave nga droga, ta ndajë atë me personelin e DEA-s, në numrin e telefonit dhe në *e-mail*. Të gjitha të dhënat do të mbahen të fshehta. Shtetet e Bashkuara janë të përkushtuara të punojnë me Shqipërinë për të luftuar trafikun e drogës dhe pastrimin e parave të lidhura me to, për një të ardhme më të mirë për të gjithë shqiptarët”.

Ky mesazh është i vetmi në vendet e Ballkanit, ku bëhet njoftim nga ambasada e vendit respektiv. Në të gjitha vendet e Ballkanit nuk është bërë njoftim nga ambasadat amerikane, ndaj them që kjo është e vërteta, të cilën e lexova në

faqen e ambasadës amerikane, meqë kishte edhe lidhje me marrëveshjen për të cilën po diskutojmë sot, sepse edhe marrëveshja me Maqedoninë e Veriut ka të bëjë me sigurinë dhe me rendin në vend.

Në fakt, si nënkryetare e Komisionit të Ligjeve, ku marr edhe informacion shtesë, edhe kolegët e komisionit mund ta konfirmojnë që në çdo diskutim marrëveshjesh pyetja ime rutinë ka qenë: cili shtet e kërkon nënshkrimin e marrëveshjes? Më ka bërë përshtypje që të gjitha marrëveshjet, që kanë të bëjnë me sigurinë, me rendin, me çështje të korrupsionit, kërkojnë nga vendet partnere, pra nga vendi tjetër që nënshkruan marrëveshjen. Pyetja ime, në fakt, nuk është rastësore, por është për të kuptuar se çfarë rëndësie u japim në këtyre marrëveshjeve. Edhe në rastin konkret, ashtu si edhe marrëveshja për ekstradimin me Spanjën, disa muaj më parë, ishin marrëveshje të kërkuara nga Maqedonia e Veriut, nga Spanja apo vendet e tjera. Pra, në të shumtën e rasteve, nuk dua ta absolutizoj, por besoj se jam e vërtetë në këtë që po them, marrëveshjet që diskutohen, sa u takojnë krimin, rendit, luftës kundër korrupsionit, pastrimit të parave e të tjera, kërkojnë nga vendi tjetër. Kjo, në fakt, jo vetëm që nuk na bën krenarë, por nuk na bën të ndihemi mirë edhe ne, si deputetë të këtij Kuvendi.

Flasim për marrëveshje lidhur me sigurinë. Po ku ka siguri këtu?! Këtu siguria është përtokë! Ministria e Brendshme mban vetëm statistika, të cilat, në fakt, për të keqen e vet, e nxjerrin keq. Nuk bëhet fjalë për parandalim; parandalim nuk ka, por ka vetëm statistika: “u vranë kaq, u arrestuan kaq, u aksidentuan kaq”. Për të keqen e tyre, e theksoj, që nga vitet 2004-2022, viti 2021 është viti me statistikën më dëshpëruese dhe më të rëndë të përlogaritur sa u takon krimeve për 100 mijë banorë: 196 krime për 100 mijë banorë. Ky është numri më i madh i krimeve të ndodhura në periudhën 2004-2022. Këtu ka kaq shumë krime! Sa të ndezësh televizorin sheh se ka ndodhur një krim, një aksident, një vrasje, një padrejtësi ndaj të pafuqishmëve, ndaj shtresës së varfër, ndaj njerëzve që nuk kanë mundësi dhe nuk kanë pushtet. “Këtu ka më shumë krime dhe vrasje sesa dasma”, thoshte Kim Mehmeti në një diskutim, që, në fakt, është dëshpëruese, është e rëndë ta dëgjosh dhe ta thuash, por ne duhet t'i pranojmë të vërtetat, dhe kjo është një e vërtetë.

Të korruptuarit janë rrugëve; kriminelët janë rrugëve, vrasësit janë rrugëve; përdhunuesit janë rrugëve, ata nuk kapen. Para dy ditësh, në rrugën “Don Bosko” ndodhi një ngjarje e rëndë, një aksident për shkak të shpejtësisë, sepse Policia Rrugore nuk kishte vepruar. Pra, çdo ditë, opinioni publik, qytetarët shqiptarë vihen para të vërtetave të hidhura dhe dëshpëruese për këtë vend.

A ka më trishtuese, më të rëndë dhe më shokuese për një vend se të deklarosh që kamerat në disa qytete ishin të bandave?! Këtë nuk mund ta perceptojë jo vetëm një deputet, por edhe një njeri i thjeshtë. Gjëja e parë që bën nëse të ndodh diçka në rrugë është të shkosh e të hapësh kamerat, dhe ti shokohesh kur kupton që kamerat paskan qenë nën kontrollin e bandave! Unë nuk e kuptoj! Ne flasim këtu për integrimin e vendit tonë në BE, por kush të pranon në familjen e BE-së me këto fakte?! Ata kanë plot të drejtë të thonë se kamerat në të gjitha qytetet kryesore qenkan në duart e bandave! Për këtë gjë jo vetëm që nuk mban njeri përgjegjësi, por na del edhe si lajm propagande: “Po i heqim këto kamera, që janë të bandave”. Kjo është skandaloze, është shokuese, është e papranueshme!

Nga ana tjetër, kemi zyrtarë të korruptuar që rrinë në zyrat e shtetit, sepse Kryeministri thotë se është përgjegjësi individuale dhe ndërkohë promovon kryetarë bashkish, promovon ministra, promovon deputetë, që sot janë në burg.

Sa herë e kemi ngritur zërin ne për kryetarin e Bashkisë së Bulqizës? Ai ka ndenjur 4 vjet nën drejtimin e kësaj bashkie dhe ka abuzuar në mënyrë të vazhdueshme. Këtë shqetësim lidhur me abuzimet e kryetarit të bashkisë unë e kam ngritur në këtë sallë disa herë, e kam ngritur në medie, në rrjetet sociale, por nuk është vetëm kryetari i bashkisë, janë 11 veta; e gjithë administrata e Bashkisë së Bulqizës sot është nën hetim. E kuptoni se çfarë ndodh? Sepse është shembulli ku një shtet i dobët degradon në hallkën më të fundit; ky është modeli i një shtetit të dobët, ku të gjitha hallkat degradojnë në korrupsion, në krim, në abuzim me buxhetin e shtetit dhe në gjithçka.

Dhashë vetëm këta shembuj, për të mos kaluar te rasti tjetër, ku policia sot, shumë e zëshme dhe me një vullnet të paparë, arrestoi një nënë 27 vjeçare lehonë, ndau foshnjën me nënën, pa parë letrat, pa parë realitetin, pa parë asgjë,

duke i thënë: “Eja, firmos thjesht një letër në komisarariat”, siç deklaroi i shoqi, që e futën brenda për të firmosur diçka dhe nuk ia kthyen më gruan.

Kjo është Policia e Shtetit; ky është rendi dhe siguria në vendin tonë; këto janë marrëveshjet që ne nënshkruajmë! I nënshkruajmë se i kërkojnë ata. Ne nuk kemi asnjë seriozitet për t’u qëndruar këtyre marrëveshjeve dhe jam e sigurt që këto marrëveshje nuk do të zbatohen nga ne, por vetëm nga pala tjetër. Me këtë qeveri, me këtë mentalitet, të njëjtin model qeverisjeje do të kemi, të njëjtat krime dhe vrasje do të kemi, dhe jam e sigurt që kamerat do të rivendosen sërish nga bandat.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zonja Çupi!

Fjalën e ka zonja Dhima.

Të përgatiten zoti Çelaj dhe zoti Deliu.

Antoneta Dhima – E nderuar zonja Nënkrjetare e Kuvendit,

Të nderuar kolegë,

Të dashur qytetarë,

Një nga çështjet me rëndësi që po diskutojmë dhe shpresoj se do ta miratojmë së bashku, të majtë dhe të djathtë, është projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut, për krijimin e task forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë”.

Ky projektligj sjell para nesh një marrëveshje të nënshkruar mes dy qeverive në nëntor të vitit që shkoi, e cila ka për qëllim bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve kompetente dhe task forcave të tyre për të shqyrtuar taktikat, përgatitjen dhe kohën për zgjidhjen e çështjeve që dalin gjatë bashkëpunimit të ndërsjellët, si dhe për të vendosur kur dhe si ndërmerren veprimet në territoret e shteteve palë, veçanërisht duke shkëmbyer informacione për raste të veçanta bashkëpunimi.

Të nderuar kolegë,

Besoj se të gjithë biem dakord se Shqipëria përgjatë të gjithë historisë së saj shekullore ka qenë një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon. Fundshekulli XX u shënjua nga destruktiviteti dhe reformimi i kufijve të Ballkanit, çka u shoqërua jo thjesht me tensione, por edhe me konflikte të ashpra, ku u përfshinë ish-republikat jugosllave dhe ku nuk u kursye as Kosova, duke lënë një plagë të thellë, ende të pambyllur në historinë e vëllezërve tanë. Edhe në këto situata ekstreme, Shqipëria dhe shqiptarët kanë ditur të mbajnë

anën e të drejtëve. Ata janë kthyer në një portë të madhe mikpritëse për këdo që është ndodhur në nevojë. Madje, Shqipëria ka ndërmarrë nisma që synojnë jo thjesht paqen, por bashkëpunimin e ngushtë mes vendeve të rajonit, përmes “Ballkanit të Hapur”, i cili i hap rrugën zhvillimit të mëtejshëm ekonomik, social dhe kulturor, e aq më tepër, bashkëpunimi dhe fqinjësia e mirë janë prioritet të qeverisë shqiptare dhe, njëkohësisht, të Kryeministrit Rama. Për këtë dëshmojnë edhe mbledhjet e përbashkëta të qeverisë shqiptare me Malin e Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Kosovën, ku janë marrë vendime dhe janë nënshkruar marrëveshje që çimentojnë bashkëpunimin e mirë mes fqinjësisë dhe mbarëvajtjen e punëve në rajonin e Ballkanit. Vetëm në mbledhjen e fundit të Maqedonisë së Veriut, të mbajtur në nëntor të vitit 2022 në Shkup, u nënshkruan gjithsej 21 marrëveshje, si dhe memorandume bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, marrëveshje të cilat i prekin të gjithë sektorët, duke filluar nga siguria, energjetika, arsimit, shëndetësia, arti dhe kultura, si dy vende në rrugën drejt anëtarësimit në familjen e madhe europiane. Në këtë mbledhje u nënshkrua memorandumi i bashkëpunimit për çështjet e integritimit në BE, për të vijuar me bashkëpunimin në fushën e trajnimeve; bashkëpunimin në fushën e digjitalizimit të shërbimeve konsullore, në lidhje me zbatimin e marrëveshjes për njohjen e ndërsjellët të operatorëve ekonomikë të autorizuar; autorizimet për sigurinë dhe mbrojtjen, për vendosjen e vendkalimit të përbashkët kufitar mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, të nënshkruar më 10.06.2022 në Tiranë, për vendkalimin ndërkombëtar në Qafë Thanë, për vendosjen e transportit ndërshtetëror ndërmjet liqenit të Ohrit, për bashkëpunimin për zhvillimin e lidhjes rrugore; memorandum mirëkuptimi dhe bashkëpunimi në fushën e financave publike dhe procesit të aderimit në BE, në sektorin e energjisë, në fushën e shëndetësisë, në fushën e politikës sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve, në fushën e arsimit dhe shkencës për periudhën 2023-2026, për rikthimin e ikonave të trafikuara në vendet e tyre të origjinës, e deri te redaktimi gjuhësor dhe zbatimi i gjuhës së shenjave shqipe. Pa dyshim që nuk munguan edhe marrëveshjet që lidhen me fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe kontrollin

e përbashkët kufitar në pikën e kalimit në Qafë Thanë.

Në kohërat në të cilat po jetojmë, kur në Europë kemi një vatër të hapur lufte, që vazhdon të marrë jetë të pafajshme dhe të paralizojë ekonominë botërore, në kohërat e sulmeve kibernetike, kjo marrëveshje patjetër që ka një rëndësi shumë të veçantë.

Projektligji që po diskutojmë sot është hartuar në frymën e respektimit të legjislacionit të të dyja shteteve, marrëveshjeve ndërkombëtare të njohura dhe njëkohësisht të pranuar nga palët, si dhe të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Mbi bazën e kësaj marrëveshjeje, autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, do të bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacione veçanërisht për vepra penale për të cilat rrethanat kërkojnë veprime të koordinuara, të sinkronizuara, dhe në veçanti për: të dyshuarit ose autorët, mënyrën e kryerjes së krimeve, kohën, vendin dhe masat e ndërmarra për parandalimin e veprave penale, autorët dhe bashkëpunëtorët e tyre, për përvojat që i referohen shfaqjes së llojeve të reja të krimit për operacionet ose aktet e ardhshme; për rreziqet e mundshme të sigurisë; për dispozitat ligjore dhe rregulloret e brendshme dhe çdo ndryshimi të tyre në lidhje me këtë marrëveshje gjatë ndjekjes së personave të dyshuar për kryerjen e krimeve dhe personave që i shmangen përgjegjësisë penale gjatë ndjekjes së personave si në lidhje me veprat penale, ashtu edhe jo, por edhe gjatë kryerjes së veprimeve me qëllim identifikimin e personave; për rezultatet e hetimeve penale; për veprat penale; për teknikat e hetimit dhe aplikimin e metodave dhe mjeteve për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, si dhe për rezultatet e ekspertizës mjekoligjore për rastet e ndërmarra.

Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente do të kryhet nëpërmjet kërkesës për ndihmë për eliminimin e rreziqeve, për rendin dhe sigurinë publike, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e krimeve, nëse kërkesa ose veprimi është në përputhje me ligjet përkatëse. Me qëllim zbatimit të kësaj marrëveshjeje autoritetet kompetente të palëve do të shkëmbejnë, do të përpunojnë dhe do të ruajnë të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin përkatës. Pa dyshim që të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe ligjore dhe mund të dorëzohen vetëm tek autoritetet

kompetente. Janë pikërisht këto autoritete që do të shkëmbejnë dhe do të rakordojnë informacionin e klasifikuar në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, që i referohet mbrojtjes së informacionit të klasifikuar, dhe vetëm për qëllimet e zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Kjo marrëveshje nuk parashikon efekte financiare dhe ka për qëllim vetëm rritjen e nivelit të sigurisë, parandalimin dhe uljen e kriminalitetit.

Kur vjen puna te rendi dhe siguria, nuk ka të majtë e të djathtë, politika duhet të jetë ndihmuese dhe bashkëpunuese, ndaj jam e bindur se do ta votojmë njëzëri ratifikimin e kësaj marrëveshjeje. Pra, kjo është një marrëveshje shumë e rëndësishme, për të cilën do të kërkoj mbështetjen maksimale jo vetëm nga e majta, por edhe nga e djathta.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zonja Dhima!

Zoti Çela keni fjalën.

Isuf Çelaj – E nderuar drejtuese e seancës,
Të nderuar qytetarë,
Të nderuar kolegë,

Sot na është paraqitur për miratim projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut “Për krijimin e task forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë””.

Në këtë marrëveshje pretendohet se do të përmirësohet dukshëm komunikimi ndërmjet dy institucioneve tona ligjzbatuese të policive respektive të shtetit për informacione në lidhje me veprat penale apo krime të ndryshme. Megjithatë, nuk specifikohet sa do të jetë koha që do të marrë që nga nisja e një kërkesë nga njëra palë ndaj palës tjetër dhe deri tek ofrimi i informacionit nga pala ofruese, pra afatet që duhet të respektohen ndërmjet palëve, në mënyrë që të realizohet edhe vetë qëllimi i kësaj marrëveshjeje: efikasiteti dhe shpejtësia e shkëmbimit të informacionit.

Nisur nga paqartësia, por edhe ndjeshmëria e çështjes së shkëmbimit të informacionit midis dy vendeve, si dy vende jo vetëm fqinje, por edhe aleate në NATO dhe bashkudhëtare në procesin e integritetit evropian, kjo marrëveshje që na prezantohet kërkon diskutime më të thelluara dhe angazhim të sinqertë nga të dyja palët për të bërë

të mundur realizimin e saj me eficiencë për shkak të situatës kriminale që ndodhet vendi, si dhe sfidat reale me të cilat përballen aktualisht policitë respektive të të dyja vendeve në lidhje me shkëmbimin e informacionit për ngjarje, të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë publike në këto dy vende, po ashtu edhe në rajon apo më gjerë, nisur edhe nga përmasat që ka marrë krimi shqiptar në rajon, Europë apo botë. Duke marrë në konsideratë faktin që të dyja vendet janë në procesin e integritetit në BE, detyrimisht këto nisma dhe marrëveshje duhet të jenë në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe atë të politikave të sigurisë së NATOS-, si vende aleate.

Sa efikase do të jetë ngritja e këtyre task forcave në përmirësimin e procedurës së shkëmbimit të informacionit? Efikasiteti i kësaj marrëveshjeje duhet të shërbejë në përmirësimin e shkëmbimit të informacionit policor ndërmjet dy policive respektive. Detyrimi i këtyre dy strukturave ka qenë edhe më parë, pasi janë anëtare të organizatave policore ndërkombëtare si: Interpoli, Europoli, SECI e të tjerë. Pra, kjo që po bëhet sot nuk është diçka e re.

Për çfarë tipologjie veprash penale apo kriminale mendohet se do të jetë i nevojshëm përdorimi i këtyre task forcave për shkëmbimin e informacionit? Problematikat kryesore në raport me Maqedoninë e Veriut mbeten dy: trafiku i drogës, si dhe aktet e veprimtarisë terroriste të pastrimit të parave, çka deri tani rezultatet në këto fusha, kryesisht në atë të trafikut të drogës, lënë shumë për të dëshiruar.

A janë burimet njerëzore mjaftueshëm të trajnuara dhe të specializuara, në mënyrë që ta ushtrojnë veprimtarinë e kërkuar në zbatim të kësaj marrëveshjeje? Me gjithë investimet e vazhdueshme të partnerëve tanë evropianë dhe amerikanë në fushën e trajnimit të burimeve njerëzore të trupës policore shqiptare, në praktikë situata lë shumë për të dëshiruar, kjo ka të bëjë më shumë me rekrutimin e personave të lidhur politikisht me rilindjen në strukturat e policisë, të cilët janë të paafte për të përballuar detyrat konkrete që ju ngarkon ligji.

Sa siguri do të ketë menaxhimi i bazës së të dhënave për një informacion me ndjeshmëri të lartë apo informacion të të dhënave personale, që do të shkëmbehen ndaj kërcënimeve kibernetike, siç ndodhi në Shqipëri vitin e kaluar apo mund të ndodhë edhe në të ardhmen? Realiteti para një viti

tregoi se sistemet tona të informacionit ranë dhe të dhënat sensitive të shtetasve shqiptarë, si dhe shumë të dhëna të sistemeve të policisë dolën sheshit, sa edhe sot janë në duart e hakerave iranianë e të tjerë.

Nëse e shikon të shkëputur nga tërësia e marrëveshjeve të vendit tonë në këtë fushë dhe shihet me kujdes, kjo marrëveshje nuk ka ndonjë element, që mund të krijojë probleme në drejtim të bashkëpunimit dypalësh me këtë vend, sepse marrëveshja në fjalë ndërmjet dy vendeve tona nuk shton ndonjë vlerë të vërtetë apo ndonjë mekanizëm ligjor për një bashkëpunim më të afërt dhe konkret, sipas modeleve të bashkëpunimit policor të dekadave të fundit. Marrëveshja mbetet e përgjithshme, sipas modeleve të viteve '90 dhe të shekullit të kaluar, ku parashikohet shkëmbim informacioni dhe jo aksione të përbashkëta, të përshkruara mirë ligjërisht. Kjo marrëveshje e ngushton fushën e bashkëpunimit të asaj që është parashikuar 16 vjet më parë nga Konventa e Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Europës Juglindore, e ratifikuar nga parlamenti ynë me ligjin nr. 9604, datë 11.09.2006. Pra, kjo marrëveshje e propozuar sot në thelb duhet të kishte si bazë të fortë ligjore Konventën e Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Europës Juglindore, ku të dyja vendet janë firmëtare, por nuk i referohet fare kësaj.

Nëse kjo marrëveshje që na propozohet sot sanksionon krijimin e task forcave me fokus realizimin e 9 detyrave të nenit 5, konventa parashikon 11 të tilla. Konventa nuk kufizohet vetëm te detyrat e shkëmbimit të informacionit, ajo parashikon edhe akte veprimi të përafërta me vendet e BE-së, si, për shembull, ndjekjen në kushtet e flagrancës, ku parashikon kushtet për kalimin e kufirit në raste emergjence të ndjekjes së një kriminelit, survejimin kufitar, dorëzimin e kontrolluar, hetimin e fshehtë, mbrojtjen e dëshmitarëve, të cilat janë të gjitha të detajuara ligjërisht, ndërsa task forca që na propozohet sot nuk merret me asnjë nga këto detyra kaq madhore.

Kjo marrëveshje që na propozohet sot duhet parë e tëra në zbatim të konventës, pasi duke qenë bilaterale, jo në zbatimin e asaj shumëpalëshe, ajo do të ketë përparësi dhe në vend që të zgjerojë bashkëpunimin, e ngushton shumë atë.

Situata kriminale në vend është shqetësuese, mjafton të përmendim atentatin e ndodhur para tre ditëve në rrugën “Don Bosko”, ku i mori jetën një

gruaje të pafajshme, e cila me sakrifica siguronte bukën e gojës, dhe u plagos mbesa e saj 10-vjeçare. Pra, bandat kriminale vazhdojnë betejat me njëra-tjetrën, duke larë hesapet, pa pasur frikë nga forca goditëse e Policisë së Shtetit. Siguria është në duart e tyre dhe kjo është alarmante për të gjithë ne, ndërsa Kryeministri mjaftohet me sloganin: “Kokat hëngshin!”. Por derisa ata të hanë kokat e njëri-tjetrit, ata po marrin jetë njerëzish të pafajshëm, të cilët kanë zgjedhur ta ndërtojnë jetën në vendin e tyre, por që nga ky regjim po bëhet i pajetueshëm, çka po e detyron pjesën më të madhe të marrë rrugët e emigracionit.

Gatishmëria për arrestimin e një gruaje lehonë me fëmijë 10-ditësh është diçka e ngjashme, që ka ndodhur në fillim të diktaturës komuniste. Ky është një makabritet dhe tregues i arrogancës suaj ndaj qytetarëve të pamundur. Këtë gjë duhet ta tregoni me arrestimin dhe vendosjen pas hekurave bandat e kriminelëve, që po i terrorizojnë dhe po u marrin jetën qytetarëve të pafajshëm dhe të pambrojtur.

Krimi shqiptar është bërë shqetësim për Britaninë e Madhe, e cila po harton marrëveshje për të bërë të mundur luftimin e tij. E njëjta situatë shqetësuese për nivelin e kriminaliteti, me në qendër trafikantët dhe kriminelët shqiptarë, paraqitet edhe në Belgjikë, Holandë, Zvicër, Itali, Greqi, Gjermani dhe deri në Amerikën Latine, aq sa medie prestigjioze “*Financial Time*” shprehet se koka e gjarprit të këtij krimi është Shqipëria.

Ju, si qeveri, prodhuese e skandaleve të rënda, duke njollosur imazhin e vendit në botë, jeni e pazonja për të luftuar krimin. DEA amerikane, nëpërmjet seksionit të saj pranë ambasadës këtu në Tiranë, ju bën thirrje qytetarëve shqiptarë që t’i denoncojnë rastet e trafikimit të drogës, si dhe ato të pastrimit të parave. Ky është një tregues i mungesës së besueshmërisë të strukturat shqiptare ligjzbatuese. Prandaj, rruga e vetme është largimi juaj, si mazhorancë, pasi këto vite keni drejtuar në simbiozë me krimin dhe për këtë do të ndëshkoheni me votë nga shqiptarët.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Çelaj!

Fjalën e ka zoti Denis Deliu.

Të përgatitet zoti Qefalia.

Denis Deliu – E nderuar zonja drejtuese e seancës,

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë shqiptarë,

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut “Për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë” vjen në kuadër të forcimit të bashkëpunimit dhe miqësisë që kemi mes palëve. Ky projektligj rregullon bashkëpunimin e drejtpërdrejtë të task forcave për të shqyrtuar taktikat, përgatitjet dhe kohën për zgjidhjen e çështjeve, që dalin si mënyrë për të vendosur kur dhe si të ndërmerren veprime në territoret e shteteve palë, duke shkëmbyer informacione për raste të veçanta.

Projektligji respekton legjislacionin kombëtar të të dyja shteteve, marrëveshjet ndërkombëtare të njohura dhe të pranuar nga palët. Kjo marrëveshje përcakton qartazi se autoritetet kompetente, në përputhje me legjislacionin përkatës kombëtar, do të bashkëpunojnë duke shkëmbyer informacione, veçanërisht për veprat penale, për të cilat rrethanat kërkojnë veprime të koordinuara, si vijon:

a) Për të dyshuarit ose autorët, mënyrën e kryerjes së krimeve, kohën, vendin dhe masat për parandalimin e tyre, autorët dhe bashkëpunëtorët e tyre;

b) për përvojat që i referohen shfaqjes së llojeve të reja të krimit; për operacionet ose aktet e ardhshme dhe rreziqet e mundshme të sigurisë;

c) për dispozitat ligjore, rregulloret e brendshme dhe ndryshimet e tyre në lidhje me këtë marrëveshje;

ç) gjatë ndjekjes së personave të dyshuar për kryerjen e krimeve dhe personave që i shmangen përgjegjësisë penale;

d) gjatë ndjekjes së personave me vepra penale ose jo, por edhe gjatë kryerjes së veprimeve me qëllim identifikimin e tyre;

dh) për rezultatet e hetimeve për veprat penale, teknikat dhe aplikimin e metodave dhe mjeteve për zhvillimin e mëtejshëm të tyre, si dhe për rezultatet e ekspertizës mjeko-ligjore për rastet e ndërmarra.

Bashkëpunimi i palëve do të kryhet nëpërmjet kërkesës për ndihmë për eliminimin e rreziqeve, për rendin dhe sigurinë publike, me qëllim parandalimin dhe zgjidhjen e krimeve, nëse kërkesa ose veprimi është në përputhje me

ligjin kombëtar të shteteve dhe nuk është në juridiksionin e autoriteteve gjyqësore.

Kërkesa e parashikuar në këtë marrëveshje mund të lidhet me:

a) Identifikimin e pronarëve dhe personave, që përdorin mjetet e transportit;

b) kontrollet në lidhje me dokumentet publike dhe dokumente të tjera të ndërlidhura;

c) përcaktimin e rezidencës ose vendbanimit;

d) identifikimin e pronarëve dhe përdoruesve të numrave të telefonit ose mjeteve të tjera të komunikimit;

dh) përcaktimin e identitetit të personave dhe prejardhjes së sendeve me të cilat është kryer krimi ose që burojnë nga krimi i kryer;

ë) mbledhjen e informacionit të nevojshëm dhe arsye të tjera, që do të përcaktohen nga autoritetet kompetente dhe nuk do të përjashtojnë bashkëpunimin e parashikuar në këtë marrëveshje.

Me qëllim zbatimin e kësaj marrëveshjeje autoritetet kompetente të palëve do të shkëmbejnë, do të përpunojnë dhe do të ruajnë të dhënat personale, në përputhje me legjislacionin kombëtar përkatës, duke respektuar kushtet e përcaktuara nga autoriteti dërgues, si dhe duke ndjekur parimet e zbatueshme për përpunimin automatik dhe joautomatik të të dhënave.

Në veçanti do të zbatohen këto parime:

a) Të dhënat personale duhet të përpunohen në mënyrë të drejtë dhe ligjore.

b) Ato duhet të mblidhen për qëllimin specifik, të qartë dhe legjitim të zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe nuk duhet të përpunohen nga autoriteti paraqitës, as nga autoriteti marrës në një mënyrë të papajtueshme me këtë qëllim.

c) Këto të dhëna duhet të jenë të përshtatshme, të mjaftueshme dhe nuk duhet të tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur dhe/ose përpunuar, në veçanti të dhënat personale, të specifikuar në kërkesën për posedim.

ç) Të dhënat personale duhet të jenë të sakta, të përditësuara, ato duhet të ruhen në një formë, që lejon identifikimin e subjekteve jo më gjatë se sa është e nevojshme dhe për qëllimet për të cilat janë mbledhur ose për të cilat ato janë përpunuar.

d) Autoriteti paraqitës dhe autoriteti marrës do të ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar korrigjimin, fshirjen ose bllokimin e të dhënave personale, kur përpunimi i tyre nuk është

në përputhje me dispozitat e këtij ligji, veçanërisht kur këto të dhëna nuk janë të përshtatshme, të sakta ose kur ato janë shumë të gjera në lidhje me objektivat e përpunimit. Kjo përfshin njoftimin e palës tjetër për çdo korrigjim, fshirje ose bllokim.

dh) Të dhënat personale mund të dorëzohen vetëm tek autoritetet kompetente. Transferimi i mëtejshëm tek autoritetet e tjera kërkon pëlqimin paraprak të autoritetit paraqitës.

e) Autoriteti paraqitës dhe autoriteti pranues janë të detyruar të përgatisin një konfirmim me shkrim për transmetimin dhe marrjen e të dhënave personale.

ë) Autoritetet kompetente të palëve do të shkëmbejnë dhe do të ruajnë informacionin e klasifikuar në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, që i referohet mbrojtjes së informacionit të klasifikuar dhe vetëm qëllimit të zbatimit të kësaj marrëveshjeje.

Duke vlerësuar anët pozitive të kësaj marrëveshjeje, ju ftoj ta miratojmë atë.

Ju faleminderit!

(Drejtimin e seancës e merr Kryetarja e Kuvendit, zonja Nikolla.)

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Xhemal Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Kjo është një marrëveshjeje, e cila, pa dyshim, kërkon edhe votat e opozitës dhe unë jam i bindur që do të ndodhë, pasi vjen në kuadër të forcimeve të marrëdhënieve midis dy vendeve tona, aq më tepër në kuadër të një bashkëpunimi të shkëlqyer që kemi me rajonin përkatës.

Duke marrë shkas nga parafolësit, të cilët u ndalën te problemet e sigurisë në vend, më lejoni, të nderuar kolegë, që t'u referohem disa statistikave, të cilat flasin qartë për nivelin e sigurisë në vend tani që po drejton kjo mazhorancë dhe në kohën kur keni drejtuar ju. Për këtë po u referohem shifrave, të cilat janë konkrete dhe dalin në buletin publik që paraqet Ministria e Brendshme, pra janë shifra që nuk janë sajuar dhe nuk kanë nevojë as për vulë dhe as për ndërrim skuadre nga një parti në tjetrën. Çfarë thonë shifrat? Dëgjova këtu kolegen Çupi, e cila tha se ka rënë perceptimi i qytetarëve për sigurinë në vend. Jo, zonjë, e keni shumë gabim. Në kohën që drejtonit ju, mazhoranca juaj, numri i telefonatave drejt 129-ës, numri publik për

qytetarët që kanë nevojë, ka qenë 156 mijë, ndërsa në vitin 2022 ka arritur në 1 milionë e 261 mijë e 988. Çfarë tregon kjo? Kjo tregon besimin që kanë qytetarët te policia. Nuk është më një polici e braktisur, një polici e keqveshur, një polici e patrajtuar në uniformë, një polici e patrajtuar në pagë. Tendenca dhe këmbëngulja e kësaj qeverie dhe e kësaj mazhorance është që policia të jetë e shtetit dhe jo e partive politike.

Ju ndoqa sot në ligjëratat tuaja, ku i kërkonit llogari qeverisë pse është dënuar ajo zonja lehonë. Normalisht, edhe unë si qytetar e ndiej që ajo zonja nuk kishte pse të ishte prapa hekurave, por tashmë ka ndryshuar filozofia e drejtimit, tashmë Kryeministri nuk është edhe kryepolic, edhe kryegjyqtar, edhe Kryeministër, institucionet janë të ndara, dhe këtë gjë ju nuk doni ta kuptoni. Tashmë nuk e vendos masën e arrestit me burg apo arrest shtëpie Kryeministri dhe qeveria, por sistemi gjyqësor. A ka vërejtje për ta riparë, po, ka, sepse, nëse nuk do të kishte, nuk do ta bënim reformën në drejtësi. Është vullneti i kësaj mazhorance që ka ndodhur kjo reformë në drejtësi. A ka ende gjyqtarë që japin një masë të tillë dhe duhet të vihen përpara përgjegjësisë edhe nga inspektorati përkatës? Natyrisht që ka.

Së dyti, numri i vrasjeve që kanë ndodhur gjatë qeverisjes suaj ishte me tre shifra, sot ai është ulur, u bënë dy-tre vjet që ka vajtur në dy shifra. Kjo tregon qëndrueshmërinë e kësaj policie.

Meqenëse nuk dua të zgjatem shumë, dua të them diçka që u përmend për Kryeministrin Rama. Çfarë nuk bëtë, erdhët këtu, kapët foltoren, nxorët çdo të enjte njerëzit në protestë duke protestuar. Për çfarë protestonin? Që të vinte Kryeministri. Këtu thoshit se Kryeministri është fshehur, madje thatë se është fshehur në "Sarajet e Surrelit". Unë jam deputet i asaj zone, në të cilën jeton edhe Kryeministri, dhe thoni se atje është një vilë e stërmadhe, madje sot ish-kryeministri Berisha tha se është me dhjetëra metra nëntokë. Çfarë mendoni ju se qytetarët nuk e dinë këto gjëra? Edi Rama nuk ka vilë as te Gjiri i Lalëzit, nuk ka vilë as te Kodra e Priftit. Me këtë rast, më lejoni t'ju falënderoj në emër të banorëve të Surrelit, sepse e keni bërë Surrelin sikur të jetë San Francisko! Më kanë thënë banorët që t'i falënderoj deputetët, sepse më në fund i njohët! Kështu që, faleminderit që e përmendni aq shpesh Surrelin!

Ju keni edhe një gjë tjetër, ndërkohë që thoni se Rama është izoluar, Rama sot takoi komisionerin e BE-së, para ca ditësh takoi Kancelarin e Gjermanisë. Jo vetëm kaq, por iu tha se samitin që bëri më 6 dhjetor ta bëjë edhe për Ballkanin Perëndimor.

Prandaj, bëhuni bashkë, jo për t'u futur te "Shtëpia e lirisë", por në apartament, sepse jeni zvogëluar pak tani, me ose pa vulë, dhe hajdeni të ballafaqohemi më 14 maj.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjalën e ka zonja Tyli, për replikë.

Dhurata Çupi (Tyli) – Faleminderit, zonja Kryetare!

Zoti Qefalia, faleminderit që m'u referuat, që të jem edhe më konkrete!

E hapa diskutimin tim me fjalët që e vërteta është vetëm një. Ato të dhëna që dhashë pak më parë unë i pata marrë nga Open Data Albania, "Koeficienti i kriminalitetit në Republikën e Shqipërisë 2004-2021", botuar në datën 25 shkurt 2023. Unë do t'ju lexoj vetëm paragrafin për të cilin më përmendët: "Në harkun kohor të 18 vjetëve, 2004-2021, në Shqipëri llogaritet një koeficient mesatar vjetor rreth 146 krime për 100 mijë banorë. Viti 2021 shënon vlerën më të lartë të këtij indikatorit, përkatësisht 196 krime për 100 mijë banorë. Vlera të larta shënon edhe viti 2019, 177 krime për 100 mijë banorë. Vlerën më të ulët të koeficientit të kriminalitetit e shënon viti 2011, me 118 krime për 100 mijë banorë." Pra, të dhënat që unë përdora i kisha marrë nga ky studim.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Nasip Naço.

Nasip Naço – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë.

Të nderuar qytetarë,

Në fillim të fjalës sime, sigurisht, nuk do të rri pa përmendur spekulimet e ditës, të analistëve, të gazetarëve, por edhe të një pjese të kolegëve të opozitës në lidhje me hapjen e zyrës së DEA-s në vendin tonë.

Unë po ju them se duhet të lexoni më shumë, duhet të kërkonit më shumë informacion. Në pak minuta unë do të përpiqem t'ju jap një informacion sa për ta kuptuar që nuk ishte rastësi hapja e zyrës së DEA-s në vendin tonë. Gjatë vizitës sime në SHBA, si ministër i Drejtësisë, në

emër të qeverisë shqiptare, (sigurisht para se të nisesha kam rakorduar me Kryeministrin e vendit për takimet dhe qëndrimin që do të mbaja për aspekte të ndryshme të politikës shqiptare, sepse atje shkoja në emër të qeverisë shqiptare), në takimin që zhvillova një nga kërkesat e mia ndaj drejtuesve të DEA-s ka qenë që, krahas Turqisë, apo hapjes së zyrës në Athinë, të vinin edhe në vendin tonë, pra të kishin edhe një degë në vendin tonë për operacionet e përbashkëta dhe për asistencë teknike, sepse ne kishim nevojë në këtë drejtim. Pavarësisht përpjekjeve të policisë shqiptare, kuptohet që DEA amerikane është në pararojë të luftës kundër narkotikëve, ndaj unë kam kërkuar asistencën e tyre.

Kush nuk e beson këtë mund t'i drejtohet Ministrisë së Jashtme, zyrës së Kryeministrit, sepse kur kam ardhur nga SHBA-të informacionin e kam drejtuar me shkrim, si çdolloj zyrtari kur bën takime jashtë vendit, për të informuar Kryeministrin dhe ministrin e Jashtëm, që edhe në mungesën time, që mund ta bëni edhe ju, mund të kërkonin informacion në Ministrinë e Jashtme dhe ta merrnin zyrtarisht qëndrimin dhe politikën që është ndjekur. Jo vetëm aq, por kam takuar zëvendësprokurorin e Përgjithshëm për reformat që kishim filluar në atë kohë, kam takuar zëvendëssekretarin e Departamentit të Shtetit, të cilët na kanë mbështetur shumë, ku kam kërkuar liberalizimin e vizave dhe heqjen e vizave në emër të qeverisë shqiptare. Sot ju e dini që vizat janë liberalizuar, ato jepen për një periudhë 10-vjeçare, nuk ishte rastësi kjo, nuk ishte rrufe në qiell të pastër, por ishin falë kërkesave të njëpasnjëshme të qeverisë shqiptare, të ministrave në takimet zyrtare që bëheshin në atë kohë.

Për të gjitha këto që them të jeni më se të bindur që keni informacion zyrtar në Ministrinë e Drejtësisë, në Ministrinë e Jashtme dhe në Kryeministri, mund të lexoni shtypin e kohës. Pra, para se të flisni këtu, merrni informacion për të qenë edhe ju seriozë me partnerët tanë ndërkombëtarë, sidomos me SHBA-të, sepse kur ju dëgjojnë që flisni në këtë mënyrë, sigurisht që nuk ju marrin seriozisht. Bëhuni më seriozë në këtë drejtim, sepse janë marrëdhëniet tona me SHBA-të.

Për të vazhduar me rendin e ditës, dua të them se kufijtë e hapur duhet të jenë edhe kufij të sigurt. Kjo marrëveshje ka të bëjë me fqinjët tanë, ka të bëjë edhe me qytetarët tanë që banojnë në

Maqedoninë e Veriut. Në lidhje me marrëdhëniet që ne kemi me këtë shtet, dua të them se që në vitin 1998 është miratuar marrëveshja e parë për ekstradimin që kemi bërë midis dy shteteve, pra kemi qenë në pararojë me disa marrëveshje me Maqedoninë e Veriut, dhe tani vjen për ratifikim marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë.

Sigurisht, hapja e kufijve kërkon siguri, kërkon garanci për të qenë më fleksibël për të kaluar me një sportel. Ju e dini, sepse keni qenë të parët, që në Maqedoninë e Veriut është përdorur vetëm një sportel prej disa vitesh. Këtë eksperiencë e kemi kaluar edhe me Malin e Zi, me Kosovën, kemi kërkuar që ta bëjmë edhe me fqinjët tanë jugorë, me Greqinë. Unë besoj se duhet përshëndetur Ministria e Brendshme për marrëveshjen, duhet inkurajuar për marrëveshje të tjera bashkëpunimi në luftën kundër krimit të organizuar, kundër korrupsionit, kundër krimit të rrugës, krimit të ditës, ministri tha se kemi pasur edhe raste të kalimit të paligjshëm të kufirit, edhe raste të kontrabandës. Sigurisht që këto marrëveshje, duke shkëmbyer informacionin, duke rritur besimin midis kolegëve tanë matanë kufirit dhe këndeje kufirit, u shërbejnë qytetarëve, i shërbejnë integritet të Shqipërisë në BE.

Të nderuar kolegë të opozitës, unë do t'ju lutem që të votoni pro kësaj marrëveshjeje, pasi nuk i shërben mazhorancës, por u shërben të gjithë shqiptarëve.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Fjala për zotin Shehu.

Tritan Shehu – Faleminderit, zonja Kryetare!

Të nderuar kolegë,

Është pozitiv fakti që sot flasim për një marrëveshje me Maqedoninë e Veriut, në vend që të flasim për firmat për “Ballkanin e hapur” apo veprime të tjera, krejtësisht në kundërshtim me interesat tona, interesat e rajonit dhe interesat e shqiptarëve.

Sidoqoftë, unë them se kjo marrëveshje, e cila, në radhë të parë, lidhet me shkëmbimin e informacioneve për luftën kundër krimit, drogës dhe trafiqeve ka shumë rëndësi, absolutisht, dhe duhet mbështetur. Por, nga ana tjetër, unë dua të theksoj se, fatkeqësisht, nuk pres që kjo

marrëveshje do të zgjidhë problemet e mëdha të ballafaqimit me kriminalitetin, me drogën, me trafiket që ka Shqipëria. Fatkeqësisht, situata ka arritur në një pikë të tillë, ku ne në Shqipëri mund të flasim qartësisht jo vetëm për krim të organizuar, jo vetëm për trafikë, por për shtet dhe institucione të kriminalizuara, të cilat në këtë mënyrë kanë bërë dhe bëjnë që Shqipëria të futet në një vorbull të madhe problemesh sociale, rendi, varfërie, bllokimi të ekonomisë.

Sot Kryeministri bëri një deklaratë pozitive, në fakt, e tha zoti Borell-i, sepse Kryeministrit nuk ia bëri goja ta thoshte, që hiqet dorë nga pasaportat e arta, të cilat nuk ishin gjë tjetër veçse një formë e futjes së kriminalitetit në Shqipëri dhe e përdorimit të kësaj metode për ta dëmtuar sigurinë tonë kombëtare në favor të trafikëve dhe elementeve të tjera. Mirë bëri që e tha, por nuk kuptoj diçka, t'ju them të drejtën, kolegë të dashur, sepse sapo zoti Borell-i tha këtë gjë, Kryeministri menjëherë bëri një deklaratë tjetër, e cila për mua ishte krejt e pakuptimtë dhe pa lidhje për një mendje normale, por, siç duket, për Kryeministrin kishte lidhje. Ai deklaroi se do të sjellin në parlament ligjin për kanabisin mjekësor. Të them të drejtën, më erdhi çudi për vendin dhe mënyrën sesi u bë kjo deklaratë, jo për aspiratën për ta mbushur Shqipërinë me kanabisin përsëri, për ta kanabizuar vendin dhe për ta kthyer atë në republikë kanabisi. Prandaj, unë ju them le të gëzohemi sot të gjithë, sepse ajo deklaratë e Kryeministrit na çon dhe na bën, pa dyshim, republikë të kanabisit dhe asgjë tjetër! Një sukses i madh ky për vendin tonë!

Kolegë, të flasim seriozisht!

Impenjimi i Kryeministrit dhe këmbëngulja e tij për të sjellë në parlamentin shqiptar ligjin për kanabisin mjekësor, nuk është gjë tjetër veçse një veprim, i cili kërkon ta kriminalizojë më tepër vendin, i cili kërkon ta kanabizojë vendin, i cili kërkon që Shqipëria të forcohet si një qendër e trafikut të drogës dhe e prodhimit të saj. Ne sot jemi një nga vendet kryesore në Europë për prodhimin e kanabisit. Në vitin 2021 në Shqipëri sipërfaqja e tokës së kultivuar me kanabis ishte 50% më shumë se në vitin 2020. Kjo është një e dhënë e Guardia di Finanza-s italiane. Jemi në një situatë të tillë: në qiellin e Shqipërisë vjen era kanabis, edhe nga shkollat del kanabisi, fëmijët fillojnë të tymosin kanabis që në moshën 13-14 vjeç. Unë po citoj të dhënat e Bankës Botërore, të

cilat thonë qartësisht se fëmijët e shkollave, veçanërisht në qytetet e vogla, nga moshën 13-14 vjeç, 75% e tyre, tymosin kanabis dhe këto janë të vërteta. Kryeministri thotë se do të sjellë ligjin për kanabisin mjekësor.

Të nderuar kolegë, nuk ka kanabis mjekësor dhe duhet ta keni të qartë për këtë gjë. Ka kanabis që quhet kanabis. Kanabisi është një drogë, e cila jep deformime të thella intelektuale, shpeshherë është prekursori i skizofrenisë dhe në 85% të rasteve, sipas pacientëve që janë shtruar në Qendrën Toksikologjike në Tiranë me overdozë, është prekursor i dozave të forta dhe i overdozës. Ky është kanabisi dhe këtu jemi. Përdorimi mjekësor i kanabisit është vetëm në fazat eksperimentale dhe përdoret në fazat terminale të tumoreve, në HIV apo në ndonjë patologji shumë të rëndë, por, absolutisht, nuk ka një përdorim të qartë shkencor. Ne nuk kemi në Shqipëri kapacitete për kërkime shkencore për kanabisin. Tregu evropian nuk ka nevojë për kanabis për kërkime shkencore; tregu evropian e përdor kanabisin si drogë.

Ju e dini që në Itali kanabisi mjekësor, i miratuar nga parlamenti italian, prodhohet në sasi shumë të vogla në plantacione të kontrolluara nga ushtria, sepse përdorimi i tij për elemente shkencore është shumë i kufizuar. Ju mendoni që ne këtu do të jemi në gjendje ta përdorim për kërkime shkencore?! Ju mendoni që Kryeministri do ta përdorë për kërkime shkencore?! Jo, nuk është kështu. Këtu kemi të bëjmë me një provokacion shumë të rëndë ndaj sigurisë kombëtare, këtu kemi të bëjmë me një provokacion shumë të rëndë ndaj shëndetit të qytetarëve dhe ndaj drogës në tërësi që do të përhapet.

Unë dua t'ju them diçka: Maqedonia e Veriut e kaloi këtë fazë, e provoi këtë gjë, por çfarë ndodhi?! Ato plantacione u kthyen në plantacione trafikësh, të dominuara nga grupe kriminale. Ku jemi sot?!

Prandaj, kjo aventurë e re, që kërkon të bëjë Kryeministri, nuk është gjë tjetër veçse kanabizimi i vendit; nuk është gjë tjetër veçse krijimi i asaj që thashë pak më parë, i republikës së kanabisit në Shqipëri.

Pse e bën tani? Nuk është hera e parë, dhe ju e dini shumë mirë këtë gjë. Në prag të çdo zgjedhje Kryeministri lëshon termin "kanabis". Kështu ndodhi në vitet 2014-2015, kështu ndodhi

edhe më tej, kur Shqipëria u mbush me kanabis, i cili shkatërroi bujqësinë, shkatërroi blegtorinë, shkatërroi jetën e qytetarëve dhe i vuri prodhuesit krejtësisht nën terrorin e policisë, e cila i kërcënonte se do t'i dënonte, në qoftë se nuk do t'ia jepnin votën Partisë Socialiste. Ata të shkretët paguanin 10-15 euro për bimë kanabisi që të mos shkatërrohej! Kjo është e vërteta.

Prandaj ktheheni përsëri sot, në prag të zgjedhjeve, te kanabisi, sepse kërkoni që në këtë mënyrë të krijoni një valvul të përkohshme shkarkimi, kërkoni t'i mashtroni qytetarët. Në këtë mënyrë kërkoni të bëni atë që keni bërë gjithmonë në fushata elektorale: të krijoni, pa dyshim, në këtë mënyrë një dëlir të rrezikshëm, që e dëmton shumë jetën e njerëzve.

Të dashur kolegë,

Të miratosh ligjin për kanabisin mjekësor, do të thotë të ndryshosh Kodin Penal. Unë besoj se kjo nuk do të arrihet. Sado që mazhoranca do që ta votojë, nuk besoj se do ta votojë e gjitha, sepse unë besoj në koshiencën dhe në përgjegjshmërinë e shumë deputetëve të mazhorancës, një pjesë e madhe e tyre janë miqtë e mi, por jam i bindur se opozita kurrë nuk do ta votojë diçka të tillë, sepse kanabis mjekësor do të thotë republika e kanabisit për Shqipërinë. Kush ka iluzione të tjera dhe kush mendon ndryshe ose kërkon me qëllim t'i shtojë trafiket në Shqipëri, ose realisht ka ide surrealiste, të papërputhshme me realitetin shqiptar dhe të papërputhshme edhe me realitetin tjetër evropian.

Unë, sinqerisht, u habita sot kur dëgjova deklaratën e Kryeministrit, i cili tha që së shpejti do të sjellin ligjin për kanabisin mjekësor. Sapo tha një fjalë të mirë për tërheqjen nga pasaportat e arta, e imponuar nga institucionet europaine, të them të drejtën, e kuptova që kjo ishte një lojë e rrezikshme; një dëshirë e ngelur për ta çuar Shqipërinë në rrugën e kanabisit, për shtimin e tij, pra për ta çuar Shqipërinë drejt republikës së kanabisit.

Faleminderit!

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Lindita Nikolla – E kemi mbyllur diskutimin për këtë projektligj.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Çfarë procedure?! Ne jemi në fund të diskutimit dhe do të kalojmë te pika tjetër.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Jo, zoti Boçi, nuk ka diskutime për procedurë, ju lutem!

Këtu mbyllet diskutimi për projektligjin...

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Po, e mbyllëm. Zoti Shehu ishte diskutanti i fundit. Uluni në vend, ju lutem!

Kalojmë te pika tjetër, te projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit".

A ka pyetje për projektligjin?! Jo, nuk ka. Atëherë, fillojmë diskutimet me paraqitjen e projektligjit nga nismëtarja.

Zonja Balluku, keni fjalën.

Belinda Balluku – Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit" është një procedurë ndërkombëtare e bazuar në Kodin e Aviacionit Civil, e cila lehtëson operimet midis vendeve kufitare. Kështu, edhe në këtë rast, pasi janë kryer të gjitha veprimtaritë për sa i përket sigurisë ajrore, pasi ka pasur një negociim të gjatë midis dy aviacioneve civile, të Republikës së Shqipërisë dhe atij të Maqedonisë së Veriut, palët kanë dakordësuar për të lejuar pikërisht përdorimin e hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit për t'i lehtësuar kështu uljet dhe ngritjet nga Aeroporti i Shën Palit Apostull i Ohrit. Kjo është një procedurë e vendosur mbi të gjitha konventat ndërkombëtare të aviacionit civil dhe Shqipëria, si një lidere rajonale në fushën e zhvillimit të aviacionit civil, sigurisht, ka kënaqësinë ta mbështesë dhe ta ndihmojë Republikën e Maqedonisë së Veriut në kryerjen e operacioneve të aviacionit.

Gjithashtu, duke qenë se kjo çështje u fol gjatë nga deputetët, gjej rastin që të them edhe njëherë me kënaqësi se dje bordi drejtues i aeroportit të Munihut ka vendosur të marrë përsipër operacionet e aeroportit ndërkombëtar të Vlorës, duke e futur kështu Shqipërinë në një hartë ekselence të operimeve të aviacionit civil. Ky është një lajm i shkëlqyer, pasi tashmë punimet e infrastrukturës në aeroportin e Vlorës janë duke ecur me ritme të shpejta. Ka përfunduar pothuajse totalisht trupi i një piste prej 3,2 kilometrash, e cila do të jetë pista më e gjatë në

Ballkan, duke akomoduar kështu të gjitha fluturimet transoqeanike dhe duke i dhënë mundësinë Vlorës, Shqipërisë, të kthehet në një *hub*, që do t'u shërbejë jo vetëm diasporës shqiptare, por të gjithë qytetarëve të Ballkanit Perëndimor, të cilët do të kenë dëshirë të udhëtojnë në kontinentet e tjera nga Vlora në drejtim të Amerikës, Kanadasë dhe Australisë.

Ndërkohë, duhet thënë që aviacioni civil tashmë në Republikën e Shqipërisë prej vitesh ka një zhvillim të jashtëzakonshëm, duke nisur nga aeroporti i Tiranës, i cili tashmë, pas kontratës së re, të firmosur me koncesionarin shqiptar, ka arritur të ketë pa dyshim një terminal të ri dhe të ketë një menaxhim totalisht të ri cilësor, i cili ndihet që nga viti i kaluar. Gjithashtu, edhe Tirana ka marrë përsipër shtimin e pistës me disa qindra metra dhe një rregullim të tërë të territorit, që do të konsistojë edhe në parkimin e automjeteve, të cilat shpeshherë kthehen në problematike. Pa harruar këtu aeroportin e Kukësit, i cili do të jetë operacional akoma edhe më shumë gjatë verës së vitit 2023.

Ashtu siç kemi publikuar shpeshherë në mediet tona sociale, kompani të reja shtohen çdo ditë në skedulën e aeroportit të Tiranës, duke u përgatitur që në vitin e ardhshëm të kemi 6,4 milionë pasagjerë, krahasuar me vitin 2019, kur kemi pasur vetëm 2,3 milionë pasagjerë. Shqipëria tashmë, me të gjitha investimet në infrastrukturë, në turizëm, në aviacion, në porte, në marina dhe në jahte, po kthehet në një pikë referimi për zhvillimin turistik dhe për zhvillimin infrastrukturor të Ballkanit. Është kënaqësi që në krahun tonë për të zhvilluar aviacionin të kemi emra të mëdhenj ekselence, si aeroporti i Munihut.

Shumë faleminderit për vëmendjen! Besoj që edhe ky projektligj duhet votuar.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Hapim diskutimet.

Fjala për zotin Ismet Beqiraj.

Të përgatitet zoti Belind Këlliçi.

Ismet Beqiraj – E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin, bazuar në nenet 32 dhe 33 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës, pasi shqyrtoi dhe miratoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së

Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit”, ia paraqet për shqyrtim dhe votim Kuvendit, sigurisht, bazuar edhe në nenet 78 dhe 83, pika 1, dhe në nenin 121, pika 1, shkronja “a”, të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr. 43/2016 “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Projektligji është hartuar në përputhje me të gjitha dokumentet ndërkombëtare, konkretisht: me Konventën Ndërkombëtare të Çikagos, e cila është e hapur për nënshkrime nga vendet e saj pjesëmarrëse që më 7 dhjetor 1944, si dhe në aneksin 11 të kësaj kontrate, e cila merret pikërisht me marrëdhëniet ndërshtetërore për sa i përket aviacionit civil.

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, me synim lehtësimin e kryerjes së sigurt të operacioneve të fluturimeve ndërkombëtare përtej kufijve të tyre të përbashkët shtetërorë në Ohër, në aeroportin “Apostulli i Shën Palit”, në interes të përdoruesve të hapësirës ajrore dhe të pasagjerëve të tyre.

Delegimi i shërbimit, në kuptim të këtij projektligji, nënkupton që pala, e cila delegon shërbim, ruan sovranitetin e hapësirës ajrore shqiptare, ndërsa, kur kemi të bëjmë me delegim hapësire, jepet sovraniteti. Në rastin e marrëveshjes në fjalë ruhet sovraniteti i plotë i Republikës së Shqipërisë.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje synon ofrimin e shërbimeve të trafikut ajror sipas standardeve ndërkombëtare dhe praktikave të rekomanduara dhe të vendosura në aneksin 11 të konventës për aviacionin civil ndërkombëtar, Konventa e Çikagos, përgjatë dhe përtej territoreve të tyre përkatëse. Aneksi 11 i Konventës së Çikagos ka të bëjë me krijimin e hapësirës ajrore, me krijimin e njësive dhe shërbimeve të nevojshme për të promovuar një rrjet të sigurt, të rregullt dhe të shpejtë të trafikut ajror. Një dallim i qartë bëhet ndërmjet shërbimit të kontrollit të trafikut ajror, shërbimit të informacionit të fluturimit dhe shërbimit të alarmit.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje palët shqiptare dhe maqedonase bien dakord që përgjegjësia për kontrollin e trafikut ajror do të transferohet nga një njësi e shërbimit të trafikut ajror e shtetit delegues në një njësi tjetër të shërbimit të trafikut ajror në një shtet ofrues fqinj,

sipas dispozitave të përcaktuara në aneksin 11 dhe sipas kushteve të kësaj marrëveshjeje. Shteti delegues bie dakord që njësia përkatëse e shërbimit të trafikut ajror e shtetit ofruet të ofrojë shërbime të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore të shtetit delegues, në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje.

Rregullat dhe procedurat që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimit të trafikut ajror në shtetin ofruet do të zbatohen kur ky shërbim të ofrohet në një pjesë të hapësirës ajrore të shtetit delegues. Për këtë qëllim marrëveshja parashikon mundësinë që shtetet kontraktuese t'i autorizojnë njësitë e tyre përkatëse të shërbimit të trafikut ajror për të përfunduar letërmarrëveshjet e tipit "LOA"

Sipas marrëveshjes, shteti delegues dhe shteti ofruet mundësohen të marrin përsipër ofrimin e shërbimit sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshje dhe sipas marrëveshjes që mund të lidhet ndërmjet njësive përkatëse të autoritetit të ofrimit të shërbimeve të trafikut ajror të Republikës së Shqipërisë, që e delegon, dhe atij që e ofron në nivel operacional.

Marrëveshja parashikon, gjithashtu, se autoritetet e aviacionit civil të të dyja vendeve autorizohen të hyjnë në marrëveshje mes tyre lidhur me mbikëqyrjen e operacioneve sipas objektit të marrëveshjes bazë. Konkretisht, marrëveshja bën një rregullim të posaçëm të marrëdhënies, ose të mundësisë që palët të mund të lidhin një marrëveshje të posaçme në nivelin rregullator, pra aviacioni civil shqiptar dhe ai përkatës i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me qëllim mbikëqyrjen e të gjithë veprimtarisë që ndodh në kuadër të kësaj marrëveshjeje, plus të gjithë veprimtarinë që ofrohet nga njësia e ofrimit të shërbimit të shtetit ofruet.

Si shteti delegues, ashtu edhe ai ofruet do ta informojnë njëri-tjetrin për çdo ndryshim në statusin operacional të objekteve të tyre të komunikimit dhe/ose të lundrimit, që mund të kenë ndikim në ofrimin e shërbimit të trafikut ajror apo në pjesën e hapësirës ajrore, brenda së cilës është përgjegjësia për të deleguar ofrimin e shërbimit të trafikut ajror.

Shteti ofruet do të jetë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga neglizhenca e tij, ose e agjentëve të tij, ose çdo personi tjetër që vepron në emër të tij, sipas dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje do të realizohet edhe hetimi i aksidenteve apo

incidenteve të rënda. Një shtet delegues do të fillojë një hetim për rrethanat e aksidenteve ose incidenteve serioze që ndodhin në territorin e tij. Me kërkesën e tij shtetit delegues do t'i sigurohen materialet e nevojshme nga njësia e shërbimit të trafikut ajror të shtetit ofruet për t'i mundësuar atij të kryejë një hetim për një aksident ose incident të rëndë që ka ndodhur në territorin e shtetit delegues. Shtetit ofruet do t'i jepet mundësia të caktojë vëzhgues, që të jenë të pranishëm në hetim dhe shteti delegues do t'ia komunikojë raportin dhe gjetjet e hetimit atij shteti. Certifikimi teknik dhe të gjitha standardet janë ato që janë përcaktuar në marrëveshjet ndërkombëtare. Në këtë kuptim, palët ruajnë të drejtën që, në lidhje me incidente apo problematika, të cilat mund të lindin gjatë zbatimit të marrëveshjes, të mund t'ia raportojnë njëra-tjetrës dhe t'i zgjidhin me marrëveshje fillimisht dhe, në qoftë se ato nuk janë të mundura, secila prej palëve mundet me një njoftim paraprak 6-mujor ta zgjidhë këtë marrëveshje duke i përfunduar efektet e saj.

Në aspektin formal projektligji përbëhet nga 2 nene dhe teksti i marrëveshjes bashkëlidhur.

Ky projektligj nuk për afron asnjë akt të legjislacionit të Bashkimit European.

Zbatimi i projektligjit nuk sjell efekte financiare shitesë në buxhetin e shtetit, pasi secila palë i merr përsipër të gjitha veprimet që do të kryhen.

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin vlerësoi rëndësinë që ka kjo marrëveshje për delegimin e shërbimeve ajrore në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit, e cila do të sjellë siguri më të lartë në operimin e fluturimeve ndërkombëtare të këtij aeroporti, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve, në mënyrë të veçantë për pasagjerët, si segment i rëndësishëm në treg dhe turizëm.

Për sa më sipër, ju ftojme ta votojmë njëzëri këtë projektligj.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Belind Këlliçi.

Belind Këlliçi – Të nderuar qytetarë,
Përsëndetje!

Në fakt, jam sot në këtë foltore për të bërë publike disa dokumente ekskluzive, të cilat nuk janë bërë publike më parë për pavarësinë e

medieve në Shqipëri dhe për një nga aferat më të mëdha në vend: ajo e inceneratorëve.

Sot kam parë në portale, në portalin e Karlo Bolinos, medias së pavarur që drejtohet prej tij, se kishte shpërndarë një sihariq dhe ishte shqetësuar pse unë kohët e fundit paskam filluar të jem aktiv në rrjetet sociale, në *Facebook*! Mirë që na censurojnë mediet dhe nuk na japin mundësinë të flasim para qytetarëve, por, tashmë, shqetësohen, shqetësohet pronari i një medieje pse unë kam bërë disa reklama në rrjetin social, *Facebook*. Tani do të thoni ju pse shqetësohet Karlo Bolino?!

Lindita Nikolla – Zoti Këlliçi, jemi duke diskutuar për ratifikimin e marrëveshjes.

Belind Këlliçi – Po, zonja Kryetare, më lër, patjetër që ka lidhje të drejtpërdrejt me marrëveshjen që po diskutohet.

I bëj me dije publikut këtë faturë, që daton më 14.04.2021, të cilën e faturon “MTSC” sh.p.k dhe blerës është “Integrated Energy BVSPV”, që ta kuptoni ju pse është shqetësuar Karlo Bolino. Por çfarë është “MTSC-ja”? Sipas QKB-së, “MTSC”-ja, e themeluar në vitin 2015, është veprimtaria e shoqërisë për aktivitetet në fushën e transmetimeve radiotelevizive me pronësi 100% të Karlo Bolinos. Çfarë është “Integrated Energy BVSPV”?

(Tregon foto.)

Është kjo kompania këtu, “GeoGenix”, që është e regjistruar në një parajsë fiskale...

Lindita Nikolla – Ju lutem, zoti Këlliçi, përmbajuni temës, sepse jemi për të diskutuar...

Belind Këlliçi – Një minutë, sepse doli inceneratori i Tiranës, i cili është incenerator...

Lindita Nikolla – Ju lutem, flisni për marrëveshjen e trafikut ajror!

Belind Këlliçi – Po, patjetër, për transportin, për trafikun ajror, për kanabisin, për të gjitha, edhe për inceneratorin do të flasim. Do të dal aty në fund, e nderuar Kryetare!

Por çfarë është inceneratori i Tiranës?! Është ky këtu, me firmë dhe me vulë të Bashkisë së Tiranës, që quhet Erion Veliaj, i cili ka firmosur në mars të vitit 2017...

Lindita Nikolla – Ju lutem, do të më detyroni t’jua heq fjalën!

Belind Këlliçi – U shqetësuar, sepse ju përmend emri?!

Lindita Nikolla – Ju lutem, jeni jashtë rendit të ditës!

Belind Këlliçi – Në muajin mars të viti 2017 ka dhënë dakordësinë për inceneratorin e Tiranës. I bëj thirrje SPAK-ut (Prokurorisë së Posaçme Antikorrupsion) të administrojë këto dy dokumente, të cilat do t’i bëj sot zyrtare për herë të parë. Uroj që, kur kanë sekuestruar materialet në shtëpinë e Klodian Zotos, të mos i kenë harruar diku këto *email*-e. *Email*-i i parë i datës 17.04.2021 është dërguar nga zonja Julia Muça, përfaqësuese e Stela Gugalljas, te Klodian Zotoja, ku “Cc” është Denisa Tollkuçi, përfaqësuese e Klodian Zotos. *Email*-i thotë: “Po ju nis faturën e “Report TV”-së, sepse ka një ndryshim, me sa më tha Matilda, që kanë kërkuar buxhet shtesë me rastin e fushatës.” Çfarë fushate ka pasur më 17 prill të vitit 2021?! Besoj se qytetarët e dinë që ka qenë fushata e zgjedhjeve të përgjithshme. Kush kërkonte buxhet shtesë për fushatën?! Cili incenerator është i regjistruar tek “Integrated Energy BVSPV”?! Është inceneratori i Tiranës. Kush është mbrapa?!

Është Erion Veliaj. Kush ka qenë drejtues politik në Tiranë në vitin 2021?! Erion Veliaj. Cila është përgjigja që kanë marrë nga Klodian Zoto?! Është vetëm “po”. Urdhëro, në orën 14:55, datë 17.04.2021.

(Tregon foto.)

Kjo “po”-ja, është kjo fatura këtu, që janë vetëm 10 mijë euro (këta 10 mijë euro i kanë lekë xhepi), të cilat Erion Veliaj, përmes inceneratorit të Tiranës, ia paguan Karlo Bolinos. Tani, ky është shembulli konkret sesi mediet në këtë vend paguhen me paratë e qytetarëve, me paratë e taksapaguesve të Tiranës dhe se si kontrollohet media në këtë vend.

Meqenëse Karlo Bolinoja u shqetësua sot për *Facebook*-un tim, i bëj një pyetje Karlo Bolinos: a është shqetësuar ndonjëherë për një ish-ministër të qeverisë së Kryeministrit Edi Rama, i cili në vitin 2014 deklaroi se dasmën në kala e bëri me kursimet e pensionit të mamasë, 500 milionë lekë?! A i ka bërë ndonjëherë përshtypje kjo deklaratë, apo jo, sepse mund ta hetojë këtë pensionin e mamasë, 500 milionë lekë?! Nëse Karlo Bolinoja pretendon se unë gënjej për këto dokumente, që i kam bërë sot publike, të më hedhë në gjyq për shpifje, të shkojmë në gjyq dhe të vijë të japë përgjigje: a është media e tij, e drejtuar prej tij dhe në pronësi të tij, e paguar dhe e ushqyer nga paratë e

inceneratorit të Tiranës? A merr para Karlo Bolinoja nga inceneratori i Tiranës: po, apo jo?

Meqenëse rrallëherë na qëllon që ta kemi Kryeministrin këtu (në fakt, e kam pasur edhe në komision hetimor dhe kam folur), dua të di si shpjegohet, zoti Kryeministër, që këtë personin, i cili quhet Klodian Zoto që ju e lavdëruat, e shpallët edhe bashkëpronar të revolucionit tuaj mjedisor në Shqipëri dhe në Tiranë, e keni në kërkim ndërkombëtar?! Silleni more, na e sillni në parlament, na e sillni këtu në krye të vendit që të krenoheni për këtë arritje të madhe që i keni bërë vendit dhe qytetarëve të Tiranës me inceneratorin e Tiranës, sepse paguajmë 80 mijë euro në ditë për një shërbim që nuk ekziston. Kur ky qenka kaq i suksesshëm, kur inceneratori i Tiranës qenka një mjet kaq i domosdoshëm për qytetarët e vendit, për qytetarët e Tiranës, kur po i shërben kaq mirë kryeqytetit, pse, more, e keni shpallur në kërkim ndërkombëtar këtë?! Silleni këtu dhe krenohuni me të.

Sigurisht, përgjigjet janë të gjitha të qarta dhe pyetjet janë të gjitha retorike. Të gjithë qytetarët e dinë tashmë që afera e inceneratorit të Tiranës po mbahet peng; po mbahet peng zbardhja nga ana e Kryeministrit këtu, sepse, nëse i shkohet deri në fund kësaj afere, patjetër, zoti Kryeministër, që aty del Benjamini yt, Erion Veliaj, sepse është me letra, me firmë dhe me vulë, por bën vaki, mund të dalësh edhe ti mbrapa.

Ajo që më bëri përshtypje sot, është si ka mundësi që këta shqetësohen edhe kur një kandidat i opozitës të vetmin medium të komunikimit publik ka mundësinë të aksesojë në rrjetet sociale, *Facebook*?! Pra, u shqetësuan këta për fondet, sepse paskam bërë unë reklamë në *Facebook*! I garantoj Karlo Bolinos edhe Erion Veliajt (sepse nuk di nëse Kryeministri e ka ndarë mendjen që ta kandidojë akoma, por uroj ta kemi në garën e Tiranës)...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Mos qesh, çfarë ke?! Rri i qetë!

U garantoj që unë do t'i bëj publike dhe transparente të gjitha burimet financiare të fushatës sime. Kërkoj dhe uroj që Erion Veliaj dhe të gjithë kandidatët e tjerë të Partisë Socialiste t'i bëjnë publike të gjitha mjetet financiare, me të cilat financojnë fushatat e tyre, duke nisur nga ajo shfaqja e shëmtuar e pak ditëve më parë, që kushtonte qindra mijëra euro në lançimin e mashtrimeve të Bashkisë së Tiranë dhe të një

plani pune për dekadën e ardhshme, që do të mbetet imagjinar, sepse jam i bindur që më 14 maj qytetarët e Tiranës do t'i japin Erion Veliajt përgjigjen e merituar, së bashku me Karlo Bolinon, me pronarët e inceneratorëve dhe me të gjithë të tjerët bashkë.

Ju faleminderit!

Lindita Nikolla – Këtu mbyllet diskutimi për projektligjin.

Në rendin e ditës janë edhe 5 projektvendime:

Projektvendimi “Për zgjedhjen e një anëtari të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”.

Projektvendimi “Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 11/2021 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (ISKK)””.

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar””.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar””.

Projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar””.

Këto projektvendime janë pa diskutime.

Këtu mbyllet debatet për çështjet e sotme.

Ju lutem, bëhuni gati për procesin e votimit!

Jemi futur në procesin e votimit.

Po, zoti Gështenja.

Lefter Gështenja – Faleminderit, zonja Nikolla!

Meqenëse do të kalojmë në votim, dua të bëj disa sqarime edhe një herë në lidhje me një projektligj shumë të rëndësishëm, siç është ai për Kodin Rrugor. Meqenëse kishte disa paqartësi, më duhet të sqaroj dhe të kërkoj votën e kësaj mazhorance, edhe pse herë të tjera nuk e ka dhënë, mbështetjen e saj për këtë projektligj.

Dua të them shkurtimisht se ku konsiston propozimi i grupit parlamentar. Pas shumë diskutimeve në komision, ne e kemi gjetur gjuhën

me njeri-tjetrin dhe kemi rënë dakord për pikat që kemi kaluar sot në projektligj. Ku konsiston propozimi? Ulja e vlerës së gjobave me 50%, heqja e shërbimeve policore ose e postblloqeve.

Në Kodin Rrugor propozohet që, minimalisht 50 % e vendparkimeve në akset kryesore në bashki të jenë publike, pa pagesë. Shpejtësia maksimale e qarkullimit në autostrada të jetë jo më shumë se 130 kilometra në përputhje me standardet europiane. Propozohet rritja e afatit të kohës së pagesës nga 5 ditë, që është deri më sot, në 15 ditë. Ndërkohë që ulet 50% vlera e pagesës sipas gjobës. Të gjitha këto ndryshime besoj se u shërbejnë qytetarëve dhe jo politikës.

Edhe një herë, kërkoj që kjo mazhorancë ta mbështesë dhe ta votojë këtë projektligj, pasi është në shërbim të qytetarëve.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Faleminderit!

Bëhemi gati për procesin e votimit.

Hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi për prezencën.

106 deputetë janë prezentë.

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritetit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian””. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

110 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 3 deri te neni 17 miratohen me të njëjtë procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë. Ju lutem, votoni!

Mbyllet votimi.

109 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

Projektligji miratohet.

Kalojmë te projektligji “Për bletarinë”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash.

Urdhëroni, zonja Xhixho!

Erisa Xhixho – Zonja Kryetare, kemi një propozim për këtë ligj. Kemi një amendament të zonjës Kryemadhi, i cili duhet të votohet, sepse nuk është pjesë e procesit, ndërkohë që është depozituar. Pra, kërkojmë të hidhet në votim amendamenti i zonjës Kryemadhi për projektligjin “Për integrimin Europian”.

Faleminderit!

Lindita Nikolla – Duhej ta kishit paraqitur amendamentin, sepse u votua nen për nen dhe në tërësi. Ne tani jemi te projektligji “Për bletarinë”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

97 vota pro, 2 abstenim, 6 kundër.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 3 deri te neni 36 miratohen me të njëjtë procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Ju lutem, zoti Majko, votoni!

Mbyllet votimi.

99 vota pro, 2 abstenim, 6 kundër.

Po, zoti Vasili.

Petril Vasili – Zonja Kryetare, duhet ta dini që e gjithë procedura për të miratuar ndryshime administrohet nga ju dhe nuk administrohet nga deputetët.

Në lidhje me ligjin e mëparshëm, jeni në shkelje të hapur të Rregullores, pasi propozimi në lidhje me ligjin përkatës është prezantuar edhe në komisionet parlamentare dhe është detyrimi i seancës ta votojë pro apo kundër, pra është në diskrecionin e të gjithë deputetëve, por ju nuk keni asnjë të drejtë të mos e hidhni në votë. Projektligji është prezantuar dhe nuk mundet që një projektligj, i cili ka filluar edhe rrugën e tij dhe ka kaluar, të mos i nënshtrohet votimit. Kjo është një shkelje e hapur.

Lindita Nikolla – Ju bëj me dije...

Petril Vasili – Më falni, por nuk kam mbaruar. Kjo është koha ime.

Ju morët përsipër ta na e kalonit... Nuk është pjesë e kësaj ane, por është juaja ta administroni situatën. Ai që e ka paraqitur, jep opinionin e tij dhe salla shprehet me votë, por nuk keni të drejtë të thoni: “Meqenëse nuk po flisni...”. Nuk kemi pse të flasim ne nga vendi, sepse e organizoni ju procedurën.

Lindita Nikolla – Patjetër.

Ju bëj me dije se nisma është paraqitur në komision dhe është rrëzuar edhe në komision. Nuk ka asnjë nismë tjetër të paraqitur në raportin e komisionit. Komisioni ka paraqitur raportin e tij, nenet përkatëse dhe të gjitha u votuan në parim dhe në tërësi.

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Po, pra, ta dhashë sqarimin: nisma është rrëzuar që në komision.

Kalojmë te projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë””. Ky akt kërkon shumicë të cilësuar votash. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

102 vota pro, 1 abstenim, 6 kundër.

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të komisionit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Nga neni 3 deri te neni 21 miratohen me të njëjtë procedurë votimi.)

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

101 vota pro, 1 abstenim, 6 kundër.

Projektligji miratohet.

Vazhdojmë me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për krijimin e task-forcave të përbashkëta në fushën e sigurisë”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

104 vota pro, 4 abstenim, asnjë kundër.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

101 vota pro, 5 abstenim, asnjë kundër.

Miratohet në tërësi projektligji.

Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për delegimin e shërbimeve të trafikut ajror në një pjesë të hapësirës ajrore mbi liqenin e Ohrit”. Ky akt kërkon shumicë absolute votash për miratim. Procedura e votimit: dy votime me elektronikë. Votimi është i hapur.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

103 vota pro, 5 abstenim, asnjë kundër.

Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen me kartonë, sipas variantit të propozuesit.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi në tërësi me elektronikë.

Ju lutem, zonja Kushi, votoni!

Mbyllet votimi.

103 vota pro, 6 abstenim, asnjë kundër.

Miratohet në tërësi projektligji.

Projektvendimi “Për zgjedhjen e një anëtari të bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare”, ku është propozuar zoti Edlir Gjata. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i mbyllur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

92 vota pro, 4 abstenim, 1 kundër.

Miratohet projektvendimi.

Projektvendimi “Për disa shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 11/2021 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri

(ISKK)”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

101 vota pro, 1 abstenim, 2 kundër.

Projektvendimi miratohet.

Kalojmë te projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 95/2016 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe klasifikimin e pagave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit”, i ndryshuar”. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

101 vota pro, 1 abstenim, 2 kundër.

Projektvendimi miratohet.

Kalojmë te projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”. Deputeti Gëzim Ademaj caktohet anëtar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuuese, Tregtinë dhe Mjedisin. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

103 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

Projektvendimi miratohet.

Kalojmë te projektvendimi “Për një ndryshim në vendimin nr. 69/2021 “Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit”, i ndryshuar”.

Deputeti Petrit Dodaj caktohet anëtar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Ky akt kërkon shumicë të thjeshtë votash. Votimi është i hapur. Procedura e votimit: një votim me elektronikë.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

105 vota pro, asnjë abstenim, asnjë kundër.

Projektvendimi miratohet.

Këtu mbyllet procesi i votimit.

Kalojmë në diskutimet për çështje jashtë rendit të ditës.

Zoti Lefter Gështhenja, a do të flisni?

Zoti Leskaj...

Ju lutem, kolegë, ju që do të lëvizni, lëvizni më shpejt, sepse do të vijojmë!

Zoti Leskaj, fjala për ju.

E dini që 5 minuta keni në dispozicion?

Bujar Leskaj – Nuk ka problem, zonja Kryetare, por jo me kursim minutat, sepse, të paktën për çështjet jashtë rendit të ditës, ju personalisht ua keni shumë borxh jo vetëm qytetareve të zonës që unë përfaqësoj, të qarkut të Vlorës, por edhe të gjithë Shqipërisë, sepse 4-5 seanca i keni djegur, ndoshta jo vetëm për fajin tuaj, megjithatë nuk ka rëndësi.

Sot dua të flas për problemet e infrastrukturës në qytetin tim, qytetin e Vlorës dhe në qytetin e Selenicës. Edhe pse vitet e fundit Vlora ka njohur shumë investime në infrastrukturën rrugore, sipas propagandës suaj, në vlera të mëdha dhe me eficiencë, por në mendimin e qytetarëve vlonjatë pa eficiencë dhe me ekonomicitet të ulët, në thelb Vlora dhe lagjet e saj periferike, njësitë e saj administrative, si dhe fshatrat e Bashkisë së Selenicës vazhdojnë të paraqesin problematika të theksuara për sa u përket rrugëve, furnizimit me ujë të pijshëm e të tjera.

Nuk do të flas sot, megjithëse duhet ulëritur, për tjetërsimin e Sheshit të Flamurit dhe për përgjysmimin e sipërfaqes së tij; as për sheshin e “Skelës”, ku piramidat prej dheu mbulojnë pamjen e detit dhe Shtëpinë e Pavarësisë; as për sheshin përpara bashkisë, që njihet në Vlorë si sheshi që duhej t’i dedikohej Luftës së Vlorës të vitit 1920, i cili është betonizuar totalisht; as për dy lagjet e vjetra të Vlorës, “Çlirim” dhe “Karabash”, që u mbyllet dalja, duke ua vështirësuar jetën qytetarëve. Nuk do të flas për historinë dhe traditën e Vlorës, e cila, në emër të modernizimit, u shkatërrua. Natyrisht, nuk kam minuta, siç thotë Kryetarja, që të flas për 90 mijë eurot në ditë për TEC-et lundruese, të cilat nuk funksionojnë.

Sot duhet të flas për një panoramë aspak normale, e cila shfaqet që në hyrje të qytetit: një numër i madh rrugësh dhe lagjesh të qytetit të Vlorës të lëna në harresë totale nga institucionet vendore, lagje me rrugë të amortizuara, shpeshherë të paasfaltuara, pa ndriçim dhe pa kanalizime. Pamje të tilla të shoqërojnë gjatë gjithë qytetit, sigurisht, jo në Lungomare apo në bulevardin Vlorë-Skelë, por në lagje jashtë fasadës së bukur. Tashmë edhe në bulevardin

Vlorë-Skelë shikohet çdo ditë nga të gjithë që makinat futen në një rrugë shumë të ngushtë.

Gjatë kësaj periudhe kandidati i PD-së për Bashkinë e Vlorës, zoti Hysni Sharra, të cilit gjej rastin t'i uroj fitoren më 14 maj (dhe besoj në fitoren e tij, besoj në fushatën e tij të ndershme dhe me alternativa), ka denoncuar në medie shumë problematika të qytetit të Vlorës: kanalet e hapura në lagjet "4 Heronjtë", "24 Maji", "10 Korriku" dhe "Hajro Çakëri", infrastrukturën e dëmtuar në zonën e ish-fabrikës së çimentos, ku me qindra familje vijnë jetesën me mungesën totale të kushteve infrastrukturore, pa rrugë, pa kanalizime, pa ujë, pa ndriçime dhe me mbetjet urbane, të cilat grumbullohen në vende të paautorizuar.

Zoti Sharra, në denoncimet e tij është ndalur në rrugën "Lef Sallata" (ish-rruga Arcobaleno), vetëm një kilometër larg qendrës së qytetit, dhe në rrugët lidhëse me të, të cilat janë në gjendje të mjeruar: gropa, baltë, male me mbeturina, njerëz që largohen dhe aktivitete që mbyllen. Kanë filluar punimet, por rezultati është: banorëve u janë rrëzuar muret rrethuese të shtëpive; punimet nuk përfundojnë, duke sjellë kaos dhe vështirësi pa fund në përditshmërinë e qytetarëve dhe në fund një asfalt elektoral.

Po ashtu, Pylli i Sodës, mushkëria e gjelbër e qytetit të Vlorës, kjo pasuri e jashtëzakonshme, është në gjendje të rëndë: papastërti, mbetje urbane e inerte të hedhura andej-këtej, duke i shtuar kësaj edhe derdhjen në det të ujërave të zeza nga hidrovori, ku aroma e keqe e bën akoma më të vështirë situatën, dëmi mjedisor, shëndetësor e turistik është i pakthyeshëm.

Mungesa totale e vëmendjes së institucioneve qendrore dhe vendore, përjashtojmë këtu asfaltin elektoral, sa herë jemi në prag zgjedhjesh, është programi i vetëm që është implementuar në këta 10 vjet, kryesisht në njësitë administrative të Bashkisë së Selenicës, në njësitë administrative dhe në lagjet periferike të Bashkisë së Vlorës.

Qytetarët e Vlorës dhe të Selenicës ankohen për furnizimin me ujë të pijshëm, edhe pse flitet sa herë ka zgjedhje. Në shumicën e fshatrave të Bashkisë së Selenicës, në njësitë administrative të Bashkisë së Vlorës, në shumicën e lagjeve të Vlorës, furnizimi me ujë të pijshëm, që nuk pihet, për hir të së vërtetës, është me orar. Njësitë, si Orikumi dhe Radhima, zona me turizëm të lartë

gjatë muajve të verës, vuajnë nga mungesa e ujit të pijshëm, por edhe e energjisë elektrike, sa herë që prishet pak koha. I njëjti problem është edhe për fshatrat Babiçë e Madhe, Babiçë e Vogël, Alikokë, Xhyherinë dhe Kaninë.

Fshatrat e Njësisë Administrative Qendër: Cerkovinë, Trevllazër, Panaja, Skrofotinë, Novoselë, Akërni, Bishan, si kultivuese të ullirit dhe prodhuese të njohura të vajit të ullirit dhe vreshtarisë, fshatra me njerëz shumë punëtorë, prej vitesh nuk po njohin asnjë ndihmë, subvencione, grante apo mbështetje financiare nga shteti.

Në fshatrat Alikokë, Babiçë, Xhyherinë, Kaninë, qindra banorë të prekur nga kalimi i bajpasit ende nuk janë dëmshpërblyer, për shkak të burokracisë dhe inefficiencës së institucioneve tona.

Nga takimet që kam pasur me banorët e këtyre zonave, disa nga problemet e tyre të mprehta janë:

1. Selenica prej vitesh kërkon ndërtimin e lotit 4 dhe urës që e lidh me aksin Levan–Tepelenë.

2. Segmenti rrugor rreth 20 kilometra i gjatë, i cili fillon nga rruga e Lumit të Vlorës, më pas për 9 kilometra në Velçë, Ramicë, Matogjin, Bashaj dhe përfundon në Vërmik, është totalisht i amortizuar. Mungesa e investimeve, mungesa e aksesit për këto fshatra, ka sjellë braktisjen totale nga banorët. Dikur kanë qenë mbi 1000 familje, sot janë 400.

3. Fshatrat e Selenicës kanë rrugë totalisht të parahabilituara, totalisht të amortizuara, ashtu siç është segmenti rrugor që fillon nga Vllahina dhe përfundon në Amonicë dhe më pas lidhet edhe me Sevasterin. Rruga sot është bërë shkak që fshatrat, si: Gërnci, Mallkeqi, Lezhani, Amonica të jenë pothuajse të izoluara e të lëna në varfëri.

4. 25 kilometra rrugë, e cila fillon në Vllahinë dhe përfundon në Poçem, segment rrugor i cili lidhet më pas me Levan – Tepelenën, mund të shërbente si një korridor për fshatrat dhe vetë Vlorën. Sot rruga gjendet në të njëjtën gjendje si në kohën e sistemit të "qoftëlargut", ku askush nuk është kujtuar për të dhe mbi 2000 familje janë të izoluara.

5. Janë dhjetëra puse naftë në fshatrat Koçul dhe Gorisht, miliona lekë, madje miliona euro të përfituara nga shitja e naftës, por asnjë lek nuk investohet për fshatrat në fjalë. Rinia largohet çdo

ditë nga këto fshatra, sepse mungojnë vendet e punës dhe perspektiva.

6. Shumica e fshatrave të Bashkisë së Selenicës furnizohen me më pak se 30 minuta ujë në ditë. Banorët mundohen të furnizohen me ujë si në mesjetë, ndërkohë që ujësjellësi është kthyer në institucion ku vegjetojnë rrogëtarët militantë të sektit në pushtet.

7. Mbetjet urbane digjen nëpër fshatra dhe ndotja është një tjetër problem për banorët dhe ekosistemin e zonave.

8. Akset rrugore dëmtohen nga rrëshqitja e gurëve dhe e dherave, nga gërryerja e rrugëve që lidhin fshatrat, si në rastin e njësisë Sevaster, me qytetin e Vlorës, sidomos gjatë sezonit të reshjeve të shiut.

Këto problematika janë ngritur edhe në takime me qytetarët e qytetit të Selenicës dhe të Lumit të Vlorës, takime të organizuara nga kandidati i Partisë Demokratike, zoti Leonard Rakipaj, të cilit gjithashtu i uroj suksese!

Gjithashtu, në njësinë administrative të Vlorës, fshati Akërni, 20 kilometra larg Vlorës...

Lindita Nikolla – Ju lutem, sepse i kaluat edhe 3 minuta.

Bujar Leskaj – Edhe 30 sekonda.

Fshati Akërni, 20 kilometra larg Vlorës, ka probleme të theksuara në furnizimin me ujë të pijshëm, megjithëse kjo zonë është shumë pranë vendit, ku zbatohet projekti i aeroportit të Vlorës dhe ujësjellësi i zonës dhe stacioni i pompave të furnizimit me ujë ndodhet vetëm 1,5 kilometra larg fshatit.

Të nderuar kolegë,

Ju pak që jeni në sallë, ju falënderoj për vëmendjen!

E nderuar zonja Kryetare, faleminderit për këto 3 minuta e 40 sekonda që më dhatë tepër!

Këto ishin disa nga problematikat, të cilat kam hasur e më kanë parashtruar qytetarët vlonjatë dhe banorët e zonës së Selenicës. Pavarësisht përpjekjeve pozitive që bëjnë deputetët vlonjatë të partisë në pushtet, problemet janë të shumta, bëhen edhe më të mprehta, sepse mungon dëshira dhe vullneti i mirë për t'u zgjidhur nga qeveria dhe nga sektit në pushtet.

Faleminderit, zonja Kryetare!

Lindita Nikolla – Fjala për zotin Isuf Çelaj.
(Ndërrhyrje pa mikrofon).

Jo.

Atëherë, këtu mbyllet seanca.

Seanca e radhës do t'ju njoftohet.

Faleminderit!

Natën e mirë!

(Seanca u mbyll në orën 20:00)

Kryetarja e Kuvendit

Lindita Nikolla

**Sekretare e Sekretariatit për
Procedurat, Votimin dhe Etikën
Klotilda Bushka**

**Drejtoresha e Shërbimit të Redaktorëve
Suela Bala**